

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 10 dhe 11. 5. 2007**

**TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 10. i 11. 05. 2007. GODINE**

MAJ - MAJA 2007

RENDI DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 prillit 2007,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006,
7. Debat për arsimin fillor dhe të mesmin,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës,
9. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për formimin e Këshillit të Ujërave,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për t'ia kthyer Qeverisë së Kosovës Projektligjin për ndërmjetësim për ripunim.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika plenarne sednice od 27 aprila 2007.god.
3. Vreme za parlamentarna pitanja,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o trgovačkom društvu,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju zaraznih bolesti,
6. Razmatranje finansijskog izveštaja MEF-a o troškovima u 2006.godini,
7. Rasprava o osnovnom i srednjem obrazovanju,
8. Razmatranje preporuke komisije za privredu, trgovinu i industriju o imenovanju članova komisije za konkurenciju,
9. Razmatranje predloga Komisije za poljoprivredu, šumarstvo i razvoj sela o formiranju Odbora za vode,
10. Razmatranje preporuke Komisije za pravosuđe, zakonodavstvo i Ustavni Okvir o vraćanju Nacrta zakona o posredovanju Vladi Kosova na doradu.

KRYETARI KOLË BERISHA - Të nderuar deputetë. Të nderuar ministra dhe Kabinet Qeveritar. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 77 deputetë, që do të thotë se ekziston mundësia që të fillojmë me punë.

Prandaj, propozoj që të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Paraprakisht ju njoftoj se kemi një grup të ri parlamentar - Grupin e LDD-ës dhe i dëshiroj mirëseardhje.

Në pajtim me rregullën 6 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Me qenë se deri në fillim të kësaj seance asnjë nga grupet parlamentare nuk ka bërë propozim me shkrim për ndryshimin e agjendës, konsiderohet se rendi i ditës i propozuar është i miratuar sipas rregullës 23.2.

Urdhëro Safete Hadërgjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ - Faleminderit z. kryetar. Të nderuar deputetë. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen, të cilën e ka mbajt dje pasdite, ka kërkuar që të diskutohet edhe rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Sipas nenit 41.1 pika a) e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, jo më vonë se më 31 mars, ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, duhet t'i dorëzojë Kuvendit raportin përfundimtar të buxhetit për vitin e kaluar fiskal. Deputetëve ky raport u është shpërndarë me datën 13 prill 2007. Komisioni për Buxhet dhe Financa, më datën 17 prill 2007 ka pasur si pikë të vetme të rendit të ditës- Shqyrtimin e raportit financiar apo pasqyrave financiare për vitin 2006. Komisioni për Buxhet në pajtim me rregullën 44 pika 9 i ka bërë ftesë me kohë ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ku do të shqyrtohen pasqyrat financiare.

Ministri ose zëvendësministri, po as ministri, janë të obliguar që të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit për Buxhet, kur është fjala për shqyrtimin e raporteve financiare. Ftesa i është bërë me kohë, kurse ministri dhe as zëvendësministri nuk kanë marrë pjesë në këtë mbledhje të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe nuk kanë paralajmëruar mospjesëmarrjen. Komisioni nuk ka mundur t'i shqyrtojë pasqyrat financiare ,pa qenë ministri ose zëvendësministri dhe ka bërë një informatë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Me qenë se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka shqyrtuar raportin financiar, nuk ka pasur mundësi të bëjë rekomandime sipas praktikës dhe sipas asaj që kërkon rregulla 51 pikë 3 e Rregullores së punës së Kuvendit. Kryesia në bazë të informatës, të cilën Komisioni ia ka dërguar për mospjesëmarrjen e ministrit në mbledhjen e Komisionit ,ka vendosur të jetë pikë e rendit të ditës -Shqyrtimi i pasqyrave financiare.

Komisioni, në mbledhjen e djeshme ishte i mendimit që Kuvendi të deklarohet në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, me qenë se nuk ka shkuar gjithçka sipas procedurave, për shkak të papërgjegjësisë së ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Mua më duhet të konsultohem së pari me shefat e grupeve parlamentare. Urdhëroni z. Gashi, nga LDK-ja.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryetar. Sipas Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës është caktuar ky rend i ditës në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren.

Kryesia e Kuvendit, në takim përgatitor me shefat e grupeve parlamentare ka ardhur në përfundim që kjo çështje duhet të trajtohet në seancën plenare të sotme. Andaj, të gjitha çështjet e Komisionit janë shkrime para atij vendimin. Ju lutem z. kryetar që ta respektoni Rregulloren dhe nëse sipas Rregullores nuk janë paraqitur mocionet për shkrim, ky rend i ditës konsiderohet i miratuar në fillim të seancës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!. Zoti Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i bindur se ministri ka shkelur ligjin, duke mos iu përgjigj Komisionit kryesor të Parlamentit për t'i dhënë përgjigjet para këtij Komisioni dhe ne do të dëshironim që kjo praktikë, vërtet, të ndërpritet. Ministrat janë të obliguar t'i përgjigjen edhe Parlamentit edhe komisioneve përkatëse. Megjithatë edhe ne për shkak të punëve të shumta që kemi përpara, nuk jemi që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës, po të debatohet se në fund të fundit deputetët shpresoj edhe besoj se janë përgatit për të debatuar dhe për të dhënë kontributin e tyre në këtë debat. Praktika e mos përgjigjes së ministrave para komisioneve përkatëse, mendoj që duhet të ndërpritet një herë mirë. Në fund të fundit është shkelje e ligjit dhe ata duhet ta dinë se i përgjigjen këtij Parlamenti, i cili e ka dhënë votën për ta ushtruar funksionin që e kanë.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Mendoj se nuk kemi nevojë të shkojmë më tutje. Urdhëroni Gjylnaze Syla, nga AAK-ja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar.

Grupi Parlamentar i Aleancës, gjithashtu, në mbledhjen me Kryesinë e Kuvendit, është pajtuar që të futet në rend të ditës kjo. Megjithatë, në të ardhmen mendoj që duhet të zhvillohet praktika e Kuvendit që edhe Komisioni të japë raportin, mundësisht, në qoftë se është i përgatitur- para shqyrtimeve. Por tani mendoj që çdo raport i Komisionit do të ishte i vonshëm. Në fund të fundit, shkresën e kemi marrë sot në mëngjes lidhur me vendimin ,të cilin e përmendi z. deputete.

Prandaj, ne mendojmë se sot duhet të debatohet lidhur me këtë pikë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – I nderuar kryetar, e nderuara Qeveri, të nderuar kolegë deputetë.

Në mbledhjen e përbashkët, të cilën e patëm Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare, diskutuam për të gjitha çështjet dhe në mes të këtyre çështjeve diskutuam edhe për çështjen e sotme të pasqyrave financiare të raportit.

Në këtë pikë, pikërisht, shefat e grupeve të pozitës ishin ata të cilët e cekën që ky raport është dashur të kalonte në Komisionin Funkcional, në Komisionin kryesor funksional. Ai komision e ka mbajtur mbledhjen, e ka ftuar ministrin, por ministri nuk e ka parë të arsyeshme të informojë që nuk mund të vijë dhe nuk ka pasur diskutim për këtë.

Prandaj, kjo tregon edhe një herë mospërfilljen e Kuvendit nga ana e Qeverisë, njëra prej shumë e shumë rasteve. Në qoftë se ne vazhdojmë që çdo herë ta lemë që herën tjetër të mos ndodh, herën tjetër do të ndodhë. Edhe herën tjetër, edhe atë herën tjetër mbas asaj, do të ndodhë çdo herë. Komisioni Funkcional edhe me Kornizën Kushtetuese në pikën 9.1.11 ka kompetenca të përgjithshme mbi këtë çështje. Prandaj, mendoj që është koha që të parandalohet kjo praktikë, që të mos ndodhë edhe një herë edhe kjo edhe çështja e Grupit Parlamentar ORA kur pas vendimit që të diskutohet për

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju lutem sa më shkurt.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Kjo është krejt e njëjta gjë, të njëjtat simptome, veç raste të tjera. Prandaj, mendoj që nuk duhet të vazhdojmë me këso praktika. Kjo pikë e rendit të ditës nuk i ka plotësuar kushtet dhe si e tillë duhet të hiqet prej rendit të ditës.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Grupi 6+ deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Poštovani predsedniče, kolege poslanici. Mi smo takođe prekjue razgovarali o ovom problemu. Nemogućnosti prisustva ili neprisustva ministara pa sam ja baš prekjue govorio o praksama u razvijenim demokratskim zemljama kada su u pitanju ovako važna pitanja. Mi nismo čuli još uvek ministra koji su razlozi dolaska ili nedolaska, ali se predužujemo ostalim kolegama da, kada su ovako bitne rasprave da obavezno omogućimo prisustvo resurnih ministara i naš je stav dakle ovaj taj. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA - Faleminderit. Gjergj Dedaj apo Ferid Agani? Z. Agani e ka fjalën.

DEPUTETI FERID AGANI – Faleminderit z. kryetar.

Grupi Parlamentar për Integrim është për respektimin e procedurave të rregullta të Kuvendit të Kosovës. Deri më sot asnjë raport nga Qeveria ose ministrinë përkatëse nuk është shqyrtuar në këtë Kuvend pa rekomandimin e Komisionit Funkcional. Prandaj, mendojmë se njëjta gjë duhet të ndodhë edhe sot. Të sigurohet një herë shqyrtimi i këtij raporti nga ana e Komisionit Funkcional dhe pastaj të hapet debati në Kuvend. Debati i sotëm, me siguri, do të jetë i mangët në shumë aspekte ,sepse shumë pyetje ,të cilat do të mund të trajtoheshin në detaje në Komisionin Funkcional nuk do të mund të trajtohen në mënyrë të tillë në debatin, që do të zgjatë vetëm dy orë e 20 minuta. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Ramadan Kelmendi e ka fjalën.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuar kryetar, të nderuar ministra, të respektuar deputetë.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë t'ju falënderoj për njoftimin pranë këtij Kuvendit për funksionimin e këtij grupi parlamentar . Ju premtojmë se do t'i përmbushim obligimet tona si grup parlamentar dhe do të jemi bashkëpunëtorë të ndershëm, të sinqertë, bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe ligjeve që ka miratuar ky Kuvend.

Në të njëjtën kohë, me këtë konfirmojmë se ne pajtohemi me rendin e ditës dhe kërkojmë që vërtet të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit për komisionet dhe për rendin e ditës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Kush është që të mbetet në rendin e ditës kjo pikë?

Kush është për atë që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë? Nuk ka diskutime rreth saj. Ju lutem, shefat e grupeve parlamentare kanë paraqitur qëndrimet.

(Polemikë)

Për të qenë vendim, propozimet e shefave të grupeve do ta hedhin në votim, për ta kthyer në vendim. Është diskutuar nga shefat e grupeve parlamentare.

(Polemikë)

Edhe një herë e hedh në votim. Urdhëroni z. Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit. Ju e dini, anëtarët e Kryesisë e dinë, kryetarët e grupeve parlamentare e dinë sa të gjatë e me diskutime ne i bëjmë mbledhjet për ta caktuar agjendën e Kuvendit në seancë plenare. Dhe kjo bëhet vetëm e vetëm për një strukturim më të mirë të agjendës. Kjo agjendë që kemi sot është e aprovuar pa asnjë hezitim, pa asnjë votë kundër me konsensus në mbledhje të Kryesisë dhe të grupeve parlamentare. Ashtë punë e grupeve parlamentare si funksionojnë ato. E kanë për detyrë kryetarët e grupeve që të kthehen e t'u thonë që kanë dhënë konsensusin për këtë agjendë, është punë e tyre si veprojnë. Megjithatë, Rregullorja obligon që kur është me konsensus agjenda ajo nuk diskutohet, Rregullorja në fuqi. Meqë këtu u lejua të zhvillohet post festum një diskutim rreth kësaj dhe ka deputetë që mendojnë që objeksionet e tyre duhet të rimerren me votë, atëherë mos të humbim kohë ,mund ta nxjerrin në vota atë propozim edhe të shkojmë tutje. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Urdhëroni z. Koci

DEPUTETI GANI KOCI – Po e përsëris atë që e tha shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Ne si grup jemi të përgatitur që sot të flasim dhe ta shqyrtojmë këtë raport. Mirëpo, me një çështje unë personalisht nuk mund të pajtohem. Ju si Kryesi keni marrë një informacion si kanë rjedhë gjërat rreth diskutimit të këtij raporti me Komisionin Funkcional. Dhe ju nuk keni vepruar mbi bazë të këtij informacioni që të kërkonin nga ministri t'i përgjigjet ftesës së Komisionit, por pa asnjë konsultim, pa asnjë informacion lidhur me këtë, ju e keni futur në rendin e ditës.

Komisioni, dje, kur e ka parë rendin e ditës në mbledhjen e vet e ka shqyrtuar dhe është kërkesë e Komisionit që ky raport të kalojë një herë nëpërmjet Komisionit dhe pastaj të dalë këtu dhe të shqyrtohet në Kuvend. Unë nuk e quaj të përgjegjshëm ministrin që i ka ikur ballafaqimit me Komisionin. Po aq të përgjegjshëm kanë dalë edhe Kryesia edhe ata që kanë pasur një konsensus, siç tha parafolësi atje, rreth rendit të ditës ose veçanërisht rreth kësaj pike të rendit të ditës. Ne nuk po kërkojmë asgjë më shumë, por që të përfillen Rregullorja e punës së Kuvendit, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe të mos anashkalohen mekanizmat që i ka krijuar ky Kuvend dhe që ministri duhet të përgjigjet para atyre mekanizmave. Kjo është kërkesa.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Rregulla 30 pika 2 thuhet: Për mocionin për ta shtyrë debatin për një datë të caktuar një debat të ardhshëm dhe për mocion për ta shtyrë seancën menjëherë mbahet votimi për debat, pa debat. Prandaj, duhet të votojmë për propozimin. Nuk ka debat ju lutem. Për rendin e ditës kemi debatuar.

E hedh në votim propozimin - Shqyrtimi i raportit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006.

Kush është për të mbetet në rend dite kjo pikë? Ju lutem, numëroni votat.

Kush është kundër?

Nga 92 deputetë që janë prezentë, 54 kanë votuar për mbetjen në rendin e ditës kjo pikë e rendit të ditës dhe 5 vota kundër.

Shkojmë në pikën e radhës të rendit të ditës

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 27 prill 2007

Procesverbali i seancës plenare.

(Polemikë)

Jo çdo deputet, me shkrim, Gjergj kemi votuar. Kur është miratuar rendi i ditës ka qenë përfaqësuesi i grupit parlamentar atje. Gjergj, ju lutem, me qenë se deri në fillim të seancës plenare asnjë nga grupet parlamentare nuk ka bërë propozim me shkrim për ndonjë ndryshim të agjendës, konsiderohet se rendi i ditës i propozuar është i miratuar. Ti e ke pas përfaqësuesin e Komisionit aty.

Ju lutem vazhdojmë më tutje. Pika e dytë e rendit të ditës. Procesverbali i seancës plenare të datës 27 prill 2007 u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Pyes deputetët a kanë vërejtje në procesverbal?

Nëse nuk ka vërejtje konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të datës 27 prill 2007.

Pika e tretë e rendit të ditës.

3. Koha për pyetjet parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26 pikë 1 të Rregullores së punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Deputetja Naxhije Doçi ka pyetje për ministrin Agim Velin Urdhëroni deputete Naxhije Doçi.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – Faleminderit kryetar. Të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputetë.

Për shkak të kufizimit të numrit të punësuarve në institucionet edukative arsimore nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në disa kuvende komunale janë zvogëluar paralelet me mësim para fillorë në nivel të shkollave fillore, për shkak të buxhetit të kufizuar të Kosovës. Edhe pse me miratimin e Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, kompetencat për institucionin parashkollor dhe për shkollat fillore janë në mbikëqyrje të DKA-ve, disa drejtorë komunale të arsimit thonë se në nuk i kemi fajet për zvogëlimin e numrit të paraleleve para fillorë. Në Shtime 16 paralele para fillorë janë në rrezik që të mbyllën, ku në mungesë të mjeteve financiare punëtorët kanë mbetur pa paga dhe të cilët për të mos u mbyll paralelet para fillorë punojnë vullnetarisht.

Në Prizren paralelet përgatitore paguhen me vetëfinancim që është në kundërshtim me ligjin. Në Fushë Kosovë vetëm tri shkolla fillore kanë paralele para fillor, ndërsa kanë nevojë për paralele të tilla edhe 7 shkolla fillore me 6 paralele. Në Ligjin për edukimin parashkollor është paraparë që deri në vitin 2010 të synohet për gjithë përfshirje të fëmijëve në përgatitjet para fillorë. Po e ndërpres kryetar. Pyetja është? A ka njohuri MASHT-i se sa është numri i kufizimeve të paralelet para fillorë në Kosovë? Cilat kanë qenë dhe cilat janë angazhimet e MASHT-it që jo vetëm të mos u mohohet e drejta e përfshirjes së regjistrimit të fëmijëve në këto paralele përgatitore. por edhe të ngritet niveli i përfshirjes më të madhe apo edhe gjithëpërfshirës edhe obligative. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Urdhëroni ministër Velin.

MINISTRI AGIM VELIU – I nderuar z. kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, kolegë ministra, zonja dhe zotërinj.

Ministra që unë e drejtoj i kushton vëmendje të posaçme institucioneve parashkollore. Themelimi dhe funksionimi i këtyre institucioneve rregullohet në Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm, nën 6 pika 1 a) mbi organizimin e programit arsimor në Kosovë.

Për të rritur efikasitetin e funksionimit të institucioneve parashkollore Ministria e Arsimit ka bartur përgjegjësinë për këto institucione tek komunat. Përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit në lidhje me këto institucione është të përgatitja e plan programeve për moshën 3 deri 6 vjeçare, sigurimi i cilësisë në edukimin para fillor, përgatitja e Ligjit mbi edukimin para fillor

Disa komuna kanë kaluar limitet e të punësuarve dhe për fat të keq ky i rrezikon edhe të punësuarit në institucionet parashkollore. Kohëve të fundit po flitet se në të gjitha komunat janë mbyllur institucionet parashkollore, por duke u bazuar në të dhënat që i kemi vetëm në komunën e Shtimes janë mbyllur 17 paralele të institucioneve parashkollore. Ka plot raste ku janë hapur institucionet e reja nëpër komuna.

Këto institucione janë nën përkujdesje të vazhdueshme nga Ministria dhe kjo parashihet me ligjin nr. 02 L-52 mbi edukimin para fillor, që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 19 maj 2006. Në 2 pika 1 i këtij ligji institucionet parashkollore thotë janë pjesë e

sistemit unik të edukimit dhe arsimit në Kosovë. Më tutje, neni 2 pika 2 thuhet se vijimi i edukimit parashkollor është vullnetar. Kjo nënkupton se Ministria e Arsimit nuk mund të ndërmarrë masa ndaj prindërve nëse nuk i sjellin fëmijët e tyre në institucione parashkollore.

Në këtë ligj po ashtu parashihet edhe themelimi dhe mënyra e financimit të institucioneve të edukimit para fillor, si dhe mënyra se si mbyllen ato. Burimet financiare për këto institucione janë: nga buxheti i Kosovës, nga themeluesi, pagesa nga prindërit dhe donacionet dhe burimet tjera. Themeluesi i institucioneve parashkollore publike është komuna, ndërsa themelues i institucioneve tjera parashkollore janë persona të tjerë juridikë privatë. Pagesa mund të bëhet edhe nga prindërit se u tha këtu. Neni 41 e rregullon ndërprerjen e punës së institucioneve dhe organizatave të edukimit para fillor, e cila mund të bëhet me vendim të themeluesit. Çdo ndërhyrje e Ministrisë në këtë drejtim, pra bie ndesh me ligjin, disa prej kërkesave që janë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit z. ministër. Ka pyetje shtesë?

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – Faleminderit z. ministër

Drejtoritë komunale në lidhje me këtë çështje thonë se fajet nuk janë tek ne, pengimi do të thotë për shuarjen e paraleleve para fillore.

Në Ligjin për edukimin parashkollor, po e ceku edhe një herë, është paraparë që deri në vitin 2010 të synohet për gjithë përfshirje të fëmijëve në përgatitjet para fillore. Pra, është fjala për përgatitjet para fillore në nivel të shkollave fillore, ndërsa interesimi i prindërve është që kjo fazë përgatitore të jetë obliguese. Të këtij mendimi janë edhe drejtorët e kopshteve si dhe grupi i këshillëdhënës i edukimit parashkollor. Do të thotë interesimi i prindërve është që këto paralele para fillore jo vetëm që të funksionojnë, por edhe të shtohen edhe bile është interesimi që përfshirja e fëmijëve në paralelet para fillor në nivel të shkollave fillore të jetë edhe obliguese mundësisht,

KRYETARI KOLË BERISHA- Z. ministër, keni përgjigje tjetër? Mirë.

Urdhëroni. Është e drejtë e juaja. Interpretimin e Rregullores brenda seancës plenare e bëj unë. Dhe tjetra, shikoje mocionin.

Rregulla 30 pika 8 - mocion për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës dhe mocion për shkëlqen e të drejtave të deputetit mund t'i bëjë madje vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese. Vazhdojmë më tutje. Deputeti Ramadan Kelmendi. Urdhëroni.

(Polemikë)

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari ministër. A është duke marrë ndonjë veprim juridik Ministria e Drejtësisë për të penguar zbatimin e ligjeve të Serbisë, të cilat në të njëjtën kohë, momentalisht, janë duke u zbatuar në Serbi dhe vazhdojnë të implikohen edhe në zonat e mbuluara nga sistemi paralel gjyqësor dhe administrativ në Kosovë. Ky sistem paralel nuk i zbaton ligjet e UNMIK-ut dhe as ato të Kuvendit të Kosovës. Sistemi paralel i lartcekur po krijon probleme të rënda të natyrave të ndryshme juridike e në veçanti të atyre pronësore- juridike, shitblerja si dhe të pronësisë banesore në komunat e Veriut të Kosovës, me theks të veçantë duke na diskriminuar të gjithë shqiptarëve atje. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI JONUZ SALIHAI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, përfaqësues të Qeverisë, të nderuar të pranishëm.

Në lidhje me pyetjen e deputetit Kelmendi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për veprimet juridike që i ka marr kjo ministri për të penguar zbatimin e ligjeve të Serbisë, si dhe të strukturave paralele në Kosovë, më lejoni të paraqes para jush qëndrimin si më poshtë.

Ashtu siç jeni edhe ju në dijoni, ekzekutivi i Kosovës mbetet i përkushtuar në përgatitjen e projekt akteve ligjore sistemore dhe zbatimin e tyre në përputhje me ligjin e aplikuar, si dhe integrimin e të gjitha komuniteteve në sistemin unik të Kosovës. Veprimet tona kanë qenë të fokusuara në eliminimin e këtyre faktorëve, në mënyrë që t'i eliminojmë edhe strukturat paralele. Kështu që ne si Ministri e Drejtësisë, që nga themelimi e deri më tani, në asnjë moment nuk kemi lënë anash politikën e integritit të minoriteteve jo vetëm në Ministrinë tonë, por edhe në sistemin e drejtësisë dhe në gjykatat e Kosovës.

Në kuadër të kësaj ne kemi ndërmarrë disa veprime, të cilat unë po i ceku më poshtë. Është e njohur dhe për të gjithë deputetët dhe për Qeverinë e Kosovës se ne kemi momentalisht në fuqi edhe akte rregullative të UNMIK-ut edhe ligje të këtij Parlamenti, po edhe ndonjë ligj që na ka mbetur nga ish- Jugosllavia. Po punojmë në ligje sistemore - Ligji për gjykata, Ligji për prokuroritë. Kemi disa pengesa në unifikimin e koncepteve mes misionit planifikues të BE-së që është këtu, UNMIK-ut dhe Ministrisë së Drejtësisë. Por jemi shumë afër të unifikimit të atyre koncepteve dhe do ta kemi shumë shpejtë një ligj këtu në Parlament për gjykatën ,një ligj për prokurori publike. Sa i përket eliminimit të sistemit paralel, gjykatave paralele, ne kemi bërë veprime shtesë në pajtim me kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, që kemi hartuar së bashku me UNMIK-un, ne kemi formuar dhe tash janë plotësisht funksionale 11 zyra ndërlidhëse për gjykata, duke filluar nga Graçanica deri te pjesa Veriore e Mitrovicës, ku z. Kelmendi ka qasje edhe më të mirë se gjithë ne.

Me këtë ne kemi bërë veprime shumë të rëndësishme. Kemi integruar minoritetin serb në sistemin e drejtësisë të Kosovës dhe ,po ashtu, kemi neutralizuar veprimin e këtyre gjykatave paralele. Të gjitha lëndët që kanë konteste ndëretnike shqyrtohen në të ashtuquajturat Ditët e gjykatave,që shpesh janë edhe publike edhe në disa prej të cilave kam marr pjesë dhe jam bind vet që ka numër shumë i madh i lëndëve që janë shqyrtuar dhe ato lëndë tanimë janë ekzekutuar.

Sa i përket pjesës së parë të integritit të minoriteteve ne veç kemi arit 14% e integritit minoritar në sistem të drejtësisë dhe 8.8% në sistemin gjyqësor të Kosovës, do të thotë kemi një tejkalim bile prej 0.8%, sepse me pakon e Ahtisarit parashihet 8% minoritar serbë te sistemi i drejtësisë. Po punojmë, pra, edhe në ligje të tjera sistemore dhe për një kohë relativisht të shkurtër besoj ta përmbushim edhe këtë objektiv. Sa i përket kontesteve pronësore ju e dini që ekziston një agjenci për prona dhe janë punë e agjencisë edhe pse intimisht me ju thanë ,unë si ministër i Drejtësisë s'jam i kënaqur me punën që po bëhet aty. Ajo agjenci është formuar me Rregulloren 2006/10 dhe e ka kompetencë, të themi. pronat diskutabile në vitin 98, 99 gjatë kësaj periode. Kjo agjenci është formuar më 4 mars 2006, do me thanë është formuar praktikisht një javë para se unë ta marr detyrën e ministrit dhe kryesisht deri tash ajo agjenci menaxhohet nga Ministria e Ambientit. Sigurisht që është sundim i ligjit dhe shumë shpejt do të kaloj në Ministrinë e Drejtësisë. Pra,kemi bërë shumë veprime dhe besoj që situata është shumë

më e mirë se deri më tani. Duhet me ba edhe shumë më përpjekje, por besoj që situata është afër normalizimit. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë?

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari ministër. Vlerësoj se është mirë të merri të gjitha masat dhe Agjencinë e Pronës ta vëni nën ombrellën e drejtësisë ose ta shuani tërësisht, sepse ajo luan me pronën e shqiptarëve dhe de fakto ndërron strukturën edhe të popullatës dhe të pronës në Veriun e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI JONUZ SALIHAIJ – Kjo agjenci punon me Rregulloren 2006/10 dhe ka të themi atë limitin kohor 98-99. Unë di që janë bërë veprime edhe jashtë këtij limiti kohor, jashtë këtyre 12 muajve sa ka kjo agjenci afat ligjor. Tash po bëhen përpjekje që të kthehet te sundimi i ligjit nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, gjegjësisht të raportohet te Ministria e Drejtësisë. Unë do të jem shpejtë në kontakt me Agjencinë e Pronës. Kam disa materiale që e dokumentojnë atë që thoni ju dhe jemi në kontakt që të bëjmë diçka, sepse ka njerëz që kanë kthyer pronat në mënyrë legale dhe mandej atyre u janë marrë. Është e vërtetë. Jemi duke grumbulluar të gjitha faktet, në mënyrë që të bashkëpunojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Për shkak të mungesës së atyre që duhet të japin përgjigjen në këto pyetje, sot nuk do të marrin përgjigje deputetët: Gazmend Muhaxheri, Bajrush Xhemajli, Qibrije Hoxha, Ramadan Kelmendi. Prapë Ramadan Kelmendi - tri pyetje, Ibush Jonuzi, Behxhet Brajshori, Hajredin Hyseni. Deputetja Zyhrije Maloku ka pyetje për Tomë Hajdarin.

Urdhëroni z. Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar. Unë nuk desha ta shfrytëzoj të drejtën time për t'i lexu pyetjet, po meqë ministrat vërtet janë të papërgjegjshëm, unë po i shtroj vazhdimisht, ata s'po vinë a po më shtje t'i lexoj. Veprimi i ministrit z. Sadik Idriz që deri tash ishte këtu, sa po erdh radha ai eci. Prandaj, unë dua ta shfrytëzoj rastin, ata në dash të vinë e në dash të mos vinë. T'i lexoj, të faleminderit, që të tri pyetjet.

Për z. Sadik Idriz është. Nga komuna e Ferizajt që nga lufta e këndej 40 pacientë, të cilët vuajnë nga insufienca renale kronike udhëtojnë vazhdimisht për në Gjilan për të bërë hemodializën. Në hapësirat e Spitalit Rajonal të Ferizajt pat filluar të ndërtohet një objekt për hemodializë për ta zgjidhur këtë problem dhe për këtë u ndan para të mjaftueshme. Por qeveria komunale e Ferizajt, në kohën e Adem Salihajt dhe tani komunalët aktualë parat i tretën dikund pa shenjë e pa u dukur fare edhe ndërtesën e lanë në gjysmë pa i dhënë llogari askuj, që nga shtatori i vitit 2005 janë ndërprerë punimet. Pyetja është -A keni paraparë që këtë objekt që ka mbetur në gjysmë ta përfundoni në mënyrë që të ndërpriten vuajtjet dhe maltretimet e 40 pacientëve të pafajshëm.

Ndërsa për z. Qemajl Ahmetin është. - Në vitin 2003, 2004 në vendbanimin hekurudhor te rruga e Reçekut në Ferizaj treni mbyti 4 qytetarë dhe pati edhe disa aksidente të tjera, pa pasoja në njerëz, derisa më në fund u vendosën disa barriera mbrojtëse. 4 qytetarë të

vdekur ishin haraçi i mosmarrëveshjen ndërmjet organit të KK-ës dhe Ndërmarrjes së Hekurudhave për formën dhe kushtet e vendosjes së barrierave mbrojtëse. Në 3 muajt e fundit të këtij vitit në qytetin e Ferizajt janë aksidentuar nga treni 3 qytetarë, prej të cilëve 2 kanë vdekur. Hekurudha, e cila kalon nëpërmjet qytetit të pambrojtur dhe organet qendrore e komunale nuk kanë marrë asgjë. Numri më i madh i vendkalimeve hekurudhore nuk kanë barriera mbrojtëse, ashtu si edhe tërë vija hekurudhore nëpër mesin e qytetit dhe absolutisht e pambrojtur, kurse mbikalimi i vetëm te stacioni hekurudhor moti është i rrënuar. Pyetja- Përse nuk ndërmerrni masa të nevojshme dhe të domosdoshme për të ju dhanë fund këtyre tragjediëve, pasi ju jeni?

Prapë për z. Qemajl Ahmeti. Jemi dëshmitarë se në këtë dimër po thuaj se nuk ka pasur borë dhe ngrica ,megjithatë nga një raport që kam pas në dorë shihet se kripa dhe orët e harxhuara të punës janë tepër enorme dhe meqë në atë raport nuk ka të dhëna vetëm për një komunë, atë të Besianës, atëherë pyes-Sa ton kripë ka shpenzuar për regjionin e Besianës dhe me sa orë pune janë arsyetuar? Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ministri Sadik Idriz nuk ka qenë i ftuar të përgjigjet. Deputetja Zyhrije Maloku.

DEPUTETJA ZYHRIFE MALOKU – I nderuari z. kryetar, ministra të nderuar. Para një viti në disa vende të rajonit u lajmërua sëmundja gripi i shpezëve, e cila është e rrezikshme dhe vdekjeprurëse edhe për njerëzit. Fatmirësisht vendi ynë nuk u prek nga kjo sëmundje, falë angazhimit të madh të Ministrisë së Bujqësisë, e cila, po ashtu, ka qenë e përgatitur shumë mirë në rast nevojë për të intervenuar.

Ministria e Bujqësisë bllokoi menjëherë importin e mishit të pulës dhe të produkteve të tij nga ato vende tek të cilat u lajmërua kjo sëmundje. Zoti zëvendësministër- A është bërë zhbllokimi i importit të mishit të shpezëve nga vendet që kanë qenë të rrezikuara nga kjo sëmundje? Nëse po- Sa e keni nën kontroll këtë import të mishi nga këto vende, por ,gjithashtu, edhe nga vendet e tjera?

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti zëvendësministër.

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Faleminderit z. kryetar. Unë përpos pyetjes kam sjell edhe raportin gjeneral të masave të ndërmarra nga 9 tetori i vitit 2006 deri më datën e sodit. Por sa i përket pyetjes së zonjës deputete- Zhbllokimi, gjegjësisht shfuqizimin e ndalesës së importit është bërë më 19.4 nga Hungaria dhe më datën gjithashtu 19.4 nga Britani e Madhe. Ndërsa, sa i përket gjendjes momentale Kosova është e lirë nga sëmundja e aviointeflorecës, sepse Ministria e Bujqësisë, gjegjësisht Agjencia e Veterinës dhe i Ushqimit, duke iu referua raporteve të Organizatës Internacionale Pizotike e Komisionit Evropian, Organizatës Botërore të Shëndetësisë. bën ndalesat apo shfuqizimet e ndalesave të importit ,duke u bazuar në situatën e epiziotologjike në shtetet e rajonit dhe shtetet fqinje me legjislacionin në fuqi.

Vetëm dua të ju njoftoj që konform këtij projekti Ministria jonë ka fituar edhe grantin e parë të Bankës Botërore prej 3 milionësh dhe 1 milion e 100 mijë ka ndarë Qeveria e Kosovës .Ka fillua implementimi i projektit për ngritjen e laboratorit të veterinës së ushqimit të shkallës së tretë të biosigurisë ,që është standard i Bashkësisë Evropiane dhe ka pas fatin Kosova të jetë e para në Evropë Juglindore ta ketë laborator. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Nuk ka. Deputeti Genc Gorani ka pyetje për ministrin Dugolli.

DEPUTETI GENC GORANI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, zoti kryetar dhe anëtarë të Qeverisë.

Pyetjen këtu s' e kam përpara, mirëpo po e parafrazoj ,sepse është relativisht e thjeshtë. Ka të bëjë me lejet për bizneset në tregti që kanë të bëjnë me tregtinë e brendshme. Sipas ligjit që është i sponzoruar nga Ministria në fjalë dhe i miratuar këtu në Kuvend, lejet për veprimtari ekonomike për bizneset që kanë të bëjnë me tregtinë e brendshme jepen në baza permanente. Sipas as që nënkuptohet, kjo do të thotë se këto leje një herë që jepen në bazë të kriterëve të parashtruara sipas ligjit, nuk mund të tërhiqen pa ndonjë arsye valide, aq më tepër këto leje nuk ishte dash të kërkohet të lëshohen në çfarëdo qoftë baze periodike, veçanërisht. Sipas informatave që i kemi në shumë komuna, në nivel pushtet lokal, këtyre bizneseve u kërkohet që ta ripërsërisin kërkesën për leje të punës dhe me atë rast natyrisht s' janë të detyruar ta paguajnë edhe një shumë të hollave. Ju lutem z. ministër të na shpjegoni- A ka bazë ligjore për këtë dhe a zbatohet ligji, të cilin ju e keni përsipër për ekzekutim? Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. ministër. e keni fjalën.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Faleminderit deputetit. Pyetja është pra shumë e shkurtër- Sa zbatohet Ligji për tregtinë e brendshme, në veçanti neni 38.4 mbi dhënien e lejes në bazë të përhershme nga pushteti lokal? Faktikisht gjatë pyetjes u bë, në një farë mënyre edhe një përgjigje ,por megjithatë Ligji për tregtinë e brendshme 2004/19 ka hyrë në fuqi dhe ai përbënë një ligj të rëndësishëm për funksionimin e tregut në Kosovë. Ministria e Tregtisë, Industrisë ka një rol parësor për zbatimin e këtij ligji, por në të njëjtën kohë ky ligj përcakton edhe detyrimet e qarta për institucionet tjera publike, përfshirë edhe funksionimin e pushtetit lokal. Një rast i tillë është i detyruar dhe i përcaktuar me nenin 38 të këtij ligji, i cili në mënyrë të qartë shprehet se leja e punës mbi dhënien e bazës të këtij neni jepet nga organi kompetent komunal, neni 38 . 3 dhe është i përhershëm neni 38.4. Praktika tregon se zbatimi i këtyre detyrimeve ligjore nuk kryhet si duhet nga më shumë se 80% të komunave të Kosovës.

Ministria e Tregtisë, Industrisë gjatë kontakteve që ka pas me strukturën kompetente të kuvendeve komunale ka kërkuar që ato të ndryshojnë rregulloret dhe të cilat veprojnë dhe të harmonizojnë ato me Ligjin e tregtisë së brendshme, i cili ka hyrë në fuqi dhe garanton detyrime ligjore edhe për pushtetin lokal. Edhe pse në parim përfaqësuesit e komunave e kanë përkrahur këtë kërkesë të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, në mjaftë raste ata nuk kanë vepruar për të ndryshuar rregulloret përkatëse, për të lëshuar lejet në afatet e përhershme.

Më duket se arsyeja kryesore qëndron tek vjelja e taksave komunale në rastin e përtëritjes së lejes së punë, gjë e cila përmjet Ligjit për tregtinë e brendshme është e shmangur.

Ministria e Tregtisë, Industrisë mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar me pushtetin lokal për mundësinë e zbatimit më të mirë jo vetëm të këtyre detyrimeve ligjore që lidhen me funksionimet e tregut dhe në të njëjtën kohë mirëkuptimin e organeve të pushtetit lokal për ushtrimin e kompetencave në përputhje me ligjet që i ka nxjerr Kuvendi i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni z. Gorani.

DEPUTETI GENC GORANI – Po z. kryetar. Një pyetje shtesë e shkurtër do të ishte- A keni z. ministër ndonjë shembull pozitiv të na dëshmoni këtu për komunat të cilat ju kanë përgjigjur pozitivisht kërkesës suaj për zbatimin e këtij ligji?

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. ministër urdhëroni.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Nuk e kemi tash fjalën me komunat specifike. Unë e thashë numrin, d.m.th. në përgjithësi nuk i kanë përfill, por kanë përfill, por ka filluar të ec pozitivisht pas kontakteve që i kemi pasur, por sido që të jetë ne do të bëjmë prapë presione të duhura, që edhe niveli lokal t'i respektojë këto, se këto janë barriera që mund t'u jepen biznesit pa nevojshme, d.m.th. Ligjit i tregtisë së brendshme e ka menduar këtë shumë mirë që ata që i nxjerrin lejet të mos kenë nevojë t'i përsëritin ato për çdo vit, por të jenë të përhershme dhe ne insistojmë në këtë, por sido që të jetë në rast se nuk do të ketë përmirësime, ne do t'i bëjmë publik edhe emrat e komunave, të cilat nuk janë duke u zbatuar për momentin. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Nazim Jashari ka pyetje për deputetin Haki Shatri.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit z. kryetar, pavarësisht që sot jeni duke punuar pa rregullore. I nderuari z. ministër, duke pasur parasysh që Administrata tatimore e Kosovës për një kohë bukur të gjatë nuk ka pasur sukses të inkasojë një shumë bukur të madhe të detyrimeve financiare të ndërmarrjeve afariste në Kosovë, bëhet fjalë për diku rreth 200 milion euro. pyetja është shumë konkrete- Sa është shuma e detyrimeve të prapambetura të painkasuara nga ana e Administratës Tatimore në Kosovë? -Cila pjesë e kësaj shume paraqet borxhin kryesor, kryegjënë, e cila pjesë e kësaj shume paraqet ngarkesën e detyrimeve me kamatë dhe interes? Pra, pyetja është shumë e shkurtër, shumë konkrete.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI HAKI SHATRI – Po, faleminderit z. kryetar. Të nderuar deputetë. Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për administrimin dhe inkasimin e tatimeve në Kosovë, si i vetmi autoritet, kurse Shërbimi Doganor i Kosovës përgjigjet për pjesën në kufi. Masat dhe format e grumbullimit të inkasimit të detyrimeve tatimore janë tri: përmes edukimit të tatimpaguesve, kontrollit të tatimpaguesve dhe mbledhjes me forcë të tatimeve.

Në periudhën 2000 deri 2007, pra për të gjitha vitet e pasluftës baza e borxhit total të bizneseve ndaj Administratës Tatimore, pra ndaj buxhetit të Kosovës është 88 milion 418 mijë e 600 euro. T'ju përkujtoj që kjo bazë është më e madhe në vitet e para të pasluftës dhe ka shkuar duke u zvogëluar. Në veçanti është zvogëluar dukshëm në vitin 2006 dhe ka rënë po thuaj tërësisht në tremujorin e parë të vitit 2007.

Nga 17 milion që ishte baza e borxheve në vitin 2002, në 2003, po ashtu 17, në 2004, 17, në 2005, 17, në vitin 2006 kjo bazë ka ra në 8 milion e 600 mijë euro. Pjesa e ndëshkimeve që lidhen me këtë bazë të borxhit është 42 milion e 526 mijë 108 euro,

kurse kamata në këto borxhe është llogaritur në 38 milion e 959 mijë e 390 euro. Gjithsejtë baza ndëshkimi dhe interesi për gjithë periudhën prej 8 viteve është 169 milion e 904 mijë euro. T'ju përkujtoj që një pjesë e këtyre obligimeve janë llogarit retroaktivisht pas hyrjes në fuqi të akteve normative si Ligji për TVSH-ën dhe ligjet tjera që rregullojnë obligimet e tatimpaguesve ndaj buxhetit të Kosovës.

Megjithatë, borxhi është i madh dhe përkundër faktit që ministri i Financave ka të drejtë që pas vjetërsimit të borxheve, sipas ligjit mund të bëjë shlyerjen ose ndryshimin e bazës së borxheve. Ministri i Financave dhe Administrata Tatimore kanë insistuar në grumbullimin dhe rritjen e efikasitetit të vjeljes së borxheve të vjetra dhe për këtë kemi pas rezultate evidente në vitin buxhetor 2006. për çka besoj se do të flasim më detalisht në raportin që do ta kemi në pikën 6 të rendit të ditës.

Kam edhe të dhënat detaje për llojet e obligimeve ku ndahen ndërmarrjet publike sa kanë borxhe, ndërmarrjet shoqërore, kompanitë e huaja, organizatat buxhetore, kooperativat, kompanitë e sigurimeve, OJQ-ët dhe bizneset private. Në qoftë se jeni të interesuar mund t'ua shpërndajë materialin dhe dua t'ju them që një pjesë e madhe e këtyre borxheve i takon një aspekti tepër formal. Për shembull, ndërmarrjet ose kompanitë publike siç janë KEK-u, më herët TVSH-ën e kanë llogarit në bazë të faturimit dhe jo në bazë të inkasimit të borxheve dhe ajo e ka rritë borxhin fiktiv të këtyre ndërmarrjeve dhe ajo është vështirë të shlyhet nga sistemi i evidentimit, prandaj, na po bëjmë veprime të nevojshme që këto të spastrohen dhe të vazhdojmë me grumbullimin e të hyrave. Faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! A ka pyetje shtesë? Urdhër z. Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. ministër, ju faleminderit për singëritetin. Pra, baza e borxhit është 88 milion, kurse ndëshkimet, kamatat e interesit janë 81 milion. Z. ministër, pyetja e radhës ka me qenë- Sa para i ka inkasuar Qeveria e Kosovës në emër të ndëshkimeve, borxheve, gjobave, kamatave dhe interesave, sa për qind e buxhetit të Kosovës mbushet me gjoba dhe ndëshkime? Gjjobat dhe ndëshkimet janë mjete për ta korrigjuar jo për ta mbush buxhetin, për t'i korrigjuar edhe për t'i përmirësuar tatimpaguesit dhe jo për ta mbushë buxhetin. 81 milion euro janë tepër shumë pare, është prerje e degëve bashkë me pemë.

KRYETARI KOLË BERISHA - Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI HAKI SHATRI – Faleminderit! Në qoftë se ka nevojë në mbledhjen e radhës unë do të përgatis të dhënat, por dua t'ju them që ministri i Financave, me një urdhëresë administrative në vitin 2006 në bazë të ligjit në fuqi ka zvogëluar normën e ndëshkimeve të kamatave nga 50% ,sa është e parapame në 25% dhe tani e tutje këto interesa dhe kamata, gjoba llogariten në bazë të urdhëresës së re administrative. Pra, po bëjmë një përmirësim në drejtim të adaptimit dhe të përshtatjes së nevojave edhe bizneseve, por pa i shkel dispozitat ligjore në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Nurishahe Hulaj ka pyetje për ministrin Agim Veliu.

DEPUTETJA NURISHAHE HULAJ – I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari ministër Veliu.

Promovimi, arsimimi, edukimi dhe aplikimi i dijenive është i shenjtë. Andaj konsideroj se kërkohet përkrahje, qasje, dinamikë më e shtuar e përkujdesjes për institucionet shkollore, me qëllim që të kemi sukses më të lartë tek nxënësit, adoleshentët, profesorët e arsimtarët dhe mirëqenie psike-sociale e siguri më të mirë. Pyetja e parë është- Çfarë keni bërë ju si Ministri apo a keni strategji të veçanta, përveç programeve shkollore që në shkolla të punohet më shumë me nxënës, arsimtarë e prindër, me qëllim që të kemi mjedis shkollor më të suksesshëm? Dhe pyetja e dytë është- Sa është i ngritur bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme që të zhvillohet siguri më e lartë në mjediset shkollore në Kosovë dhe si rrjedhojë e kësaj të parandalojmë disa elemente të dhunës në mes të nxënësve, adoleshentëve, si dhe ndaj drejtorëve mu në mesin e shkollës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. ministër. Nuk është marrë pyetja me kohë. Vazhdojmë më tutje. Deputetja Qibrije Hoxha ka pyetje për ministrin Bujar Dugolli.

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA – Ju faleminderit i nderuar kryetar.

Shitja e kompanisë ndërtimore "Ramiz Sadiku" në kuadër të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është bërë më datën 8 mars të vitit 2006. Kanë mbet pa u shit disa objekte në lagjen Ramiz Sadiku dhe objekte të tjera në Prishtinë si dhe objektet në Ferizaj, Mitrovicë dhe në Pejë. Në bazë të Rregullores së AKM-ës 2003/13 neni 10/4 ,të drejtën për marrje të mjeteve nga 20% i mjeteve të shitjes së kompanisë e kanë 460 punëtorë, si dhe pagesat e papaguara të punëtorëve nga koha e shitjes së kompanisë.

Pyetje për ju z. ministër? Nëna a)- Pse nuk po shiten objektet e pashitura që i përmenda më lart, në mënyrë që të bëhet likuidimi definitiv i kompanisë ndërtimore "Ramiz Sadiku"?dhe nën b) -Pse nuk i paguhet 20% nga shitja e kompanisë punëtorëve dhe kur do t'i marrin pagat e papaguara punëtorët e kompanisë ndërtimore "Ramiz Sadiku" kur dihet se mjetet nga shitja e kompanisë përbëjnë shumën prej 23 milion e 500 mijë euro?. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti ministër. urdhëroni.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Mirë, autoriteti ligjor sa i përket AKM-ës besoj i keni të qartë ,por ne kur bëhen pyetje nga deputetët insistojmë dhe i kërkojmë përgjigjet me shkrim nga menaxhmenti ekzekutiv i AKM-ës për t'u përgatit në pyetjet e juaja.

Pra, deri më tash është shit ndërmarrja "Ramiz Sadiku," Transporti, Makineri, SHPK në rundin e 12, mbi 14 milion. Ndërmarrja "Ramiz Sadiku", Fabrika e betonit- SHPK në rundin e 12, mbi 5 milion, ndërmarrja "Ramiz Sadiku", ndërtesa administrative SHPK në rundin e 12, mbi 1 milion, ndërmarrja "Ramiz Sadiku "Gurthyesi në Çikatovë në rundin e 15 mbi 2 milion e 500 mijë. Pra, vetëm ndërmarrja "Ramiz Sadiku" ,ndërtesa administrative ende nuk është nënshkruar kontrata. Për ndërmarrjet tjera janë nënshkruar kontratat. Ato që kanë mbet janë Autogarazha në Prishtinë, ka mbet, sepse mungon dokumentacioni dhe pronësi juridik, Stadiumi i sportit te Spitali i Prishtinës mungon dokumentacioni pronësor juridik, ish- Drejtoria e ndërmarrjes, Ambulanca ,si kuzhinë e punëtorëve dhe disa baraka, gjithashtu në Prishtinë mungojnë informacionet dhe dokumentacioni. Tokat bashkë me një objekt në Ferizaj, objekti plotësisht i dëmtuar, objekt tokë në Pejë, objekti i demoluar, janë ndërtuar apartamentet private para vitit 1999. Objekti- tokë në Parkun Nacional Germia në Prishtinë, objekti është i demoluar i shkatërruar nga bombardimet e NATO-së, objekti- tokë në Podujevë është e uzurpuar për

të pastrehët dhe barakat në Lagjen e spitalit Prishtinë është uzurpuar. Po ashtu mungojnë dokumentacionet pronësore- juridike si dhe objekti 9 barakat në kompleksin "Rilindja" janë të uzurpuar dhe mungon dokumentacioni pronësor- juridik.

Pra, ndërmarrja shoqërore "Ramiz Sadiku," ndërmarrja e vjetër ende nuk është publikuar zyrtarisht për likuidim edhe pse bordi i AKM-ës në takimin e vet të tetorit më 2006 ka aprovuar një gjë të tillë, për arsye se janë duke pritur nënshkrimet e kontratës për ndërmarrjen "Ramiz Sadiku"- ndërtesa administrative.

Në moment që kjo kontratë do të nënshkruhet ,që shpresojmë së shpejti, atëherë fillon edhe publikimi i njoftimit për likuidim të ndërmarrjes dhe normalisht grumbullimi dhe shqyrtimi i ankesave që do të dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Në këtë proces duhet të parashtrohen edhe kërkesat e të gjithë punëtorëve të "Ramiz Sadikut", të cilëve ndërmarrja e vjetër nuk ju ka paguar pagat apo ju ka mbet borxh për këtë çështje.

Sa i përket 20% të punëtorëve ,Zyra regjionale në në bashkëpunim me përfaqësuesit e ndërmarrjes, si dhe Sindikatën është duke i rishqyrtuar listën e punëtorëve për 20%. Pra. posa që të jetë e gatshme kjo listë, sipas procedurave të reja që janë ndryshuar për këtë çështje, lista do të publikohet nga Bordi i AKM-ës për mjetet e informimit. Të gjithë ata që pretendojnë që u është bërë e padrejtë që nuk janë futur në këto lista, do të kanë mundësi të ankohen brenda 20 ditësh. Në rast se ankesat do të vijnë. atëherë Gjykata, Dhoma e Posaçme, që merret me këto raste do t'i shqyrtojë ankesat dhe në rast se nuk ka ,atëherë lista është e plotfuqishme dhe do t'u paguhet mjetet. Këto janë politikat operacionale dhe sipas tyre është duke u punuar. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Pyetje shtesë? Urdhëroni.

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA – I nderuar ministër. Para se të vij në seancë unë u takova me kolegët e mi, me cilët kam punuar prej vitit , pra të ndërmarrjes" Ramiz Sadiku," të cilët sot janë tubuar në një tubim protestues para selisë së tyre në lagjen Ramiz Sadiku ,pra te ambulanca e" Ramiz Sadikut." Sipas fjalëve të tyre, mendoj se ata edhe pse punëtorët e" Ramiz Sadikut" krah për krah me minatorët e kanë treguar veten edhe në kohëra shumë të vështira se dinë të protestojnë në mënyrë paqësore, por megjithatë durimi i tyre është mjaftë në kufi dhe duhet të llogarisin për këtë. Unë nuk e di sot se me çfarë përgjigje do të dalim para tyre. Në qoftë se keni diçka më shkurt, do me thanë unë këto procedura që ju i shpjeguat i mora vesh mirë edhe ata i dinë sigurisht edhe më mirë se unë edhe sigurisht kanë biseduar, por ata d.m.th. mendojnë se koha është tepruar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni zoti ministër.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Ju e dini besoj që punëtorët e dinë që pa përfunduar tërë shitja e ndërmarrjes ata nuk mund t'i realizojnë 20% e mjeteve. Unë e thashë që është një ndërmarrje -ndërtesë administrative që pret nënshkrimin e kontratës. Kontrata nuk mund të nënshkruhet pa i kalua procedurat e hetimeve financiare që i bënë policia rreth prejardhjes së pasurisë së atyre që i kanë ble.

Në moment që nënshkruhet kjo kontratë për të gjitha objektet tjera 9 objekte tjera që janë në mungesë të dokumentacionit dhe me probleme çështje pronësore- juridike, hapet procesi i likuidimit. Pasi të hapet ky proces do të zgjatë procesi i likuidimit thashë 20 ditë

dhe pas atyre 20 ditëve në rast se nuk ka pretendime tjera, atëherë gjithë ky proces i shitjes së kësaj ndërmarrje mbýllet dhe 20%, në moment që hartohet lista dhe aprovohet lista me vendim të Gjykatës , ata fillojnë, i marrin mjetet. Kjo është procedurë për të gjitha ndërmarrjet njësoj, nuk bëhet me theks të veçantë për një ndërmarrje edhe pse janë procedura të komplikuar po ky është proces që është në fuqi dhe ne do ta zbatojmë këtë.

Ne kemi pas takime, për ata Bordi i AKM-ës në tetor të vitit të kaluar ka vendos që ndërmarrja pjesa tjetër qitet në likuidim ,të mos pritët vetëm për shkak që t'u jepet përgjigje punëtorëve edhe në obligimet që i ka pas ndërmarrja e vjetër, po edhe në obligimet që i ka AKM-ja për t'ia kthý 20% punëtorëve. Thjeshtë ne si bord e kemi shtý edhe më shpejtë këtë procedurë, duke marrë vendimin për likuidim ende pa u kry gjitha procedurat edhe për çështje tjera. Thjeshtë, bordi ka gatishmëri, por janë procedura ligjore që nuk mund t'i anashkalojmë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për zëvendësministrin Tomë Hajdaraj. E ka fjalën deputeti Xhevat Bislimi. Regjia ju lutem. Urdhëroni në foltore z. Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryetar, Lere që ju që nuk ma dhatë fjalën në fillim të seancës për rendin e ditës, po edhe teknika s'po donë me ma dhënë fjalën.

Z. zëvendësministër, gjatë periudhës së pushtimit kujdesi për ruajtjen dhe zgjerimin e tokës së bukës në Kosovë nuk ekzistonte pothuajse fare. Çdo vit Kosova humbiste mbi 1000 hektarë tokë buke. Pas Luftës anti-pushtuese çlirimtare të UÇK-ës me të drejtë prisnim një përkujdesje institucionale edhe për tokën e bukës në Kosovë. Por jemi dëshmitarë të zënies dhe shkatërrimit në rritje të kësaj toke. Pyetja- Sa hektarë tokë buke ka humbur Kosova gjatë këtyre tetë viteve? Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. zëvendësministër.

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Faleminderit z. kryetar. Z. deputet Bislimi. Pyetja e juaj ka një domethënie të gjanë për Kosovën, sidomos kur është fjala për gjendjen e krijuar tokës bujqësore. Ne duke parë këtë gjendje, menjëherë pas luftës kemi hartuar në prioritetet tona Ligjin për tokat bujqësore, i cili rregullon :shfrytëzimin, mbrojtjen, qiradhënien, mbikëqyrjen dhe inspektimin e saj.

Ligji për tokën bujqësore është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2005, ndërsa është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special në qershor, një vit më mbrapa, në vitin 2006. Pas shpalljes së këtij ligji Ministria menjëherë ka filluar zbatimin e tij, duke ndërmarrë aktivitete konkrete, siç janë: hartimi i 6 udhëzimeve administrative për zbatimin e ligjit, përgatitja e planit për zbatimin e ligjit, i cili është prezantuar në Qeveri dhe në të gjitha komunat e Kosovës. Në Ministri është themeluar Divizioni për tokat bujqësore ,në kuadër të cilit është Sektori për shfrytëzimin e tokës bujqësore, Sektori për rregullimin e tokës bujqësore, Inspektorati i shkallës së dytë për tokën bujqësore. Janë mbajtur takime me kryeshefat ekzekutivë drejtoratet dhe drejtorive komunale dhe zyrtarët e tjerë të komunave që merren me bujqësi, ku janë prezantuar kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë dhe komunave sipas ligjit dhe është kërkuar edhe emërimi i inspektorëve për implementimin e Ligjit për tokat bujqësore në të gjitha komunat e Kosovës. Sipas ligjit për tokën bujqësore ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore mund të

bëhet vetëm me planet hapësinore të komunës, pra plani zhvillimor i komunës dhe plani zhvillimor urban dhe plani rregullativ urban, të cilët komunat janë të obliguara t'i hartojnë sipas Ligjit për planifikim hapësinor i cili është aprovuar në vitin 2003.

Në pajtim me ligjin çdo komunë ka qenë e obliguar t'i miratojë planet hapësinore dhe urbanistike brenda afatit prej 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Nga kjo del se organ kompetent për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore dhe mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërrimet e kundërligjshme të destinimit është komuna brenda të së cilës është i domosdoshëm bashkëpunimi në mes të drejtorive komunale për planifikim dhe asaj për bujqësi e sidomos bashkëpunimi mes inspektorëve komunal për bujqësi dhe atyre për ndërtim. Pra, pa hartimin e planeve zhvillimore dhe për zonat rurale është shumë vështirë të mbrohet toka bujqësore. Por konkretisht për t'i dhënë përgjigje pyetjes së juaj ne kemi përgatit edhe raportin nga Ministria me të dhënat të cilat i kemi marrë nga të gjitha komunat e Kosovës. Pas luftës në Kosovë nga sipërfaqet e tokës bujqësore në pronësi shoqërore dhe publike janë uzurpuar 6 mijë e 457.5 hektarë tokë buke. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni z. Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. zëvendësministër, ju e thatë mirë se Ligji i ka obliguar komunat brenda 18 muaj të hartojnë planin e tjera e tjera, por t'i më thuaj ose ju më thoni- Sa komuna e kanë bërë planin hapësinor dhe për ato që nuk e kanë bërë çfarë keni ndërmarrë ju si Qeveri? Në qoftë se ligji i ka obliguar- sa komuna i kanë bërë këtë plan, ose edhe e kanë miratuar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Zëvendësministër urdhëroni.

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Faleminderit z. kryetar. Sigurisht se kjo është punë e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe në seancën e radhës ne sigurisht në bashkëpunim me ministrin Gjini do të japim edhe përgjigjen konkrete në këtë drejtim. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Pyetja e fundit. Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për ministrin Agim Veliu.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryetar, Z. ministër. Flitet e përflitet se në Kosovën tonë ka shumë diploma të falsifikuara ose false. Për këtë çështje ndonjëherë është shkruar edhe në gazeta. Thuhet e shkruhet se njerëz me këto diploma të rrejshme punojnë edhe në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe administratës. Madje thuhet se ka edhe ndonjë, si Astrit Haraqija e ndonjë tjetër që ka marrë diplomë pa hy kurrë në provim dhe pa parë kurrë profesorin me sy. Çfarë ka ndërmarrë Ministria juaj për vërtetimin e këtyre përfaljeve dhe parandalimin e kësaj dukurie të shëmtuar dhe të dëmshme dhe poshtëruese për shoqërinë tonë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. ministër urdhëroni.

MINISTRI AGIM VELIU – I nderuari kryetar i Kuvendit, deputetë të nderuar, i nderuar z. Bislimi.

Kam kënaqësinë t'ju përgjigjem në pyetjen e deputetit Xhevat Bislimi lidhur me diplomat e falsifikuara, si thotë ai. Njëkohësisht ndjej pezëm derisa përgjigjem kur shoh se pyetjen e tij e ka nisur me një gjuhë jo parlamentare dhe të kultivuar. Pyetjen tuaj z. Bislimi e keni nisur me shprehjen flitet e përflitet. Ju lutem- Çfarë serioziteti impononi pyetje që fillon me flitet e përflitet? Megjithatë, menjëherë po ju them se Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë merret me këtë dukuri në suazat e kompetencave që ka brenda hapësirave dhe mundësive ligjore. Po dukuria e falsifikimit të një dokumenti nuk është vetëm barrë e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Ajo është një problem i etikës sonë publike që duhet të goditet nga të gjitha anët dhe nga të gjitha institucionet.

Një diplomë e falsifikuar ndëshkohet dhe përcillet për në organet hetuese nga Ministria e Arsimit kurdo kur kjo është e mundur. Kurdo kur asaj i ofrohen të dhëna për këtë, kurdo kur ajo përmes pushtetit të saj institucional e zë një diplomë të tillë. Ministria është duke u marrë me rastet e tilla aty ku ka fakte, por jam i sigurt se një dukuri e tillë nuk mund të luftohet përmes parullave e fjalëve që nuk ofrojnë të dhëna konkrete.

Më së paku mund të goditet përmes shprehjeve- flitet e përflitet. I nderuar deputet. Desha të nderoj me këtë përgjigje statusin tuaj të deputetit, ndonëse formulimi i pyetjes suaj nuk linte hapësirë për ndonjë përgjigje. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni z. Bislim.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër. Për këtë çështje kanë shkruar edhe shtypi edhe masmediat dhe flitet e përflitet dhe shumë e drejtë të thuhet, sepse edhe ju e dini që flitet e përflitet, madje gjithë rrugët e çarshisë janë të mbushura me këto thënie e këto folje e përfole. E dini që shpërndahen diploma edhe me para ,besoj që jeni të informuar, por unë nuk jam as polic as hetuesi të mbledh fakte e t'i sjell te ju. Jeni ju që në momentin që përmendet dikush, flitet për dikën, shkruhet për dikën, ju duhet ta verifikoni si Ministri nëse ajo diplomë është marrë në mënyrë të rregullt nga një universitet, fakultet e tjera, e tjera. Prandaj, është puna e juaja edhe pyetja është shumë serioze dhe bile kjo është dukuri shumë poshtëruese edhe për shoqërinë tonë dhe veçmas për Ministrinë e juaj dhe qeverisjen tuaj në përgjithësi. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Shkojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Ka kaluar koha. Xhevat Bslimi

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Zoti kryetar, i kisha lutur këta kolegët deputetë të pozitës që të na kursejnë me kohën e pyetjeve, sepse këta vijnë nga grupet parlamentare ku bëjnë pjesë edhe ministrat e tyre në këto grupe. Vijnë nga parti ku bëjnë edhe ministrat në ato organe të partive, le të na lënë hapësirë neve opozitarëve, deputetëve opozitarë më shumë për pyetje dhe mos të na marrin kohë dhe çështja e teknikës që e kanë ngritur edhe një herë, të mos vihet teknika mbi deputetin, t'i ndërpritet brutalisht fjala deputetit ose ministrit. Kjo është çështje që mund të rregullohet, të sinjalizohet deputeti që po i mbaron koha, por jo teknika ta sundojë deputetin. Pastaj, puna që nuk po na e jepni fjalën, po shkëlpi procedurat. Në qoftë se mendoni këtë Kuvend me e shndërruar në teatër kukullash është vërtet gjynah edhe shumë gabim dhe këta deputetë

duhet t'i kundërvihen kësaj tendencë, se po mendojnë vetëm edhe ata penjtë me i vu këtu dhe deputetët me lëvizë sipas diktatit të juaj ose të grupit ku bëni pjesë edhe ju. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Është mendimi i juaj. Ju faleminderit!

Shkojmë, pika e katërt e rendit të ditës

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Projektligji u është shpërndarë, më 16 prill të vitit 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Dugolli që në emër të Qeverisë të Kosovës, para deputetëve ta prezantojë këtë projektligj.

MINISTËR BUJAR DUGOLLI -

- I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj.

Kam kënaqësinë që në vijim të paraqes shkurtimisht para jush rëndësinë dhe fushën e rregullimit të **Projektligjit për shoqëritë tregtare**. Ky projektligj do të jetë i zbatueshëm për të gjithë personat, ndërmarrjet dhe autoritetet publike në Kosovë.

Rëndësia e Projektligjit *për shoqëritë tregtare*, rrjedh nga fakti që ky instrument ligjor rregullon në mënyrë të plotë një aspekt të rëndësishëm të ekonomisë së tregut në Kosovë. Shoqëritë tregtare përbëjnë thelbin e funksionimit të mekanizmit të tregut në vend dhe njëkohësisht ato janë burim kryesor i prodhimit vendas, punësimit dhe rregullimit ekonomik të Kosovës. Ndaj në qendër të vëmendjes për hartimin e këtij projektligji kanë qenë jo vetëm kushtet konkrete të zbatimit të tij në Kosovë, por njëkohësisht edhe pasqyrimi i praktikave më të mira ndërkombëtare, duke siguruar gjithashtu, një përputhshmëri të plotë me normat vendeve të BE-së.

Deri më sot funksionimi i shoqërive tregtare në Kosovë është bazuar në rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/6 "*Për Shoqëritë Tregtare*", nëpërmjet së cilës u vendos për herë të parë në legjislacionin kosovar baza ligjore për rregullimin e marrëdhënieve në fushën e tregtisë, të ekonomisë së re të Kosovës.

Por zhvillimi i ekonomisë së Kosovës prej vitit 2001, integrimi i saj në tregun rajonal si dhe pritshmëritë pozitive që lidhen me përcaktimin e statusit final të Kosovës e kthejnë në rishqyrtim dhe bazën ligjore si një domosdoshmëri të kohës. Në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh se legjislacioni ekzistues ka vakumet e veta në përcaktimin e organizimit të biznesit, sipas të gjitha normave që parashihen në vendet e BE, por edhe atyre vendeve të rajonit, miratimi i këtij projektligji do të ndihmojë krijimin e një klime më të favorshme për të bërë biznes në Kosovë, duke u ofruar investuesve të huaj mundësi që ata do t'i gjejnë edhe në vendet e tjera.

Për këtë arsye, paraqesim përpara jush projektligjin e ri të hartuar, pasur parasysh faktorët e mësipërm. Qëllimi parësor i këtij projektligji është të përcaktojë formën e organizimit të shoqërive tregtare dhe rregullimin, funksionimin e tyre, si bazë e ekonomisë së tregut në Kosovë.

Në përgatitjen e këtij projektligji të rëndësishëm, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka respektuar procedurën ligjore dhe përcaktimin e Qeverisë së Kosovës në bazë të planit legjislativ për vitin që jemi. Ajo ka kërkuar edhe në këtë rast forcimin e marrëdhënieve institucionale të gjithë partnerëve relevantë dhe grupeve të caktuara të interesit dhe përfaqësuesve të tyre që lidhen me këtë fushë.

Projektligji, përmban një kornizë rregullatore të plotë e të detajuar për shoqëritë tregtare. Projektligji përbëhet prej 8 pjesëve dhe 236 nene.

Pas , përkufizimit,qëllimit dhe fushës së rregullimit,

- Në pjesën e dytë të projektligjit, shprehet organizimi e funksionimi i regjistri dhe regjistrimi i shoqërive tregtare;
- Në pjesën e tretë, flitet për organizimin dhe funksionimin e sipërmarrjeve individuale;
- Në pjesën e katërt, flitet për organizimin dhe funksionimin e shoqërive kolektive;
- Në pjesën e pestë, për organizimin dhe funksionimin e shoqërive komandite;
- Në pjesën e gjashtë, për organizimin dhe funksionimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar;
- Në pjesën e shtatë, për organizimin dhe funksionimin e shoqërive aksionare dhe
- Në pjesën e tetë, shprehen dispozitat kalimtare të ligjit.

Projektligji i përgatitur nga grupi punues i Qeverisë të Kosovës është i përafuar me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Në hartimin e këtij projektligji, përveç ekspertëve vendorë rol të rëndësishëm dhe vendimtar kanë luajtur ekspertët nga Agjensioni i Sheteve të Bashkuara të Amerikës USAID dhe Agjencioni Evropian për Rindërtim ...

Të nderuar deputetë !

Rregullimi juridik i kësaj fushe për ndërtimin e një ekonomie të Kosovës, të bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, është shumë i rëndësishëm. Projektligji do të vendosë një rregull ligjor për sa i takon shoqërive tregtare në Kosovë, duke ofruar garanci juridike, institucionale për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga krijimi, organizimi, funksionimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i shoqërive tregtare.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e plotësisimit të kuadrit ligjor në fushën ekonomike në përgjithësi, ju rekomandojmë që pas shqyrtimit në parim ta miratoni projektligjin ,që është shumë i rëndësishëm.

Ju faleminderit për vëmendje !

KRYETARI KOLË BERISHA – Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së
Urdhëroni Brikenda Kryeziu

DEPUTETJA BRIKENDA KRYEZIU – Ju faleminderit z. kryetar, të nderur
ministra, kolegë deputetë,

Projektligji për shoqëritë tregtare, i sponzoruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është një ligj, projektligj bazik me rëndësi të veçantë, jo vetëm në aspektin e fushëveprimit që mbulon, por pjesë e rëndësishme e legjislacionit që ndikon në zhvillimin e tërësishëm ekonomik. Ky projektligj paraqet kornizën themelore të legjislacionit, i cili është në harmoni me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, në kushtet e reja të liberalizimi të tregut, duke zëvendësuar Rregulloren 2001/6, e cila nuk përkon më me realitetin e krijuar në kushtet e tanishme ekonomike. Gjithashtu, Ky ligj përmban edhe koston buxhetore që tregon kriteret financiare të parashikuara dhe të përballueshme me buxhetin e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës me kujdes të veçantë ka shqyrtuar këtë projektligj, duke vlerësuar projektligjin në aspektin e përgjithshëm si të konceptuar mirë, kurse në aspektin legjislativ është mjaft i avancuar, paraqet zbatim të politikave të propozuara sipas kategorive të caktuara të shoqërive tregtare. Gjithashtu, përcakton mënyrën e qartë dhe të detajuar për të drejtat, obligimet, detyrimet e secilës shoqëri tregtare në veçanti.

Njëkohësisht në këtë projektligj vlerësojmë se ka edhe disa vërejtje parimore edhe teknike, të cilat duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm.

Në aspektin e vërejtjeve parimore, në tërësi të projektligjit, në mënyrë kronologjike mund të veçoj: mungesën e përcaktimit të afateve kohore në nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat në disa fusha paraqesin kusht themelor në implementimin e këtij ligji, sidomos në aktet nënligjore ku përcaktohen edhe tarifat për regjistrimet dhe aktet e tjera përcjellëse.

Çështje tjetër është se nuk është i definuar përcaktimi i gjykatave se cilit juridiksion i takojnë rastet e kontesteve, duke marrë parasysh që ekzistojnë: gjykata ekonomike, gjykata për kundërvajtje dhe gjykata të tjera dhe organe relevante.

Nuk parasheh mundësinë e delegimit të përgjegjësive të kufizuara, të autorizuar nga Zyra e regjistrimit në nivelet regjionale dhe ato komunale, për hapjen e zyrave të, me qëllim të lehtësimit, të ofrimit të shërbimeve. Nuk parasheh edhe mënyrën e qartë për procedurat e ndarjes së shoqërive tregtare që është çështje mjaft me rëndësi, po aq e rëndësishme sa edhe bashkimi i tyre.

Është me rëndësi që në dispozitat kalimtare të përcaktohet njohja e statusit të shoqërive aksionare të regjistruara në gjykata, e cila njëkohësisht është pranuar edhe i njëjti status është pranuar edhe nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, duke kërkuar në vazhdimësi plotësimin e përmbushjes së të gjitha procedurave të ligjit të aplikueshëm pranë Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë.

Në aspektin e vërejtjeve teknike, duhet të qartësohen formulimi i disa neneve të caktuara, të rregullohet radhitja e tyre, si dhe paraqiten edhe dispozitat e neneve të caktuara që kanë dykuptimësi.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke marrë për bazë vërejtjet e paraqitura dhe duke shprehur gatishmërinë për të kontribuar, e mbështet në parim projektligjin me qëllim që funksionimi i plotë i këtij projektligji duhet të pasurohet edhe me ligjet e tjera po aq të rëndësishme sa që është edhe ky projektligj. Andaj, i

rekomandojmë Qeverisë, njëkohësisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të fillojë përpilimin e Projektligjit mbi tregtimin e letrave me vlerë dhe emetimit të aksioneve, të cilat do të përmbushin në tërësi bazën legjislative të shoqërisë tregtare, jo vetëm në aspektin e themelimit dhe të funksionimit, por gjithësesi edhe në aspektin e tërësishëm ekonomik.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga PDK-ja deputetja Sala Berisha Shala

DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë dhe anëtarë të Qeverisë

Projektligji për shoqëritë tregtare e rregullon një fushë shumë të rëndësishme të ekonomisë së tregut dhe bizneseve në Kosovë. Kjo materie më parë është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6 për shoqëritë tregtare. Andaj, Partia Demokratike e Kosovës mendon se ,pavarësisht se në çfarë niveli është hartuar ky projektligj, përparësia e tij është se e zëvendëson një rregullore të UNMIK-ut.

Hartimin e projektligjit e përcjellin mjaftë dobësi dhe mangësi ndër të cilat shkurtimisht do t'i veçoja disa prej tyre me radhë. Që në fillim bie në sy një gjë. Dihet se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka hartuar Projektligjin në fjalë, por nuk dihet me çfarë ekspertësh, vetëm i përmend, keni parasysh, nuk dihet cili është grupi punues që e ka hartuar projektligjin.

Pse duhet të dihet grupi punues? Vlen të përmendet ,përveç tjerash edhe për arsyen e veçantë nga se, kur në grupe punuese mungon përfaqësuesi i UNMIK-ut, po ndodh të ketë pastaj edhe si pretekst për zvarritjen e nënshkrimi e tij nga Përfaqësuesi Special.

Nën dy, vërejtja tjetër është: harmonizimi i versioneve gjuhësore. Në shikim të parë është një element teknik jo shumë i rëndësishëm, por megjithatë praktika ka treguar se edhe kjo është një ndër zvarritjet për mosnënshtrimin , krahas konfuzionet në zbatimin e ligjeve të tilla.

Nën tre, do të veçoja një mangësi tjetër që po përcillet në shumicën e projektligjeve e që vërehet edhe te ky projektligj. Fjala është mos përcaktimi i afateve kohore për nxjerrjen e akteve përcjellëse nënligjore të cilat do të bënin më lehtë të zbatuar një ligj. Mangësia e tillë në shumë dimensione, përveç që e vështirëson implementimi e ligjit, krijon hapësirë edhe për interpretime të ndryshme, që një rast të tillë kemi pasur rastin ta shohim në terren gjatë monitorimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit si Komision parlamentar. Në këtë drejtim Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk e ka kryer obligimin e vet në kuptimin e nxjerrjes së akteve nënligjore që sugjerojmë se kësaj radhe të jetë më e vëmendshme. Në lidhje me këtë problematikë, rekomandojmë se në lidhje me çështje të tilla, siç është nxjerrja e akteve nënligjore do të ishte mirë të hartohet një projektligj i veçantë për legjislacionin sekondar që do t'i rregullonte edhe afatet kohore pastaj.

Në fund, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim në parim këtë projektligj, duke dhënë kontributin tonë në Komisionin funksional.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga AAK-ja Xhevdet Neziraj

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuar z. kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Krahas trendit botëror të ekspansionit të shoqërive tregtare edhe në Kosovë, e sidomos nga viti 1990, filloi formimi i shpejtuar i shoqërive tregtare. Derisa në shumë vende shoqëritë tregtare paraqiten në funksion të stabilizimit dhe të ekspansionit ekonomik, në Kosovë ato u formuan dhe po formohen, para së gjithash, me qëllim të përballimit të situatës së krijuar politike dhe ekonomike. Por, tani kur Kosova është në prag të statusit final, ku Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka lidhur marrëveshje të tregtisë së lirë me vendet e rajonit, ka nënshkruar marrëveshjen në kuadër të CEFT-ës, tani Qeverisë dhe ministrive ju mbetet të përgatisin legjislacion kosovar në sferën e ekonomisë, ku duhet të ndryshojë konceptin e punës, konceptin e zhvillimit dhe të hyjë në hapa të rinj afarist. Për të hyrë në hapa të rinj afarist është e domosdoshme që të kemi edhe infrastrukturë të mirëfilltë ligjore, ku veprimi i shoqërive tregtare të veprojnë në një situatë institucionale dhe krejtësisht të sigurt, që do të ndikojë në zhvillimin e hovshëm ekonomik. Ristrukturimin e sistemit ekonomik i politikës së zhvillimit të gjitha politikave makroekonomike, me fjalë të tjera, një ristrukturim të jetë i tërë hapësirës ekonomike në bazë të ekonomisë të tregut.

Me një infrastrukturë të mirëfilltë ligjore dhe në rrethana stabile politike-ekonomike, atëherë promovimi i shoqërive tregtare do të ishte shumë më i organizuar dhe me efekteve më të mëdha për ekonominë e Kosovës dhe në këtë edhe të hyra më të mëdha buxhetore. Prandaj, me Projektligjin për shoqëritë tregtare rregullohet fusha e tregtisë në mënyrë specifike, forma e organizimit, llojit, drejtimi dhe funksionimi i shoqërive tregtare, që nga themelimi e deri te likuidimi dhe përcaktimi i fazave të likuidimit të tyre.

Me Projektligj rregullohet veprimtaria e shoqërive tregtare, ku veprimtaria e tyre është me blerjen e prodhimeve dhe prodhuesi apo nga shitësi i mallit dhe shitja e mallrave te blerësit, pra konsumatorëve. Pos blerjes dhe shitjes shoqëritë tregtare merren edhe me kryerjen e disa punëve të ndërmjetësimit. Me fjalë tjera, detyra e shoqërisë tregtare është që nëpërmes shitjes dhe blerjes së mallrave të sigurojë vazhdimësinë e pandërprerë të procesit të riprodhimit shoqëror. Ky projektligj do të zëvendësojë Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6, që është miratuar dhe nënshkruar nga Përfaqësuesi Special që në vitin 2001. Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës përgëzon Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për punën që e ka bërë për këtë projektligj me shumë rëndësi për ekonominë e Kosovës, sepse me këtë projektligj plotësohet një vakum ligjor që do të rritë efektet pozitive në ekonominë e Kosovës, në buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe në punësim. Mirëpo si çdo projektligj edhe ky mbi shoqëritë tregtare duhet të plotësohet dhe të pasurohet e që këtë do ta bëjmë Komisionin Funkcional dhe kontributin për këtë do ta japin deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do të thotë deputetët e AAK-së dhe IRDK-së në Komisionin Funkcional dhe në komisionet kryesore që do të kalojnë projektligjin. Prandaj, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë projektligj dhe përgëzon Ministrinë për një projektligj mjaft me rëndësi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nga ORA, deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI - Ju faleminderit z. kryetar edhe pse sot shumë keq e keni nis këtë seancë tue mos u bazu fare në Rregulloren e punës, por sidoqoftë në punën do ta vazhdojmë.

Të nderuar kolegë deputetë,të nderuar ministra

Ligjin që e kemi përpara e të cilin më është caktu ta analizoj nga ana e grupit tim parlamentar është një nga ligjet e rralla në Kuvendin e Kosovës që ka ndodhur të vij kaq i harmonizuar dhe kaq i ndërtuar mirë . Në këtë aspekt nuk do të kisha dashur shumë të ndalem në ato që i thanë parafolësit e mi, përveç se ta përsëris edhe një herë atë që kolegeja Sala e përmendi që, në shkresat përcjellëse të projektligjit mungojnë emrat e hartuesve të projektligjit dhe vetë mungesa e emrave të hartuesve mu më bën të dyshoj se ndokush nga vendorët ka marrë pjesët në hartimin e këtij ligji. Këtu ministri na tha që ka marrë pjesë nga USAID-i nga AER-i, por kisha pasur shumë dëshirë ta di se a ka pasur vendor që ka marrë pjesë në punën e këtij ligji, sepse ky ligj është ligj i mirë. Ka pasur raste kur kam thanë për ligje – ky është ligj i keq, ky është ligj i mirë edhe droj shumë që ne në Kuvend, në Komision të Kuvendit mund ta prishim ligjin, kaq është mirë i harmonizuar, kaq është mirë i ndërtuar dhe i konceptuar. Prandaj, mendoj se do të ishte shumë mirë që ministri të na jep informata se kush ka qenë në grup punues me emër, që së paku publikisht t'ua shprehim një mirënjohje njerëzve të cilët kanë punuar në atë ligj dhe një gjë tjetër që duhet po ashtu ta theksoj është deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së. Është një agjenci në kuadër të Qeverisë, e cila e ka ndërtuar autoritetin e vet në përcjelljen e ligjeve me rekomandime dhe të cilët, kryesisht janë shumë korrekt dhe shume të qartë në shkresat përcjellëse të ligjeve, atëherë kur nuk përshtaten me legjislacionin e BE-së d.m.th. nuk përshtaten, atëherë kur kanë dyshime thonë se nuk është në shpërpushje, kësaj radhe e kanë thënë me shumë zë që Projektligji është gjerësisht në përputhje me parimet e **aki-kmuniter**, prandaj edhe analiza e këtij ligji, nga ana ime ka qenë shumë më sipërfaqësore, tue marrë parasysh besueshmërinë që kjo zyre e ka ndërtuar në raport me punën e vet që e ka bërë deri sot.

Ne Grupi Parlamentar ORA e përkrahim këtë projektligj. Sigurisht që në Komision do të përpiqemi që ky ligj të mos pësojë ndryshime,të cilat do ta sakatojnë dhe do të mundohemi që ta bëjmë punën tonë.

Ju faleminderit!

KRYETAI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Në emër të LDD-së , Ramadan Kelmendi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit. I nderuari kryetar, të nderuar ministra prezentë, kolegë të nderuar,

Grupi ynë parlamentar i LDD-së e ka marrë në shqyrtim këtë propozim ligj për tregtinë dhe shoqëri tregtare dhe pas analizave në raport, me nivelin e shoqërive tregtare dhe qëllimin që Ministria ia ka parashtruar vetës dhe dëshirës që të arrihet me këtë propozim ligj, vlerëson:

- Nën një, Propozim ligji nuk është adekuat me nevojat e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare në nivelin e Kosovës,

- Dy, Propozim ligji nuk është i formuluar në disa raste dhe formulimet janë shumë të gjata dhe do të ishte më e udhës të ishte i shkurtër, i kuptueshëm ngase kemi disa raste, që disa dispozita janë në kundërshtim njera me tjetrën,

- Tre- Propozim ligji vështirë në disa pjesë se mund të zbatohet në praktikën e përditshme. Megjithatë në vlerësojmë se ekipi që e ka bërë hartimin e këtij propozim ligji ka treguar një vlerë të lartë të punës të ekspertëve të fushës konkrete dhe të fushës praktike, gjë që në tërësi mund të vlerësojmë se Ligji është në pajtueshmëri edhe me BE-në.

Propozim ligji ka disa të meta, të cilat vërtet në procesin e mëtutjeshëm duhet të eliminohen, ngase- gjashtë-nuk specifikon llojet e shoqërive tregtare, veprimtarinë dhe format e tyre. Kriteret për regjistrimin nuk i përcakton në tërësi, duke i numëruar ato më parimore të shoqërive tregtare, nuk sqaron rolin e ortakut në shoqëritë tregtare. Nën nëntë- format e bashkimit të shoqërive aksionare i lenë pezull, por i hap si tema të përcaktuara dhe nën dhjetë - kapitali dhe ndarja e kapitalit nuk i përcakton kompetencat gjyqësore në rast të konflikteve të interesit apo edhe mosmarrëveshjeve eventuale.

Shikuar në tërësi, përkundër këtyre sugjerimeve, të cilat vërtet duhet konsideruar qëllimshëm në konsiderojmë se vërejtjet mund të eliminohen me amendamentimin që dhe ne do të ta bëjmë përmes Komisionit Funkcional dhe amendamenteve individuale, andaj i japim përkrahje të plotë në punën e mëtutjeshme këtij propozim ligji.

Ju faleminderit!

KRYETAI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ Mahir Yagcilar

DEPUTETI MEHIR YAGCILAR - Sayın Meclis Başkanı, sayın bakanlar ve değerli milletvekilleri

6+ Parlamenter Grubu, Piyasa Şirketleri Yasasını özel dikatle görüştü. Grup olarak her devletin en önemli yasalarından biri olan, aynı zamanda piyasa şirketlerinin normal işlevliliğini sağlayan ve ekonominin gelişmesini destekleyen bu ve benzeri yasaların kabul edilmesi gerektiğini düşünüyoruz. Yasa Tasarısı, Piyasa şirketlerinin kayıt koşulları yanı sıra, çeşitli pazar şirketlerinin hak ve görevlerini, menajerlerin ve yöneticilerin hak ve görevleri yanı sıra üçüncü tarafın da hak ve görevlerini öngörürken, Piyasa Şirketlerinin oluşmasını, faaliyetlerini, onların düzenli ve etkili likidasyonunu teşvik eden ve kolaylaştıran yasal hükümleri içermektedir.

Yasa Tasarısı temelde Özel Şirketler, Karma Şirketleri, Paylaşım Şirketleri, Sınırlı Limitli sorumluluk Şirketleri, Hissedar Şirketleri olmakla beş çeşit ortaklığı kapsarken bütün piyasa ortaklık şekillerinde kapsamaktadır diyebiliriz.

İlk bakışta Yasanın aşırı kapsamlı ve bileşik olduğu intibası yaratılmaktadır. Ancak özenle okunurken bu Yasanın aslında, şirketlerin iç hukuki ve yasal düzenlemelerini oluştururken dolayısıyla piyasanın normal işlevliliğinin konusunda Piyasa Şirketlerine aslında yardımcı olmaktadır.

Premsipte bu yasanın, Kosova'da Piyasa Şirketlerinin yasallaşmasına, elverişli piyasa uygulamasına olumsuz davranışları sınırlandıracağına, Kosova'da hizmet ile üretimin

daha kvaliteti olmasına yardımcı olacağına, ve ayrıca Avrupa standardlarına görev uygun bir yasa olduğuna inanmaktayız.

Yasa Tasarısının gelince özel olarak 13.6 noktası hakkında uyarımız bulunmaktadır. Bu hüküm bize göre, Piyasa Şirketi adının kullanılması açısından özgürlüğünü kısıtlamaktadır, bu yüzden sözkonusu hükümün de, Kosova Meclisinde önceden kabul edilen Yasaları ile uyumlu olması gerektiğini düşünüyoruz. Sonunda prensipte bu Yasa Tasarısının, kabul edilir halini olduğunu düşünüyor ve Meclisin ilerideki ek süreçlerde çalışmalar sayesinde, uygulanması için en uygun şekline alacağına inanıyoruz.

Dikkatinize teşekkür ederim, Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Grupi për Integrim. Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush

DEPUTETJA VEZIRA EMRUSH - Hvala Lepa! Pozdravljam Predsednika Skupštine, sve kolege poslanike i gospodu ministrie,

Ja sam predstavnik subjekta GIG-a i veliko mi je zadovoljstvo da sam član ove Skupštine.

Kada smo dobili Nacrt zakona o trgovačkim društvima, pošto sam član Komisije za edkonomiju, trgovinu, energetiku, transport i telekomunikacije, imala sam priliku da u istoj komisiji dana 8.05. da raspravljamo bliže i o ovom Nacrtu zakona. Zakon u suštini sadrži obavezu uspostavljanja zdravih tržišnih uslova na Kosovu gde se daje zakonska obaveza za registraciju svih trgovačkih preduzeća koji u Zakonu ima 5 vrsta formi udruživanja, da ne bih ponavljala, ovde su prethodne kolege rekli o kojim se formama udruživanja radi, radi se od individualnog do koektivnog deoničarskog društva akcinarskog.

Zakon opisuje i način i formu udruživanja i način registracije i plaćanje taksu za osnivanje jednog vida preduzeća po svojim grupacijama i delatnostima sa obaveznim elementima i potrebnom dokumentacijom za registrovanje, kao što su trgovačko ime, ime osnivaoca, adresa i delatnost udruživanja.

U zakon je analizirana i forma svih udruživanja i raspodela kapitala, bez obira da li su u pitanju osnovna, obrtna sredstva, gotovni novac ili pak hartija od vrednosti. Zakon ne analizira i sve obaveze trgovačkih udruženja na ime prekršaja zakona sa obaveznim članovima i amandmanima da snose zakonsku kaznenu formu od strane sudskih organa na osnovu.

Zakon stvara obavezu da se radne finansijski izveštaji, da se vodi knjigovodstvo, knjigovodstvo ne ovo knjige kako bi se došlo do samih izveštaja, ali ne prejudicira da ima obavezu revizije, redovne revizije jer znamo svako osnovno preduzeće da ima svoju dobit i da ima obavezu da da jedan deo državi. Ovakav vid zakona do sada je funkcionisao na ime UNMIK-ove Uredbe br. 2001/6, to smo čuli i da bih ovaj zakon saživeo prethodno je potrebno da se stavi van snage ova Uredba o trgovačkim društvima.

Zakon o trgovačkom društvima, čuli smo da je ovde uradila Agencija za registraciju biznisa, USAID i Radna grupa Vlade Kosova. Medjutim, žalosno je do je jedna od velikih primedbi da u Zakonu nema potpisnika, to je kada uradite neko delo a autora nema. U Zakonu je isto dato da taj zakon, troškovi na ime izrade tog zakona su 327.285 €, to je za 2007, 2008. i 2009. godinu, gde vidimo da je puno ljudi radilo na

tom zakonu 27 ljudi i jako je dobro da znamo imena i prezimena svih ovih koji imaju udela u ovom radu.

Zakon smo dobro izanalizirali ponovo i sa svojom Grupom za Integraciju, sa članovima i sa šefom grupe g. Ferit Aganijem, i u potpunosti se slažemo da je Zakon dobar, da je neophodno da saživi na kosovskom tržištu, gde je opšti haos udruživanja, da se što pre spremimo za zdravu trgovinu i proizvodnju, pošto smo zemlja u tranziciji i samo sa zakonskom formom sredjenog tržišta možemo da privučemo strani kapital koji nam je sada neophodan za svakog radjanina na Kosovu.

Da se prece sve slobodne forme udruživanja i svaki šverc koji okupirao naše tržište posle rata. Zakon nema diskriminacionu formu, te štiti interese svih zajednica kao interese i moje zajednice čiji sam subjekat. Zakon je usladjen sa Evropskim zaonom i pošto je Kosovo nedavno postalo i članica CEFTE, moramo što pre da se evropski organizujemo i da koordiniramo sa svim regijonima u svim delatnostima trgovine i da se trudimo da pored anormalnog uvoza imamo i uspešno povećanje izvoza u regionu. Treba da se trudimo da na evropskom tržištu ne budemo slepo crevo nego jedan važan vitalni organ. Što se zakona tiče podržavamo sve stavke zakona, ima pojedine forme koje koje ćemo u pismenoj formi da damo na neke članove i amandmane zakona da se što više udje u suštinu samih amandmana oko stečaja. Još bih htela da dam veliku formu i kada su u pitanju društvo kompanija sa ograničenom odgovornošću i deoničarsko društvo - akcionarsko. Moramo da pazimo jako zato što se radi o interesima radnika u ovim velikim preduzećima, znate da je transformacija društveno u privatni kapital i tu treba da se izradi dobar zakon o deonicima da ne bih radnici bili oštećeni za to što je sada spremaju se preduzeća za privatizaciju.

Toliko oko zakona, rekla sam još jednom da ćemo nešto u ovim komisijama kojima radimo da damo nešto u pismenoj formi oko ispravke. U načelu se slažemo sa Zakonom i čestitamo i pozdravljamo, i verujemo da će Zakon da saživi na Kosovu.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI - Ju faleminderit z. kryetar. Fillimisht përshëndetje për të gjithë, për kolegët deputetë, për ministrat

Fillimisht dua të vë në pah se ky projektligj është i dytë që del në Kuvendin e Kosovës, pasi projektligji i parë ka dal para deputetëve qysh në mandatin e kaluar dhe, edhe pse pat kaluar në shqyrtimin e parë në parim dhe u amendamentua nga Komisioni Funkcional, nuk kaloi në shqyrtimin e dytë dhe ky ishte një veprim i përgjegjshëm i deputetëve të mandatit të kaluar, pasi që ishte një draft, i cili me të metat tepët të mëdha që kishte nuk mund të bëhet ligj funksional. Edhe sa i përket këtij drafti, nuk jam fort optimist se do të ketë mundësi të përpunohet në atë nivel sa të plotësojë kriteret e një ligji të suksesshëm. Për të ardhur në përfundimet e mëposhtme, kam konsultuar ekspertë të shumët të kësaj lëmie, pasi kemi të bëjmë vërtet me një materie tejet të komplikuar të një ligji tejet të rëndësishëm për komunitetin e biznesit.

Ja vërejtjet e mia: Ky, nën një do të ishte më mirë të emërohej Projektligji për ndërmarrjet e jo siç është kështu Projektligji për shoqëritë tregtare.

Nën dy, nuk janë përkufizuar me ligj organet e shoqërive të kapitalit Kuvendi, Këshilli drejtues e ai mbikëqyrës, të cilat organe janë me rëndësi shumë të madhe për përcjelljen dhe rregullsinë që duhet të ekzistojë në punën e tyre.

Nën tre, nuk rregullohen aktet normative të shoqërive tregtare, siç është statuti, një akti me rëndësi sidomos për shoqëritë e kapitalit që krijon një rregullsi në jetën e tyre dhe ka rëndësi informative për të gjithë pjesëmarrësit, sepse në këtë mënyrë ata i njohin të drejtat dhe obligimet e tyre në mënyrë të çartë. Kjo është me rëndësi të madhe, sepse këto trajta të shoqërive tregtare po formohen te ne për herë të parë tani, kur mungon përvoja dhe çdo çështje që nuk është qartë e rregulluar me ligj, ajo do të ketë pasoja tejet të mëdha në praktikë.

Nën katër, renditja e trajtave të shoqërive dhe subjekteve afariste është bërë në mënyrë jo të pranueshme, si dhe statusi i tyre juridik, regjistrimi i tyre dhe organi i cili duhet të mbajë regjistrin, e ky organ do të duhej të ishte Gjykata Ekonomike apo Tregtare e jo Agjencia dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Nevoja e komunikimit me gjuhë të njëjtë afariste, me shtetet më të zhvilluara dhe shtetet tjera po i imponon kriteret e standardizuara të klasifikimi të shoqërive tregtare, të cilat e kanë statusin e personit juridik dhe regjistrohen në regjistrin e gjykatave tregtare apo ekonomike, të cilat e krijojnë një rregull e disiplinë, sepse e njohin ligjin dhe formalitetet gjyqësore. Pra, do të ishte lëshim tepër i madh që këto punë t'i kryejë ndonjë ministri e jo gjyqi i lartpërmendur.

Nën pesë, në aspektin juridik ndërmarrja nuk është nocion juridik dhe nuk mund të jetë subjekt juridik. Subjekti juridik mund të jetë vetëm shoqëria ekonomike e cila është bartëse e ndonjë ndërmarrjeje dhe ndërmarrëse.

Nën gjashtë, jo vetëm gjuha juridike, por edhe në përgjithësi shprehjet gjuhësore janë tejet të rënda dhe të ngatërruara etj. Sidoqoftë, meqë shumica e parafolësve u shprehën në favor të shkuarjes në shqyrtim të dytë edhe unë nuk po e kundërshtoj për të dhënë këtë vizë, por më është e qartë se ne që jemi në Komisionin FunkSIONAL ku edhe i përket ky projektligj do të kemi shumë punë me përgjegjësi për ta bërë një ligj të suksesshëm.

Unë në fund dua t'i kërkoj falje ministrit Sadik Idriz për faktin se nuk e kam ditur qysh nuk i ka shkuar pyetja parlamentare, por z. ministër kjo është çështje e administratës që është ngatërruar dhe ju kërkoj falje.

Ju faleminderit shumë për mirëkuptim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi

DEPUTETI IBUSH JONUZI - Ju faleminderit. I nderuari kryetar, ministra të respektuar, deputetë të çmuar, zonja dhe zotërinj.

Ne si Komision funksional e kemi shfrytëzuar të drejtën në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit dhe punës së komisioneve funksionale. Projektligjin për shoqërinë tregtare e kemi shtruar në Komision, para se me ardhë në shqyrtim të parë në seancë plenare.

Përgëzoj grupin punues për hartimin e Projektligjit për shoqëri tregtare dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Njëkohësisht i falenderoj të gjithë deputetët deri tani që dhanë vlerësim pozitiv për një projektligj mjaft mirë të hartuar. Asnjë deri tani e as ky nuk mundet të jetë i përkryer, por sidoqoftë në punën e mëtutjeshme për sugjerimet, vërjetjet dhe propozimet që u dhanë, Komisioni FunkSIONAL në fazën e

amendamentimit do të përpiqet me përpikëri t'i inkorporojë dhe besoj se projektligji përfundimisht do të jetë mjaft mirë i hartuar.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. Xhemajli, faji është i administratës së juaj personalisht. E keni atë. Shkojmë më tutje

DEPUTETI MILAZIM HALITI - Ju faleminderit z. kryetar. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Projektligji për shoqëri tregtare i propozuar nga Ministria për Tregti dhe Industri është i rëndësishëm, duke pasur parasysh se me këtë bëhet plotësimi i vakumit në lëmin e tregtisë. Në fakt kjo fushë rregullohej me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6 për shoqëritë tregtare, që ka pasur rëndësinë e duhur, sepse më të janë vu bazat për rregullimin e marrëdhënieve në ekonominë e re të tregut.

Projektligji është në përputhshmëri me praktikën e avancuar dhe të legjislativitetit të Bashkimit Evropian për shoqëritë tregtare edhe nuk paraqet ndryshim të sistemit, por mbështet një sistem ekzistues të kësaj fushe në Kosovë. Projektligji për shoqëritë tregtare është mjaft voluminoz. Projektligji rregullon organizimin e regjistrimit të shoqërive tregtare, çështjet administrative, pastaj organet drejtuese të tyre. Gjithashtu bën edhe kufizimin e sjelljeve të palejuara që janë në kundërshtim me veprimet e mira tregtare. Ky projektligj ka një strukturë të mirë ligjore dhe është hartuar mirë nga ekspertët, për çka gëzon përkrahjen për miratim në parim.

Sic u theksua edhe më parë se projektligji është voluminoz dhe rregullon një fushë të gjerë dhe disa formulime të neneve janë shumë të gjata, që ka nevojë për riformulime me qëllim të kuptimit më të mirë dhe të zbatimit më të lehtë në praktikë. Po i theksoj edhe disa nga vërjetjet e mia, siç është te neni 170, i cili bën fjalë për numrin e anëtarëve të Bordit të drejtorëve ku thotë se një shoqëri me 500 ose më shumë anëtarë, Bordi duhet të ketë jo më pak se 7 anëtarë, por nuk e thotë se sa mund të ketë më së shumti.

Neni 183.3, ku thotë: "Udhëheqësi mund të zgjedhet nga Bordi i drejtorëve", Bordi mund, sipas dëshirës, të jetë një personi- titullin kryeshf ekzekutiv, kryetar, drejtor menaxhues ose ndonjë titull të ngjashëm, që në këtë rast lenë mundësinë e vendosjes sipas dëshirës për më shumë se katër alternativa, që nuk do të duhej të jetë kështu.

Neni 185 parashih shkarkimin e nëpunësit ku thotë: "Çdo nëpunës mund të shkarkohet nga Bordi i drejtorëve në çdo kohë sipas diskrecionit të tyre dhe pa ndnjë shkak të caktuar". Edhe në këtë rast do të duheshin argumente ose arsye për vendosje në këtë mënyrë. Do të duhej gjithashtu të përcaktohej me ligj edhe gjykata kompetente që do të merrej me zgjedhjen e lëndëve pasi që kjo nuk është paraparë.

Për fund, në parim e mbështes miratimin e këtij projektligji, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet e parashtruara gjatë leximit të parë, mendoj se do të merren parasysh nga Komisioni Funkcional gjatë amendamentimit dhe ky projektligj do të plotësohet dhe të kompletohet më mirë.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Kandidat i fundit është deputeti Behxhet Brajshori

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI - I nderuari zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë

Unë që në fillim them se e mbështes miratimin e këtij projektligji në këtë fazë, në leximin e parë dhe miratimin e tij për të shkuar në procesurat e mëtutjeshme parlamentare, për tri ose katër arsye, në mes të shumë arsyeve të tjera. Natyrisht se e para është se ky ligj, do të thotë është një ligj më shumë në fushën e ligjeve ekonomike që rregullon një fushë tepër të rëndësishme sikur që është organizimi i shoqërive tregtare të të gjitha tipeve apo llojeve dhe funksionimin e tyre.

E dyta, ky ligj do të mundësoj një mundësi më shumë, do të ketë që investitorët e jashtëm të investojnë në Kosovë. Çështja e tretë që po ashtu është e rëndësishme, mendoj se në krahasim me disa ligje tjera të cilat pastaj në praktikë po na nxjerrin telashe të mëdha, ky ligj nuk ka implikime buxhetore shtesë. Përkundrazi, ka mundësi të realizohen të hyrat e caktuara, të cilat natyrisht do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi.

Besoj se në hapat e mëtutjeshëm do të korrigjohen edhe ato të meta që projektligji i ka. Projektligji është mjaft voluminoz, e ndoshta në interpretim do të jetë pak më vështirë dhe duhet shkurtuar nenet që ato të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme dhe më të lehta për implementim. Unë e mbështes projektligjin në këtë fazë.

Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!
Ministri Dugolli ka një sqarim

MINISTËR BUJAR DUGOLLI — Për mos t'i mbetur borxh Kuvendit pasi që ky Ligj është ligj kapital, ligj më i rëndësishëm për ekonominë, unë do të jep edhe emrat e ekspertëve. pasi që këta emra të ekspertëve janë bërë të ditur për Qeverinë, radhëve të tjera do t'i dërgojmë te Komisioni Funkcional dhe pse nuk ka qenë praktikë ne do ta aplikojmë këtë praktikë me kërkesën e juaj. Do t'i bëjmë me dije emrat për të pasur besimin dhe ju që gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të kihet kujdes që të mos ndodhë ndoshta që me u dëmtuar, duke marrë për bazë atë punë që është bërë nga ekspertët.

Ministria e Tregtisë ka pasur 4 përfaqësues:

1. Hakif Jashari, kryesues- shef i Zyrës Ligjore,
2. Naser Grajçevci, zëvendëskryesues – shef i Agjencisë për Ndërmarrje të Vogla e të Mesme,
3. Blerim Burjani,
4. Salih Ibishi, nga Kabineti i Ministritë, përfaqësues, anëtarë
5. Fehmi Stublla nga Zyra e Kryeministrit, anëtar
6. Ardian Kryeziu, nga Zyra e Kryeministrit, anëtar
7. Villiam Kllavo nga USAID,
8. Undre Schruder nga IEAR,
9. Naim Berisha nga Ministria e Financave,

10. Shkelzen Maliqi, nga Ministria e Drejtësisë,
11. Majk Men, përfaqësues i AER-it ACA grup që ndihmon teknikisht Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Oda Ekonomike e ka pasur një përfaqësues, s'ka marrë pjesë,

12. Adnan Elshani, Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe
1. Shyhrete Bunjaku, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Para se ky ligj të vi në Qeveri, duke ditur rëndësinë dhe duke pasur parasysh vështirësitë që janë shkaktuar në mandatin e kaluar, unë kam kërkuar që të bëhen tri dëgjime publike në nivel të ekspertëve dhe të marrin pjesë para se finalist të vjen ligji në Qeveri. Janë kryer këto tri dëgjime në nivel të ekspertëve dhe drafti final ka ardhur në Qeveri dhe ne e kemi procedua dhe konsiderojmë që është ligji ndër ligjet më të mira. Sa i përket emrit, emri është qëndrim i ekspertëve që nuk duhet quhet Ligji për ndërmarrje ,sepse është një terminologji ndoshta më e kaluar, por ligji për shoqëritë tregtare.

Sa i përket aspekteve gjuhësore, çdo herë ka nevojë lektura, aspektet gjuhësore të korrigjohen , ndoshta deri në instancat më të fundit dhe ne pajtohemi për këtë.

Ju faleminderit për sugjerimet.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatitet për votim në parim të ligjit

Votojmë tash. Në sallë aktualisht janë 82 deputetë

Për..... 73

Kundër..... 2

Miratohet në parim Projektligji për shoqëritë tregtare. Andaj në bazë të rregullës 23. pika 6 dhe rregullës 35.2 Kuvendi i ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Tregëti, Industri, si komision funksional dhe raportues,
- Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion të Kornizës Kushtuese,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
- Komisionin për Komunitete

Komisionet duhet, që në afatin jo ma vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime. Po e theksoj këtë , sepse kemi ligje që ende nuk janë proceduar në procedurë të mëtutjeshme. Kanë kaluar leximin e parë dhe kanë mbetur nepër sirtarë . Me qëllim të efikasitetit të aprovimit të ligjeve po e theksoj se rregulla 35 e Rregullores, pika 7 thotë: „Komisioni funksional – përgjegjës, raportues ose kresor mund ta shqyrtojë Projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të Projektligjit në Seancë Plenare“. Do ta shfrytëzoj këtë mundësi tash e tutje.

Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 22 dhjetor të vitit 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë propozuar, paraqitur rekomandimet si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për parandalimin e luftimit të sëmundjeve ngjitëse dhe amendamenteve të propozuara nuk i cenojnë të drejtat e komuniteteve.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues ka bërë rekomandimin dhe amendamentet në tekstin e Projektligjit për parandalimin e luftimit të sëmundjeve ngjitëse si vijon:

Shkojmë sipas radhës se amendamenteve

Amendamenti nr. 1

Votojmë tash,

Për..... 67

Kundër..... 1

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 2

Votojmë tash,

Për..... 56

Kundër..... 1

Kalon amendament

Amendamenti nr. 3

Votojmë tash,

Për..... 66

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 4

Votojmë tash,

Për..... 67

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 5**Votojmë tash,**

Për..... 66

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 6**Votojmë tash,**

Për..... 66

Kundër..... 0

Amendamenti nr. 7**Votojmë tash,**

Për.....65

Kundër..... 0

Kalon amendament

Amendamenti nr. 8**Votojmë tash,**

Për..... 71

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendament nr. 9**Votojmë tash,**

Për..... 70

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 10**Votojmë tash,**

Për..... 70

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 11**Votojmë tash,**

Për..... 71

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 12**Votojmë tash**

Për.....68

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 13

Votojmë tash,

Për..... 70

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 14

Votojmë tash,

Për71

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr 15

Votojmë tash,

Për..... 70

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 16

Votojmë tash,

Për..... 66

Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 17

Votojmë tash,

Për..... 67

Kundër..... 0

Amendamenti nr. 18

Votojmë tash,

Për..... 72

Kundër..... 0

Kalon amendament

Amendamenti nr. 19

Votojmë tash,

Për 66

Kundër..... 1

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 20

Votojmë tash

Për..... 63

Kundër..... 1

Amendamenti nr. 21

Votojmë tash

Për..... 73

Kundër..... 0
Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 22

Votojmë tash

Për..... 69
Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 23

Votojmë tash,

Për..... 72
Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr 24

Votojmë tash,

Për..... 65
Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Amendamenti nr. 25

Votojmë tash,

Për..... 69
Kundër..... 0

Kalon amendamenti

Lus deputetët që të deklarohen për tekstin në tërësi bashkë me amendamentet e votuara

Votojmë tash,

Konstatohet se me 72 vota për dhe 2 kundër miratohet Projektligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse

Kryetari – Shkojmë në drekë

Një orë e gjysmë pushim . Në orën 14,00 fillojmë të punojmë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Vazhdojmë me punë.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për shpenzimet e vitit 2006

Na ka ikur ministri. Ministër e patëm frikën se mos ke ikur. Në pajtim me nenin 41 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësinë, Ministria e Ekonomisë dhe të Financave ka përgatit dhe Kuvendit i ka paraqitur për miratim Raportin përfundimtar të buxhetit për vitin 2006. Raporti financiar për shpenzime buxhetore për vitin 2006 u është shpërndarë të gjithë deputetëve, më 13 prill të vitit 2006.

Ftoj ministrin Shatri ta marrë fjalën.

MINISTRI HAKI SHATRI – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë. Kam nderin dhe kënaqësinë që sot para jush paraqes Raportin për Buxhetin e vitit 2006. Në dhjetor të vitit 2005 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për buxhetin e vitit 2006, i shpallur nga PSSP-ja me Rregulloren 2005/55.

Gjatë vitit buxhetor kanë ndodhur dy rishikime, përkatësisht amendamentimet e buxhetit, njëri në qershor dhe tjetri në shtator.

KRYETARI KOLË BERISHA – Konstatoj se në sallë ekzistojnë 66 deputetë. Vazhdo ministër.

MINISTRI HAKI SHATRI – Të gjitha të dhënat për nivelin e ndarjeve bazë dhe ndryshimeve nëpër organizata buxhetore janë pasqyruar në anekset 1, 2 dhe 3, të pasqyrave financiare që i dispononi ju.

Të nderuar deputetë,

Raporti apo materiali i ofruar për diskutim ofron të gjitha informacionet që i parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike ,gjë që mund të shihet në pasqyrën në faqen numër 5 dhe jo vetëm kaq. Kësaj radhe jemi përpjekur që jo vetëm të përmbushim kërkesën formale të përcaktuar me ligj për raportim, por kemi ofruar të dhëna dhe informacione të shumta,të cilat, po ashtu, kemi bërë përpjekje që duke iu shmangur shablloneve formale të jenë të lexueshme dhe të kuptueshme, pra të qarta. Përveç kësaj, kemi ofruar edhe të dhënat për buxhetin e vitit paraprak, pra vitit 2005, me qëllim që të bëhen krahasime në rast të interesimit të shfrytëzuesve të këtyre dokumenteve.

Në pjesën e dytë të pasqyrave janë prezantuar: gjendja e parasë, pasurive dhe detyrimeve sipas zërave dhe nënzërave, fondet, donacionet, sipas kodit dhe numrit të llogarisë ku këto para mbahen. Po ashtu ,kemi ofruar të dhëna të përpikta për llogaritë bankare të komunave, paratë në transit, keshi, fondi i privatizimit, grantet e përcaktuara, të hyrat vetanake qeveritare, të gjitha llojet e të hyrave dhe në fund gjendjen e fondeve të pashpërndara.

Në Kapitullin III janë ofruar të dhënat mbi të hyrat buxhetore dhe ato veçmas sipas institucioneve që kanë realizuar këto të hyra, pra, dogana, administrata tatimore. Për secilën sipas llojit dhe burimit të hyrave. Të hyrat vetanake sipas komunave, të hyrat jo tatimore të nivelit qendror, grantet e përcaktuara të donatorëve, grantet mbështetje buxhetit dhe pranimet tjera.

Pjesa e katërt, pasqyron pagesat apo shpenzimet sipas linjave buxhetore për të dy nivelet e pushtetit. Raporti i buxhetit për vitin 2006 është dhënë si pjesë e veçantë dhe mbështetet nga të dhënat në anekset 1, 2 dhe 3 të materialit që dispononi.

Të nderuar deputetë,

Qeveria dhe në veçanti Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si Ministri e sektorit angazhimin e vet gjatë vitit 2006 e kanë fokusuar në sigurimin dhe forcimin e stabilitetit

dhe qëndrueshmërisë buxhetore, si njëra ndër kushtet bazë për funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Por, gjithashtu edhe njëri ndër standardet kyçe për fillimin e procesit të definimit të statusit politik të Kosovës.

Jam shumë i lumtur dhe krenar që Ministria e Ekonomisë dhe Financave në këtë vit vendimtar këtë detyrë dhe obligim, sa të rëndësishëm aq edhe të komplikuar, e ka kryer me shumë sukses, duke u vlerësuar maksimalisht nga subjekte dhe institucione kompetente ndërkombëtare që na mbështesin, monitorojnë dhe raportojnë për proceset buxhetore në Kosovë. Janë vlerësimet pozitive të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, Këshillit të Evropës, ato që shërbyen si bazë për përgatitjen e raporteve për Kosovën në çdo tre muaj para Këshillit të Sigurimit ku vlerësimi për stabilitetin buxhetor dhe proceset në vitin 2006 ishin pjesa më e shndritshme e tyre. Këto vlerësime të rezultateve kanë nderuar Ministrinë e Ekonomisë së Financave, Qeverinë dhe vetë Kuvendin e Kosovës. Këto rezultate janë arritur duke u përqendruar në dy kahe të aktiviteteve, së pari duke e ngritur efikasitetin në vjeljen e të hyrave dhe në anën tjetër duke kontrolluar rigorozisht rrjedhën e shpenzimeve. Në të dy anët rezultatet janë shumë evidente.

Të hyrat. Të hyrat e parapara me buxhet në shumë prej 656 milion euro janë tejkaluar për 8.5% ose për 56 milion euro, që do të thotë janë realizuar 712 milion euro të hyra në vitin buxhetor 2006. Kjo ngritje është realizuar pa u ndryshuar tarifat dhe politikat fiskale, vetëm me rritjen e efikasitetit të punës së Administratës Tatimore dhe të Shërbimit Doganor.

T'ju përkujtoj se Fondi Monetar Ndërkombëtarë në fillim të vitit 2006 kishte vlerësuar dhe insistuar që mundësia e të hyrave të përkufizohet në 100 milion euro më pakë. Me qenë se në material janë dhënë detajet për të hyrat e realizuara, veçmas për Administratën tatimore dhe veçmas për Shërbimin Doganor sipas llojit, dëshiroj të theksoj, po ashtu, që në vitin 2006 të hyrat buxhetore ishin më të mëdha se sa në vitin 2005, për 84 milion euro. Ky rezultat është arritur në një vit shumë delikat për rrjedhat buxhetore për dy momente të caktuara, vdekja e presidentit Rugova dhe mbyllja e vendkalimit kufitar me Maqedoninë. Struktura e të hyrave në këtë vit është përmirësuar dukshëm.

Të hyrat në kufi që grumbullohen nga doganat janë 456 milion euro ose 7% mbi planin e paraparë me buxhet dhe po aq mbi realizimin e vitit 2005. Përkundër rritjes absolute, pjesëmarrja e të hyrave të realizuara në kufi ka ra nga 74% në vitin 2005 në 64% në vitin 2006. Administrata Tatimore e Kosovës ka inkasuar 30% më shumë të hyra se sa kishte të përcaktuar me buxhet për vitin 2006. Në vend të 126 milion euro ka grumbulluar 164 milion euro. Pra, plot 38 milion mbi planin buxhetor.

Të gjitha format dhe burimet e të hyrave janë pasqyruar detalisht, qoftë te pasqyrat financiare, qoftë te raporti buxhetor në shifra, grafikone struktura dhe të krahasuara në vitin paraprak. Pagesat apo shpenzimet buxhetore në vitin 2006. Janë paraparë gjithsej 727 milion euro shpenzime buxhetore, nga të cilat 28% për paga dhe mëditje, 162 milion për mallra dhe shërbime komunale, 163 milion për transferuat sociale dhe 190 milion për investime kapitale.

Shpenzimet gjatë vitit kanë qenë për 90 milion nën shpenzimet e lejuara me buxhet. Në dukurinë e nën shpenzimeve buxhetore në vitin 2006 ka dy efekte të kundërta.

E para, në kategoritë apo linjat e shpenzimeve si pagat mallra dhe shërbime dhe transfere e subvencione janë kursyer 33 milion e 180 mijë euro. Këto janë kursimet e pastra nga shpenzimet vijuese dhe janë rezultat i mbikëqyrjes së procesit të shpenzimeve në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe normalisht rezultat i kujdesit të shtuar të organizatave buxhetore për të zvogëluar shpenzimet e parave publike pa nevojë. Në këtë mënyrë për paga janë shpenzuar vetëm 203 milion nga 209 sa ishin të parapara.

Pra, janë kursyer 5 milion. Për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 124 milion dhe janë kursyer 17.7 milion. Pra, kemi shpenzime vijuese më pak se sa kanë qenë të lejuara me buxhet afër 18 milion euro.

Shërbimet komunale kanë kursyer afër 2 milion euro, dhe subvencionet dhe transferet kanë kursyer 8 milion euro, pra gjithsejt 33 milion euro kursime.

Ana e tjetër e nën shpenzimeve është ana më e dobët e proceseve buxhetore ,sepse nuk janë realizuar shpenzimet për investime kapitale që do të ishte shumë e dobishme po të realizoheshin sipas dinamikës së paraparë. Pra janë pika më e dobët e procesit buxhetor. Nga 180 milion euro të lejuara në buxhet për investime janë realizuar vetëm 133 milion euro, ose rreth 57 milion më pak.

Me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në sferën e investimeve kapitale Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka formuar një grup punues, i cili ka punuar me organizatat buxhetore, të cilat kanë nën shpenzime të investimeve kapitale dhe po punojnë për identifikimin dhe eliminimin e pengesave, përkatësisht në aftësimin e organizatave buxhetore për shpenzimin më efikas të parave publike.

Njëra ndër pengesat kyçe të identifikikuara ishin procedurat e prokurimit të cilat shpresojnë të jenë rregulluar me ligjin e ri të prokurimit të aprovuar para disa kohe këtu në Kuvend.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka aplikuar një metodë të re në procedura buxhetore, me të cilën organizatave buxhetore ju mundësohet vazhdimi i realizimit të programeve investive në vitin vijues buxhetor.

Shpenzimet buxhetore janë pasqyruar po ashtu edhe sipas funksionit dhe klasifikimit të aktivitetit ekonomik.

Të nderuar deputetë.

Në materialet e ofruara do t'i gjeni të dhënat e shpenzimeve të kategorive tjera, si rezervat e ministrit, rezervat e Përfaqësuesit Special, grantet e donatorëve etj.. Me një fjalë të dhëna për çdo euro të shpenzuar gjatë vitit buxhetor 2006,llojet e shpenzimeve emrat dhe shumat e projekteve investive sipas organizatave buxhetore. Duke çmuar kohën tuaj dëshiroj t'i ofrohem fundit të këtij paraqitje para jush dhe dëshiroj që të jem në disponim të jap përgjigje në pyetjet e juaja apo sqarime të nevojshme sipas rastit. Mirëpres të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet që qojnë në përmirësim të mëtejshëm të proceseve buxhetore dhe të vetë raportimit dhe njëkohësisht të pasqyrave financiare dhe raportit të buxhetit.

Dëshirojmë, po ashtu, që këtë material ta bëjmë publik, me qëllim që qytetarët e Kosovës të kenë informata burimore dhe në këtë mënyrë t'i kursejmë nga interpretimet e njëanshme dhe shumë herë edhe të dyshimta. Po ashtu, mirëpresim Raportin e Auditorit Gjeneral që duhet të përfundojë deri në fund të qershorit të këtij viti.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave i ka garantuar presidentit Rugova me rastin e themelimit të delegacionit të Kosovës për negociata dhe ia ka përsëritur presidentit Sejdiu që buxheti nuk do të jetë kurrë pengesë e formimit të shtetit të Kosovës.

Puna e shkëlqyer në vitin 2006 e që po vazhdon në këtë vit kanë bërë që Qeveria e Kosovës të marrë përsipër koston e statusit. Pra, formimin e ministrive të reja, siç janë: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme dhe bartja e kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet vendore.

Grupet punuese kanë bërë llogarinë e kostos buxhetore dhe ballëhapur ne i përballojmë të gjitha shpenzimet që do të dalin si kosto e statusit që aktualisht quhet.

Dua të them që rezultatet e arritura në vitin 2006 dhe vlerësimet pozitive të proceseve buxhetore ia kanë hapur rrugën Kosovës që menjëherë pas statusit të realizohet një konferencë e madhe me donatorë, e cila supozohet dhe sponsorizohet nga Këshilli i Evropës dhe Banka Botërore, kurse përgatitjet e duhura janë duke përfunduar sipas kalendarit dhe tanimë janë tejkualuar po thuaj të gjitha pengesat e mundshme pas përfundimit me sukses të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në dhjetë ditët që sapo kaluan.

Sipas të gjitha indikacioneve Kosovës do t'i ofrohet mbështetje e tillë buxhetore për investimet kapitale çfarë nuk i ka ofruar deri më tani asnjë popull dhe vendi në fazat e këtilla të zhvillimit. E përfundoj këtë ekspozë duke iu falënderuar për dëgjim të vëmendshëm.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit z. ministër. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI - I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Lidhja Demokratike e Kosovës, përkatësisht Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar raportin, përkatësisht pasqyrat financiare për vitin 2006 të Qeverisë së Kosovës dhe ka ardhur në disa konstatime, të cilat nuk do t'i paraqes në vazhdim para jush.

Gjatë vitit 2006 janë përgatitur dhe dorëzuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa pasqyrat financiare brenda afatit të paraparë me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësiive. Këto pasqyra kanë arritur një shkallë të lartë të besueshmërisë së informatave dhe prezantimit të tyre. Për dallim nga vitet e kaluara këto pasqyra janë avancuar dhe janë konform me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për financat publike, të cilat kanë informata të mjaftueshme, si për rrjedhën e parasë së gatshme për vitin 2006, krahasim në realizimin ndaj planifikimit buxhetor, po ashtu edhe krahasimin ndaj vitit paraprak, duke u pasuruar edhe me shpalosje të shënimeve nga niveli më i ultë i kategorive ekonomike.

Në këto pasqyra të vitit 2006 janë përfillur dhe zbatuar të gjitha rekomandimet e Zyrës së Auditorit Gjeneral, të dala nga Raporti i auditimit për vitin 2005. Po ashtu gjatë këtij viti ka filluar realizimi i projekteve kapitale që nënkupton një element më i shtuar i kontrollit për të përcjellë secilin projekt veç e veç, gjë që kjo nuk ka qenë një praktikë e viteve të kaluara. Prioritetet do të përcillen ashtu siç janë aprovuar edhe nga Parlamenti i Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Fundi i vitit 2006 ka rezultuar me barazinë e llogarive bankare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës me Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës dhe librin kryesorë të Thesarit, ku diferenca e mosbarazimit ka qenë shumë e vogël ose mospërfillëse vetëm 62 euro. krahasuar me vitet e tjera ky është një sukses dhe progres i arritur gjatë vitit 2006 sidomos në aspektin e barazimit bankar.

Po ashtu, ka pasur proces barazimit mujor të llogarive bankare të Buxhetit Konsoliduar të Kosovës dhe sistemit informativ të menaxhimit financiar. Për dallim prej viteve tjera ky barazim është bërë në baza tremujore.

Gjatë vitit 2006 është zhvilluar një bashkëpunim i ngushtë i organizatave buxhetore me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave sa i përket zbatimit kontrollit dhe barazimit, duke krahasuar shumat e secilës organizatë buxhetore me sistemin informativ-financiar të Kosovës. Është bërë identifikimi i shpejtë i të hyrave në llogaritë bankare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe regjistrimi në sistemin informativ financiar të Kosovës pasi që disa të hyra janë regjistruar si të paspecifikuara nga organizatat të cilat i mbledhin këto të hyra.

Po ashtu është bërë trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarëve të organizatave buxhetore nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për regjistrimin e pasurisë fikse dhe është bërë regjistrimi në sistemin informativ i pasurisë së secilës organizatë buxhetore. Ky veprim ka qenë po ashtu edhe implementim i rekomandimit dalë nga revizioni i Auditorit Gjeneral të bërë më herët për vitin 2005.

Dorëzimi i pasqyrave financiare për vitin 2006 nga organizatat buxhetore këtë vit ka rezultuar shumë më mirë, është konstatim i grupit tonë parlamentar, se sa në vitin e kaluar, pasi që shumica e organizatave buxhetore i kanë dorëzuar pasqyrat financiare në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave me kohë, me përjashtim të komunave të banuara me popullatë shumicë serbe.

Pasqyrat e vitit 2006. Organizatat buxhetore, duke u referuar Udhëzimit administrativ 2006/14 kanë paraqitur edhe gjendjen e pasurisë së tyre fikse sipas vlerës së tyre fillestare.

Të nderuar deputetë,

U tha edhe nga ministri për ecuritë e të hyrave dhe të dalave buxhetore, unë nuk do të doja që të ju marrë kohë shumë, me përjashtim do të thosha dy indikatorë kryesorë.

E para, kemi të bëjmë me të hyrat të cilat shënojnë një ngritje relative të kënaqshme dhe e dyta kemi rënie të shpenzimeve në total, duke mos hyrë në përmendje të kategorive të

caktuara ekonomike të shpenzimeve që nuk dua të ju lodhi, sepse u tha në pjesën hyrëse që e bëri ministri.

Si formulim i përgjithshëm i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në lidhje me pasqyrat financiare për vitin 2006, të nderuar deputetë, është se menaxhimin e financave publike për vitin 2006, gjatë vitit 2006 ka pasur një avancim të dukshëm krahasuar në vitin 2005 dhe vitet tjera. Është përmendur edhe më lart se gjatë vitit 2006 ka filluar realizimi i projekteve kapitale sipas projekteve dhe kjo nënkupton një element shumë më të shtuar të kontrollit për të përcjellë secilin projekt veç e veç, e cila nuk ka qenë e aplikuar në praktikë, pra e cila nuk ka qenë e aplikuar në vitet e kaluara..

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës pas një analize të gjerë që i ka bërë raportin financiar për vitin 2006 e mbështet raportin dhe inkujaron Qeverinë që edhe më tej të vazhdojë në optimalizimin dhe rritjen e të hyrave publike ,me qëllim të përmbushjes së kërkesave në financimin e projekteve zhvillimore sipas prioriteteve të Qeverisë dhe më ndërmarrjen e masave adekuate të politikave ekonomike dhe politikave fiskale të cilat nxisin zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi.

Po ashtu, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet Qeverinë e Kosovës në përpjekje të saj në ngritjen e mekanizmit dhe të efikasitetit në fushën e kontrollit dhe të përgjegjësisë në menaxhimin e financave publike në bazë të ligjeve dhe procedurave që kanë të bëjnë me financat publike në tërësi. Kjo do të bëjë të mundur një nivel më të lartë të efikasitetit të racionalizimit, të transparencës dhe të efektivitetit në menaxhimin dhe në shfrytëzimin e financave publike në përgjithësi . Ju thërras që ta mbështesim raportin mbi pasqyrën financiar për vitin 2006. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-ës z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, ministra, të nderuar deputetë.

Unë do të përqendrohem më tepër në mangësitë që i ka raporti dhe për lëvdata mendoj që dy parafolësit, ministri dhe zëvendësministri i thanë. Këtë raport e karakterizon mos transparenca sidomos te pjesët e të dalave buxhetore ,të cilat janë të paraqitura në mënyrë sintetike. Kjo mënyrë e formësimit të raportit u pamundëson tatimpaguesve që të kenë një pasqyrë të qartë për mënyrën e shpenzimeve të parave publike.

Raporti financiar për vitin 2006 e konfirmon qëndrimin e drejtë të Kabinetit për Qeverisje të mirë si me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2006 dhe raportet financiare për tremujorin e parë të vitit 2006, gjashtëmujorin dhe raportin financiar për nëntëmujorin e vitit 2006. Sa i përket planifikimit të hyrave buxhetore duke përfshirë gjithë llojet e të hyrave, të hyrat e mbledhura në kufi, dogana, akciza dhe TVSH, si dhe të hyrat e brendshme kemi një nën lexim të kapaciteteve financiare që i ka Kosova.

Ministri pak më parë në fjalën e tij përmendi planifikimin dhe miratimin e buxhetit në vitin 2005 për shpenzimet buxhetore të vitit 2006. Dhe ne e dimë që edhe Parlamenti e ka miratuar buxhetin e vitit 2006, por do ta kisha pyetur ministrin e Financave -A ka pasur politika programore mbi të cilat është dhënë buxheti që e kanë paraparë një zë të veçantë

qe jfet e ministrave dhe natyrisht në raport nuk është asnjë fjalë, e cila do të na jepte një pasqyrë se sa mjete buxhetore janë shpenzuar në vitin 2006 për politika të paplanifikuara dhe cilat ministri kanë harxhuar buxhetin e tyre për politika të paplanifikuara? Për këto gjëra në raport nuk e hasim as edhe një fjalë, se kemi nënvlerësim tregon edhe ky raport. Nga raporti vërejmë se kemi tejkalim të hyrave për vitin 2006. Ky është rezultat i planifikimit të kufizuar prej 605 e 6 milion erosh, ndërsa janë inkasuar 712 milion. Dhe kemi një progres ndaj planit për 8.5% dhe kjo vjen si pasojë e planifikimit joreal.

Nëse Qeveria do të zvogëlonte evazionin fiskal, sidomos në pjesën veriore, po të kishte një vlerësim më të drejtë dhe real të doganave për mallrat e ndryshëm, po të zvogëlohej niveli i kontrabandës në artikujt e caktuar si: duhani, kafja, pijet e alkoolit e të tjerat. Me një menaxhim më të mirë të hyrave të , zgjerimin e bazës së tatimpaguesve, ngritjen e të hyrave vetanake të komunave, të cilat janë në nivel të ulët vetëm për 27.75 milion që është inkasim shumë i vogël, Kosova do të kishte buxhet dhe të hyra më të mëdha që është real dhe lehtë i realizueshëm. Po që se shikohet struktura e të hyrave si pasojë e planifikimit joreal kemi një tejkalim të hyrave të realizuara në krahasim me të hyrat e planifikuara.

Edhe më tutje të hyrat e mbledhura në kufi, doganat, akciza, TVSH-ja e tjera në nivel prej 456 milionë e 390 mijë euro janë të hyra kryesore dhe merr pjesë me 64% ,që është një ngarkesë shtesë për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe kjo duhet të ndryshohet duke u zvogëluar. Dhe në anën tjetër duhet të rriten të hyrat e brendshme, pasi që këtë lloj të hyrave të biznesit detyrohen ta paguajnë ende pa i shitur mallrat e tyre. Duke analizuar strukturën e të hyrave vërejmë se deri te ngritja e të hyrave vjen si rezultat i futjes së tatimeve të reja e jo si rezultat i një menaxhimi më të mirë, ku vetëm në emër të tatimit në ekstra profit janë mbledhur 21 milion e 27 mijë euro. Sa i përket shpenzimeve të parave publike vazhdon treni i njëjtë me periudhat paraprake, ku për shkak të nivelit të ulët të hyrave pjesëmarrja e pagave është e lartë ,që është pjesëmarrje më e lartë në region.

Pastaj vijnë mallrat dhe shërbimet me 134 milion e 33 mijë euro, shërbimet komunale me 18 milion e 36 mijë euro dhe është për brengosje sidomos pjesëmarrja shumë e vogël e investimeve kapitale me vetëm 133 milion e 20 mijë euro, nga 189 milion e 95 mijë të planifikuara ose 21% të përealizuara.

Ndoshta do të justifikohet suficiti buxhetor në vende me ekonomi të zhvilluar, kurse tek ne ku mungojnë barnat nga lista esenciale, ka mungesë të ujit për pije, mungesë e hapësirës shkollore, infrastrukturë të dobët rrugore e nevoja të tjera, kjo tregon nivelin e ulët të organizimit dhe të përgjegjësisë që ka Qeveria e Kosovës.

Edhe më tutje vazhdohet me shpenzime, shpenzimi i parasë pa kontroll sidomos në këto pozicione.

Një, Shpenzimet e telekomunikimit janë 3 milion e 475 mijë e 285 euro,
Shpenzimet për derivate 20 milion e 544 mijë e 913 euro,
Mirëmbajtja 20 milion 167 mijë 773 euro,
Shpenzimet për udhëtim 3 milion e 986 mijë 400 euro,
Shpenzimet kontraktuese 22 milion e 297 mijë 91 euro,
Çka mund të jenë këto shpenzime nga raporti ne nuk mund ta dimë. Është fjala për 22 milion euro, gati 23. Shpenzimet tjera janë 33 milion e 947 mijë 205 e 8 euro mungesë specifikimit edhe për këtë, këto shpenzime që janë gati 34 milion euro.

Mobilet dhe pajisjet 8 milion e 908 mijë e 105 e 7 euro. Nuk di prej nga pasi veç 2 – 3 vite më parë për mobile kanë qenë të pajisura gjitha ministratë.

Qiraja 4 milion e 324 mijë e 539 euro. Edhe pse shpenzimet kapital për vitin 2005 kanë qenë më të ulëta në raport me totalin, këtë vit, në vend që të përmirësohej gjendja, kemi një trend negativ të zvogëlimit prej 144 milion e 87 mijë euro është në 133 milion e 20 mijë euro. Pjesë të caktuara të raportit nuk ofrojnë transparencën e duhur, sidomos në pjesët e shpenzimeve ku pozicionet e caktuara duhet të specifikohen siç janë: pajisjet tjera, furnizime për zyra, struktura tjera e të ngjashme.

Nga kjo që u cek konkludojmë se kriza ekonomike në Kosovës është duke u thelluar, e cila ka reperkusione të gjëra negative për gjithë shoqërinë në Kosovë. Dominojnë të hyrat e mbledhura në kufi, duke përfshirë 64% të gjitha të hyrave. Pjesëmarrja e pagave është shumë e lartë, e cila sillet rreth 32% dhe është më e larta në rajon. Pjesëmarrja e pozicionit mallra - shërbime vazhdon të jetë e lartë dhe me trend të ngritjes, investimet kapitale janë në nivel shumë të ulët, me trendë negative në krahasim me vitin paraprak me pjesëmarrjen prej vetëm 21%.

Për të tejkaluar këtë gjendje rekomandojmë.

1. Të krijojmë parakushte për ambient të përshtatshëm dhe të sigurt për investime, gjë që Qeveria gjatë këtij mandati nuk e ka bërë.
2. Të ngritet disiplina financiare dhe të zvogëlohet evazioni fiskal, sidomos në pjesën veriore ku do të ndikonte në mbushjen e buxhetit dhe eliminimin e konkurrencës jo lojale.
3. Të shikohet arsyeshmëria e vendeve të punës në administratën publike.
4. Të zvogëlohen shpenzimet enorme për pozicionet e caktuara siç janë: derivatet, telefonat, reprezentacioni.
5. Të ndryshohet

KRYETARI KOLË BERISHA – Për grupin e AAK-së Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar. Ministria Ekonomisë dhe Financave në pajtim me ligjin na ka ofruar raportin përfundimtar mjaft transparent të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit të vitit 2006.

Kjo praktikë është për t'u përshëndetur dhe ne e mirëpresim, megjithatë, ende ka punë për t'u bërë që të arrihet një buxhet i qëndrueshëm për Kosovën. Në këtë aspekt raporti e pasqyron mosarritjen e nivelizimit të dizbalancit në mes të hyrave nga dogana dhe të hyrave të brendshme tatimore në vitin e kaluar.

Të hyrat nga dogana ende përbëjnë 64% të hyrave të përgjithshme, por një progres dukshëm është arritur në të hyrat e brendshme në krahasim me vitin e shkuar. Sipas këtij raporti plani për këto të hyra është tejkaluar për 30%. Administrata Tatimore e ka përcaktuar për objektivi të saj rritjen e të hyrave nga tatimet në të ardhura dhe në fitim. Duke pas parasysh nivelin e tanishëm të zhvillimit ekonomik dhe klimën e tanishme të investimeve që në të vërtetë është peng i statusit të pazgjidhur të Kosovës është e kuptueshme se një ngritje të dukshme të hyrave të brendshme tatimore, në mungesë të investimeve nuk mund ta presim. Sidoqoftë ne duhet ta përkrahim Administratën Tatimore në çdo përpjekje për vjedhjen e tatimeve në mënyrë më efektive.

Në krahasimin proporcional del se kemi një përqindje të madhe të shpenzimeve për paga dhe mëditje. Por nëse këto shpenzime krahasohen me nevoja në shërbimin publik, atëherë do të konstatojmë se as nevojat e shërbimeve publike nuk mund të përmbushen me shumën e tanishme të shpenzimeve dhe as kushtet materiale për punonjës në shërbimin publik nuk janë të kënaqshme. Prandaj, duhet ta kemi parasysh se pa rritje të dukshme ekonomike nuk mund të ndryshohet as proporcioni i shpenzimeve dhe as përmirësim i dukshëm i kushteve materiale.

Sa i përket politikave të hyrave tatimore Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave duhet të shqyrtojë mundësitë e shtimit të hyrave nga të hyrat jo tatimore në nivelin qendror dhe në atë lokal në komuna. Në njërin, anë një veprim efikas do të ishte nëse komunave u mundësohet një autonomi në vjeljen e taksave jo tatimore, veprim ky që do të rrisë pavarësinë financiare të komunave nga buxheti qendror. Po ashtu vjelja më efektive e taksave jo tatimore nga sektorët e ndryshëm të shërbimit publik do të bënte të mundshëm përmirësimin e shërbimeve. Në anën tjetër efektiviteti i shërbimeve do të ngritë gatishmërinë e qytetarëve që të shfrytëzojnë shërbimet publike dhe paguajnë taksa jo tatimore për to. Së fundi është për t'u përshëndetur politika e ngritjes së shpenzimeve kapitale nga buxheti i Kosovës. Çdo shpenzim kapital krijon bazë për rritjen dhe qëndrueshmërinë buxhetore. Por këtu duhet të kemi më shumë kujdes në të ardhmen, një sistem më efikas i monitorimit të investimeve kapitale duhet të ndërtohet.

Momentalisht kemi shumë nisma për investime kapitale, por shumë prej tyre ngecin në realizim dhe disa nuk përfundohen. Këtë nuk duhet ta lejojmë, çdo ngecje dhe mosrealizim i këtyre investimeve është i kushtueshëm dhe mund të rezultojë me humbjen e parasë publike. Ky nuk është problem me të cilin ballafaqohemi vetëm ne, këtë problem e kanë pas edhe shtetet tjera të rajonit ku ka ndodhur që për të njëjtin projekt janë ndarë disa herë mjete dhe së fundi disa prej tyre nuk janë realizuar. Duke pas parasysh buxhetin, çdo mangësi në menaxhimin e suksesshëm do të paraqesë ngecje serioze në ndërtimin dhe zhvillimin e shtetit. Praktika e ndarjes së mjeteve nga një vit në tjetrin ose brenda 10 viteve është praktikë joefikase e menaxhimit të mjeteve buxhetore. Për ta evituar këtë dukuri Grupi Parlamentar i Aleancës i propozon Kuvendit që ta krijojë një komision për monitorimin e shpenzimeve kapitale të gjitha organizatave buxhetore të vendit.

Kërkon nga kryetari i Kuvendit që këtë propozim ta vë në votim dhe të autorizohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që të propozojë përbërjen e këtij komisioni dhe formën e organizimit të tij.

Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet raportin e Ministrisë së Ekonomisë së Financave dhe inkurajon që në të ardhmen të vazhdojë të raportojë në të njëjtën mënyrë si tani transparente. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit Nga Grupi Parlamentar ORA Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit. z. kryetar. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Sot është futur në rend dite diskutimi për raportin për pasqyrat financiare të shpenzimeve për vitin 2006 në një mënyrë krejtësisht jashtë procedurës së punës së Kuvendit. Ky është një standard i ri në këtë Kuvend. Duke pasur parasysh që Kosova ndodhet në një fazë shumë vendimtare të definimit të statusit të vet, çdo veprim i institucioneve tona në drejtim të respektimit të ligjit të rendit të rregullit të procedurave është një plus në drejtim të rritjes së besueshmërisë së Kosovës tek ata që e vëzhgojnë punën e institucioneve tona, kurse çdo punë e cila bien ndesh me praktikën e miratuar në institucionet tona, pra me Komisionin Kushtetues, me rregulloret e punës, është një minus në këtë aspekt.

Prandaj, më lejoni që diskutimi im është i fokusuar lidhur me shkeljet procedurale që janë bërë, sepse nuk na u dha mundësia më herët ta themi shkeljet procedurale lidhur me futjen në rend dite në këtë mënyrë pa një diskutim paraprak në Komisionin e Buxhetit të kësaj pike kaq të rëndësishme, siç është mënyra se si janë shpenzuar mbi 700 milion euro të qytetarëve të Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Futja në këtë mënyrë, pa një diskutim të ngushtë, të specializuar nga ana e Komisionit që e ka për detyrë ta bëjë atë punë, është një shprehje shumë e keqe, një mostër e keqe e punës dhe një precedent, i cili duhet këtu të mbetet dhe të mos përsëritet kurrë më.

Komisioni Kushtetues e Kosovës, pikat 9 dhe 11 - tha shefja e grupit tim parlamentar e thotë qartazi: Komisioni për Buxhet ka kompetencën të përgjithshme e që në gjuhën angleze, që është gjuha bazë e interpretimit të tyre dokumenteve thotë: Gjeneral kompetencis mbi çështjet buxhetore dhe financiare.

Në qoftë se ka kompetencë gjenerale Komisioni për Buxhet, pa mendimi e Komisionit për Buxhet, nuk është dashur të procedohet më tutje me këtë dokument që ka ardhur sot në Kuvend. Një pikë tjetër që është shumë e rëndësishme në Komisionin Kushtetues është pika 9 neni 23 ku thotë: Çdo deputet ka të drejtë që mbi bazat të barabarta me deputetët e tjerë të marrë pjesë në gjitha debatet e Kuvendit. Është po ashtu një dispozitë e cila është cenuar sot edhe u është cenuar e drejta që të marrin pjesë në baza të barabarta me deputetët tjerë.

Rregulli 51.3 i Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, i miratuar nga ky Kuvend, ku bëhet fjalë për Komisionin për Buxhet thotë: Komisioni për Buxhet dhe Financa ka përgjegjësi për kontrollin e raporteve vjetore dhe pasqyrave financiare, pra ka përgjegjësi ka të buxhetit të konsoliduar të Kosovës që lidhen me buxhetin e IPV-ve dhe me raportet tjera financiare që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit, të kryetarit, të Qeverisë, ministrive ose me aktivitetet tjera të IPV-ve të mbështetura drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga buxheti konsoliduar i Kosovës.

Rregulla 47 që bën fjalë për Komisionin Përgjegjës Raportues thotë, rregulla 47.4 - Raportimi në Kuvend bëhet vetëm nga Komisioni Përgjegjës raportues, kurse rregulla 47.5 thotë: Raporti përmban propozimet e Komisionit Përgjegjës Raportues për cilat Kuvendi duhet të marrë vendim në mbledhjen plenare, si dhe pjesën tjetër, arsyet dhe opinionet e kundërta, në rastet kur vendimi i komisionit është marrë me shumicë votash, si dhe, komentet e komisioneve përkatëse tjera.

Rregulla 47.6 thotë: Raportuesi ose kryetari i Komisionit Përgjegjës Raportues paraqet punën dhe rezultatet të komisionit në Kuvend. Fatkeqësisht sot në këtu po diskutojmë pa

raportim, pa komision raportues, dhe pa një raport të shkruar para seancës për- me ndihmën e Komisionit Përgjegjës që ka përgjegjësi me Kornizën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e këtyre aspekteve të funksionimit të mirë apo të keq të institucioneve tona.

Sa i përket aspektit të dhënies së fjalës z. kryetar, rregulla 30 që përmendët edhe ju- Emocionet procedurale thotë: Në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetit i jepet e drejta të propozojë këto emocione procedurale. Në ne është mocioni për konstatimin e shkeljes së Rregullores së punës së këtij Kuvendi që e kemi miratuar bashkërisht dhe ti nuk ia dhe të drejtën askujt për me shpreh mocionin për shkeljen e Rregullores së punës. Përkundrazi thatë se unë e kam në dorë. Po është e vërtetë, mirëpo tek pasi që të thuhet mocioni, pasi që të shprehet deputeti lidhur me nevojën për të konstatuar shkeljen e Rregullores së punës .Neni nën pikën 30.5 thotë që në rast ku këtë mocion për shkeljen e Rregullores së punës kryetari vendos të japë përgjigje menjëherë .por mundet menjëherë të jep përgjigje që është shkel ose nuk është shkelë, ose nëse ka nevojë për mendim të ma specializuar i procedohet një komisioni të caktuar për të dhënë mendim. Ju gjitha këto i bllokuat ,e bllokuat një debat demokratik dhe mendoj se me këtë punë të sotshme ky Kuvend i ka qar një mesazh shumë të keq gjithë atyre që monitorojnë punën e tij, se Kuvend i Kosovës nuk i ka bash mirë punët në lidhje me përgjegjësitë që duhet t'i marr në të ardhmen. Nuk kurrjë më shumë me shtuar. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Për Grupin LDD Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar ministra prezentë, të nderuar deputetë . Raporti i buxhetit për vitin 2006 është vlerësuar edhe nga grupi ynë parlamentar i LDD-së dhe ne kemi vlerësuar se ky raport është ngritur mbi aprovimin e buxhetit për vitin konkret dhe në saje të saj ky raport pasqyron një menaxhim të hyrave dhe shpërndarjen e tyre.

Në realitet raporti ka pësuar disa ndryshime të cilat ne vlerësojmë se kanë qenë të arsyeshme dhe kjo arsyeshmëri është bazuar në përmbushjen e kërkesave dhe prioriteteve që ka kërkuar shoqëria jonë për to. Nga pasqyra shihet qartë se shfrytëzuesit e këtyre mjeteve janë të arsyetuara, por ka edhe raste të tejkalimeve të cilat në raport nuk paraqiten dhe në mundësitë e funksionimit të institucioneve të Kosovës patjetër këto ndryshime duhet të qëndrojnë në të gjitha nivelet , duke filluar që nga ai lokal deri te ky qendror.

Ajo që meriton të vlerësohet dhe ishte vlerësuar pozitivisht është puna e Administratës Tatimore e cila bën inkasimin pozitiv dhe të hyrat që vijnë nga doganat, por nga format tjera nuk përmenden aq sa duhet. Ne mendojmë se rekomandimet apo sugjerimet duhet të ishin më të theksuara mbi shfrytëzimin e mënyrën ma racionale të mjeteve të grumbulluara dhe në veçanti ky racionalizim duhet t'i përfshijë të gjitha instancat dhe të gjitha nivelet , duke filluar prej ministrive e deri te komunat, sepse nëse nuk mësohemi të racionalizojmë dhe të shfrytëzojmë mjetet tona në mënyrë racionale, vërtet ne nuk do t'ia dalim në krye me buxhetin që kemi dhe me mundësitë e kapacitetin, posaçërisht në fazën kur hyjmë pas bërjes së Kosovës shtet.

Vlerësoj se me rastet e aprovimit të buxhetit dhe me rastet e raportimeve të buxhetit duhet të vemi në spikamë se sa në këto buxhete ndikojnë edhe pjesët tjera të cilat me

vështirësi po inkorporohen në sistemin edhe juridik edhe ekonomik edhe politik të Kosovës dhe u kuptua fjala është për pjesët veriore apo komunat veriore të Kosovës

Dhe unë do të kisha dashtë që vërtet për në të ardhmen me rastin e aprovimit dhe përgatitjeve për buxhetin e vitit të ardhshëm të parashihet një buxhet, mos të them special, po një buxhet i cili do të mundësonte një specifikë të posaçme në veçanti për pjesët veriore, e posaçërisht për veriun e Mitrovicës, sepse kjo është emidiate dhe është mase e rëndësishme.

LDD-ja mbështet raportin i cili besoj që nxit zhvillimin ekonomik dhe është në kufij të arsyeshëm të menaxhimit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA: Ju faleminderit! Grupi për Integrim, deputeti Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI: Ju faleminderit zotëri kryetar, I bashkohem konstatimit të deputetit Jashari, se ky debat sot do të ishte shumë më i përgatitur dhe më frytdhënës sikur t'i kishin parapri rekomandimet e Komisionit përkatës funksional dhe në këtë drejtim dëshiroj që kjo të jetë hera e fundit që punojmë në këtë mënyrë. Sa i përket raportit në fjalë, unë do t'i kisha përkujtua deputetët në konkluzionet e raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2006, i cili vlerësoj se situata e përgjithshme ekonomike në Kosovë ka mbetur e zymtë, pra ky është një vlerësim i organit më të lartë të Bashkësisë Evropiane, në të cilën synojmë që të anëtarësohemi.

Banka Botërore ka dalë me të dhëna se në Kosovë ende kemi 37% varfëri, 15%, e popullatës jeton në varfëri të skajshme, papunësia është 42-44%, sipas të dhënave të vitit 2005, ndërsa në qershor të vitit 2006, i kemi 323.000 të papunë, të regjistruar. Jam i gëzuar me disa të arritura, të cilat i paraqiti ministri dhe që janë të paraqitura edhe në raport. Është fakt se edhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, është duke u shënuar përparim në organizimin dhe përparimin e shërbimeve, sigurisht që edhe investimet dhe ndihma e ekspertëve ndërkombëtarë janë duke japë rezultate.

Megjithatë raporti në disa pozicione nuk është i qartë dhe atë në disa pozicione me rëndësi. P.sh. derisa nga raportet paraprake, ka qenë shumë e qartë se, brutoprodhimi vendor, i ashtuquajtur i xhidipi, për kokë të banorit në vitin 2005, ka qenë 1100 €, ndërsa ai ka pasur një rënie për 0.2%, në krahasim me vitin paraprak, nga raporti nuk është e qartë se sa është kjo e ardhur në këtë vit. Pra, nuk e kemi të qartë se sa është xhidipija-për kapita në vitin 2006. një parametër shumë i rëndësishëm makroekonomik. Është e qartë se politika fiskale më strikte dhe inkasimi i shtuar i tatimeve, u dëshmuua si në rrugë e qëndrueshme fiskale për financimin e minimumit të funksionimit të shërbimeve publike, mirëpo po ashtu mund të kuptohet edhe si një indikator i planifikimit të dobët të hyrave, ashtu siç e parashtrroi edhe deputeti i Partisë Demokratike.

Është fakt se u sigurua deficiti i ulët i buxhetit, në vlerën më të lartë prej 6%, të xhidipisë-së në vitin 2004 dhe 3.2% në vitin 2005, ndonëse nga raporti nuk mund të konkludohet se sa është ky deficit buxhetor për vitin 2006. ndonëse, është i qartë se ka një tendencë të uljes.

Nga raporti kuptohet se buxheti vazhdon të mbes variabla kryesore makroekonomike. Fondet publike janë në tërësi të përjashtuara, nga projeksionet makroekonomike dhe në

këtë mënyrë janë zvogëluar në masë të dukshme mundësitë për mobilizimin e mjeteve financiare, përpos politikave ekzistuese fiskale.

Shpenzimet për investime kapitale kanë shënuar rënie prej rreth 7%, prej 144.869.000 € në vitin 2005 dhe 133.200.000 €. Posaçërisht brengosin investimet e ulëta kapitale në arsim dhe edukim, në situatën kur në shkallë të vendit e kemi një analfabetizëm prej 6% në mesin e të rriturve. Si dhe në vitin 2004, shpenzimet e përgjithshme në arsim edhe në vitin 2005 dhe 2006, paraqesin diku rreth 4.7% të bruto prodhimit vendor që është përqindje mjaftë e ulët. Ky buxhet, e kemi parë shumë mirë se çfarë probleme ka krijuar në sektorin e shëndetësisë në vitin 2006, me çfarë probleme jemi ballafaquar, çfarë intervenime faliative është dashur të ndërmerren në mënyrë që sistemi shëndetësor të funksionojë. Të përkujtojmë inekcionet financiare prej 800.000 €, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës p.sh.

Nga raporti nuk mund të kuptohet se Ministria e Ekonomisë dhe Financave, ka zbatuar programe për planifikimin adekuat të buxhetit, në pajtim me nevojat e popullatës. Këto kanë qenë më tepër projeksione, të cilat kanë pasur për qëllim dhe kanë qenë të përpiluara, me qëllim që të kënaqin kriteret dhe standardet e organizatave relevante financiare ndërkombëtare, që nuk dëshiroj që t'i anashkaloj me këtë rast. Mirëpo, është dashur të tregohet një shkallë shumë më e lartë e ndjeshmërisë politike për nevojat e qytetarëve të Kosovës.

Aktualisht e kemi një situatë ku në fondin e privatizimit, sipas raportit i cili është paraqitur kemi 238 milion €. E kemi situatën ku 90 milion € janë shpenzuar më pak se sa që janë planifikuar që të shpenzohen, e kemi situatën ku depozitat e akumuluarat të KESH-it, në formë të fondeve të pashpërndara.

Ndonëse e kam të qartë se paraqesin burim të vetëm, të financimit të deficitit buxhetor, në fund të viti 2005, këto depozita të akumuluarat ishin 104.684. mijë €, ndërsa në vitin 2006, 179.974 mijë €.

Me të gjitha këto fonde në diskonim, të mos tentohet të gjendet përgjigje në problemet e normës sociale në shoqëri, të mos përmbushen rekomandimet e Kuvendit të Kosovës lidhur me përkritazi me pensionistët e Kosovës, të 7. korrikut 2005. dhe të mos tentohet që të shqyrtohen mundësitë për rritjen e pagave mjera të punëtorëve në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë, në kuadër të rishikimeve afatmesme të buxhetit është së paku jo kritike dhe e pa përgjegjshme. Të arritura në disa pozicione të përmendura nga parafolësit posaçërisht nga ana e përfaqësuesve ose deputetëve të bllokut Qeveritar, me siguri se na gëzojnë të gjithëve, mirëpo Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Qeveria e Kosovës duhet të jenë koshiente se vlerësimt pozitive të organizatave, të përmendura ndërkombëtare nga ana e ministrit, janë ndërtuar në radhë të parë mbi tolerancën dhe dinjitetin, e pensionistëve, mësimdhënësve dhe punëtorëve shëndetësorë të Kosovës.

Janë këto kategori të qytetarëve, që mund të ndihen të nderuara, me këto vlerësime të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe organizatave të tjera, para së gjithash. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA: Ju faleminderit, deputeti Rifat Krasniq, në emër të Grupit për 6+.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ: Ju faleminderit zoti kryetar,

I nderuar kryetar dhe ministra. Në emër të Grupit Parlamentar 6+ edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, e përkrahi propozimin dhe vendimin e Komisionit, se kjo pikë nuk është dashtë me u shqyrtua në këtë seancë. Pra për këtë arsye, nuk dëshiroj të marrë pjesë në diskutim për këtë pikë të rendit të ditës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ: Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar deputetë!

Kuvendi i Kosovës me vota të pozitës, por jo me vota të opozitës e ka mandatar këtë Qeveri, por nuk e mbikëqyr atë. Ky Kuvend nuk ka shqyrtuar raportin 3-mujor, 6-mujor dhe 9-mujor të buxhetit. Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nuk i ka raportuar Kuvendit sipas ligjeve në fuqi, ai nuk e përfillë Kuvendin, ka personalizuar Ministrinë, ka personalizuar buxhetin dhe pasojat e tij i paguan Kosova dhe qytetarët e saj.

Nuk i përgjigjet ftesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për të diskutuar prioritetet buxhetore, nuk i përgjigjet ftesës së Komisionit për të shqyrtuar pasqyrat financiare për vitin 2006. Është e kuptueshme se ministri ka punë më të mençura, është dhënë në krye të bordeve dhe bashkë me grupet e interesit, është në aksion për të shitur, në fakt për të falur pasurinë me interes kombëtar të Kosovës, po nxiton për të shfrytëzuar kohën sa është në pushtet, për të fituar vetë dhe një grup i caktuar rreth tij, pa u shqetësuar shumë për të ardhmen e shtetit të Kosovës.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka dështuar në menaxhimin e buxhetit të Kosovës, në zhvillimin e politikave fiskale, ka dështuar edhe në politikat e Administratës Tatimore. Me planifikimin e buxhetit është bërë planifikim jo real i të hyrave dhe tani në mënyrë fiktive në raport, na del se paska rritje të hyrave për 8.5%. Nga raporti shihet se 64% të hyrave sigurohet në kufij, që është ngarkesë shtesë për biznese, pasi që ata bëjnë pagesa jo të arsyeshme duke bërë pagesa në kufi dhe ende pa i shitur mallrat e tyre. Nga ana tjetër Qeveria nuk ka bërë asgjë që të pengojë kontrabandën me mallra të forta, nuk ka bërë asgjë për të penguar kontrabandën me karburante, të cilat buxhetit të konsoliduar të Kosovës po i kushtojnë me miliona euro.

Sipas të dhënave të doganës për 6-7 vite nuk janë futur as 10 kg. ari në rrugë legale, kurse vetëm me një kontroll në dy qendrat e Kosovës janë konfiskuar 120 kg. ari. Sipas tyre vetëm 5% e arit është e futur në rrugë legale. Si mund të shpjegohet fakti i futjes së arit dhe shumë mallrave të tjera në kanale ilegale? Kjo dëshmon se Qeveria nuk ka bërë asgjë për të ndaluar tregtinë me çanta, e cila po ashtu i ka kushtuar buxhetit të Kosovës, me miliona €, ngase në pikat kufitare të Kosovës nuk ka kontroll.

Ka ngecje në të hyrat vetanake të komunave, që janë inkasuar vetëm 82%, nga planifikimi ku vazhdon trendi i rënies së të hyrave vetanake nga viti në vit. Nga 34 milion € të planifikuar janë realizuar vetëm 27.75 milion €. Qeveria nuk ka bërë ndonjë analizë se pse po përcillet një dukuri e tillë. Sipas raportit të hyrat nga Administrata Tatimore janë 164 milion €, apo 23% të hyrave. Progresi ndaj vitit 2005 sipas raportit është 11%. Këto të hyra nuk janë rezultat i menaxhimit dhe efikasitetit në vjeljen e të hyrave siç thotë ministri, sepse nuk është fjala për ndonjë performancë më të mirë të Administratës

Tatimore, por rezultat i planifikimit jo real të hyrave dhe i ndëshkimeve që janë bërë ndaj bizneseve.

Ju sot na i dhatë disa shifra për borxhet, kamatat etj. por juve ju obligon ligji që këto të na i paraqitni në formë të raportit, Kuvendit të Kosovës.

Zoti ministër, pse në vazhdimësi po e shkëlmi Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedura, 2004/48, ku ju nuk keni raportuar as vitin e kaluar dhe nuk keni raportuar as këtë vit për punën e Administratës Tatimore. Pse mbani të fshehur raportin detal të Administratës Tatimore?, Pse lejoni që në Administratën Tatimore të ketë terr informativ?, Pse nuk i paraqiteni detajet mbi të ardhurat e mbledhura në Administratën Tatimore të Kosovës? Pse nuk i paraqitni në detaje borxhet ndaj Administratës Tatimore?. Pse nuk i tregoni hollësitë e shumave për secilin lloj të tatimit dhe për secilin regjion si dhe të dhënat tjera që i parasheh ligji? Pse nuk jeni transparent për Kuvendin dhe qytetarin e Kosovës? Pse nuk keni dhënë detaje mbi numrin dhe nivelin e stafit të Administratës Tatimore të Kosovës ,që u obligon neni 8.3 pika b).?. Ju këtë nuk e keni bërë , sepse ka dominuar ndikimi i politikës mbi Administratën Tatimore.

Në këtë Administratë Tatimore janë bërë pastrime politike, janë hequr kuadrat në të cilat është investua me vite dhe janë vendosur kryetarët e degëve të partisë në pushtet, apo shërbyes të devotshëm të partisë, sepse këta kanë pasur aftësi më të mira për të rregulluar marrëdhëniet mes administratës fiskale dhe biznesit, me ndikim mbi bazën e negociatave informale dhe aspak mbi bazën e ligjeve fiskale. Kështu po dëmtohet buxheti e po fillohet kriza ekonomike. Ju nuk keni bërë asgjë për të penguar invazionin fiskal, ju po përpiqeni të pengoni ivazionin fiskal, duke dënuar të varfëritë ,kurse u lejoni evazion fiskal bizneseve të forta.

Kjo Qeveri është treguar mospërfillëse, nga humbja që po pëson Kosova nga ekonomia informale, në përgjithësi dhe nga puna e zezë, në veçanti. Në vazhdimësi kryhen pagesa të mëdha me para në dorë dhe jashtë kanaleve të sistemit financiar dhe bankar, kurse Qeveria nuk ka bërë asnjë hap për të penguar një gjë të tillë. Mosmbledhja e tatimeve dhe taksave ka qar në varfërim të buxhetit dhe mungesë investimesh në infrastrukturën publike dhe ka reflektuar dukshëm, në nivelin e pagave në arsim, shëndetësi, te shërbyesit civilë dhe tek profesionistët e rastet sociale.

Nga raporti vërehet se buxheti ka ndryshuar sipas urdhëresave 2006/10 dhe 2006/14. Është bërë rishikimi i buxhetit pa pëlqimin e Kuvendit. Kuvendi nuk është njoftuar për transferin e mjeteve të cilat janë bërë pas miratimit të buxhetit të Kuvendit. Ka vazhduar trendi vjetër i shpenzimeve pa kurrfarë kontrolli. Krahasuar me trendin e të hyrave pjesëmarrja e pagave është 32% e shpenzimeve të përgjithshme. Në krahasim me vitin 2005, pagat janë rritë për 12 milion e 291 €. Nuk ka pasur rritje të pagave as në arsim, as në shëndetësi, por si pasojë e rritjes së numrit të shërbyesve civil dhe përkundër reagimeve të vazhdueshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe po ashtu kjo rritje ka ardhur edhe si pasojë se pagat në mungesë të nivelizimit janë rritur sipas preferencave të ministrave.

Edhe në vitin 2006 ka vazhduar trendi i shpenzimeve për luksin qeveritar, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, si kategoria më e përshtatshme për këtë qëllim. Nga buxheti i vitit 2006 janë shpenzuar për thirrje telefonike 5.300 mijë €. Vetëm Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka shpenzuar 460 mijë e 936 €, 21 mijë e 40 € më shumë se në vitin 2005. Shpenzimet për derivate janë mbi 20 milion €, vetëm Ministria e Ekonomisë

dhe Financave ka shpenzuar 213 mijë e 315€, do me thënë 16 mijë € më shumë se në vitin e kaluar, në vitin 2005. Për mirëmbajtje janë shpenzuar mbi 20 milion €, kurse vetëm për mirëmbajtjen e makinave Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka shpenzuar 86057 €, 80871€, më shumë se në vitin 2005.

Shërbimet kontraktuese, mbi 22 milion € vetëm për shërbimet kontraktuese të kohë pas kohshme janë shpenzuar 13 milion e 839 mijë €. Vetëm Ministria e Financave ka shpenzuar 2 milion € për këtë destinim. Ku është efektshmëria e këtyre shpenzimeve zoti ministër? Për shpenzime të udhëtimit brenda dhe jashtë vendit janë shpenzuar 4 milion €, kurse Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka shpenzuar, 323.610 €. Ministria e Ekonomisë dhe Financave për dreka zyrtare ka shpenzuar 43.723 €, ku 42.525 € më shumë se sa në vitin 2005.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave për keqadministrim dhe mos kompetencë profesionale ka shkarkuar nga detyra një sekretar të përhershëm në fillim të vitit 2006. Bazuar në shifrat me të cilat disponojmë dhe në rezultatet e punës së kësaj Ministrie, keqmenaxhimi dhe abuzimi me mjetet e buxhetit veç sa është thelluar në këtë ministri. Ministria që është e thirrur për menaxhimin financiar të buxhetit të Kosovës, keqpërdorë dhe keq-menaxhon buxhetin e vet ministrisë.

Realizimi jo i kënaqshëm i investimeve ku nga 189 milion €. janë shpenzuar vetëm 133 milion €, reflekton aftësi të pamjaftueshme absorbimi nga ana e Qeverisë të fondeve të akorduara nga buxheti për investime kapitale. Qeveria nuk ka aftësi profesionale për ndryshimin e këtij fenomeni dhe për rritjen e efikasitetit në përdorimin e fondeve për investime, ku mjetet e taksapaguesve u kthehen atyre në formë të mirave publike.

Po dalim në dy sektorët që Qeveria e i ka proklamuar si me prioritet, në sektorin e arsimit dhe .

KRYETARI KOLË BERISHA: Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri

DEPUTETJA TEUTA HADRI: Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar deputetë. Në raportin vjetor të punës së Qeverisë në vitin 2006 në kuadër të planit zhvillimor të Kosovës, u hartua një strategji shëndetësore për vitin 2007 e më tutje, ku kishte si qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe shërbimeve më cilësore në shëndetësi. Bazuar në draftin e kësaj strategjie, prioritetet mbeten të njëjta si 7 vitet e mëparshme. Si prioritate në këtë strategji mbeten, zhvillimi i shëndetshëm i jetës, përmirësimi i shëndetit të rinjve, përmirësimi i shëndetit mendor, zhvillimi i resurseve njerëzore, zvogëlimi i mortalitetit dhe zvogëlimi i riskut financiar të pacientit.

Këto ishin prioritetet që ishin paraparë nga Qeveria vitin e kaluar për këtë vit, por kjo strategji ka kaluar gjysma e vitit dhe këto prioritetet nuk janë realizuar ku janë dhënë shuma parash që nuk shprehen në këtë raport. Një rëndësi dhe prioritet që është vendosur t'u jepet ka qenë edhe projekti për kirurgjinë invazive, si një ndër prioritetet më të rëndësishme që ka shëndetësia e Kosovës, ku në këtë lëmi Kosova është në pozitë 0 të zhvillimit.

Pastaj projekti për Onkologjinë dhe Njësinë Koronare.. Punët në këto projekte kanë ngecur pa përfunduar, nuk ka informatë në raport për shpenzimet rreth këtyre projekteve. Prandaj qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të pyesin- Pse këto projekte kanë ngecur pa u realizuar dhe sa janë shuma të dhënash parash, ku shprehen me miliona, a qytetarët ende

vazhdojnë rrugën e vuajtjes dhe udhëtimeve për të dalë jashtë Kosovës dhe kërkuar një ditë jete më shumë.

Çka u bë me fondin, me prioritetin, që u dha institucioneve primare shëndetësore, ku komunat kanë përgatitë në kuadër të aktiviteteve të tyre, implementimin e statuteve qendrore të zhvillimit, të mjekësisë familjare. Këto qendra të zhvillimit të mjekësisë familjare, kanë përkrahur këto projekte dhe mbesin ende në realizim. Njëherit janë përgatitur planet, e programet, për specializimin e vitit të parë të mjekësisë familjare, ku janë dhënë shuma parash për këto. Por sa janë aplikuar këto?

Por mos harroni zotëri deputet, qytetarët presin e presin, por jeta po kalon dhe gjeneratat po mbesin në duart e fatit, ku ne me duart tona po i caktojmë. X Çka u bë me fondin me prioritetin që u dha institucioneve primare shëndetësore ku komunat kanë përgatitur në kuadër të aktiviteteve e të tyre implementimin e statuteve qendrore të zhvillimit të mjekësisë familjare. Këto qendra të zhvillimit të mjekësisë familjare kanë përkrahur këto projekte dhe mbesin ende në realizim. Njëherit janë përgatitur planet dhe programet për specializimin e vitit të parë të mjekësisë familjare ku janë dhanë shuma parash për to. Por sa janë aplikuar këto? Por mos harroni zotërinj deputetë ,qytetarët presin ,por jeta po kalon dhe gjenerata po mbesin në duart e fatit, punët me duart tona po i caktojmë. Çka u bë me hartimin e strategjisë se re për dispenzimin e barnave esenciale ,e cila është paraparë të fillojë me 1 janar 2007, nga raporti i punës, që ka të bëjë Qeveria për vitin e kaluar. Po të realizohej kjo, Ministria e Shëndetësisë do ta kishte të kursyer buxhetin për 1 milion € dhe njëkohësisht do t'i mundësohet qytetarëve tanë në qasjen në listën e barërave esenciale. Po destinomi i bashkë-pagesave, a po kontrollohet dhe nga kush po kontrollohet? A janë unike bashkë-pagesat e qytetarëve që bëhen në qendrat spitalore dhe sa po kontrollohen këto, kur dihet se disa qendra spitalore në shumë vise dhe vende rajonale ato janë diku më shumë, diku më pak, ashtu siç paraqiten në

në bashkë pagesat. Do me thënë këto nuk janë unike, por pagat e mjekëve që ka premtuar Qeveria që disa vite, sa janë ngritur, kur dihet se në këtë Raport fondet e pashpërndara janë 179 milion dhe këto para pse nuk kanë ndikuar që të ngritën pagat e punëtorëve në përqindje ashtu siç ka premtuar Qeveria? Ndërsa, pagat e deputetëve janë ngritur dhe nuk është paraqitur ngritja e pagave të deputetëve, kurse punëtorët shëndetësorë kanë mbetur në gjendje ende të rëndë.

Ku ka mbetur Qeveria këtu? Spitalet kanë kompletuar të gjitha aktivitetet e tyre, me gjithë dokumentacionin përcjellës, doracakët e veprimt, aktivitetet tjera të implementimit të statuteve për vitin e kaluar dhe si sfida ka mbetur që ky vit të furnizohet dhe të jetë më i furnizueshëm me barëra, por kjo gjendje nuk ka ndodhur a shuma parash janë dhënë. Qeveria përmend shuma marramendëse për ndarjen e parave dhe barërave mbi 1 milion euro jepen para për barëra, ndërsa në sallat e operacionit nuk ka as maska për një përdorim e ato përdoren jashtë Rregullores së punës edhe disa here në ditë.

Shërbimi final, për shërbimin, për shërimin e qytetarëve që kryhet në Kosovë, siç është Shërbimi terciar, bëhet në institucionin e vetëm të QKU-s si institucion që përballon punën e tëra qendrave shëndetësore që vijnë nga regjioni. Është rënduar aq shumë dhe është aq numër i madh i pacientëve sa që këtë Shërbim terciar e ka shndërruar në shërbim primar dhe ky shërbim nuk po i kryen funksionet e veta terciare sipas kushteve, por duhet t'i përballojë punës së rëndë.

Qeveria për një kohë të shkurtër ka caktuar një bord për ta qeverisur QKU-në dhe ky bord e ka pas mandatin e vetë, mirëpo këtij bordi i ka skaduar mandati dhe nuk po bëhet menaxhimi dhe organizimi i punës dhe shpërndarjeve të mjeteve të fondit për QKU-në. Pse Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë nuk po e bënë lëshimin e licencave të spitaleve private, kur sot çdo ditë në Kosovë po mbinë nga një spital i pa licencuar, bëhen operacione, vijnë mjekët nga jashtë operojnë, nuk kanë licencë. Çka janë ata mjekë apo veterinarë që vinë, kryejnë operacionin dhe e bëjnë operacione me organet e pacientit e askush nuk din, nuk din as Ministria e Shëndetësisë se çka bëhet me këta pacient , se nuk ka të dhëna referimi.

Por çështja më spekuluese dhe përfitim prurëse nga individë të caktuar dhe mbetet të jetë edhe shqetësuese mosrealizimi i tenderëve të barërave, por të jetë ky realizim, besoj se organizimi i punës në shëndetësi do të jetë më në nivel. Dhe si fund dua ta harroj të kaluarën në shëndetësi të tashmën në shëndetësi dhe të mendoj për të ardhmen e qytetarëve tanë dhe është një shqetësim i imi personal . Dua ta pyes Qeverinë - A ka bërë ndonjë organizim në këtë stinë të pranverës, po të shpërthente ndonjë epidemi e gripit të shpeztëve, kurse ne si Komision i Shëndetësisë kemi pasur një informatë në Komision nga ekspertët e jashtëm se janë ndarë shuma parash prej 5 milionë euro për këtë çështje në rast të shpërthimit të epidemive. Mua më intereson Qeveria a ka marrë këtë fond nga Banka Botërore apo është tue menaxhua apo si është puna e këtij Fondi. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Enver Hoxhaj, por nuk është këtu. Fjalën e ka deputeti Gani Koci

DEPUTETI GANI KOCI – Shyqyr para Enver Hoxhës sot fjalën.. Ju faleminderit z. kryetar Të nderuar deputetë. Vërtetë fjalët e ministrit ishin të atilla sa, ne ndoshta nuk do të na mbetet të themi asgjë vetëm të miratojmë, jo me një dorë po me të dy duart këtë Raport që na e ka ofruar këtu. Por, unë konsideroj se nuk është ashtu dhe mu do të më vinte turp si po të isha në vendin e ministrit dhe të kisha ardhur në këtë gjendje që të mos i përgjigjet funksionit të cilin e ka marrë, të mos i përgjigjet rregullave të cilat i ka miratu vetë ky Kuvend dhe të mos i përgjigjet edhe rregullativës ose Rregullores të punës të Qeverisë në cilën bënë pjesë edhe vetë. Unë dua t'i përkujtoj z. ministër vetëm rregullën, Po e lexoj z. Alush se nuk e ke ditë, rregullën 65 – përfaqësuesit e Qeverisë, ministrat, zëvendësministrat ose zyrtarët e caktuar, të cilët kanë përgatitur materialin për shqyrtim nga Qeveria, duhet të marrin pjesë në takimet e trupave parlamentare me ftesën e tyre. Në nenin pasues 66 thotë: në qoftë se nuk mund të marrë pjesë, duhet ta paralajmërojë arsyen dhe tjetri nen po pas tij thotë se: Ministri duhet të raportojë në Qeveri për takimin që e ka pasur me trupat parlamentare. Ju, jo që nuk e keni respektuar Rregulloren e punës së Kuvendit, nuk e keni respektuar Kornizën Kushtetuese, ju nuk e keni respektuar edhe vetë rregulloren e Qeverisë suaj dhe ky është shembulli më i mirë vërtet, se si i ka respektuar kjo Qeveri dhe Ministri edhe ligjet tjera, edhe Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe Raportin e të cilit jemi sot duke e shqyrtu këtu. Por, le të mbetet prapë në ndërgjegjen e tij dhe në atë kryelartësinë e tij edhe atë ballëhapuren që e tha ai duhet të jemi ballëhapur.

Është bërë praktikë e raportimeve të tilla, është krijuar një shabllon dhe sinqerisht t'ju them që 7 vjet nuk mund t'i ikim këtij shablloni, bile as në numër të faqeve, le më në diçka tjetër, por as në numër të faqeve. I tillë është edhe Raporti, të cilin na e ka ofruar ministri në këtë rast. Për dallim nga vitet tjera, ne para vetes së paku ne si anëtarë të Komisionit i të cilit kemi qenë kemi edhe një lloj specifikimi të harxhimit të mallrave dhe shërbimeve, do të thotë që e dallon këtë raport nga raportimet e deritashme, por edhe

në këtë specifikim ka aq paqartësi, ka aq përgjithësim dhe mbi bazë të tyre paqartësive. Mbi bazë të këtyre përgjithësimeve lirisht mund të vijmë te konkluzioni se Ministria përkatëse, respektivisht Qeveria nuk ka ditë të menaxhojë në mënyrë racionale buxhetin e Kosovës, i cili buxhet i është besuar në mbikëqyrje dhe në menaxhim Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave.

E thanë edhe parafolësit rreth projekteve ose projektive të hyrave dhe realizimit të tyre me një plus apo minus, rritje ose zvogëlim të tyre, që pak ka rëndësi për mendimin tim. E rëndësishme është se tri të katërtat e buxhetit realizohen në dogana, shumë e rëndësishme është kjo. Tu marrë parasysh atë çka u tha edhe nga parafolësit se në Kosovë kemi një ekonomi informale, kemi një invazion fiskal që llogaritet në miliarda euro dhe kemi në borxh ndaj Administratës Tatimore diku në vlerë 160 milion ose 170 milion euro dhe Qeveria, respektivisht ministri lavdërohet se paska arrit një rritje në mbledhjen e taksave nga qytetarët. Edhe ky është një mashtrim i ministrit ndaj vetvetes në radhë të parë, në radhë të dytë ndaj qytetarëve po edhe ndaj tatimpaguesve.

Raporti i shpenzimeve buxhetore ndërmjet pagave dhe linjës së pagave dhe mallrave dhe shërbimeve në shumë njësi buxhetore është një me një, nuk jam ekonomist le të më thotë ministri vërtet është ky në racionalitet në shpenzimin e buxhetit dhe në realizimin e buxhetit.

Neni 15 i Ligjit mbi menaxhimin e financave publike parasheh qartë se paratë publike do të përdoren vetëm për qëllimet e miratuara publike. Unë kërkoj nga ministri të më thotë vërtetë a janë realizuar këto shpenzime mbi bazën e qëllimeve të parapara dhe të miratuara në këtë Kuvend? Para vetës unë e kam listën e projekteve për vitin 2006, të gjitha njësitë buxhetore dhe veçanërisht dua të ndalem në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit. Në këtë projekt ose në listën e projekteve kapitale është realizimi i një morie e rrugëve ose pjesë e këtyre projekteve dhe ne para vetes nuk kemi një raport po ashtu të detajizuar se këto projekte të kësaj Ministrie në ç'fazë të realizimit janë, sa janë realizu dhe sa janë bartur në këtë vit, në të cilin tani jemi, a që është dashur të realizohen në vitin paraprak. Duhet përmend vetëm një fakt: vitin e kaluar ka filluar ndërtimi i rrugës Skenderaj – Vushtrri, një fazë e caktuar e kësaj rruge diku në 8 kilometra: Nuk e di saktësisht sa ka qenë vlera, por e di se është dashur të kryhet për 72 ditë dhe ajo rrugë nuk është kryer, nuk ka përfunduar ajo fazë për të cilën është projektuar dhe ç'është më e keqja vetëm janë degraduar tokat bujqësore, të cilët pronarët e atyre tokave tash një vit nuk mund t'i punojnë. Duhet të llogarisë Qeveria edhe në humbjen e parasë për mosrealizim ose krijimin e detyrimeve për mosrealizim të projekteve të cilat i ka pasur. Një fakt tjetër që duhet përmend te shpenzimet pa i përmendur shifrat që i thanë të tjerët, te shpenzimet telefonike. Ju lutem, më thoni ju se a është racionale që Ministria e Kulturës të shpenzojë mbi 220 mijë euro për telefon, ndërsa Kuvendi të shpenzojë tri herë më pak se Ministria e Kulturës. Por nuk është e çuditshme te kjo ministri, ai në një prononcim të tij publik patë thënë se: "Unë i kam harxhuar paratë e babës e nuk po i harxhoj paret e Qeverisë dhe të miletit" dhe kjo është logjika e veprimit të kësaj Qeverie, kjo është logjika e veprimit të ministrave të kësaj Qeverie.

Do të ndalem dhe do të pyes ministrin të më tregoj se cili është dallimi të në mes të vajit për ngrohje dhe mazutit, që i ndanë këto linja, cili është dallimi në mes karburanteve për gjeneratorë dhe karburanteve për vetura dhe cili është dallimi në mes naftës dhe naftës për ngrohje? Të gjitha këto me një fjalë janë karburante dhe si të tilla

kanë vetëm këtë emër karburante dhe kjo vlerë arrin atë që ju na e keni dhënë këtu, që është e teprurme, e stërteprurme, ose çështja tjetër. Ne e kemi pasur sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dy fonde rezervë, fondin rezervë të ministrit dhe fondin rezervë për Përfaqësuesin Special.

Ne ë faqet e fundit kemi pak fjalë rreth realizimit ose menaxhimit të këtyre fondeve dhe në raport janë dhënë 31 raste të ndarjeve nga ky fond. Po të shikohen këto raste mund të vijmë në përfundim se ministri nuk e ka respektuar dhe besoj që s'e ka lexuar nenin 26 dhe nuk ka ditur të vlerësoj se çka do me thënë shpenzim ir rastit dhe shpenzim urgjentë. Unë do ta përmend vetëm një ndarje për KEK-un që është bërë diku 230 mijë euro dhe nuk përshkruhet fare pse është bërë kjo ndarje, kur dihet se për vitin fiskal, vetëm për KEK-un nëpërmjet AKM-së janë ndarë mbi 36 milion euro dhe tjetra, janë dhënë 9000 euro, që është shumë banale për një traktor që i paska premtuar kryeministri i atëhershëm dikujt, ose janë ndarë mjete në shuma të caktuara. Nuk dua t'i përmendi shifrat, për mos të marrë kohë, Ministrisë të Kulturës, e cila nga ato fonde ka financuar do farë festivalesh që kanë krijuar pseudo vlera dhe jo vlera të mirëfillta kulturore. Krejt në fund do të dëshiroja që sa më shpejtë Raporti i Auditorit të Përgjithshëm lidhur mbi menaxhimin e buxhetit për vitin 2006, të vihet para deputetëve, para Kuvendit. Vetëm ai do ta qartësojë mënyrën vërtet të shpenzimeve buxhetore të kësaj Qeverie në përgjithësi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Enver Hoxhaj, le të përgatitet deputeti Shaban Halimi

DEPUTETI ENVER HOXHAI - I nderuar z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë – Realisht nuk e kam pasur ndërmend që të paraqitem për fjalë pas prezantimit të shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës z. Krasniqi. Më habiti më tepër terminologjia që e përdori ministri Shatri. Unë personalisht çdo të premtë e blej një revistë që thirret "Ekonomist" dhe që merret me çështje të ekonomisë, por, kryesisht me politikë. E lexoj që 7 vite pothuajse dhe asnjëherë nuk më ka ra në terminologji të kësaj gazete kur flitet për tema ekonomike me përdorur : "Fjalor i ndritshëm".

Zakonisht njerëzit që merren me kulturë, ose me arsim, mund të flasin për sukseset e ndritshme. Njerëzit e ekonomisë e kanë pakëz problem me përdor terminologji të tillë. Përveç kësaj, që shumë interesant, sepse para se të zhvillohej debati, ministri ofroi një paragjykim të tillë që tha:

Po interpretohen të dhënat në mënyrë të njëanshme, selektive me atë reflektoi më tepër mentalitetin vetëqeverisës, atë mainsetin, i cili e përçjell këtë Qeveri. Dhe do të thotë ky ke gati njëri nga shkaset, ndërsa shkaku për se jam në foltore do t'i prezantoj kalimthi disa prej qëndrimeve që për mendimin tim janë shumë shqetësuese rreth asaj si debatohet edhe për një raport buxhetor.

E para. Unë kam pas mundësinë javën e kaluar ta lexoj programin e Qeverisë të vitit 2006, dhe të shoh ta lidhi buxhetin, këtë raport buxhetor për vitin 2006. Programi i Qeverisë dhe buxheti janë dy gjëra të ndryshme.

Nëse dikush prej jush në këtë sallë edhe ministri, kishte qenë në gjendja ta jap një sqarim të detajuar: Pse programi i Qeverisë dhe buxheti janë dy segmente, dy dimensione të

ndryshme, sigurisht që qytetarëve të Kosovës kishte qenë një çështje që u kishte interesuar jashtëzakonisht . Për më tepër. A më lejoni t'i përsëris disa të dhëna të cilat u përsëritën prej kolegëve më herët.

Edhe ne që vijmë prej shkencës sociale dhe kemi dëgjuar katër semestra statistikë e kemi problem fillimisht me lexuar këtë buxhet në formën si është prezantuar. Unë e di që pat fjalime pararendëse këtu për transparent, po buxheti në mënyrën si përgatitet buxheti dhe ka edhe shembuj të tjerë të buxheteve, tregon që pikërisht buxheti në formën si është prezantuar nuk është transparent, meqë nuk janë prezantuar në formë konkrete shpenzimet për të cilat janë përdorur.

Më lejoni vetëm t'ju kujtoj disa shuma të cilat i kam nxjerrë nga ky buxhet. P.sh. janë mbi 20 milion euro që janë përdorur për derivate. Çfarë gjeografie politike ka Qeveria e Kosovës, apo është fjala për gjeografi private të kësaj qeverive. Për çfarë territori, çfarë territori operojnë, e lëvizin njerëzit e kësaj Qeverie nëse janë në gjendje mbi 20 milion euro për derivate të përdoren. Mbi 20 milion euro janë të përdorura për mirëmbajtje, a e mirëmban kjo Qeveri Nju Jorkun, çfarë hapësire mirëmbahet, çfarë nënkupton termi mirëmbajtje, për çka janë përdorur këto shumat e mirëmbajtjes.

Shpenzimet e tjera afër 9 milion- mobile, është viti 2007, pse në 2006 ka pas nevojë për 9 milion mobile, për çfarë mobilesh , a ban ta pyes ministrin Shatri ku i keni çuar mobiliet e vjetra, se ndoshta mund t'ia dhurojmë ndonjë shkolle Dhe çfarë ka ndodhur me mobiliet e vjetra nëse 9 milion keni blerë mobile?. Dhe për mendimin tim këto nuk janë të dhëna të cilat flasin për raportet e ndritshme, përveç kësaj është edhe një shumë tjetër që thirret si shpenzimet e tjera dhe në cilën janë dhënë 33 milion dhe për të cilat nuk ka specifikim se për çfarë janë përdorur. Për mendimin tim një shumë prej 33 milion pa specifikim është problem. Në këtë Kuvend do të duhej të debatohej shumë gjatë për të gjitha këto shuma që i përmenda kalimthi. Dhe e gjithë kjo më shtyri të dal në foltore të flas edhe për problemet e buxhetit për një arsye të thjeshtë. Ne do të debatojmë ndoshta sot ndoshta nesër për hapësirën shkollore dhe për mungesën e hapësirës shkollore e cila është në zvogëlim e sipër. Për atë se sa pak shkolla ndërtohen në Kosovë, për atë se si nxënësit ulen nga 3 në bankë, për atë se si klasë janë të stërngarkuara. Imagjinoni këto shuma që i përmenda unë se sa shkolla do të mund të ndërtoheshin gjatë vitit të kaluar që lamë. Dhe për veç kësaj ekziston edhe një kategori të cilin unë definitivisht kam nevojë, mbi gjitha këtu të kem përgjigje prej ministrit e cila titullohet: Fondet e pashpërndara dhe shuma është 179 milion euro. Imagjinoni në vendet perëndimore kur fillon gjysma e dytë e vitit, qeveritë hyjnë borxh në buxhet të vitit të ardhshëm për shkak të asaj se janë të interesuar t'i implementojnë planet, ne jetojmë në varfëri gjer sa 180 milion euro mbesin të pashpërndara! Për mendimin tim e gjithë kjo tregon që ministri duhet të përdorë gjuhë ekonomike, duhet të ofrojë fakte ekonomike dhe duhet të tregojë çfarë ndodh me mënyrën se si menaxhohet buxheti i qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALIMI – Ju faleminderit fjalën e ka deputeti Shaban Halimi

DEPUTETI SHABAN HALIMI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Raportin të cilin e kemi sot përpara për diskutim, unë mendoj në aspektin e përpilimit të raporteve financiare, është një raport i cili plotëson ato kritere, sepse është një pasqyrë e qartë ku jepet krahasimi i periudhave do të thotë viteve. Vitet 2006 dhe 2005, ku kjo ka qenë edhe një kërkesë e vazhdueshme e deputetëve që raportet e tilla të jenë raporte krahasuese dhe tjetra është se në këtë raport po ashtu paraqiten,

edhe në formë tabelore, edhe në formë grafike e gjithë struktura e të hyrave të të gjitha pozicioneve, po ashtu edhe struktura e shpenzimeve apo e të dalurave.

Kjo më jep bindjen për të thënë se një raport i tillë është raport i cili meriton të them kështu jo lëvdatë, por meriton që të kihet kujdes të mos jepen kritikak kështu s'e di sa të mëdha.

Në anën tjetër ky raport na jep me kuptue se kemi lëvizje pozitive në drejtim do të thotë të shpenzimeve, ku kemi një rënie dhe gjithashtu edhe një drejtim të të hyrave në përgjithësi në të gjitha pozicionet edhe pse këto lëvizje nuk janë të mëdha, por janë shpresëdhënëse se buxheti ka filluar ta marrë veten.

Një çështje tjetër e cila është te shpenzimet nuk është më tepër rezultat me thënë i një aktiviteti më profesional, ose i një aktiviteti të mirëfilltë, por është më tepër influencë ose ndikim i Fondit Monetar Ndërkombëtar me uljen e numrit të të punësuarve në përgjithësi në shërbimet civile dhe një herit në uljen do të thotë të pozicionit të mallrave dhe të shërbimeve.

Këtu sigurisht se në kohën të cilën po kalojmë, në të cilën po punojmë, edhe masat e këtilla janë të domosdoshme janë të nevojshme, por në këtë drejtim duhet të theksoj se kuvendet komunale sidomos ato të vogla dhe janë shumë më larg qendrës, e gjejnë veten në një formë pakëz të hendikepuar siç është edhe komuna e Dragashit. Kuptohet në këtë drejtim do të thotë se edhe kriteret që kanë qenë për ndarjen e buxheteve ose granteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës kanë qenë kriteret jo ndoshta deri tash të punuara mirë, sigurisht se tash Ministria është në fazën, ose në përpilimin e fazës së përpilimit të buxhetit për vitin 2007 dhe në këtë drejtim sigurisht se edhe kriteret duhet të përmirësohen ose të avancohen pakëz më tepër dhe komunat larg qendrës të cilat u ekspozohen shpenzimeve shumë më të mëdha sesa komunat që janë afër qendrës, do të thotë janë më pakëz të favorizuara në këtë drejtim.

Tjetër që është shpresëdhënëse është se kemi do të thotë mjete të akumuluar, si fondet e pashpërndara, qoftë nga fondi i privatizimit dhe transaksionet e tjera financiare që neve si deputetë po ashtu duhet ta kemi fjalën tonë dhe sigurisht se do ta kemi që edhe këto të përdoren për nevoja më elementare ose për kërkesa për të cilat shpesh në këtë parlament diskutohet për kategori në nevojë, dhe nuk jepen p.sh. pozicione ose nuk jepen ide se kah mund të sigurohen këto mjete. Çështja tjetër është po ashtu se kursimet ose ulja e shpenzimeve nuk mund të shkohet në forma direkte por ato mund të shkojnë me forma të tjera të përpunuara siç janë format e punësimeve me stimulime për agjencitë buxhetore dhe këtu besoj p.sh. se mund të nxirren mjete të cilat kishin me qenë të nevojshme ose kishin me qenë në shërbim të kategorive të tjera që kanë nevojë.

Gjithashtu kam përmendur edhe më herët gjatë diskutimeve të buxheteve, a përpilimit të tyre, por edhe shpenzimit, raporteve shpenzuese të buxhetit se kategoria ose skema sociale në përgjithësi të cilën diku afër 24% e buxhetit shkon, është një çështje e cila duhet të rishikohet për të mund me nxjerrë mjetet të cilat kishin me shkuar do të thotë në favor të kategorive të tjera. Dhe krejt për fund z. ministër kemi një dukuri do të thotë ku inspeksionet tona zënë duhanin kontrabandë. Unë si deputet nuk jam i njoftuar se ai duhan verifikohet se është i cilësisë dhe nuk është i cilësisë, dhe ai në përgjithësi do të digjet, por në praktikën e shteteve të tjera, ai duhan do të kthehet si pasuri e shtetit dhe

shteti pastaj e manipulon atë. Nëse keni një informatë me dhënë për opinion edhe për ne mirë kishte me qenë.

Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi

DEPUTETI BAJRAM KOSUMI – Ju faleminderit, i nderuar kryesues i nderuar ministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë. Menaxhimi i buxhetit të vitit 2006 ka dy trende kryesore pozitive. Në një, është në përputhje me politikën afatmesme buxhetore të miratuar nga Qeveria, që është shumë e rëndësishme që në përgjithësi për buxhetin dhe menaxhimin e tij nga Qeveria dhe nën dy, është në përputhje me letrën e qëllimit të nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, gjë që u krijon Qeverisë dhe buxhetit të Kosovës një pranim dhe një qasje më të mirë nga institucionet ndërkombëtare.

Prandaj në këto dy trende pozitive i përgëzoj ministrin edhe qeverinë që keni ecur kështu. Por megjithatë unë do të kisha shfrytëzuar rastin t'i japë disa sugjerime, disa rekomandime në disa pika kyçe të buxhetit 2006, dhe në bazë të këtij buxheti edhe atyre që mund të ndodhin në vitin 2007, 2008 e të tjera.

Ju e dini se me zgjedhjen e statusit final të Kosovës të hyrat buxhetore nga doganat do të vijnë duke u zvogëluar, meqenëse pjesa më e madhe e buxhetit tash mbledhet në doganë zvogëlimi i këtyre të hyrave do ta sfidojë buxhetin e Kosovës. Pritet që buxheti i Kosovës të rritet nga të hyrat e brendshme do të thotë kryesisht nga të hyrat që do të mbledhë administrata tatimore e Kosovës. Unë e kam shikuar me kujdes të hyrat e vitit 2006 nga administrata tatimore e Kosovës dhe këtu ka një rritje, ka një rritje prej 11%, mirëpo kjo rritje prej 11% është prej disa të hyrave që nuk shpresohet të jenë të rregullta, është tatimi në ekstra profit për PTK-në dhe disa kode tjera që mund të mos jenë të rregullta dhe mund të mos i kenë këto shuma, por të hyrat nga administrata tatimore kanë shënuar rënie disa kode që janë shumë të rëndësishme dhe të ndjeshme për buxhetin e Kosovës siç është tatimi në fitim që ka një rënie -26%, tatimi në të ardhurat personale që ka -20% po edhe TVSH-ja që është kodi kryesor i këtyre të hyrave ka një rritje shumë të vogël prej 3%.

Këto të dhëna për këto të hyra nga administrata tatimore e Kosovës mendoj duhet të jenë një sinjal për Qeverinë dhe për juve si ministri dhe si ministër që të bëni një analizë pse ka ndodhur kjo rënie dhe të shikoni mundësinë që në këtë vit 2007 dhe në vitet e ardhshme të hyrat nga administrata tatimore e Kosovës të rriten sepse këtu do të jetë burimi më i madh i buxhetit të Kosovës në vitet e ardhshme.

Çështja e dytë, janë të hyrat vetanake të komunave edhe pse te këto të hyra ka një rritje të vogël 10 komuna në Kosovë kanë një rënie në të hyrat vetanake në krahasim me buxhetin paraprak.

Këto rënie janë në disa raste shumë të mëdha, ka rënie në -43% Malisheva, Rahoveci ka -38% dhe të mos i numëroj të gjitha, kurse Vitia 25%, Deçani 24%, Peja 23%. Të gjitha këto janë minus. Ka rënie të të hyrave vetanake të komunave. Janë 6 komuna të tjera që kanë ngritje shumë të vogël prej 1 deri 5%. Unë ju kisha sugjeruar si ministri të bëni një vlerësim të këto raste të komunat ku ka rënie, pse ka rënie dhe të shikoni edhe shkaqet e arsytet e kësaj rënieje sepse rënia prej -43% është shumë domethënëse. Nuk është një

rënie për një çështje të vogël administrative është rënie thelbësore substanciale. Prandaj duhet të hulumtoni dhe po ju sugjeroj të hulumtoni dhe të keni këtë para vetes si një vlerësim. Qeveria të ketë një vlerësim pse është ky trend negativ në disa, në gjysmën e komunave të Kosovës.

Çështja e tretë që u përmend këtu edhe prej juve i nderur ministër por edhe prej shumë folësve, janë shpenzimet kapitale. Unë nuk do të ndalem, por kjo është pjesa më interesante për buxhetin e Kosovës që sa vjet që menaxhohet prej Qeverisë. Dhe në këtë pjesë të buxhetit ka rënie, do të thotë prej 180 milionëve të lejuara 183 janë shfrytëzuar, do të thotë ka një suficit prej 53 milionëve. Ndoshta ju e keni analizën tuaj, vlerësimin tuaj pse ka ndodhur do të ishte mirë si Qeveri ta merrni shumë seriozisht dhe të shikoni detajisht cilat organizata buxhetore nuk e kanë shfrytëzuar buxhetin e tyre si duhet dhe të merrni masa ndaj tyre.

Çështja e fundit është një mungesë në këtë raport buxhetor, është raporti për financat për statusin final të Kosovës. Ministër ju thatë vetë se keni treguar gatishmëri dhe ashtu duhet besoj që deri në fund që të jetë që të financoni të gjitha punët rreth statusit final të Kosovës. Mirëpo, unë besoj se është dashur në këtë raport të raportohet edhe për financat, shpenzimin e buxhetit për statusin final të Kosovës dhe për deputetët dhe qytetarët e Kosovës të shohin saktësisht si janë shpenzuar paratë publike në procesin e statusit final të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Ju faleminderit z. kryesues, unë do të ndalem te disa vlerësime në bazë të këtyre diskutimeve që nga disa deputetët që e patëm.

Është një gjë e rëndësishme që Kosova ka arritur të ndërtojë një sistem financiar nga të hyrat e veta dhe kjo është shumë pozitive për ne dhe është duke vazhduar shpenzimin e këtyre të hyrave, këtyre parave, t'i bëjë konform ligjeve që të dalin nga ky Kuvend.

U tha këtu se nga një vlerësim nga disa deputetë që ka ramje ekonomike. Unë nuk di se si janë marrë këto informacione, por unë mund t'ju them me përgjegjësi në bazë të informacioneve zyrtare dhe në bazë të analizave të faktorëve relevantë ndërkombëtarë që kujdesen për këto çështje.

Rritja ekonomike në Kosovë për vitin e kaluar ka ndodhur 5%, do të thotë kemi një rritje të gjithmbarshme 5% dhe kemi mbi 5% vetëm në sektorin privat dhe këto janë të konfirmuar nga faktori ndërkombëtar. U përmend raporti i Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, edhe këtu në një farë mënyre u la të kuptohet që është një raport shumë negativ për Kosovën dhe institucionet e Kosovës që, për mendimin tonë ai nuk qëndron, sepse po t'i bëhet një analizë shihet qartë progresi që e kanë bërë institucionet e Kosovës në shumë fusha sa i përket zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe mund të them se ato vlerësime negative nuk qëndrojnë sa i përket rritjes ekonomike të Kosovës.

U tha se **GDP -ja** për kokë të banorit në Kosovë ka shënuar rënie. Edhe unë them me përgjegjësi se nuk është e vërtetë që ka shënuar rënie, **GDP-ja** është rritur për 3.5% për kokë të banorit në Kosovë. Pra, bruto produkti vendor i Kosovës për kokë banori është rritur dhe nuk ka shënuar rënie.

Sa u përket të hyrave, ministri i përmendi, të hyrat, se të hyrat janë rritur edhe nga grumbullimi në kufi, por edhe të hyrat e brendshme, edhe në pjesën e fillimit domethënë në tremujorin 2007 të hyrat nga kufiri prapë janë të larta po edhe nga brenda ka progres. U fol këtu për shpenzimet, normalisht të gjitha strukturat qeveritare institucionet publike që punojnë, bëjnë shpenzime, sepse puna që bëhet edhe paguhet, u fol këtu edhe për shpenzimet e mallrave e shërbimeve, është mirë që t'u sqarohet qytetarëve të Kosovës të mos krijohet një përshtypje negative se ministrinë apo qeveria po bën shpenzime enorme kur dihet sa shërbyes civilë në institucionet shoqërore dhe publike i kryejnë detyrat e veta duke llogaritur në këto para që derdhen për këtë çështje.

U tha për karburante. Ne mund të themi që në Ministrinë e Tregtisë i kemi 15 automjete dhe dihet në muaj sa mund të shpenzojnë ato automjete dhe ka ndoshta mbi 1000 apo 2000 automjete që ka shërbimi policor të cilat për çdo ditë e ruajnë dhe kujdesen për rendin dhe qetësinë në Kosovë, po ashtu ka trupa mbrojtëse të Kosovës, që i kanë të gjitha shërbimet në Kosovë, dhe i kanë të gjitha institucionet e tjera dhe komunat dhe nuk duhet të krijohet një përshtypje e rreme te qytetarët e Kosovës se këto shpenzime po treten, këto para publike të qytetarëve po treten, sepse dihet për çka përdoren ato.

Dhe qytetarëve të Kosovës mund t'ua bëjnë të qartë se po të bëhet një analizë nga qeverisja e gjerë ku kanë qenë tri parti të gjitha e kanë ruajtur njëra tjetrën dhe nuk kanë folur dhe të shikojmë nga qeverisja e këtij koalicioni me plotë kuptimin e fjalës mund të themi se janë të kursyera mbi 50 milion euro vetëm nga këto shpenzime që ju po i përmendni dhe është mirë që të bëhen këto analiza edhe për qeverisjen e kaluar edhe për tani dhe të shohim kush ka shpenzuar mallra dhe shërbime më shumë edhe kush ka shpenzuar paga dhe mëditje më shumë ajo qeveri ose kjo.

U tha që nuk po luftohet ekonomia informale, kjo nuk është e vërtetë, për çdo ditë është duke u punuar në luftë për ekonominë informale dhe kemi hapa dhe projekte shumë konkrete dhe nuk është mirë të thuhet gjëra të pa vërteta.

U fol për deficitet, u fol për shkëmbimet, shkëmbimet tregtare të Kosovës janë rritur, eksporti i Kosovës është rritur dhe janë trendet pozitive duke u rritur për çdo muaj, për çdo vit. Prandaj unë e pashë si obligim si deputet i këtij Kuvendi t'i them disa argumente të vërteta të bazuara edhe në raportet e Fondit Monetar të Bankës Botërore dhe institucionet e tjera që e përcjellin punën e qeverisë dhe institucioneve të Kosovës, por është mirë që edhe të tjerët deputetë t'i thonë që qytetarët e Kosovës kanë nevojë të njoftohen realisht se si është duke u punuar. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit z. Dugolli, për fjalë është paraqitur deputeti Hydajet Hyseni, më falni deputeti Ferid Agani e ka fjalën.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryesues. Është fakt se emri nuk m'u ka përmendur, por ministri u thirr në një të dhënë të cilën unë e dhashë, të cilën ai ndoshta nuk e ka kuptuar edhe nuk e kam thënë mirë. Ta qartësoj këtë pozitë, do të thotë se unë thashë : Bruto prodhimi vendor GDP-ja për kokë të banorit në vitin 2005 nga raporti zyrtar ka qenë 1100 euro dhe ky ka qenë 0.2% më i ulët se në vitin 2004. Unë thashë se nga ky raport nuk mund të konkludohet sa është **GDP –ja** . Pra nuk është i paraqitur në raport. Ky është një fakt që raportit i mungon në kuptim të mungesës së raportit. Dhe e dyta kur është në pyetje eksporti është shumë e qartë se në vitin 2005 eksportet kanë qenë 14 herë më të ulëta se importet. Nga ky raport i vitit 2006 nuk

mund të konkludohet se cili është ky raport, eksporte importe. Unë nuk kam arsye të dyshoj në fjalët tuaja se ky është përmirësuar por në raport nuk është e paraqitur dhe nuk mund të konkludohet një gjë e tillë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, kjo rregullorja jonë është sipas dëshirës. Z. Dugolli, urdhëroni edhe një herë.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI- Unë nuk përmenda emra, por nëse flitet për raport financiar dhe jepen të dhëna për trendet e rritjes së zhvillimit ekonomik apo futjes së termit të importeve dhe eksporteve atëherë unë reagoj, sepse keni thënë gjëra të pavërteta. Prandaj unë e thashë qëndrimin që nuk përputhet ajo me realitetin, sepse GDP –ja nuk është ra, por është rritë, eksportet nuk kanë ra, por janë rritur, ne nuk mund të themi se i kemi rritur e kemi bërë bilancin, sepse bilanci për t'u bërë ndoshta i duhet Kosovës edhe 10 vjet për ta mbuluar importin me eksport, por ne kemi krijuar politika të tilla dhe zhvillim që eksporti në Kosovë është rritur, prandaj nëse diskutoni për raportin financiar në rregull, por ato nëse i përmendni ne reagojmë kur nuk ka të vërteta. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, replikë.
Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Ne nuk jemi duke luajtur futboll as pingpong me gjuajtur topin herë këndeje herë andej. Ne po flasim për buxhetin e vitit 2006 z. ministër dhe flasim me shifra që ju na i keni ofruar, atë që e keni në mend dhe ruani për veti, ne nuk e dimë, na e thoni këtu edhe mund të flasim edhe për të. Por në qoftë se vetë ministri e tha se 50 milion euro nuk janë investuar në investimet kapitale kanë mbetur pa hyrë, çfarë zhvillimi më thua ti këtu, si është menaxhuar ajo para, po i lëmë mallrat dhe shërbimet dhe atë nacionalitetin e harxhimeve të tyre. Por në qoftë se 50 milion euro dhe Kosova ka nevojë për ato 50 milion euro, urdhëroni vetëm rrugën shihe për Pejë që dy vjet po bëhen vetëm është gërryer asfalti mjetet kanë shkuar. Për ditë kalon nëpër atë rrugë, e keni pas në projekt vitin e kaluar, e keni nisur vitin e kaluar dhe s'e keni përfunduar akoma, pse? Kjo është ajo rritja ose zvogëlimi i juaj që i thoni ju.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, z. Dugolli, vetëm ministri mundet me u përgjigjur, por fjalën e ka Hydajet Hyseni, nuk ka kundër replika këtu ma. Unë së pari dua t'i jap vërejtje deputetit, meqenëse si deputet diskutoi dhe realisht e mori rolin e ministrit të financave, megjithatë unë ta jap prapë fjalën z. Bujar por të kisha lutur që përgjigjet janë të rezervuara për ministrin por jo për ju. Deri në mëngjes kam me ju dhanë fjalën sa të mundeni me fol, urdhëroni. z. Dugolli e ka fjalën.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Ju faleminderit z. kryesues, unë thashë se fola si deputet nga faktet dhe argumentet që i kam për sektorët që lidhen me atë çka edhe unë punoj, por unë nuk fola për shpenzimet kapitale. Është e vërtetë që shpenzimet kapitale ka nevojë të rriten dhe të shpenzohen ato në afatet e duhura, mendoj që Ministria e Financave është apo dikush tjetër fajtor për këtë, ju e dini që ligji i prokurimit sa pengesa i shkakton dhe është mirë që të fillohen ato përmirësime që të mos pengohemi në këtë fushë, por sido që të jetë unë nuk mund t'i mohoj faktet e rritjes edhe në sektorin privat që janë ndalë në Kosovë edhe rritjes së përgjithshme, se ato janë fakte të prekshme dhe janë të vlerësuara nga instancat ndërkombëtare. Ju faleminderit.

KRYESUSI XHAVIT HALITI – Z. Ferid Agani edhe një herë e keni fjalën.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryesues. Vetëm ta qartësoj edhe ministrin ta informoj edhe atë për këto të dhëna, meqenëse po i konsideron si jo të sakta. Ndoshta referenca të cilës iu kam referuar do ta qartësojë pozitën, vetëm po e citoj: raportin e progresit të Komisionit Evropian të datës 8 nëntor 2006, ju ka dorëzuar ky dokument gjithë deputetëve të Kuvendit, sipas llogaritjeve të Fondit monetar ndërkombëtar **GDP –ja** është llogaritur të ketë rënë për 0.2% në 2005, përkundër asaj ka pas disa shenja të përmirësimit në gjysmën e parë të vitit 2006, por kryesisht për shkak të aftësisë ripërtëritëse të aktivitetit të sektorit privat, unë thash dhe prapë po them. Në raport nuk është e theksuar sa është ky përmirësim. Si mangësi e raportit.

E dyta. Në të njëjtin raport thuhet eksportet mbeten tejet të ulëta. 14 herë më të ulëta se importet në 2005. kryesisht për shkak të mungesës së kapacitetit eksportues dhe konkurrencës, pra këto janë të dhëna nga raporti i Komisionit Evropian, këtë nuk e kam zbuluar unë. Jo. Ky është raport i dhjetorit 2006 s'është dy vite.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Unë ju kisha lutur që ta thirrni një seminar dhe të debatoni lidhur me këto çështje. Edhe gjysmë minute po e kërkon z. Bujar Dugolli dhe ma nuk jua jap fjalën.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Pra, qytetarët duhet t'i njoftoni, nëse doni t'i paraqitni raportet se bëhet fjalë për 2005 dhe nuk qëndrojnë ato për 2006. unë t'i dhashë për 2006 që janë 3.5%, dhe të mos jepni informacione për vitet që i kemi lanë pas, sepse dikush mund të thotë 2000 ka qenë një zhvillim shumë negativ, por rritja ka ndodhur gjatë vitit 2006 dhe ajo po argumentohet edhe 2007. Ju kisha lutur mos të jepni raporte të vjetëruara që nuk u duhen qytetarëve tash.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, fjalën e ka Hydajet Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë, unë fillimisht dua të sforcoj vërejtjen që bëri Kuvendi edhe në fillim, edhe në debat, për prijeten shumë të rrezikshme për mendimin tim të anashkalimit të komisionit funksional në këtë rast.

Do të duhej që ministri të jepte një përgjigje pse ka ndodhur kjo? Dhe kjo të na shërbejë të mos të lejohet të na bëhet **precedent** edhe në të ardhmen. Unë dua kontributin tim ta bëj në formë të pyetjeve dhe pyetja e parë ka të bëjë me praktikën që është bërë vërtet e zakonshme që të na lihet shumë pak kohë gjatë shqyrtimit të buxhetit sidomos shumë pak kohë për të shqyrtuar eventualisht për të konsultuar ekspertët për këtë, pse ndodh kjo? Dhe lidhur me këtë edhe një çështje që duket formale teknike. Pse ato tabela gjithmonë dendësohen e minimizohen aq sa të bëhet gati e pamundshme për t'i lexuar dhe për t'i krahasuar, aq shumë po kursehet me letër z. ministër.

Megjithatë edhe ndonjë pyetje tjetër kaq e shtruar përpara dhe nuk ka marrë përgjigje, besoj që kësaj radhe ministri do të përgjigjet. P.sh. Sa shpenzohet për bordet? Të ashtuquajtura borde dhe sa marrin ministrat për një mbledhje në to, dhe krahasuar me to sa shpenzohen ta zëmë për subjekte që mund të jenë të krahasuara me bordet unë p.sh. do të bëja pyetjen: Sa është shpenzuar deri tash për këshillin gjyqësor? Organin e pushtetit të tretë në Kosovë.? Një pyetje tjetër që për mendimin tim pret përgjigje, është: Flitet se për

qira janë shpenzuar diku 4 milion euro, dhe ka indicje se një pjesë e madhe e objekteve që janë marrë në shfrytëzim nga Qeveria janë ilegale? Si shpjegohet ky fenomen z. Ministër. Është pyetur edhe përpara dhe është bërë vërejtje në të ashtuquajturat fonde rezervë. Sa dhe si janë shpenzuar ato? Dhe në fund u theksua nevoja e përgjigjes për telefonatat e tepërta, si e shpjegoni z. ministër këtë debalans, që në një ministri bën aq shumë shpenzimet për telefonata, kurse Kuvendi i Kosovës, Shërbimi i Protokollit nuk ka dalje dhe mundësi komunikimi telefoni mobile me 044, shërbimi i deputetëve nuk e ka këtë mundësi. Receptioni në hyrje të Kuvendit në asnjërin anë as në anën tjetër nuk e ka mundësinë të kontaktojë deputetët me vala 900. Pse ndodhin këto anomali, vetëm për sa të ilustruar paradokset në fushën që e mbuloni ju. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Sala Berisha Shala

DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA- Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë, anëtar të Qeverisë. Të flasësh rreth raportit financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për shpenzimet e vitit 2006 është një diçka e mirë në aspektin e paraqitur këtu, së paku ashtu si paraqitet raporti i grymosur me grafike dhe tabela. Ndërsa të flasësh se si janë menaxhuar mjetet buxhetore është krejt diçka tjetër. Unë do të përqendrohem në këtë të dytën.

Të nderuar kolegë deputetë, besoj se askush nuk ndihet mirë kur keq- menaxhohet dhe keqpërdorohet buxheti. Keq menaxhimi dhe keqpërdorimi i buxhetit këta dy terma janë të përafërta, por nuk janë të njëjtë: keq menaxhim është kur mjetet financiare nga buxheti i konsoliduar i Kosovës ndahen në destinime të gabuara pa ndonjë analizë dhe kriter të mirëfilltë që më vonë t'i kthehen buxhetit. Ndërsa keqpërdorim është kur mjetet financiare nuk shpenzohen për destinacionin e ndarë.

Këto dukuri nuk mund të shpjegohen e kuptohen ndaras nëpër njësi buxhetore ngase ekziston një zinxhir përderisa mbikëqyrja e shpenzimeve nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave mungon ose qëndron symbyllur. Për ta sqaruar më tutje këtë, se buxhetin e përcjellin këto fenomene do të përpiqem t'i ilustroj me disa shembuj konkretë të keqmenaxhimit dhe keq përdorimit të mjeteve financiare nëpër disa njësi buxhetore.

P.sh. në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë vetëm në tremujorin e parë të vitit 2006, sa u përket shpenzimeve ka tejkaluar shpenzimet në bazë të buxhetit të ndarë si në harxhimin e karburanteve për automjete, mandej në faturat e telefonave celular roving ku në vend të 5 telefonave të lejuar nga qeveria ajo ministri shfrytëzonte 15 telefona celular roving ku shpenzimet ishin të larta, ka pasë faturë deri në 500 euro. Mandej mjetet e ndara për të ashtuquajturat investime kapitale, përkatësisht unë do të ndalem me një keq-menaxhim të buxhetit për miniera.

Trepçës i janë ndarë 10 mijë euro për standardizimin e ashtuquajtur të pronës intelektuale që nënkupton rezervat nëntokësore të mineraleve në këtë pjesë, konvertimin e tyre me standarde ndërkombëtare, ndërsa në anën tjetër në Çukën e Batllavës jepet një licencë nga KPMM-ja për hulumtimin e asaj zone. Mandej po në komisionin e pavarur për miniera dhe minerale ndahet 1 milion euro për incizimin e tokës në emër të hulumtimit të mineraleve të Kosovës dhe prapë lëshohen licenca që të bëhet një hulumtim i tillë, jepet një incizim përmes aeroplanit ose helikopterit që për kushtet e Kosovës është një luks. Tani ndarja e më shumë se 60 mijë euro për një projekt për

shërbimin gjeologjik të Kosovës e që askujt nuk i ka hyrë në punë. Ndarja e 500 mijë eurove për të ashtuquajturin plani i gurorëve të Kosovës e që ka mbetur vetëm plan në letër që ka gëlltitë mjete nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Unë nuk e di , krejt në fund, do të thosha si ndihet i lumtur, krenar dhe ballëhapur ministri kur këto shprehje e shoqëruan gjatë tërë ekspozitës së tij, i lumtur mund të ndihet ndoshta ai vetë së bashku me ata që e rrethojnë për rreth koalicionit qeveritar, ose si qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. deputete. Fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Ju faleminderit z. drejtues i seancës, të nderuar ministra, kolegë deputetë dhe deputete.

Është shumë normale që tani të bisedohet për shpenzimet e buxhetit të vitit 2006 dhe të mendosh se kemi pas vërtet planifikimin e duhur për vitin 2006 dhe kjo tashmë i takon së kaluarës dhe tanimë mund të flasim vetëm për mënyrën e shpenzimit të këtij buxheti. Është shumë e qartë që shumë nga kolegët kanë prekur çështje me interes dhe mënyrën e shpenzimit të buxhetit të Kosovës, unë do të ndalem në një segment të veçantë që disa nga kolegët në mënyrë përciptazi e përmendëm, por megjithatë unë mendoj se ka vend për një analizë pak më të thellë. Komunitetet e Kosovës të nderuar kolegë deputetë marrin pjesë në buxhetin e Kosovës vetëm me 27. milion e 755 mijë euro nga të hyrat vetanake.

Kjo është vetëm 4 % nga shuma e buxhetit të Kosovës që është një pjesëmarrje shumë e ulët. Natyrisht që nga kjo pjesëmarrje kaq e ulët në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës nënkuptohet se janë në mundësi të vogla për të realizuar projektet e tyre kapitale sipas planeve që kanë bërë komunitet në kohë. Tërheqja e vërejtjes sime dhe tërheqja e vëmendjes së përgjithshme në opinion do të ishte ajo që projektet kapitale të cilat kanë ngelur të pa realizuara kanë adresën e përgjegjësive.

Nuk besoj që janë komunitet përgjegjëse për mosrealizim të disa projekteve kapitale, sepse ato në kohë kanë ofruar listën e projekteve me prioritet dhe ministritë përkatëse kanë marrë këto projekte. Prandaj, mendoj se Ministria e Financave është përgjegjëse për mosrealizimin e një pjese të mirë të projekteve kapitale në komuna.

Çfarë ndodh në këto raste të nderuar kolegë deputetë. Ndodh që në pjesën e parë të vitit kemi shpenzim tejet të ulët të buxhetit dhe natyrisht edhe realizim të vogël të projekteve kapitale në komuna. Në pjesën e dytë të vitit ajo ku është pjesa më e përshtatshme për punime, ndodh të zvarriten projektet për arsye të procedurave financiar dhe të procedurave të tjera që kanë bukur shumë burokratik dhe ndodh që në pjesën e fundit të vitit të ketë shpenzime enorme dhe në këtë rast të kemi shpenzim të pakontrolluar të buxhetit, madje edhe kemi projekte të cilat përfundojnë pa cilësi pa mbikëqyrje të duhur dhe natyrisht këtë rast kush është përfitues, përfitues janë vetëm ata që ndajnë këto mjete dhe natyrisht ata që japin punën punëdhënësit dhe në raste të caktuara edhe punëmarrësit, por më së paku qytetarët e Kosovës të cilët dëmtohen për nga cilësia e projekteve që realizohen atje.

Sugjerimi im konkret kishte me qenë që jo vetëm në rastin të Ministria e financave por të gjitha ministritë në Qeverinë e Kosovës, në kohë të pranojnë projektet me prioritet të

komunave, të hapin listën e këtyre projekteve me prioritet të dihet cilat komuna përfitojnë në cilin projekt, sa mjete financiare që në fillim të vitit, në mënyrë që në fund të vitit kemi vetëm realizimin e këtyre projekteve dhe vlerësimin sa janë realizuar projektet me efikasitet. Prandaj, kolegë të nderuar mendoj që nëse duam të kemi një shpenzim të buxhetit ashtu çfarë i duhet një qeverie, planifikimi duhet të jetë në përputhje edhe me agjensionet shpenzuese përkatësisht në këtë rast me komunat e Kosovës të cilat janë të dëmtuara në masë të madhe . Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit fjalën e ka Selvie Halimi.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Ju faleminderit z. kryeses, të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra.

Se sa është i rëndësishëm buxheti i vitit 2006 që duhet të diskutohet dhe të debatohet në Kuvend për Qeverinë e Kosovës, tregon edhe prezenca e anëtarëve të kabinetit qeveritar sot në mbledhje të Kuvendit të Kosovës ku diskutohet për raportin financiar të vitit 2006. Realisht nuk mund të thuhet se çdo gjë është zi në këtë raport. Pse nuk mund të thuhet ashtu, sepse janë harxhuar,

.....Kolegë deputetë unë ju dëgjova të gjithëve, ju jeni mësuar se çka ju raportohet nga qeveria që ju e keni mandatuar me votën tuaj t'i thoni ok. Mirëpo ok. të thoni edhe për ata që po udhëheqin Kosovën, e jo për qytetarët. Andaj bëhuni pak të ndërgjegjshëm.

Ku kanë shkuar rreth 700 milion euro të qytetarëve të Kosovës, për çka kërkohet nga qytetarët e Kosovës që të paguajnë shërbimet e tyre komunale apo taksat apo tatimet e tjera, për të udhëhequr vetëm qeveria dhe për t'u pasuruar klane qeverisëse se si është menaxhuar buxheti financiar i vitit 2006, më së miri flet po qe se bëjmë një matje, si është gjendja e qytetarëve të Kosovës në shëndetësi, si është gjendja e qytetarëve të Kosovës në arsim, si është gjendja e qytetarëve të Kosovës kur përdorin ujin e pijshëm, si është gjendja e qytetarëve të Kosovës për ushqimin që e përdorin, si është gjendja e qytetarëve të Kosovës rrugëve të qytetit të Kosovës dhe atëherë mund të themi se vërtet është menaxhuar mirë ose keq.

Po qe se, e bëjmë një krahasim të tillë unë jam shumë e bindur që edhe vetë kabineti qeveritar do ta shohë se si e ka menaxhuar buxhetin e vitit 2006. Nuk mjafton që të dilet me shifra, se këtu janë harxhuar kaq mjete e aty kaq mjete, unë bëj pyetje: Sa projekte të investimeve kapitale kanë filluar që në vitin 2005 dhe nuk kanë përfunduar ende, janë paraparë të përfundojnë gjatë vitit 2005 pa hyrë në të gjashtin kanë vazhduar në vitin 2006 dhe nuk janë përfunduar dhe ato objekte kanë filluar të amortizohen, ato objekte kanë filluar të ndërtohen si investime kapitale vetëm për t'ua prerë shiritin, kolegë të nderuar.

Unë bëj pyetje, për çdo vit ndahet buxhet për blerje të makinave të kabinetit qeveritar dhe për çdo vit duhet të mirëmbahen dhe të rregullohen ato makina deri në vlerën prej 20 milion euro brenda një viti. Për çfarë makinash është fjala, mos janë makina që ecin nëpër tokë, apo helikopterë apo aeroplanë?

I nderuari ministër sa jeni transparentë për buxhetin e vitit 2006, unë kisha me thënë se jeni apo nuk jeni, sikur të kishit prurë një material që i shoqëron këto shifra, sa është realizuar programi i Qeverisë për vitin 2006. A ka përqindje këtu? Sa i është siguruar

transport nxënësve në shkollat fillore në pjesët më të larta në pjesët rurale të Kosovës? Sa u sigurohet transporti paçientëve të sëmurë që duhet të shoqërohen nga pjesët rurale në qendra emergjente apo në kryeqytet në Qendrën Klinike Universitare? Sa janë rastet e vdekjes së pacientëve në mungesë të ambulanteve për t'i transportuar ata?

I nderuari ministër, juve dhe dy kolegëve tuaj ua bëj një pyetje dhe kërkoj nga ju që këtë pyetje ta plotësoni me përgjigje në mbledhjet tuaja të qeverisë: Pse shërbyesit civilë në të gjitha institucionet e Kosovës mezi presin ta përfundojnë orarin e tyre të punës për 8 orë? A thua kanë vullm të madh të punëve? E nuk i përballojnë dhe u duhet pushimi? Apo nuk kanë farë pune që të punojnë, sepse punët e tyre i kryejnë këshilltarët politikë, sa është numri i shërbyesve civilë profesionalë që janë detyruar ta lëshojnë vendin e punës për shkak të ndikimeve politike dhe për shkak të ngulfatjes së ndihmës së tyre profesionale në lëmitë e caktuara për shkak të ndikimeve politike?

I nderuari ministër, sa është numri i stafit profesional që në emër të avancimeve profesionale Qeveria i ka dërguar jashtë vendit dhe ata persona kanë marrë pagë gjatë kohës së kryerjes së këtyreprofesionale jashtë vendit dhe kur janë kthyer në Kosovë është bërë e pamundur të vazhdojnë punën pastaj në ministritë përkatëse?

Të nderuar kolegë deputetë këtu humb buxheti i Kosovës. Neve na duket se është arritur diçka, neve na duket se është përparuar se është përparuar diçka, neve na duket krejt normale të bëjmë krahasime para 8 viteve çka ka ndodhur sa është shpenzuar aty e këtu e sot. Mirëpo njerëzit janë duke vdekur për bukë, dikush thotë nuk kemi buxhet që e sigurojmë bukën, është anormale që njerëzit të vdesin për bukë. Si shoh unë nëpër qytetet e Kosovës shihni edhe ju. Nuk është në rregull që ne të shohim pasurimin e njerëzve apo të shohim se kemi një avancim të gjendjes sociale të popullatës vetëm në mjediset tona familjare ku shkojmë se atyre u kemi ndihmuar në një formë apo tjetër, të dalim te shtresa e popullatës që ata nuk po kanë lidhje direkte apo indirekte në qeveri dhe si po jetojnë ata. Nëse nuk kemi mundur t'u bëjmë pallate kemi mundur t'u sigurojmë kulm mbi kokë.

Nëse s'kemi mundur t'u sigurojmë shkollim në Universitet kemi mundur t'u sigurojmë shkollimin fillor që është i obligueshëm me ligj, e të mos flasim pastaj për gjërat e tjera të domosdoshme. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku

DEPUTETJA FATMIRE MULLHAXHA – KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryesues, është e qartë që Qeverisë, konkretisht Ministrisë së Financave i konvenon një debat si ky i sotmi që është bërë praktikë në Kuvendin e Kosovës. Debatojmë, flasim në fund, ditën e mirë faleminderit që u krye. Sikurse të ishte shkuar kjo procedurë si është dashur, ky raport ka dashur së pari të shkojë në komisionin që është i thirrur për këtë çështje, komisionin profesional, komisionin kryesor, që është Komisioni për buxhet dhe financa. Dhe ai komision të japë vlerësimin profesional dhe me përfundime të cilat do t'i kishte sjellë sot në seancë dhe do ta ngriste nivelin e debatit, sepse ky Kuvend do të kishte mendimin e kolegëve të tyre të cilët janë më së ngushti të lidhur me këtë problematikë dhe nuk do të jetë vetëm i njëanshëm vetëm prej qeverisë këtu sot një raport, pra këtu është vërejtja për Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, pse e ka lejuar këtë gjë, meqenëse e kemi këtu informatën nga Komisioni për buxhet dhe financa që i është

drejtuar Kryesisë së Kuvendit që Ministri i Financave nuk e ka respektuar ftesën e tyre që të vijë dhe të raportojë në komisionin ku e ka obligim të raportojë, së paku një herë në vit, nëse nuk do me ardhur herëve tjerë, por kur është çështja kaq e rëndësishme për gjithë qytetarët e Kosovës, Ministrisë thashë i konvenon kjo se ky debat, po mendoj nuk kemi kurrfarë përfundimi si duket në fund, se në fund tash do të vjen edhe ai i fundit që do tëdhe do të përfundon tash me konstatime e si thanë të ndritshme të ministrit, por ky do të merrni një kahe tjetër sikur ta kishim një raport të komisionit në të cilën së paku ne kolegët e tyre do të besonim, se i kemi edhe përfaqësuesit tanë.

Çështja e dytë, qenë prezentë këtu, e pamë një debat në mes deputetit edhe një ministri, ai ministër i cili aq shumë e mbrojti një çështje pse nuk na tha këtu gjithëve sa është rritur **GDP –ja** këtë vit, 2006-tën, pse na foli aq shumë e nuk na tha atë shifrën e famshme pasi thotë që ka rritje, sa që ajo rritje edhe do të ishte ndërprerë ai debat që zgjati këtu aq gjatë.

Çështja e tretë. Kemi qenë këtu edhe kur u diskutua për keqpërdorimet e Kuvendit të Kosovës sa i përket buxhetit. Habit fakti i indiferencës së vetë ministrit për Financa, habit fakti se ai çdo gjë thotë; Kaq u kërkua, u kërkuan 240 mijë euro për veturën e Kuvendit: "Unë i kam dhënë se unë tek e fundit s' kam çka bëj, ata m'i kanë kërkuar unë i kam dhënë. Kështu po vazhdon edhe ky debat këtu, sot ka me u çua ministri dhe ka me thanë, ky për këto keqpërdorim që u tha për 20 milion euro për derivate, 20 milion për mirëmbajtje, 9 milion për mobile 33 milion pa specifikime, ai ka me thanë nuk thotë këtu nuk shihet një analizë me ndonjë ta them thjesht një brengosje, ose një analizë me thënë kritike. Po mirë unë si ministër dua ta heq para qytetarëve të Kosovës përgjegjësinë, sepse p. sh. nuk bëhet planifikimi i mirëfilltë ose po të jep një vlerësim kritik, jo të ndritshëm po ta jep ta heq prej vetes se ky krejt në anën tjetër do të thotë ky po i merr përgjegjësitë përmbi veti edhe për gjithë ata që kërkojnë dhe shpenzojnë pa kurrfarë kriteresh, qysh t'i përgjigjemi, ne sot nuk mundemi me i hy tash debatit se për buxhet i kemi dhënë vlerësimet edhe kur është bërë për këtë vit.

Mirëpo si t'u përgjigjemi vazhdimisht pensionistëve, njerëzve të hendikepuar, personave që duhet të përfitojnë nga Ligji për vlerat e luftës e krejt si t'u themi ne, si të arsyetohemi për këto shpenzime të kota. Buxheti është i kufizuar por megjithatë ka mundësi të bëhet një distribuim më i mirëfilltë. Si të përgjigjemi që një qytetar i Deçanit më ka thënë çdo vikend 15 gjipa të qeverisë vijnë në Deçan p.sh. mua më ka thënë qytetar, ato janë derivate, derivate që shpenzohen dhe derdhen nga buxheti i Kosovës, telefonatat mobile, çështja e fundit është, po flas edhe për ligjin për sigurim shëndetësor.

Një ditë ministri në mjete të informimi tha: Ky ligj do t'i kushtojë 200 milion euro buxhetit. Ju lutem a e di ministri që ekziston formimi i fondeve që nuk do të jetë dhe mbushet vetëm nga buxheti. Të mos japë aso deklaratash në mjetet e informimit, duhet me ditë njerëzit që duhet të krijohet një fond, fond i cili nuk do të mbushet vetëm nga buxheti e të mos përfojë që ai do ta dëmtojë buxhetin për kaq e kaq. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, i fundit është deputeti Xhevat Bislimi

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryesues faleminderit. Unë do të them nja dy tri çështje. Z. ministër, sipas raportit që ju keni prezantuar 20 milion janë tashmë u tha shpenzime për karburante Këtu ju edhe qeveria juaj meriton ndjekje të dyfishtë. E para,

për shpërdorim të buxhetit, kurse e dyta për ndotje të ambientit, sepse 20 milion karburante rrezikojnë seriozisht shëndetin publik dhe kur t'i shtohet kësaj si karburantet që fut Bujar Dugolli janë kancerogjene, rreziku kuptohet vetvetiu, pastaj 5 milion telefon.

Ne z. ministër e dimë se ministri të jashtme nuk kemi, ku i shpenzojnë këto para, ku i bëjnë këto telefona, këta ministrat e qeveritarët tuaj, brenda për brenda Kosovës me i shpenzuar 5 milion është vërtet shumë astronomike, Prandaj, kisha dashur listën e thirrjeve telefonike të paktën nga një ministri që të shohim ku thërresin këta njerëz, ku i shpenzojnë afërsisht 400 mijë euro për ministri.

5 milion mirëmbajtja e veturave, 20, 55,30 milion, 30 milion është buxheti i nja 6 ose 7 komunave të Kosovës në qoftë se e keni parasysh. Tjetër, 8 milion janë ndarë më duket për ato bisedimet e famshme që na sollën këtë që na sollën, atë projektin që e keni miratuar këtu.

Unë kërkoj një raport të hollësishëm për shpenzimin e këtyre parave, mënyrën si janë shpenzuar këto para, si janë shpenzuar, kush i ka shpenzuar etj.

Kërkoj shpjegime për 6 milion të fondit stimulues, cila komunë ka përfituar nga ky fond, sa ka përfituar etj. dhe së fundi kërkoj z. ministër shpjegime për 2 milion e 500 mijë euro që i paske shpenzuar për veshmbathje, a thua i keni veshë edhe mbath gjithë qytetarë apo ku kanë shkuar këto, kënd e keni veshë, a i keni çuar në Afrikë me vesh ndokënd apo çka u bë me këto shpenzime, me e ditur për çka janë shpenzuar, veshmbathje 2 milion e gjysmë, faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, z. Dugolli ka replikë.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI - Pasi ma përmendi emrin unë po ia jap një përgjigje deputetit që unë nuk jam tregtar dhe nuk fus naftë në Kosovë. Tregtarët kanë emër dhe mbiemër dhe i kryejnë obligimet ndaj shtetit, prandaj mos krijoni gjëra me krijua huti në opinion.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Xhevat Bislimi ka kundërreplikë

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. ministër nuk kisha për qëllim me i shti fjalët me ju të Drenicës po si do qoftë ju keni marrë një vendim politik, për futjen e atyre karburanteve që është konstatuar që janë kancerogjene dhe kjo është diçka që e njeh gjithë publiku, të gjitha mediat, është debatuar është thënë, është përfolur se atij ministrit pranë jush i pëlqyeka kjo shprehje është fol është përfolë e tjera. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryesues Haliti, z. koleg Haliti. Unë e respektoj dëshirën tënde të pakufishme që t'i jepet fjala gjithkujt të thotë çka do, dhe kjo e ka njëfarë kuptimi, në këtë rast e ka pasur një kuptim të keq për deputetët dhe kuptim të jashtëzakonshëm për ministrin tonë. Mënyra si është biseduar për raportin e tij, sot i ka dhënë atij të drejtë plotësisht sepse me përjashtim të dy vetëve profesionalisht askush s'ka biseduar, por janë kënaq me replika ndërmjet veti, ndërsa ai mund ta ripërsërisë fazën e fillimit që është krenar.

Kjo është keq për Kuvendin, mirë për ministrin , mua më vjen keq sepse unë nuk jam i këtij zanati, unë e pranoj, po di aq kur rrëshqitet nga tema dhe ne përgjithësisht gjithë kemi rrëshqitur nga tema për t'i dhënë mundësi ministrit thotë që jam krenar për atë që e ka sjellë në Kuvend.

Pra, Kuvendi këtu e humb kohën me procedurat, se edhe procedurat janë një risk i demokracisë, por nuk është anësia. Tërësia gjithmonë është substanca. Unë e di që opozita s'e pëlqen raportin dhe është detyrë e saj se edhe kur është bërë programi i 2006, opozita s'e ka votuar. Dhe prapë është e drejta e saj, unë pak po e them se jam çuditur pse i gjithë diskutimi është orientuar nga harxhimet, nga ajo që unë e quaj teori e barkut kur bisedohet, 90% sa telefona harxhohen, sa benzinë harxhohet për mos me thanë edhe sa haja harxhohet, .

Masa e punës e një qeverie bëhet nga teoria e kokës dhe nga filozofia e zhvillimit. Unë mendoj se edhe ky raport financiar që përfaqëson shifra në raportin e punës së Qeverisë, do të ishte shumë më mirë të shihet nga kjo punë. Po e zëmë unë për veti, për mua, problemi themelor pse ka kaq para të parapara në investime kapitale dhe pse këto nuk realizohen, kjo është problem i madh për një Qeveri. Nuk është problemi i madh për një qeveri që në një muaj njëra ministri ka harxhuar 1000 euro më shumë e tjetra më pa dhe është bartje totale e problemit. Unë nuk e kam njet si ajo kolegia me ju lutur me më dëgjuar sepse në parlament është demokraci le mos me dëgjuar njeriun por me lëshuar bankën e me dalë jashtë kujt nuk i pëlqen. Prandaj, në një farë mënyre dua t'i jap përgjigje dikujt këtu që u përpoq ta thyejë krejt parlamentin pse zonjat dhe zotërinjtë nuk kishin dëshirë me dëgjuar se çka thonte, kjo është demokraci.

Pra, unë po vazhdoj me logjikën time, pra edhe një herë po them për mua është e çuditshme pse iket nga tema kaq substanciale dhe kalohet në periferi, edhe një herë po them, kjo është keq për Kosovën ,sepse e kemi opozitën e cila e bën pozitën komode, e bën edhe ma të papunë edhe ma përtace se që është, sepse argumentet që i thotë i thotë aq anësore sa që nuk i bën asfarë vërejtje. Nuk është esenciale tërë kohën na morën , jo komisionit s'i ka ardhur ministri, nëse ministri ia çon dy ekspertë dhe komisioni për kryeneçësi thotë, nuk bisedojnë me ekspert po të donë ty në zyrë, atëherë komisioni e ka fuqinë vendosëse kuvendare që e bën analizën edhe pa fytyrën e ministrit në këtë rast të Shatrit dhe e bien në Kuvend. Kush i ka thënë komisionit të bëhet kaq komod meqë nuk na erdhi ministri ne idhnohemi dhe nuk i përgjigjemi Kuvendit. Barabar janë përgjegjës edhe Shatri që nuk ka shkuar në komision, edhe komisioni që nuk ka kurrfarë analize për Kuvendin. Këtë le ta dinë gjithë anëtarët në krye me kryetarin që nuk është këtu. Por nënkryetarin më duket që është.

Dhe në fund unë dëgjova një propozim shumë interesant që e thanë dy vetë të dy partive tjera dhe unë e përkrah, që të bëhet një analizë e saktë e harxhimeve të ekipit që ka punuar për bisedat për statusin e Kosovës, mua më duket që kolegu eks. kryeministri e tha, e tha edhe z. Bislimi, unë pajtohem me ta u bashkëngjitem atyre dhe nëse ata pajtohen që në Kuvend të raportohet saktësisht për harxhimet rreth bisedave për Kosovë. Jo vetëm për harxhimet, por edhe për strukturën e atyre organeve të riprodhuara. Dhe atëherë të jeni të bindur që unë dhe Xhevat Bislimi do të bisedojmë pak më ndryshe bashkë, kur t'i shoh emrat kush ka puñuar aty. Plotësisht pajtohem me të, dua emra dhe shifra. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – I kam edhe dy të paraqitur për replikë, Selvije Halimi e ka fjalën.

DEPUTETI SELVIJE HALIMI – Ju faleminderit z. kryesues me gjithë respektin që kam për kolegun unë nuk bëj lutje të dëgjojnë, por respekt, unë e di që sikur edhe ai që e di që ekzistojnë dy lloje logjikash, dhe për gjithë njerëzit që kanë një logjikë të shëndoshë ju vjen rënd me dëgjua se asgjë s'është bërë gjatë vitit 2006 me buxhet dhe disi duhet të reflektojë ajo, o të mos dëgjojnë o të dalin jashtë apo diçka tjetër. Mirëpo çdo gjë lidhet me buxhetin, andaj bëhet kjo bisedë rreth buxhetit sepse askush nuk foli për diçka që nuk ka me buxhetin, gjitha diskutimet kanë fillimin dhe mbarimin në buxhet, andaj që është përgjegjës për buxhetin në Qeveri ai e bart edhe barrë, qoftë të mirën qoftë të keqen.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – z. Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Sipas Rregullores së punës së Kuvendit gjithkush ka të drejtë replika, atëherë kur dikush i referohet me emra ose kur i referohet një pjesë e fjalës atij. Në qoftë se dikush ka insistuar procedura në Kuvend kam unë në procedura, prandaj drejtën e replikës e kam plotësisht dhe pikërisht për shkak të fjalës teme që ka insistuar në procedura.

Demokracia është procedurë z. Hamiti e dini fort mirë, demokracia është procedurë edhe përderisa është procedurë dhe procedura duhet të respektohet se pa procedurë nuk ka demokraci z. Hamiti, prandaj kemi ministra që po e marrin ligjin në krah edhe po ngasin me ligj në krah, edhe po u vjen ligji i ngushtë, edhe thotë Dugolli po na pengon ligji për prokurim, se i pengon Ligji për prokurim po sigurisht që i pengon Ligji për prokurim, sepse ligji e pengon, se nuk mundet me bërë çka të dojë. Prandaj demokracia është procedurë, po e përsëris edhe një herë, kushdo që mendon ndryshe e ka rënë, gabim shumë gabim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Edhe dy janë lajmëruar për replikë, Gani Koci, Hydajet Hyseni, Bujar Dugolli. Në qoftë se ke replikë Hydajet mere fjalën në qoftë se nuk ke....

DEPUTETI GANI KOCI – Unë jam edhe një adhurues dhe lexues i atyre shkrimeve të bukura që profesori e ka profesion, por ne sot folëm këtu për shifra dhe me shifra, dhe në qoftë se janë bërë krahasime mes një agjensioni buxhetor me shpenzimet në një fushë të caktuar me një agjencion tjetër, dhe paska dalur një vlerë 1000 ose 500 euro që e tha parafolësi, ne po diskutojmë për buxhetin dhe duhet të diskutohet për çdo cent të këtij buxheti, në qoftë se atij i duken qindra mijëra euro të pa rëndësishme atëherë vërtetë këtu nuk ka logjikë, ose ka një logjikë që ka një emër tjetër që nuk dua ta them.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryesues. Unë nuk do të jap drejtë vetes që t'i vlerësoj tash diskutimet e kolegëve deputetë. Dhe përveç tjerash edhe pas diskutimit të Hoxhës që thoshte diqysh e jani në vete. S'do të jap të drejtë të bëjë as moralizime. Megjithatë, një sqarim mendoj që imponohet lidhur me atë që u tha për procedurat. Zonja dhe zotërinj Kuvendi punon në seanca plenare dhe në komisione. Puna

e komisioneve është përmbajtjesore, substanciale, prandaj theksimi sa e sa herë edhe nga ana ime që të mos lejohet praktika e anashkalimit të komisioneve, megjithatë duhet të merret parasysh në të ardhmen. Komisionet raportet i përgatisin si është thënë edhe në rregullat e procedurës, edhe në bazë të pyetjeve që i bëjnë ministrin ose përfaqësuesve zyrtarë të ministrive dhe Kuvendi pret nga komisionet pikërisht atë anën që deputetët me të drejtë e kërkojnë do të thotë shqyrtimin profesional, funksional të detajizuar, ju vutë re që ne s'i kemi pas të gjitha materialet që i kanë pas anëtarët e Komisionit për buxhet, por për mendimin tim komisioni për buxhet ka pas të drejtë që ka insistuar që ministri të ndjekë rrugën e duhur nëpër komision në Kuvend. Kaq kësaj radhe unë pres përgjigje në pyetjet që bëme.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – ju faleminderit. z. Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë flas njësoj si atje si këtu. Ashiqare që ia kam qëlluar temës se reaguat nja 5 për një herë, kjo domethënë që ka qenë shumë e vërtetë ajo çka kam thënë unë, në princip dialogu këtë e prodhon. Pra, z. Jashari, unë thash që nuk është vetëm procedurë demokracia, është një pjesë procedurë pajtohem plotësisht, po jo vetëm e thashë unë, dhe jo besoj që edhe ti pajtohesh, sepse krejt nuk është krejt. Tutje, zonja e re mua më tha nuk di t'i përdori dy logjika. Unë nuk besoj që ekzistojnë dy logjika një ose nuk ekziston asnjë, por çdo send e ka emrin thonë latinët por thonë edhe shqiptarët. Këtu jemi në Kuvend e duhet me i thanë lisit lis, fshisës fshisë, pra me fol konkretisht të gjithë e kemi një respekt dhe vetë- respekt, por ju po e shihni edhe vetë se kush kur flet, vetë mendon që tërë dynjaja duhet me dëgjua kujdesshëm a posa e mbaron vetë fjalën, nihet nga qoshi në qosh tu komentuar me tjerët, atëherë një edukatë e të folurit dhe të dëgjimit kolektiv na duhet ende dhe nuk është marre me thënë na duhet nga pak edukatë.

Kur e them nga pak edukatë kjo ka të bëjë edhe me kolegun tim të vjetër Hyseni. Nuk ka gjë të keqe që ne jemi në situatë të bisedave institucionale kur edhe një copë moralitet nuk na bën dëm asnjë fije. Unë mendoj. Koha do të tregojë a është ashtu a jo.

Problemi është i temës dhe qysh po bisedojmë, ju thoni çka të doni. Këto tema do të dalin në letër dhe do t'i lexoni për nga natyra secili çka keni thanë, unë po ju them që diskutimi për shifrat që thatë ju, dhe që e tha konkretisht Koci që është merakli, vetë do ta shihni, merrni fjalën time e shifeni, 80% të diskutimeve janë, do ta shihni, biseda për jetën sociale, për mos të them një demagogji e lodhur sociale. A ne kemi biseduar për buxhetin, pra po të ndiqej rregullorja, po të ndiqej procedura, që u kërkua këtu dhe unë e kërkoj, udhëheqësi në këtë rast Xhavit Haliti do të duhej çdo të dytit t'i bënte vërejtje, zotëri deputet i ke prej teme, por ne ende nuk jemi në këtë nivel, dhe Halitin unë e kuptoj që nuk intervenon. Ju faleminderit. Unë nuk kam çka shtoj më beso që e kryem.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Si keni filluar që të paraqiteni prapë për së dyti në qoftë se teknika ka mundësi me n..... gjithë mikrofonat dhe gjithë me fol, megjithatë nga një minutë e keni, Hydajet Hyseni, Selvije Halimi dhe Bujar Dugolli.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Unë po reagoj për shkak se po përmenden emrat dhe po personalizohen gjërat, mendoj se nuk është në rregull kur u diskutua te realizimi i investimeve kapitale. Unë e thashë që një pengesë ose një vështirësi e ka shkaktuar edhe ligji i vjetër i prokurimit publik sepse ju e dini vetë që ky Kuvend ka votuar për ndryshim, dhe ai ndryshim ende nuk është finalizuar nga përfaqësuesi special, dhe nuk

është mirë t'i personalizoni gjërat, sepse është më së paku ndoshta punë që Ministria e Tregtisë që ka të bëjë me çështjet e prokurimev, sepse nuk ka çka bën prokurime nuk ka, por këtë i adresohem deputetit Jashari i cili ma potencoi emrin pse e ndërlidha me çështjen e investimeve kapitale. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Hydajet Hyseni e ka fjalën.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryesues. M'u përmend emri dhe nuk do ta shfrytëzoja të drejtën për replikë por meqë sugjerimi që u justifikua edhe si moralizim ,si e drejtë për moralizim, por mendoj megjithatë është mirë sa më pak të kemi tilla se megjithatë ka një dispozitë që deputetët i vë në raport të barabartë, por lidhej edhe me përmbajtjen e debatit të sotëm dhe thuhej sipas një zakoni që është bërë rregull dhe unë pak do të dua kësaj radhe ta kontestoj, që ndonjë deputet ta ruajë gjithmonë të drejtën që në fund ta bëjë rezyrenë dhe t'i vërë kapakun. Mirëpo tash edhe me sugjerime se si do të duhej të bëhej të ishte bërë debati prej fillimit, është tepër vonë.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Selviqe Halimi e ka fjalën.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit, unë vetëm desha të them se jam në Kuvend, dhe nuk jam në një amfiteatër ku dëgjoj ligjërata edhe vlerësime, dhe nuk kam ardhur në provim. Me gjithë respektin për gjithë sikur të kishte folur vetëm kolegu nuk ishte ndier gjithë ajo zhurmë që e mori krejt për vete atë që e thashë un. Duhet të mbajmë qetësi megjithatë nuk dua të bie në nivelin e askujt.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Gani Koci e ka fjalën.

DEPUTETI GANI KOCI – Për hir dua të respektojë ministrin e tregtisë dhe të industrisë por nuk dua të pajtohem me fjalët që i tha se pengesë është ligji prokurimit publik. Z. ministër atë ligj kemi punuar ne në komision mbi 3 muaj për të mos thënë 6 muaj. Ndryshimi i vetëm në atë ligj është se afati prej 52 ditësh është bërë me 42 ditë, për 10 ditë është diferencë. T'i nuk ke realizuar 50 milion euro investime kapitale, nuk ka qenë pengesë ligji po ka -në qenë pengesë keqmenaxhimi dhe moszbatimi i ligjit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit z. kryesues, para se të përfundojë seanca dëshiroj t'i kujtoj seancës se ne si grup parlamentar kemi bërë propozim dhe kemi kërkuar që ky propozim të vihet në votim. Ta kujtoj edhe një Grupi parlamentar i Aleancës i propozon këtij Kuvendi për me formua një komision për monitorimin e shpenzimeve kapitale të organizatave buxhetore dhe konsiderojmë se Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të jetë propozues për përbërjen dhe formën e organizimit të këtij komisioni. Z. kryesues ju lutem vëne në votim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit, unë nuk mund ta vë në votim por ajo duhet të vijë me procedurë, unë këto çështje nuk jam kompetent me i vu në votim. Z. Hamiti a jeni paraqitur.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë, nëse ka nevojë për mësim dhe për moral, këtu po shihet edhe në ato replikat që u bënë. Ka nevojë shumë për mësim fillor do të thosha të sjelljes. Njerëzit, ashiqare kur flasin nuk e dëgjojnë veten çka thonë, është hera e parë e

dytë, e tretë,... që në mënyrë kolektive janë fye deputetët. Unë asgjë më shumë nuk po them, pos për të gjithë ata që fola sot në sallë u kërkoj falje që fola me ta. Kaq

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Z. Krasniqi, e ka fjalën.

DEPUTETI JAPUP KRASNIQI – Z. kryesues, do të thotë unë në emër të Grupit Parlamentar e mbështes propozimin e grupit të Aleancës për ardhmërinë e Kosovës, por me kusht që në krye të komisioni, pasi është një komision hetimor të jetë opozita.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit, kjo është një çështje po mendoj që u takon seancave të ardhshme. Sot nuk kam asnjë lloj materiali dhe nuk e di për çka bëhet fjalë. Në qoftë se ju jeni dakord që të vihet në votim merruni vesh kryetarët e grupeve parlamentare rreth kësaj. Megjithatë sipas procedurës, në qoftë se duhet me u deklaruar deklaroni edhe ju. Sipas procedurës debati lidhur me këtë është kryer, radhën e ka ministri që të japë përgjigje në çështjet që janë ngritur dhe ta thotë mendimin e vet rreth gjithë debatit që është zhvilluar sot. Z. ministër e keni fjalën. Urdhëroni.

MINISTRI HAKI SHATRI – Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë, dua të kujtoj edhe një herë se sot në rend dite ka qenë materiali, pasqyrat financiare për buxhetin për vitin 2006.

Të gjitha kërkesat për raportim janë të shkruara dhe të përcaktuara saktësisht në nenin 41 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe ju i gjeni në materialin e ofruar në faqen 5, kërkesat e ligjit për raportim, kërkesat specifike për raportim dhe çka përmban ky raport si përgjigje ndaj këtyre kërkesave. Nuk do të doja të përgjigjem në asnjë çështje që nuk ka fare të bëjë me raportin për buxhetin dhe pasqyrat financiare.

Do të përgjigjem në ato çështje që është kërkuar specifikisht të përgjigjem me emër. Nuk është e vërtetë që Ministria e Financave nuk ka transparencë në lidhje me shpenzimet buxhetore, çdo raport financiar mujor, tremujor, vjetor buxheti publikohet në mjetet e shkruara të shtypura dhe në Ueb faqen të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, kush di me lexua e ka në dorë kurdo që të dojë.

Ju lutem shumë, janë thënë para këtij forumi, të nderuar, çështje që nuk kanë të bëjnë as nuk kanë fare të bëjnë me realitetin. Nuk është rritur numri i shërbyesve civilë në vitin 2006, shiheni materialin, lexoni ju lutem, 1500 njerëz janë më pak në vitin 2006 sesa në vitin 2005 si shërbyes civilë. Mos e dezinformoni opinionin ju lutem.

Prandaj, kam kërkuar dhe do të insistoj që ky raport përmes mjeteve të informimit masive t'u shpërndahet të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe ata do të jenë gjykatësit më të mirë të punës së Ministrisë së Financave dhe të Ministrit të Financave. Pra ajo që dua të them është jo vetëm që jam krenar por jam tepër krenar për atë që e kam bërë në këtë vit të kaluar buxhetor, sepse me procedurat buxhetore kam siguruar buxhet dhe mjete të mjaftueshme për formimin e shtetit të Kosovës, për formimin sot të Ministrisë së Mbrojtjes, për formimin dhe financimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme për marrjen e të gjitha kompetencave që do të bëhet brenda muajit qershor nga UNMIK-u te institucionet veçdore. Asnjë lloj dileme te asnjë institucion vendimmarrës ndërkombëtar nuk ka se a do të mund Kosova me këtë buxhet ta përballojë koston e statusit, prandaj jam krenar që puna jonë është bërë themel i pavarësisë së Kosovës.

Ju faleminderit shumë.

Do të përgjigjem me akuzat që janë bërë prej fillimit të seancës, në qoftë se keni durim. Nuk është e vërtetë që Ministri i Financave dhe Ministria e Financave nuk iu ka përgjigjur ftesës së Komisionit për Buxhet, kam kërkuar fjalën por kryetari i Kuvendit e ka pa të udhës që ta tejkalojë atë situatë dhe unë po e shfrytëzoj rastin, meqenëse u kërkuua decidivisht nga unë që të përgjigjem.

Z. Koci e lexoi çka është neni i cili përcakton obligimin e ministrit dhe të organit kompetent ku thuhet: Zyrtarët e caktuar nga qeveria ose ministrat, ose zyrtarët e caktuar, hartuesit e materialeve duhet t'u përgjigjen komisioneve të Kuvendit. Ju lutem shumë, Ministri i Financave në mungesë të kohës ka dërguar dy drejtorë kryesorë të Ministrisë së Financave hartues të materialit, drejtorin e thesarit dhe drejtorin e buxhetit, ata kanë ardhur këtu me porosi të veçantë nga ministri që çdo pyetje të deputetëve në veçanti të komisionit t'i përgjigjen dhe të ofrojnë materiale shtesë.

Si e dëgjuat nga disa deputetë edhe u kanë ofruar materiale shtesë të cilat nuk janë të parapara në kërkesat për raportim, por ne jemi treguar të gatshëm që ato t'i ofrojmë dhe ne do t'i ofrojmë të gjitha ato materiale që disponojmë, që janë në Ministrinë e Financave, por nuk janë kërkesë për raportim dhe nuk janë as nevojë për debat të këtij rasti, por që mund të merren në dispozicion nga deputetët, sepse ata e përfaqësojnë votën e popullit dhe ne jemi në dispozicion.

Kur do që të donë, përndryshe i kanë edhe publikimet në Ueb faqen e Ministrisë së Financave.

Sot, të nderuar deputetë, nuk kemi debatuar për ecuritë ekonomike, në ecuritë ekonomike debatohen indikatorë makro ekonomikë, lëvizja e GDP, punësimi, papunësisë, varfërisë etj. Sot kemi pas në rend dite pasqyrat financiare. Ju lutem shumë se edhe ministri nuk e ka pa të nevojshme me ngarkua materialin me gjana të cilat nuk janë në kërkesë për raportim, prandaj, ishte e nevojshme që të jap këtë sqarim. Përndryshe rritja e GDP-së në bazë të vlerësimit të Bankës Botërore, të ekspertëve të Bankës Botërore në vitin 2006 ka qenë 3.5% në krahasim me vitin 2005.

I nderuari deputet Hyseni, keni kërkuar të përgjigjem specifikisht për pagat që marrin bordet, ajo nuk ka qenë pjesë e raportit, sepse nuk parashihen të jepen me emra e mbiemra, pagat janë shpenzimet për paga sipas institucioneve por në qoftë se jeni të interesuar ne do t'juja përgatitim një raport të veçantë lidhur me këtë. Por dua të them diçka tjetër: mos u shërbeni me shkrimet e gazetave, sepse në një gazetë shkruan që unë kam 5 burime të të ardhurave kanë qenë që të gjitha rrena dhe unë për atë arsye iu kam drejtuar komisionarit për media për të marrë masat e nevojshme për ata që përhapin dezinformata.

Diçka që dua të them këtu më duket që zotëriu që kërkoi është se: kur ka qeif i publikojmë të ardhurat personale dhe e shohim kush merr më shumë.

Ishte fjala te z. Bislimi, që aludonte në çështjet e pagave. Z. Mujota, komunat nuk marrin vetëm 27 milion euro nga buxheti, komunat kanë realizuar 27 milion të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë dhe marrin 22.5% nga buxheti total i Kosovës që do të thotë grantet për komunat financojnë shëndetësinë, arsimin dhe administratën. Ju lutem. Ishte edhe fjala për fondet, fondet e veçanta rezervë të ministrit dhe të përfaqësuesit special,

gjëni në faqet e fundit të materialit çdo vendim, çdo cent, me datë, me numër, me kod e gjëni në material.

E të mos i përhapim këto dyshime gjoja se ne po fshehim diçka, në qoftë se dikujt i intereson edhe diçka më tepër ne mund t'i ofrojmë në mënyrë specifike kurse kërkesa e z. Koci për të thënë pse janë 230 mijë euro për KEK-un janë se: në një moment vërshimi pas shirave të gjata në minierën e Sibocit është derdhur një sasi e madhe balte dhe dheu dhe ka qenë në pyetje që të mbyllet miniera në muajin janar dhe ne kemi ndërhyrë me intervenim të ngutshëm dhe ai defekt është evituar dhe nuk ka kushtuar 230 mijë euro raporti është që ka kushtuar diçka mbi 100- mijë euro dhe tjerat mjete kanë mbetur në buxhet.

Dua t'ju përkujtojë që telefonat, e di që keni aluduar në Ministrinë e Financave, që i ka 650 inspektorë tatimorë që punojnë 24 orë e 7 ditë në javë dhe është e obligueshme për nga natyra e detyrës që secili të ketë nga 10 euro mbushje në muaj për shkak të natyrës delikate të punës që e bëjnë, veshmbathjet, ju lutem shumë ju e dini që i kemi 8 mijë pjesëtarë të Shërbimit Policor, i kemi 3 mijë pjesëtarë të Trupave të Mbrojtjes të Kosovës, nuk kanë blerë ministrat tesha 2 milion, por i kemi bërë për strukturat tona të cilat i kemi ngritur vetë. Në fund dua të them që jam i gatshëm kur do që ju të jeni të interesuar t'ju ofroj edhe informata tjera shtesë, por vetëm për ato që kanë të bëjnë me raportin buxhetor dhe me pasqyrat financiare. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. ministër, konstatoj që debati është kryer, në sallë janë 81 deputetë dhe lus deputetët të përgatiten për votim për ta miratuar raportin.

Votojmë tani;

Konstatoj që raporti është miratuar me 45 vota për, 22 kundër dhe 3 abstenime.

Ju faleminderit, sa i përket propozimit të kryetares së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dua t'ju kujtoj që kompetencat për çështjet e ngritura sipas Rregullores së Kuvendit, rregulla 51 pika 3 i ka komisioni për buxhet dhe financa, në qoftë se ju mendoni që duhet me ngritur dhe një komision tjetër për çështjet e ngritura ju kisha lutur që ta procedojmë përmes institucioneve përkatëse.

Sipas radhës është pika e 7-të e rendit të ditës, unë nuk e di se si po mendoni, por po më duket se jemi lodhur të gjithë dhe kjo pikë merr kohë mjaft, prandaj i kisha lutur kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen rreth kësaj, a doni me shty apo jo? Z. Krasniqi e ka fjalën.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues, ne e kemi një konsultim me shefin e Grupit të LDK-së dhe të AAK-së dhe jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës me pikat e tjera të mbetet për seancën e nesërme.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Atëherë në rregull për nesër. Mirë u pafshim në orën 10.

VAZHDIMI I SEANCËS PLENARE TË DATËS
11 maj 2007

KRYETARI KOLË BERISHA – Kolegë deputetë, ju lutem uluni. Vazhdojmë aty ku e kemi lënë dje, do të thotë vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës

7. Debat për arsimin fillor dhe të mesëm

Në pajtim me rregullën 6.5. të Rregullores së punës Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka kërkuar që Kuvendi të debatohet për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Me qëllim të përgatitjes së këtij debati, Kryesia ka kërkuar nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Arsimit, që të paraqesë një informatë si material bazë për debat.

Kërkesa e Grupit Parlamentar të PDK-ës për informata e Ministrisë u është shpërndarë deputetëve.

Fillojmë me debatin „natyrisht me kryetarët e grupeve parlamentare. Më falni „propozuesi në këtë rast e ka fjalën. Urdhëroni profesor Hoxhaj.

DEPUTETI ENVER HOXHAI - I nderuari z. kryetar i Kuvendit, i nderuari z. ministër, të nderuar deputetë të këtij Kuvendi, zonja dhe zotërinj

Nëse e shihni një shtëpi pa rrethoja ose me rrethoja të rrëzuara dhe me mure të pa bojatisura dini se është shkollë. Kjo situatë e cila e përshkruan gjendjen në shkollë dhe në arsimin në Kosovë nga një mësues i shkollës së mesme të rrethit të Prishtinës dhe kjo është fotografia të cilën ai e jep për gjendjen e arsimit në Kosovë.

Gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm kurrë nuk ka qenë më shqetësuese dhe më e rëndë se sa këto tri vjetet e fundit. Deri më tash ka pasur përpjekje serioze që të kemi një reformim të sistemit arsimor, reforma këto të cilat janë bartur më përkushtim nga shkollat, arsimtarët, nxënësit dhe prindërit dhe nga gjithë shoqëria kosovare. Çdo kush i ka parë reformat si një hap shumë pozitiv për Kosovën ,disa prej tyre i kanë dhënë edhe rezultatet e pritura. Një pjesë e madhe e tyre kanë mbet aty ku kanë filluar. Kjo gjendje është pasoja e saj se sistemi i arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë ka funksionuar këto tri vite të fundit sikurse Kosova të mos kishte fare Qeveri dhe Ministri të Arsimit. Për një arsye të tillë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka bërë kërkesë që nga janari i këtij vitit ta kemi një seancë të veçantë sa i përket gjendjes në arsimin fillor edhe të mesëm.

Për më tepër një kërkesë e tillë së fundi është bërë edhe nga Sindikata e Arsimit. Komisioni për Arsim ka organizuar një dëgjim publik me Sindikatën. Ekziston transkripti dhe sipas rregullës së transkriptit duhet të jenë në dispozicion të gjithë deputetëve. Dhe më datën 10 prill po kjo sindikatë ka bërë edhe një letër të hapur publike, e cila është

botuar në media, e cila do të duhej të ishte në dispozicionin edhe të gjithë deputetëve, sa i përket gjendjes së rëndë në arsim.

Përndryshe, kur kemi debatuar për gjendjen e arsimit të lartë për më tepër se sa një vit, është vendosur në këtë Kuvend që të ketë debat për arsimin fillor dhe të mesëm. Ky ka qenë sugjerimi i Grupit Parlamentar të Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Debati s'është mbajtur që një vit, meqë koalicioni qeverisë nuk ka qenë i interesuar të ketë debat për arsimin fillor dhe vazhdimisht është shty me argumentin se duhet të përgatitet një informatë nga Ministria e Arsimit.

Një informatë nga Ministria e Arsimit të gjithë ju e keni. Kjo informatë më tepër tregon se Ministria e Arsimit është më tepër Ministri e Mjerimit për asaj se si janë gjërat, se sa Ministri e cila vërtet tregon se çfarë po ndodh në arsim. Për mua s'ka qenë dhe sot e kësaj dite nuk është e kuptueshme pse deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e marrin pasqyrën e punës së Ministrisë në cilën prezantohen gjitha problemet që ka Ministria, po jepet një informatë e cila është shumë selektive. Për një arsye të tillë sot unë se kam ndërmend të merrem me atë se çfarë vërtet mendon Ministria e Arsimit, por më tepër me atë se si është gjendja në arsimin fillor edhe të mesëm. Kërkoj nga ju që vërtet ky debat të fokusohet në problemet kyçe që ka arsimit në Kosovë, në problemet urgjente që ka arsimit në Kosovë dhe definitivisht arsimit t'i jepet vendi më i rëndësishëm, sidomos për vitet që vijnë dhe për muajt që na presin.

Deri më tash kam takuar në 17 qytetet e Kosovës prind, arsimtarë, nxënës të cilët e përshkruajnë gjendjen sipas tyre- i citoj- si shumë alarmante në arsim. Unë kur e kam ndërmend t'i reflektoj të gjitha këto, shpresoj që deputetët nga zonat dhe qytetet që vijnë do ta përshkruajnë një gjendje të tillë. Po më lejoni vetë të ju bëjë me dije se sot ne debatojmë për 439 mijë e 445 nxënës që i ka arsimit fillor dhe i mesëm në Kosovë. Secili prej jush në mëngjes ose në mesditë e përcjell një nxënës në shkollë dhe secili prej jush në mbrëmje e ka një komunikim me nxënës se si ka kaluar në shkollë.

Unë e kam ndërmend vetëm t'i prezantoj 5 probleme kyçe në formë shumë të shkurtë, të cilat e përcjellin arsimin në Kosovë.

Problemi i parë ka të bëjë me hapësirën shkollore. Hapësira shkollore në Kosovë jo vetëm që është e vogël, por është edhe në zvogëlim e sipër. Asnjëherë nuk ka pas kushte më të vështira në disa shkolla edhe në qytete, jo vetëm edhe në fshatra se si janë kushtet e këtyre viteve të fundit. Hapësira shkollore nënkupton që mësimi në shkolla fillore dhe të mesme zhvillohet me tri, katër ndërrime, që ora zgjatë 20 ose 25 minuta, që në një bankë ulen 2 deri në 3 nxënës. Nëse dikush mendon që kjo është fotografi që nuk i takon Kosovës, unë i ftoj që të shkoni ta vizitoni sot shkollën "Hasan Prishtina" në Prishtinë dhe mund ta shihni. Nëse dikush nuk beson që kjo fotografi është e Kosovës ju ftojme ata që janë nga Gjilani të shkojnë në Gjilan dhe ta shohin Shkollën Mjekësore në Gjilan se sa ndërrime gjatë ditës së sotshme i ka kjo shkollë.

Kosova sot ka 1200 shkolla. Hapësirën gjeografike të Kosovës e njohim a nuk ka mund me të vërtetë deri sot mendohet edhe në cilat pjesë të Kosovës ka nevojë për shkolla shtesë? Përveç kësaj, mënyra se si është shpërndarë hapësira shkollore në rrethinë të Prishtinës, ju keni shkollë e cila ndiqet nga 30 ose 40 nxënës përderisa shkollat tjera në Prishtinë janë të stërngarkuara me nxënës.

Problemi i dytë, për të cilin ju ftoj sot që debatojmë ka të bëjë me cilësinë e arsimit, me nivelin e diturisë, me atë se çfarë i afrohet nxënësve- çka fiton nxënësi. Më lejohet vetëm t' ju ofroj një citat me qëllim që ta dini se për çka është fjala: Citoj: "Natyrë quhet çdo gjë që nuk e ka bërë dora e njeri", "Dituria", klasa e tretë. E krijon botëkuptimin për nxënësit që na jetojmë në një kohë parahistorike dhe që shoqëria në të cilën jetojmë është e kohës parahistorike. E dini pse ndodhë kjo? Kjo ndodh se tekstet shkollore shkruhen në Kosovë nga gjysma e punëtorëve që punojnë në Ministri të Arsimit dhe nga gjysma e të tjerëve të cilët janë të preferuar nga varësia. Recensionet nuk merren fare parasysh, të cilët i bëjnë autorët. Një pjesë e madhe e teksteve shkollore, jo të gjitha, nuk shkruhen nga njerëzit të cilët që kanë autoritet shkencor dhe kulturor, të cilët na i kemi në Kosovë dhe të cilët do të ishin në gjendje ta përmbushin një vakum të tillë. Përkundrazi shkruhen nga njerëz, të cilët janë thjeshtë të preferuar të Ministrisë dhe aty unë s'e kam ndërmend të bëjë akuza direkte, po definitivisht ka hapësirë të mendohet për një manipulim klasik edhe me libra edhe me tekste shkollore.

Ka shumë shkolla dhe nëse doni ju përmendi edhe me emra, të cilat edhe klasë, që vitin e kaluar i kanë marrë librat në dhjetor, disa prej tyre në janar. Për çka? Pikërisht për shkak të mos aftësisë së Ministrisë, të Departamentit që merret me çështje të tilla, që ta koordinojë çështjen se kur duhet të botohen librat, cili libër është më i rëndësishëm. Prindërit, në çdo fillim viti shkollor nuk e dinë a ta blejnë librin e "Diturisë" të këtij autori, apo të atij autori, meqë është një anarki e cila është e krijuar dhe e cila shërben vetëm grupit të caktuara të interesit.

Me qëllim që t' ju tregoj se në shkolla fillore dhe të mesme mendimi kritik, mendja e shëndoshë, analiza dhe përdorimi i trurit më tepër i takojnë së kaluarës. Më lejoni vetëm t' ju jap dy fakte, të cilat nuk janë fakte të mia, por të cilat i kam nxjerr nga Pasqyra e Ministrisë për vitin 2005/2006 dhe që është botuar në janar të 2006-ës.

Së pari ka të bëjë me suksesin e nxënësve në gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2005/2006, sipas analizës së vet Ministrisë. Përderisa në arsimin fillor deri në klasën e pestë rezultatet janë pozitive në arsimin e ulët të mesëm dhe në arsimin e lartë rezultatet të cilat dominojnë janë ato negative. Unë ju kisha ftuar vetëm ta shihni raportin ose Pasqyrën, prej faqes 16 deri në faqen 18 dhe ju do të bindeni me grafikë se si shkolla e mesme është në krizë.

I dyti ka të bëjë me provimin e maturës dhe me rezultatin e tekstit kombëtar. Definitivisht kur e lexoni këtë raport ju e shihni që është arrit pragu i kalueshmërisë prej 40%. Kjo qëndron, po ashtu, një pjesë tjetër e të vërtetës, një pjesë tjetër e medaljes, i cili del nga ky raport. Më lejoni t' ju bëjë me dije se në cilat drejtime ka dështim procesi mësimor. Për shembull në Gjinnazin Matematikor dhe atë të Shkencave Shoqërore, vetëm 26.6% e kalojnë matematikën është nën 40%. Në Gjinnazin e Shkencave Natyrore kalueshmëria është 35.1%. Në Gjinnazin e Gjuhëve është 33.1%. Kjo tregon që në shpeshherë themi kalueshmëria është mbi 40%, por kur të shkojmë në formë të hollësishme dhe shohim se çfarë ndodh e të hapësirën që të interpretohen gjërat se si janë edhe në realitet.

Pjesë kryesore e këtij dështimi është mos implementimi i kornizës kurikulare për dokumentin kornizë kurikul në shkollat fillore dhe të mesme. Ky është njëri prej dokumenteve më të mira që ka Kosova, i cili është hartuar në bashkëpunim me UNICEF-in, që vlerësohet shumë nga njerëzit që marrin vesh në arsim, por ai dokument është më tepër dokument i cili ruhet në ndonjë fiokë se sa përdoret në shkollë fillore. Ministria e

Arsimit, para disa javësh, ju keni parë që ka bërë një strategji për arsimin para universitar, i cili fare nuk i referohet nevojave të tregut të punës. Si mund të ketë shkollë të mesme moderne sot nëse ajo nuk u referohet nevojave të tregut të punës.

Gjendja në arsim, niveli i diturisë që ofrohet në shkollën fillore dhe të mesme

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor e keni kaluar kohën për 12 minuta.

DEPUTETI ENVER HOXHAJ – Jam duke folur në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kështu që besoj që duhet të më lejohet t'i sqaroj deri në fund.

Gjendja e diturisë dhe niveli i cilësisë në shkolla nga vetë raportet e Ministrisë juve ju bën me dije që sot në këtë seancë do të duhet të mendoni shtruar se çfarë forme t'i qasmi këtij problemi.

Problemi i tretë ka të bëjë me autonominë e shkollës. Autonomia e shkollës nënkupton ku shkolla duhet ta ketë edhe autonominë e saj administrative.

KRYETARI KOLË BERISHA – T'i vazhdohet.

DEPUTETI ENVER HOXHAJ – S'ma merr mendja që Kuvendi i Kosovës nuk është i interesuar të debatojë për ,pothuajse, gjysmë milioni nxënës ,veç nëse e kemi ndërmend me u marrë me globalwarming (me klimë globale) dhe të kufizohet hapësira kohore në formë teknike, sikurse të jem në ndonjë Kuvend të huaj.

Më lejoni vetëm t'ju bëj me dije që shkollat fillore dhe të mesme funksionojnë në një formë të tillë, ku komunikimi mes shkollës fillore,drejtorisë për arsim në komuna, Ministrisë së Arsimit nuk paraqet vijë vertikale. Mund të shihni raste të tilla në Prizren,në Besianë, në Klinë , në Burim. Nëse dëshironi ju përmendi se si Drejtoria për Arsim nuk i respekton vendimet e Ministrisë dhe këto janë pushtete në vete. Përveç kësaj, mënyra se si bëhet përzgjedhja e kuadrit mësimor në shkolla në baza partiake, mënyra se si caktohen drejtorët në baza partiake. Rasti më klasik është i shkollës" Ismail Qemajli "në Prishtinë ku, këshilltarja komunale e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës nga qyteti i komunës caktohet për drejtoreshë në këtë shkollë dhe largohet dikush që nuk ka kurrfarë përkatësie partiake. Kjo është më tepër se sa politizim i shkollës. Mungesa e pedagogut, e psikologut, mungesa qoftë edhe e 50 euro buxhet për shkollën, nëse thyhet një xham në shkollë, nëse priset një dorëz në shkollë, nëse një fëmijë sëmurët në shkollë, nuk ka kushte shkolla që t'i financojë.

Nga të gjitha zonat që vini ju, unë ju përmendi shembuj ku nxënësit paguajnë nga 3 ose 5 ose 10 euro që t'i vetëfinancojnë aktivitetet e shkollës.

Çështja e katërt ka të bëjë me statusin e arsimtarit. Nuk ka shkollë të suksesshme pa një lidrship të mirëfilltë, me një lidrship të dobët . Nëse doni dhe nëse dëshirojmë të kemi arsim modern, arsimtari duhet ta ketë një pozitë të definuar qartë dhe pagën të cilën e merr absolut nuk duhet të jetë pagë e cila duhet t'i takojë atij. Nuk mund të ketë kualitet në arsim me paga lineare. E dini që arsimtarët marrin paga lineare, pavarësisht nëse dikush punon qe 30-vite në shkollë edhe ai që do të fillojë me procesin mësimor në këtë shtator e merr pagën e njëjtë, pavarësisht nëse dikush ka arsimim universitar e merr pagën e njëjtë. Pavarësisht nëse dikush është më tepër i përkushtuar e merr pagën e njëjtë. Ne si Kuvend duhet sot të mendojmë për 27 mijë e 16 arsimtarë se si ta tejkalojmë pagën

lineare. Apeloj mos operoni me rritje prej 10%. Nëse deputetët në këtë Kuvend, të cilët s'kanë disa prej tyre edhe durim që ta dëgjojnë gjendjen se si është në arsimin fillor dhe të mesëm, kanë hesht dhe kanë pasur si beneficion rritjen e pagesës së tyre për 100%, nëse shumica e zyrtarëve të lartë në Kosovë kanë mund t'i risin pagesat për 100% definitivisht edhe rroga e arsimtarit duhet të rritet për 100%.

Nëse nuk e dini se për kenë është fjala, më lejoni veç t'ju përmendi dy shembuj. A meriton për shembull Idriz Ajeti t'i marrë sot 40 euro pension ose 100 euro 150 euro me angazhimin e tij në Akademinë e Shkencave ose në Institut Albanologjik? A meriton sot Rexhep Qosja t'i merr 200 euro pagesë përderisa një sekretar permanent i një ministrie paguhet mbi 610 euro. Mendoni për këtë punë. Këta kanë qenë arsimtarë - shtyllë e Kosovës. Mendoni se në çfarë gjendje janë sot dhe çfarë kushte jetojnë.

Problemi i pestë dhe i fundit dhe për të cilin s'kam dëshirë të ju lodhi shumë, por i cili është shumë shqetësues, ka të bëjë me braktisjen e shkollës. Nuk do ta përmendi dhunën në shkollë. Më lejoni vetëm të ju përmendi një shifër e cila shifër përsëri nuk është shifër ime për të cilën ju duhet të informoheni si deputetë jo ta merrni atë raport selektiv nga pasqyra e punës së Ministrisë së Arsimit botuar në janar të vitit 2006. Për vitin 2004/2005 kanë braktisur shkollën 4141 nxënës, prej tyre 47% janë meshkuj, përderisa 53% janë vajza. E dini që unë kam takuar mësues të cilët thonë që nxënësi fillon klasën e parë në shkollë fillore dhe ne nuk e dimë se a mbërrin në klasën e 8. S'ka kurrkush të dhëna, a mbërrin ai në klasën e tetë. A ka Ministria e Arsimit përgjigje për katërmijë vetë, të cilët e kanë braktisur shkollën në kohën kur unë po citoj se çfarë ka ndodh me ta? Do të ishte mirë ta kemi një informatë.

Prandaj, me qëllim që të kalojmë në pjesën e sugjerimeve, më lejoni vetëm në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të kërkoj nga ju që të përdoret gjysma e suficitit buxhetor nga viti i kaluar për ndërtimin e shkollave të reja dhe për renovimin e të vjetrave. Ne e pamë dje nga debati që kishim që 179 milion euro janë fond i pashpërndarë. Ne kërkojmë që gjysma e kësaj të shpërndahet për shkolla. Më lejoni që të kërkoj nga ky buxhet të pajisen shkollat, që shkollat të mos bazohet në një mësimdhënie, e cila funksion me shkumës dhe me shpuzë, veç që të kemi mjete konkretizuese për mësim laborator dhe teknologji informative.

Së treti, që të ngitet mbi të gjitha cilësia në arsim kur është fjala për matematikë, për gjuhë angleze dhe për gjuhë amtare. Që të definohet qartë statusi i arsimtarit si nëpunës shtetëror, rroga e të cilit do të duhej të rritej nga kjo seancë e Kuvendit për 100% dhe e cila rritje duhet të jetë në progresion. Nëse dikush ka dëshirë të dëgjoj shifra se si duhet të ndodhë kjo punë definitivisht ne si grup parlamentar mund t'ju ofrojmë dhe se si ndodh këtë punë. Dhe mbi të gjitha, të rritet numri i studentëve që pranojnë këtë vit në Universitetin e Prishtinës, meqë maturantët, të cilët çdo vit janë rreth 20 mijë në Kosovë, këtë vit ndoshta do të jenë edhe dyfish dhe është absurde që Universiteti i Prishtinës ta pranojë vetëm 30% e tyre. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka ministri Veliu. Ju njoftoj se në sallë kemi 82 deputetë.

MINISTRI AGIM VELIU – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë ministra.

Ju falënderoj për mundësinë që të shpalosësh para jush disa të dhëna dhe vlerësime për gjendjen aktuale të arsimit para universitar në Kosovë si dhe t'i prezantoj disa projeksione për të ardhmen e këtij sektori.

Ju e keni marrë paraprakisht një material që është mjaft voluminoz, i cili përmban të dhëna relevante për arsimin para universitar në Kosovë. Ndërsa unë do të përpiqem t'i përmbledh të gjitha këto në një fjalë jo shumë të gjatë.

Zonja dhe zotërinj,

Ka disa vite që arsimit para universitar ka kaluar nga faza emergjente në fazën zhvillimore. Prandaj edhe përballohet me të gjitha sfidat që janë tipike për një shoqëri në tranzicion. Këtë vit shkollor në Sektorin para universitar kemi rreth 440 mijë nxënës dhe para fillor, të cilët mësojnë në 1117 institucione edukativo - arsimore me rreth 27 mijë të punësuar.

Meqë gjatë këtyre 8 viteve kemi marrë një përgjegjësi të përbashkët për ndërtimin e institucioneve në Kosovë, fokusi i parë i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë dhe mbetet ndërtimi i kapaciteteve menagjuese të sistemit arsimor. Në këtë drejtim i kemi kushtuar kujdes të veçantë kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe ndërtimit të mekanizmave për jetësimin e saj. Kështu janë aprovuar një varg aktesh ligjore dhe nënligjore, ndërsa disa të tjera janë në procedurë. Edhe pse nuk vërehet ndonjë vakum legjislativ dhe arsimit është një kompetencë e transferuar prej kohe, mund të them se zgjidhjet konkrete që lidhen me statusin përfundimtar të Kosovës e në veçanti me decentralizimin na kufizojnë në veprimet tona dhe imponojnë një dinamikë e punë më të ngadalshme nga ajo që do të kishim dëshiruar.

Para dy javësh Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë e arsimit para universitar 2007/2017, dokumentin që skicon rrugën e zhvillimit të këtij sektori në të ardhmen. Ky dokument është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe parasheh masa konkrete dhe të afatizuara si dhe zotime buxhetore për avancimin e arsimit para universitar në Kosovë. Tani jemi në procesin e ndërtimit të kornizës për monitorimin e vazhdueshëm të implementimit të këtij dokumenti dhe besojmë se do të jemi në gjendje ta vazhdojmë këtë proces duke ndërmarrë veprime korrektuese aty ku ka nevojë.

Një pjesë e masave kanë të bëjnë me sigurimin e një menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit, që nënkupton angazhimin e mëtutjeshëm në hartimin e legjislacionit në harmoni me normat e Bashkimit Evropian, profesionalizimin e udhëheqjes arsimore në të gjitha nivelet përmes programeve aftësuese, ndërtimin e një infrastrukture për punimin e të dhënave në arsim, delegimin më të madh të kompetencave dhe të përgjegjësive në nivel shkollor etj.

Sigurimi i cilësisë është një fushë ku kemi punuar shumë, po ku gjykojmë se duhet bërë shumë punë për të ndërtuar një sistem të krahueshëm me vende tjera. Kemi zhvilluar kutikula të reja për të gjitha nivelet me pjesëmarrje aktive të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Kemi hapur tregun e teksteve mësimore, kemi ndërtuar sistemin e ri për edukimin e mësimdhënësve, kemi organizuar, përkrahur dhe financuar trajnime të mësimdhënësve në shërbim, kemi ndërtuar kapacitetin për organizimin e teksteve kombëtare në arsim, por nuk jemi të kënaqur me të arriturat tona.

Mendoj se mund të bëjmë më shumë në këtë drejtim,, duke i kushtuar më shumë kujdes cilësisë së punës që bëjmë dhe efekteve që ajo ka në klasë në mesin e nxënësve. Për ta arritur këtë duhet ta kuptojmë të gjithë se ndryshimet në arsim e në veçanti ato që kanë të bëjnë me cilësinë paraqesin një proces që e karakterizon nevoja për përsëritjen e kohëpaskohshme të disa hapave reformues ,ndërsa efektet e këtij procesi shihen vetëm pas një kohe relativisht të gjatë.

Pra, duhet të mësohemi t'i rishikojmë dhe t'i plotësojmë kurikulet, tekstet mësimore, programet e trajnimit duke ndërtuar kështu një sistem për sigurimin e cilësisë, sepse dihet asnjëherë nuk kanë fund, ndërsa cilësia asnjëherë nuk është e kënaqshme.

Strategjia e arsimit para universitar riafirmon përcaktimin tonë që të gjithë fëmijëve në Kosovë t'u ofrojmë arsimim cilësorë dhe të orientuar kah shkathtësitë që paraqet edhe një lloj obligim ndërkombëtar karshi politikave të proklamuar nga UNESK-o.

Zonja dhe zotërinj,

Koha e sotme vërtet kërkon një gjithë përfshirje barazi dhe respektim të diverzitetit në arsim. Para disa vitesh kemi pas një numër relativisht të madh të fëmijëve që kanë braktisur shkollimin e obligueshëm dhe një numër edhe më të madh të atyre që nuk kanë qenë në gjendje ta vazhdojnë shkollimin e mesëm. Është obligim ndërkombëtar i proklamuar me politikë e UNESKO-s arsimi për të gjithë që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët të përfundojnë arsimimin e detyrueshëm, prandaj edhe i kemi dhënë vetes për detyrë që pjesëmarrjen në arsim fillor dhe të mesëm të ulët ta ngrisim nga 97% që është tani në 100%.

Në këtë fushë problemet arsimore ndërlidhen me probleme sociale, por edhe me probleme të natyrave tjera. Jo të gjitha familjet në Kosovë mund t'i përballojnë shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të tyre. Ndërkaq te disa komunitete pakicë, në veçanti te romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit shkalla e pjesëmarrjes në arsim vazhdon të jetë brengosëse.

Pastaj i kemi fëmijët me nevoja të veçanta për të cilët në çdo komunë në Kosovë janë hapur të ashtuquajturat paralele të bashkangjitura, me qëllim që ata të mos izoloohen në shkolla speciale, sepse besohet se integrimi i tyre është rruga më e mirë për zhvillim maksimal psikik dhe fizik.

Mendoj, se si Ministri jemi duke krijuar kushte që të gjithë fëmijët në Kosovë të mund të regjistrohen dhe të vijnë në mësimin në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, por si shoqëri mund dhe duhet të bëjmë shumë më tepër për t'ju bërë të mundur t'i realizojmë të drejtat e veta.

Në Kosovë janë krijuar kushte optimale për organizimin e mësimin në gjuhët e komuniteteve ,por këto kushte nuk shfrytëzohen nga të gjithë. Përderisa mësimi në gjuhën boshnjake dhe turke organizohet normalisht, te komuniteti serb akoma vërehet një përcaktim për të funksionuar në kuadër të një sistemi arsimor paralel të kontrolluar nga Beogradi. Mendoj se kjo është një çështje që do të zgjidhet bashkë me statusin përfundimtar të Kosovës, por dëshiroj ta bëj të qartë se ne do të vazhdojmë të synojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, i cili do ta respektojë diverzitetin e segmenteve të ndryshme të shoqërisë kosovare.

Edhe pse institucionet parashkollore janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e komunave, nuk e kemi lënë pas dore as këtë segment të rëndësishëm të sistemit të arsimit para universitar. Përveç plan programeve mësimore që janë zhvilluar kemi inkurajuar themelimin e institucioneve private të këtij niveli, sepse e kemi të qartë se përfshirja e fëmijëve në këtë nivel është shumë e ulët në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu, jemi në kërkim të formave alternative për organizimin e edukimit para fillor me bazë në komunitet. Me gjithë investimet e mëdha që janë bërë në infrastrukturë akoma nuk mund të flitet për një mjedis të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimdhënie dhe nxënie. Lëvizje demografike dhe shkatërrimet e luftës kanë bërë që ne sot të kemi shkolla të stërngarkuara edhe me tri ndërrime në zona urbane dhe gjysmë të zbraza në disa zona rurale. Për momentin në shkollat e Kosovës ka rreth 2.5 metra katrorë për nxënës që përmbush vetëm gjysmën e nevojave, ndërkohë që 30% të hapësirës shkollore ekzistuese ka nevojë për renovime urgjente gjatë periudhës vijuese 5- vjeçare.

Gjendja ekzistuese imponon që të angazhohemi për përmbushjen e nevojave të ndryshme të shkollave duke filluar nga sigurimi i ujit të pijshëm e deri te sigurimi i teknologjisë informative dhe qasjes në internet. Pa dyshim, gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore ndikon dukshëm edhe në faktorët e tjerë përcaktues të cilësisë, siç janë mësimdhënia dhe konkretizimi etj.

Zonja dhe zotërinj,

Të gjitha nevojat e sektorit të arsimit para universitar i servisojmë me një buxhet prej 99 milion euro, që paraqet rreth 4.2% të bruto produktit vendor. Me gjithë faktin se ky parametër shpenzues është mbi mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian që është 4% e në veçanti mbi mesataren e shumicës së vendeve të rajonit, duhet ta kemi parasysh se kemi numrin më të madh të rinjve në Evropë dhe njëkohësisht bruto produktin vendor më të ulët. Prandaj, nuk mund të themi se investimet në arsimin para universitar janë të mjaftueshme, por as të premtojmë rritje të shpejtë të tyre.

Strategjia e arsimit para universitar parasheh rritjen e buxhetit për arsimin para universitar deri në 133 milion euro në vit brenda periudhës 2008/2012 që në varësi nga trendi i zhvillimit ekonomik përbën 4.46 deri 4.47 të bruto produktit vendor.

Infrastruktura është investimi më i madh që na pret në 5 - vjeçarin vijues, ndërsa sipas kalkulimeve tona do të na kushtoj rreth 215 milion euro ose 88% të shumës prej 245 milion euro, që parashihet për implementimin e strategjisë së arsimit para universitar. Nga kjo shumë synojmë që rreth 56 milion euro të sigurohen nga donatorët që paraqet një obligim afatgjatë për Kosovën.

Rritja e projektuar e shpenzimeve për arsimin para universitar është sinjifikante dhe do të ishte sfiduese edhe për vendet më të zhvilluara. Ne nuk mund të funksionojmë jashtë disa parametrave që vlejné paka shumë për të gjitha vendet e botës. Prandaj, në Kosovë duhet të krijohen politika makroekonomike që bëjnë të mundur këtë shkallë të rritjes së shpenzimeve. E kemi plotësisht të qartë se pa përmirësimin e pozitës materiale të arsimit nuk ka reformë të mirëfilltë, por ne duhet t'i balancojmë kërkesat dhe mundësitë që kemi. Në këtë aspekt nuk gjykoj se janë të bazuara premtimet që po i dëgjoj ndonjëherë se do të ketë përmirësime të shpejta dhe të lehta të pozitës materiale të arsimit.

Qeveria e Kosovës dhe Ministria që unë e drejtoj janë të përkushtuar që të bëhen lëvizje në drejtim të përmirësimit të pozitës materiale të mësimit dhe të mësuesve. Ne jemi të gjithë të vetëdijshëm për vështirësitë dhe përgjegjësinë që ka bërë kjo pjesë e shoqërisë kosovare në arsimin e brezave të tërë në kushtet e pasigurisë së plotë fizike. Në këtë drejtim ne po punojmë që me rastin e rishikimit të buxhetit të analizohen mundësitë për përmirësimin e pagave të mësimit dhe mund të them se jemi në rrugë të mirë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkundër zvogëlimit evident të shpenzimeve do t'i marrë të gjitha masat që shpenzimet për arsim të jenë sa më racionale, në mënyrë që të prodhojnë rezultate sa më të mëdha.

Të nderuar deputetë,

Në fund të fjalës time dëshiroj t'ju siguroj se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e shikon arsimin, jo si shpenzim, por si një investim në të ardhmen. Në kohën kur në tregun e punës kemi një prurje prej 20 deri 23 mijë punëkërkuarë të rinj në vit, sistemi i arsimit ka përgjegjësi që të sigurojë njerëz që janë të përgatitur për t'u përshtatur kërkesave dinamike të këtij tregu. Prandaj, është me rëndësi që reformat në arsim të mbështeten nga të gjithë sektorët e Qeverisë, por edhe nga Kuvendi, me vetëdije se rezultatet e tyre nuk mund të shihen me njëherë, ashtu siç shihen rezultatet e investimeve në disa sektorë të tjerë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-ës. Nimon Alimusaj.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra e ju kolegë deputetë, si dhe përfaqësues të sindikatave të arsimit që i kemi atje si mysafirë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka mirëpritur këtë debat për arsimin fillor dhe të mesëm, sepse sferën e arsimit e konsideron si sferë me rëndësi vitale për shoqërinë kosovare në përgjithësi. Mendojmë se debati duhet të ketë synim të ngrejë përgjegjësinë dhe llogaridhënien, në një anë dhe në anën tjetër të forcojë participimin dhe përfaqësimin, të zgjerojë bazën e vendimmarrjes, duke futur në dialog të gjitha organet qeverisëse, por edhe opozitën, sepse, për gjendjen në arsim nuk janë përgjegjëse vetëm një ministri, në këtë rast Ministria e Arsimit, vetëm Qeveria, vetëm pozita, por është përgjegjëse e tërë shoqëria. Thënë shkurt dështimet në arsim janë përgjegjësi e të gjitha subjekteve shoqërore. Unë dua me përmend vetëm nja dy shembuj drejtuar faktorëve tjerë që nuk merren me çështjen e arsimit edhe opozitës.

Do ta jap një shembull shumë absurd, KEK-u, i cili s'ka lidhje me arsimin e që kujdeset për buxhetin e Televizionit Publik të Kosovës ngarkon të gjitha shkollat, gjithë njëzorët e rrymës në shkolla edhe me pagesën për televizion e dihet se shkollat kanë nga disa njëzorë elektrik e s'kanë asnjë televizion. Të rralla janë ato që kanë televizion, ose, opozita është e vërtetë se nuk e mbanë barrën kryesore për përparimin e arsimit, por mund ta ndihmojë, siç është rasti i debateve, duke shtyrë, duke numëruar të metat, por edhe mund ta pengojë, siç është rasti me Universitetin e Prishtinës, ku opozita e mbajti peng udhëheqjen e Universitetin për disa vjet, vetëm me qëllim që të mbajë mbikëqyrjen politike mbi Universitetin. Pasi u përmendën këtu çështja e drejtorëve le të përmendet rasti i Malishevës ku haptazi qeveria lokale, të cilën e udhëheq opozita nuk pranon as konkurset që i hap Ministria.

Nëse ky debat është futur për të bërë marketing politik e fushatë të parakohshme zgjedhore, duke identifikuar ndonjë faktor për dëmtim, debati do të merrte kaheje, të cilën nuk e meriton kjo sferë që bashkë me sferën e shëndetësisë dhe të policisë përmbajnë sferën që e kërkon tretmanin më të denjë në një shoqëri.

Na duket i qëlluara apeli i ministrit të Arsimit thënë para pak ditësh se është koha të punojmë së bashku, të mbledhim energjitë dhe burimet për të zhvilluar arsimin, për ta integruar sa më shpejtë Kosovën në familjen e kombeve të qytetëruara.

Për rezultatet e arritura në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm foli ministri dhe ato nuk mund të mohohen. Madje ato, nëse i vërejnë në raport me periudhën para vitit 1999, mund të konsiderohen të mëdha dhe inkurajuese. Madje, në disa aspekte Kosova është para disa shteteve të rajonit, siç janë Shqipëria dhe Maqedonia. Kosova është e vetmja që ka hartuar strategji shumë serioze afatmesme për arsimin parauniversitar, si një proces gjithëpërfshirës. Kjo strategji është shumë e mirë, por nëse nuk do të zbatohet, ajo do të mbetet vetëm një grumbull letrash. Po në anën tjetër, duke krahasuar gjendjen e arsimit në Kosovë me gjendjen e sistemeve të arsimit në botë, mund të konstatojmë se arsimit tek ne është shumë lartë të dëshirueshmes.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i di rezultatet e arritura në sferën e arsimit fillor dhe të mesëm dhe përgëzon Ministrinë përkatëse për punën e bërë, por publikisht falënderon organizatat e ndryshme qeveritare, joqeveritare, ndërkombëtare, për ndihmën e madhe materiale dhe me ekspertë që i dhanë Kosovës në këtë sferë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, duke u bazuar në hulumtimet e veta dhe të ekspertëve të tjerë vendorë dhe ndërkombëtar i ka evidencuar mangësitë të metat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet arsimit fillor dhe i mesëm në Kosovë, disa nga të cilat po i shtrojmë vetëm në formë konstatimesh. Me të drejtë është konstatuar se procesi i fuqizimit të shkollës nuk mund të realizohet pa një buxhet të mirë. Gjithsesi çështja e mungesës së mjeteve financiare për investime në arsim është faktori determinues i gjendjes në arsim dhe ky është fati i Kosovës i cili ka një buxhet me rreth 700 milion euro, kurse siç e pamë komisioni ynë vetëm Dablini i ka 32 miliard euro për vit. Buxheti i ndarë për arsim është aq i vogël në të dy vitet e fundit nuk kapte nga 10 milion, që nuk lejon sigurisht rezultate të larta në sferën e arsimit. Nuk mund të ketë zbatim të reformës arsimore në nivel evropian të mësimdhënies dhe të mësim nxënies pa një buxhet stabil, i cili do të siguronte ngritje të pagave të arsimtarëve e dihet se nuk do të ketë arsim cilësor pa mësues të paguar mirë. Një buxhet i cili, pra, lypset të ketë këtu një sistem që stimulon arsimtarin. Tash të gjitha kategoritë e mësimdhënësve marrin pagë lineare. Ne mendojmë se është e nevojshme sistemi i dallimeve pozitive. Merr njësoj si arsimtari që është në vitin e parë të punës së tij, si ai që ka kaluar 40 vjet në atë sferë.

Buxheti më i madh është i nevojshëm për ngritjen e buxhetit të infrastrukturës kapitale, sepse dihet se nuk mund të ketë rezultate të duhura në arsim pa hapësirë të përshtatshme dhe në shkolla të punojnë me 3, 4 ndërrime. Lypset, pra një buxhet i ngritur edhe për mallra e shërbime, sepse dihet se nuk do të ketë arsim cilësor ku nuk mund të kryhen kabinete, laboratorë e prova e eksperimente. Me të drejtë, pra, ne konstatojmë se ligji ekzistues nuk është i mjaftueshëm pa rregullimin e infrastrukturës shkollore, pa paga më të mira për arsimtarët. E investimi në arsim është tejet i rëndësishëm. Tashmë është i njohur

gjithkund konstatimi se një popull, një shtet nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa një arsim cilësor e arsim cilësor nuk mund të ketë pa paga të mira, pa investime në arsim.

Praktika e vendeve të tjera ka treguar se ato vende që për arsimin kanë ndarë buxhet të varfër janë penduar edhe shumë pas 10 vjetësh, kurse ato vende të cilat nuk kanë kursyer buxhetin për shkollat siç janë : Irlanda në rend të parë, pastaj Suedia, Danimarka e tjerë, pas 10 vjetëve kanë konstatuar se shkollat e tyre ishin industria më e madhe e tyre. Edhe në mënyrën e buxhetit të shkollave ka mungesa për të cilat nuk na premtim koha të ndalemi.

Është konstatuar me të drejtë sa u përket kurikulave që u përmend se shtrirja horizontale dhe vertikale e përmbajtjeve kurikulare të mos jetë shumë korrente dhe që nga klasa në klasë të kemi përmbajtje që përsëriten. Madje, me të drejtë është thënë se ka lëndë ,si bie fjala në klasën e 9 krejtësisht të panevojshme dhe Ministria duhet të ketë parasysh këto. Për çudi mungon formimi i një organi a këshilli nacional që do të merrej me këtë çështje të veçantë .Sa i përket plan programeve paraqet mësimi zgjedhor i cili tash është në rrugë plotësisht në plotësim norme të arsimtarëve që nuk kanë normë nga lëndët mësimore përkatëse. Kurikulat i punojnë vetë ata arsimtarë me defekte të natyrës materialo-shkencore, metodiko – didaktike- pedagogjike etj. Problem tjetër është edhe mekanizmi i monitorimit të vlerësimit të kurikulave. Mund të konstatojmë se mungon mbikëqyrja pedagogjike e shkollave. Në këtë fazë mësimi ka ngelur në mëshirën e arsimtarëve. Zyrat rajonale në këtë drejtim kanë dështuar. Po të ishte një sistem kontrollimi pedagogjik shkollat tona do të lroheshin nga arsimtarët e dobët. E thashë se zyrat rajonale kanë dështuar, sepse është e pamundur p.sh. në Pejë 3- 4 punëtorë të zyrave rajonale t'i kontrollojnë, t'i monitorojnë 120 shkolla sa ka ky regjion.

Një rëndësi të veçantë për në arsim cilësor kanë edhe tekstet mësimore. Hulumtuesit kanë konstatuar se jo çdo herë ato janë cilësore ,sepse ato hartohen turr e vrap nga disa autorë që kanë krijuar shumë herë monopol. Kjo e bën të nevojshme krijimin e mekanizmave të cilët garantojnë cilësinë e teksteve, ka edhe shumë probleme të tjera që kërkojnë qasje tjetër. Për shembull zbatimi i reformës në ngritjen e cilësisë së mësimdhënësve.

Pastaj, hartimi i Ligjit për pensionim të parakohshëm me probleme shëndetësore .Është vërtetuar se në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës kanë mbi 1000 arsimtarë me sëmundje të ndryshme që punojnë në shkollë dhe rrezikojnë edhe shëndetin e fëmijës, nuk dalin në pension invalidor, sepse duhet t'i presin 65 vjet për t'i marrë ato 40 euro.

Rregullimi i pushimeve mjekësor është një çështje tjetër që kërkon qasje tjetër. Arsimtarët marrin paga vetëm për 15 ditë pushim mjekësor, pastaj janë të papaguar. Një çështje tepër e rëndësishme është rregullimi i mekanizmit juridik për masa disiplinore të nxënësve. Në shkollat e mesme që nuk janë obligative kemi për çdo ditë lajmërim në shtyp sa aty ndodhin therje, rrahje, prandaj drejtorja e shkollës nuk ka mundësi t'i largojë të tillët. Mund t'i largojë nga 6 ditë dhe pastaj të organizojë mësim plotësues për ta.

Pasojat e mungesës së autonomisë së shkollës dhe mungesa e buxhetit të shkollës është një çështje tjetër që meriton të shihet ndryshe. Shkolla në pikë të dimrit duhet të pres 10-15 apo 20 ditë përderisa ngritët një dritare e thyer. Të gjitha këto janë çështje që në ecje kërkojnë zgjidhje, e shumë nga këto kërkojnë qasje edhe të Kuvendit e sidomos e Komisionit për Arsim.

Lidhja Demokratike e Kosovës do të japë gjithë kontributin e vet, qoftë Ministrisë, qoftë strukturave tjera që të përmirësohet kjo gjendje e arsimit, sepse me të drejtë thuhet: "Arsimi me pakicë është helm, kurse arsimi në doza të mëdha është një ilaç shumë i madh për kombin." Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, nëse shkojmë kështu me vazhdim të minutazhit sigurisht se do të bëjmë shumë gjatë diskutimi, ose do të merr vendim Kuvendi që të vazhdohet më shumë se 10 minuta. Po do të jem i detyruar të ndërpres 10 minutëshin mandej, në rregull. E respektojme Rregulloren, pra. Me që deputetja Sala Ahmetaj e ka një rast specifik, ka rast vdekje, por është lajmëruar për të marrë fjalën, a kemi mundësi të japim përpara. Urdhëroni.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë. Paraprakisht ju falënderoj për mirëkuptim.

Debati i sotëm për arsimin do të kishte kuptim dhe domethënie në qoftë se merren vendime të arsyeshme dhe të afatizuara për çështje të arsimit. Në të kundërtën, vetëm debati si i tillë do të dukej një retorikë abstrakte. Arsimi sot kërkon qasje serioze dhe veprime të ngutshme. E them e keqardhje se gjendja në arsim nuk është vetëm shqetësuese, por është duke u shndërruar në gjendje anakronike. Mësuesi ynë përballet me shumë vështirësi. Ai për fat të keq i ngjason mësuesit të kohës së Migjenit. Po të flasim me statistika shohim se gjendja në arsim është e njëjtë në tërë Kosovën. Kudo ka mungesë të hapësirës shkollore, madje në shumë shkolla punohet edhe në 4 ndërrime. Shkollat janë pa pajisje elementare, pa banka, pa karrige e tjera. Kabinetet kthehen në klasa dhe për pasojë në shkolla të tilla vetëm me shkumës dhe tabelë, interesimi i nxënësve bie. Prandaj, ka ikje të shumta nga orët e mësimit. Hapësira për aktivitete artistike mungon. Për këtë arsye për nxënësit shkolla nuk duket joshëse, sepse nuk ka hapësirë as për aktivitete sportive e as për ato artistike.

Mësimi parashkollor në shumë shkolla nuk mbahet fare edhe atje ku mbahej në shumë raste janë mbyllur. Kjo duket anakronike për epokën në të cilën jetojmë, ose a mund të ketë arsim cilësor me klasë të kombinuara ose me klasë me më shumë se 40 ose 45 nxënës? Mësuesi sot është idealisti që rrallë blen rroba të reja, ose rrallë mbath këpucë të bukura. Mësuesit s'janë të dënuar vetëm me paga të vogla, por edhe me statusin e tyre që parashihet kontrata kolektive e cila nuk po zbatohet. Statusi i mësuesit duhet të jetë i njëjtë me të gjithë shërbyesit civilë.

Tekstet shkollore shpesh dalin me mangësi të shumta dhe vijnë në duar të arsimtarëve e të nxënësve tek në nëntor ose në dhjetor që paraqet parakusht për dështime eventuale.

Dukuri e shëmtuar në shkollat tona është edhe gjuha që përdoret dhe flitet në to. Çdo popull që e quan veten i civilizuar në nivelin institucional komunikon me një standard. Në shkollat tona edhe në institucionet tjera në emër të lirisë dhe të demokracisë së shprehjes gjuha standarde përbuzet deri në keqardhje.

Një gjë duhet ta dimë të gjithë. Gjuha standarde së pari mësohet në shkollë. Ndhmës të madhe mund të bëjnë edhe mediat me programe arsimore dhe arkëtuese, të cilat për fat të keq nuk janë të nivelit të kënaqshëm. Prandaj, Ministria e Arsimit edhe institucionet tjera duhet të promovojnë kulturën gjuhësore si vlerë e domosdoshme për komunikim të mirë dhe të saktë. Prandaj, ne e ftojme Ministrinë e Arsimit që t'i promovojë këto, nëpërmjet seminareve ose kurseve për gjuhën që do t'i organizojë në tërë Kosovën. Mangësitë e

ligjit e përballin mësuesin dhe udhëheqësit e shkollave me vështirësi të shumta. Prandaj, amendamenti i ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm është i domosdoshëm dhe i ngutshëm dhe për këtë ka përgjegjësi edhe Komisioni për Arsim.

Politizimi i shkollës është ndër çështjet që e dëmtojnë arsimin. Zgjedhja e kuadrit, për fat të keq, në shumë raste bëhet me preferenca politike se sa me ato profesionale. Kjo mënyrë e veprimit duket dhe duhet të ndërpritet, sepse kështu matet dija dhe vlera. Duke i marginalizuar çështjet dhe duke qenë indiferente ndaj realitetit shumë të rëndë në arsim, Qeveria po prodhon krizë dhe në këtë mënyrë edhe pa perspektivë për të rinjtë që duan të arsimohen. A ka rrugëdalje? Mendojmë se po. Prandaj, propozojmë që Qeveria urgjentisht të gjejë mënyrën se si t'i rrisë pagat në arsim. Mundësit mund të gjenden gjithmonë, si, rruhdja e buxhetit për lukse, sidomos për mallra dhe shërbime, pastaj të vihet tatim i shtuar për naftë, kafe, cigare, lojëra të fatit, tatim i cili do të shkonte në buxhetin e arsimit ose edhe ndonjë shtesë nga buxheti rezervë dhe suficiti.

Kërkojmë që shtimi i hapësirës shkollore të jetë një prej projekteve kapitale, sepse për shembull, si është e mundur që në Prishtinë, në të cilën sot jetojnë një e treta e qytetarëve të Kosovës, të mos ndërtohet asnjë shkollë e mesme, gjimnaz ose shkollë tjetër profesionale? D.m.th. gjendja në shkollat e mesme është njësoj sikur para 30 ose 40 vitesh, ose është anakronike që edhe 8 vjet pas luftës nxënësit të mësojnë në kontejner, siç është rasti i Skenderajt ose Obiliqit. Kjo gjendje nuk është vetëm për mungesë mjetesh, por edhe për menaxhim jo të mirë, për politikë të paplanifikuar si duhet. Me këtë gjendje reforma duket e paarritshme. Ajo mbetet vetëm dëshirë, sepse klasat me 40 e 45 nxënës dhe me tri-katër ndërrime, pa mjete konkretizimi, reformë përmbajtësore nuk mund të ketë. Gjendja në arsim do të ndryshojë vetëm në qoftë se ndërrohet qasja ndaj tij.

Prandaj, Qeveria duhet ta mbështesë Ministrinë e Arsimit, në mënyrë që arsimi të bëhet prioritet kombëtar. Për t'u bërë prioritet, buxheti i përgjithshëm i arsimit duhet të jetë së paku 20%. Kështu dhe vetëm kështu mund të themi se po investojmë në ardhmëri dhe në zhvillim. Dhe në fund një digresion.

Kryetari amerikan Ajzenhauer e kishte ftuar në darkë një shkrimtar të njohur. Shkrimtari, në të njëjtë kohë, kishte caktuar një takim me mësuesin e tij dhe i shkruan kryetarit: "Më vjen keq, por sot do të takohem me mësuesin tim" Në letër kryetari i përgjigjet: "Ke bërë një zgjidhje të mirë, sepse në jetë njeriu ka vetëm një mësues, kurse kryetar mund të ketë më shumë." Edhe unë sot kam një rastësi. Ka vdekur mësuesi im dhe do të shkoj të përshëndetem me te për herë të fundit. Ju falënderoj për mirëkuptim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nga Grupi Parlamentar AAK, Myrvete Dreshaj.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ – BALIU – Z. kryetar, të nderuar ministra, ministri i Arsimit, deputetë.

Grupi Parlamentar i Aleancës duke u mbështetur në programin e saj partiak e ka përcjellë dhe po përcjell zhvillimin e arsimit në Kosovë. Në këtë rrjedh mbështet edhe kontributi ynë në diskutimin e organizuar për këtë seancë.

Grupi Parlamentar e konsideron me peshë organizimin e këtij debati, jo vetëm se reagimet për gjendjen në këtë sektor të jetës po shtohen, për të mos thënë janë

permanente, por pse mendojmë që diskutimi dhe angazhimi ynë në fushë të arsimit duhet të jetë më i madh dhe më sintetik.

Pas lufte Kosova në fushë të arsimit ka trashëguar një gjendje të dyfishtë, mungesën materiale, por edhe gatishmërinë morale, të cilën nuk e kishte në sektor të tjerë. Por a mund të thuhet se kjo ta quajmë, kushtimisht, përparësi është shfrytëzuar mjaftueshëm.

Materialet që na ka afuar Ministria e Arsimit, shqetësimet e Sindikatës së Arsimit dhe opinionet e organizatave joqeveritare theksojnë këtë brengë. Po thuaj se të gjithë pajtohen me faktin se në arsim është trashëguar një gjendje shumë e rëndë. Fjala është për infrastrukturën e shkatërruar shkollore, sistemin e çintegruar të organizimit, strukturën ligjore rekomanduese për të cilën është punuar nga e para. Dhe gjithë këtë në masë të lartë e ka vështirësuar edhe lëvizja e popullsisë dhe grumbullimi i pakontrolluar i nxënësve nga njëra shkollë në tjetrën. Po të përjashtojmë pjesën retorike të përshkrimit të gjendjes në të njëjtën kohë të gjithë pajtohen se ka mbetur edhe shumë për të bërë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjatë kësaj kohe ka nxjerrë një numër ligjesh themelore dhe ka krijuar një infrastrukturë të mirë ligjore për funksionimin e sistemit arsimor. Gjithashtu, ajo ka nxjerrë një numër të madh udhëzimesh administrative me të cilët është bërë strukturimi i brendshëm dhe janë funksionalizuar disa nga objektivat dhe kriteret rajonale evropiane të arsimit. Përmes këtyre mund të shihet se janë realizuar tre nga hapat themelor të arsimit në Kosovë: integrimi i të gjithë minoriteteve, përveç atij serb, në sistemin arsimor të Kosovës, fillimi i reformave sipas strategjisë së arsimit afatmesëm të arsimit në Kosovë dhe tash strategjisë së arsimit para universitar dhe fillimi i rikualifikimit të mësimit në programin për aftësim pa shpëputje nga puna i cili nëse do të arrit të jetë një proces gjithëpërfshirës do të sjell kreativitet të ndjeshëm të arsimit në shkollën tonë.

Po në materialin e sjellë nga Ministria për debat nuk është bërë diferencimi i aktiviteteve të saj për lëmin e arsimit fillor dhe të mesëm. Përkundrazi është sjellje e gjithë strategjia sfidat dhe objektivat e Ministrisë në përgjithësi pa diferencuar ato për temën konkrete të debatit parlamentar.

Cilat janë sfidat nëpër të cilat po kalon arsimit kosovar. Po të bëjmë një përpjekje sado të vogël që tekstin e ofruar nga Ministria dhe letrën e hapur të sindikatave ta lirojmë nga ndonjë deklaratë jo aq përmbajtësore nuk është vështirë të shihet se në arsimin kosovar shqetësimet janë të përbashkëta si për institucionet qeveritare ashtu edhe për ato joqeveritare. Nga tri kërkesat esenciale dy janë të përbashkëta, e këto kanë të bëjnë me gjendjen materiale të mësimit dhe infrastrukturën shkollore. E treta për Ministrinë është politike, integrimi i minoritetit serb, ndërsa për sindikatën kontrata kolektive.

Kontrata kolektive dhe nivelizimi i pagave ,që unë po ia lejoj vetes t'i quaj thellësisht politike nuk kanë të bëjnë me Ministrinë e Arsimit por as nuk mund të përjashtohen. Ata po e mbajnë pengë statusin e qytetarit të Kosovës. Në këtë kontest reagimi punonjësve të arsimit del jo vetëm si rezultat i mos menaxhimit të institucioneve të tyre arsimore, por edhe si rezultat i mos menaxhimit të motivit në emër të cilit ata kanë punuar një kohë të gjatë.

Mosrealizimi i projektit për realizimin e pagave në shërbimet publike ka rrënuar baraspeshën sociale në Kosovë. Ndërsa mësimit janë më të goditurit në këtë

aspekt. Edhe zbatimimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative paraqet sfida me vetë. Pakënaqësia e punonjësve të arsimit këtu ka një rëndësi prej burimeve të përditshme.

Prandaj Grupi Parlamentar i AAK-ës sugjeron që të insistohet në zbatimin e plotë të atyre ligjeve që janë miratuar në këtë fushë, rishikimit a plotësimit të tyre në bazë të nevojave, insiston rishikimin e objektivat të Ministrisë me theks në rishikimin e plan programeve me qëllim të ndryshimeve, përmirësimeve dhe plotësimeve për t'i përshtatur ato me orientimet e tregut të punës dhe politikat zhvillimore ekonomike të vendit e të tregut ndërkombëtarë.

Grupi Parlamentar i AAK-ës insiston në diskutimin e rezultateve dhe efekteve të plan programeve të aplikuara deri tash në institucionet tona të arsimit fillor dhe të mesëm e me theks të veçantë në arsimin profesional. Duke ditur prioritetin e Qeverisë për tri jetë pra edhe për lëmin e edukimit dhe arsimit e mbështesim dhe e inkurajojmë atë në krijimin e burimeve të domosdoshme materiale dhe infrastrukturës për rezultate konkrete e cilësore. Njëkohësisht i rekomandojmë Qeverisë që gjatë planifikimit të buxhetit t'i jep prioritet ndarjeve të mjeteve përkatëse për arsim. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit, Genc Gorani nga ORA.

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar zonja dhe zotëri deputete.

Debatimi i sotëm edhe para folësimit të mi e konstatojmë se ka ardhur me një vonesë të madhe ,ndonëse është njëri prej debateve më të rëndësishëm që do të ishte dashtë të zhvillohej në shoqërinë tonë e veçanërisht në këtë Kuvend.

Konstatoj, po ashtu, mungesën e disa prej udhëheqësve tanë në nivelin partiak. Po ashtu ,mendoj se prej mysafirëve kemi mund t'i ftojme edhe partnerë tjerë të cilët janë relevantë të rëndësishëm në këtë debat.

Përshëndes ,po ashtu, mysafirët nga Sindikata . Kam pasur rast ta shoh letrën e hapur. Mendoj se ka qenë e udhës që kjo letër e hapur e kësaj sindikate t'u jetë shpërndarë edhe deputetëve si edhe të tjerëve.

Pasi që e lexova pasqyrën mbi gjendjen e arsimit para universitar të cilën organet zyrtare të Ministrisë së Arsimit na e dërguan edhe pse këto informata i kisha pas shumë më herët, sepse jam anëtar i Komisionit për Arsim më duhet të kthehem konkretisht në atë pasqyrë në fazë të dytë.

Për fillim dua t'i theksoj disa prej detaleve të cilat e reflektojnë gjendjen në arsim dhe kujdesin ndaj arsimit që supozohet se Ministria duhet ta zhvillojë me gjithë përkushtim. Në ligj thuhet se shoqëria jonë nëpërmjet të kësaj Ministrie ju siguron tekstet për vogëlushët tanë prej klasës së parë deri në klasën e pestë i siguron këto tekste dhe këto tekste janë falas.

Në pyetjen në interesimin tim personal, por edhe të kolegëve të mi, sepse këto tekste më gjithë se janë falas, përgjigja ka qenë lakonike e thjeshtë- S'kemi buxhet, na është refuzuar. Kur jemi interesuar me zyrtarët të Ministrisë së Financave gjatë shqyrtimit të buxhetit ata na patën thënë se kërkesën nuk e kemi marrë fare. Më vonë e kemi kuptuar se kërkesa i është dërguar në një shumë prej diku rreth 9 milion eurosh. Ajo që ishte çudi është se një llogari shumë e thjeshtë tregon se tekstet shkollore nuk kushtojnë më tepër se

5 milion euro, që është një shumë relativisht modeste, duke marr parasysh se sa është e rëndësishme. Është fjala për një masë shkollore prej 200 mijë nxënësve. Bile është më e vogël, mirëpo ne dhe na mungon vullneti për ta arsyetuar si duhet këtë shumë modeste për të arritur deri aty. Mu për këtë arsye ne i mirëpresim nxënësit dhe kujdesin e prindërve në lidhje me arritjen në moshën shkollore të nxënësve, mirëpo i presim me një dhuratë të një çante të zbrazët. Derisa është shumë thjesht të arrihet deri te ajo që me këtë gjest, me këtë simbol t' i tregojmë se sa është e rëndësishme këtë shoqëri që një fillim i shkollimit të jetë aq i mbarë.

Nga ana tjetër nuk mungojnë pamjet e tipit të marketingut politik të zyrtarëve, që shkojnë nëpër vende të ndryshme rurale, më së tepërmi dhe në vendet ku varfëria është e skajshme ose pasojat e luftës janë të atilla ku prindërit, ata që kanë mbetur ndaj fëmijëve ose fëmijët pa prind fare ju dorëzohen edhe iu falen libra dhe nuk mungojnë mbulesat mediale. Është e papranueshme për një shoqëri të ndajë mjete të gjejë mjete për të bërë lëmshë nga ana tjetër të njëjtat mjete të mos i ndaj atje ku duhet në formë sistematike, ashtu si edhe parasheh ligji.

Shkelja e këtij ligji neve na ka lënë para hundëve pa kurrfarë debati, pa kurrfarë diskutimi, praktikisht dhe jo vetëm një vit, por për disa vite radhas. ... ne nuk befasohe mi kur të kemi braktisje shkollore. Deri vonë braktisja shkollore s'ka qenë shqetësim i rëndësishëm për ne as në këtë Kuvend. Ndërkaq një prej shembujve të fundit në Vulljakë 197 raste të braktisjes të shkollës fillore dhe kjo kalon si një as si një fenomen vetëm si një rast kështu kalimtar, si diçka që nuk e di një indiferencë, një flegmatizëm i skajshëm. Nuk është momenti, ndoshta, ta përmend këtë, mirëpo as për këto raste dhe për këto raste mëparshme dhe për shumë çështje të tjera derisa na kemi pasur dëshirë. Kur flas për Komision për Arsim, kemi pasur dëshirë të diskutojmë këtë çështje me zyrtarët e arsimit, veçanërisht me ministrin, ministri s' ka ardhur. Ka pasur ftesa që janë dërguar në emër të ministrit, por ministri nuk u është përgjigj atyre ftesave.

Për këto tri vjet praktikisht, dy vjet e gjysmë janë bërë të punës sonë në Komisionin për Arsim, ministri është paraqit vetëm një herë diku rreth 10 minuta dhe pastaj ka shkuar, sepse ka pasur punë të rëndësishme.

Mbyllja e klasave parashkollore me arsyetim të mungesës së buxhetit. Derisa vendet fqinje i hapin këto klasa parashkollore, i gjejnë mënyrat për t'i hapur këto klasa parashkollore është një diçka që ka me na kushtua shumë shtrenjtë. Është diçka që do të na kushtoj jashtëzakonisht më i shtrenjtë se sa investimi për këto klasa parashkollore dhe mënyra se si kjo realizohet me anë të ndërrimeve kozmetike të ligjeve, me anë të bartjes së përgjegjësisë prej një instance në një instancë tjetër të qeverisjes, është praktikisht abstenim prej detyrave tona elementare.

Shkollimi në këtë moshë 3, 4, 5 dhe 6 -vjeçare gjithkund është dhe në çdo shtet sot pranohet të jetë një prej fazave më të rëndësishme të shkollimit dhe të edukimit të fëmijëve. Pasojat e lënies me një anë, të anashkalimit të kësaj janë jashtëzakonisht të rënda dhe mund të shifrohen madje edhe me mjete tepër të mëdha për sanimin e këtyre pasojave.

Të ardhurat mujore të arsimtarëve tanë u përmendën gjatë tërë kohës. Ato janë jo stimuluese, ato janë, më falni ne shprehje- poshtëruese. Mënyra se si ne e sjellim një arsimtar që i ka përkushtuar deceniet e jetës së vet në një kërkues të lëmshës pas

karrierës së tij ,nuk do koment. Ajo reflekton edhe na tregon,se çka ne faktikisht jemi duke bërë dhe çka mendojmë. Të kota janë premtimet- arsyetimet.

Objektet e pamjaftueshme shkollore janë një fenomen dhe nuk është vetëm faji i shkatërrimeve të mëposhtme. Kur ne i kemi provuar, kur kemi filluar t'i ndërtojmë këto objekte shkollare dhe falë donacioneve të shumta për të cilat gjithmonë duhet të jemi falënderues , ajo është e pakapërcyeshme, ne i kemi bërë këto donacione, i kemi realizuar në mënyrë jashtëzakonisht të paorganizuar. Është e pakuptueshme që të shkohet të ndërtohen shkollat për një numër tepër të vogël nxënësish edhe arsimtarësh,ndërkaq aje ku nevoja është shumë e madhe, atje të mos ketë ndërtime fare. Prizreni prej nga unë vij është një prej rasteve eklatante për këtë. Dhe për fat të keq e dëmtojmë edhe procesin mësimor atje ku ka tepër pak nxënës e natyrisht se dëmtohet edhe procesi mësimor atje ku ka stërngarkim të nxënësve. Fillon para orës 7 të mëngjesit ora e mësimit për një vogëlush 8 vjeçar e t'i kryhet vogëlushi tjetër shokut apo shoqes së tij në orën 8 të mbrëmjes. Nuk e di, ne vetë punojmë prej 10 deri në 5 këtu në Kuvend, si mund të pranojmë që diku tjetër fëmijët t'i detyrojmë në aso kushte. S'jam i bindur fare se është patjetër duhet të bëhet kështu. Jam i bindur se s'jemi t'u bë mjaftë në radhë të parë Ministria dhe jo opozita si u pretendua pak parashë që është Ministria e cila keq organizon punën dhe nuk realizon atë që mund të realizohet.

Moszbatimi i reformave në orët mësimore dhe përcjellja e zbatimit nga zyrtarët e MASHT-it është diçka që është mjaftë evidente Këto reforma nuk mund të zhvillohen dhe të realizohen në këto kushte edhe kjo është ajo. Burimi i shumë problemeve është në Ministri ose përreth Ministrisë në problemet e centralizimit të skajshëm të politizimit

.....
Problemet me udhëheqjen e shkollave fillore dhe të mesme rrjedhin thash nga politizimi i skajshëm dhe centralizimi jofunksional.

Problemet në arsimin privat kërkojnë kohë edhe më tepër për të diskutuar. Ne aktualisht i kemi 22 mijë maturantë, të cilët praktikisht përfaqësojnë dyfishimin e numrit të maturantëve që janë në fazë të hyrjes në arsimin e lartë. Arsimi i lartë publik ka kapacitet diku rreth 7 mijë për t'i absorbuar vetëm 7 mijë maturantë. Ndërkaq planifikimi i dobët na ka sjell në atë që kandidatët të jenë dy herë më të mëdhenj. Numri i kandidatëve do të jetë dy herë më i madh. Me atë kemi vu faktikisht në një situatë jashtëzakonisht të vështirë edhe Universitetin publik, por edhe instancat e shkollimit privat dhe e dimë fortë mirë se na ky presion do të kemi shumë defekte si korrupsioni dhe të tjera.

Grupi Parlamentar ORA sugjeron që të gjitha rekomandimet, sugjerimet, mendimet e tjera që këto Ministria t'i shënojë me kujdes, t'i marre parasysh dhe ta përpilojë një listë të rekomandimeve dhe të veprimeve që ajo mendon që mund t'i realizojë në afate të caktuara. Ne do të mirëprisnim që këto rekomandime të dala nga ky debat, të vijnë së pari në nivel të Komisionit për Arsim dhe pastaj të procedohen sipas asaj që do të imponohen nga këto dokumente. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nga Grupi për Integrim doktor Agani. Numan Baliq.

DEPUTETI NUMAN BALIQ – Faleminderit z. kryetar. Dopushte mi da ũ ime Grupe za integraciju, najpre vas selamim i iznesem neke činjenice koje su bitne vezano za obrazovanje, odnosno osnovno i srednje školsktvo, s tim što ću obratiti mnogo kraću

pažnju na neke zajedničke probleme vezano za obrazovanje a onda ću posvetiti pažnju nekim specifičnim problemima koji postoje za druge zajednice.

Mislim da se trebamo svi složiti u vezi sa tim da plate, kao jedan od osnovnih problema koji zaista postoji, opterećuju rad u obrazovanju, posebno u osnovnom i srednješkolskom obrazovanju treba povećati. Vlada jednostavno mora naći mogućnosti, da se plate povećaju i ne može niko poreći da je ključna odgovornost institucija i rukovodioca na centralnom nivou za stanje u obrazovanju. Naravno da odgovornost imaju lokalne institucije, ali ipak je ključna ona koja postoji u Vladi i Ministarstvu obrazovanja.

Vezano za neke zajedničke probleme koji postoje, još bih istakao i to da postoji jedan ozbiljan problem sticanja znanja i kvaliteta znanja u školama. Škole više nisu mjesta u kojima je omiljeno i dobro biti uredan i onaj koji će steći puno znanja, pala je cijena stečenoga znanja zato što se diplome kupuju, to je ozbiljan problem koji postoji pred cjelokupnim kosovskim društvom. To je problem koji moramo zajednički riješiti i vratiti dostojanstvo obrazovnom sistemu.

Dakle, jedna čitava društvena akcija koja će oformiti ove poluge na kojima počiva kosovsko društvo ,a koje su vezane za tri, četiri glavna stuba kao što je obrazovanje, zdravstvo i pravosudni policijski sistem bez koga ne postoji dobro organizirano društvo, to je obaveza svih nas, ponavljam ključna odgovornost je Vlada Kosova i Ministarstvo obrazovanja Kosova.

U vezi sa nekim specifičnim problemima koji su vezani za Bošnjake i druge zajednice treba da kažem sledeće: u ovom izveštaju koji ovde stoji kaže se da su odštampani svi udžbenici od prvog do dvanaestog razreda, to jednostavne nije istina. Moram da istaknem da vezano za knjige ,odnosno udžbenike za Bošnjake i druge zajednice bar one koje se tiču Bošnjaka tek ove godine su odštampane knjige za prvi i drugi razred u nižoj osnovnoj, zatim za 6. 7. i 9. razred u osnovnoj školi. Nema uopšte knjiga već 8 godina za sve ostale razrede u osnovnoj školi, a nema niti jednog udžbenika u srednjem školama. Napominjem da prema statistici koja je ovde prikazana od strane Ministarstva obrazovanja ima ukupno oko četiri i po hiljade učenika na bosanskoj nastavi i oko hiljadu i tristotine učenika na nastavi međuzajednice koja se izjašnjava kao gorani.

Dakle, naša je pretpostavka na osnovu zadnje , odnosno pouzdana procjena na osnovu zadnjeg ispitivanja da oko 3 hiljade učenika najmanje možda 3.200 uopšte nemaju knjiga iz redova nastave na bosanskom jeziku. Ako se napravi jedna prosta računica da je za jednog učenika u nižim razredima potrebno 5 do 7 udžbenika a u višim razredima 12 do 14 maksimum i da je prosjek za jednog učenika 10 knjiga, odnosno 10 udžbenika ,ispada da je za oko 3 hiljade učenika nastave na bosanskom jeziku kojima nedostaju knjige potrebno oko trideset hiljada udžbenika puta dva i po evra da je 75 hiljada evra. Mi smo čuli neke prikaze vezano za budžet obrazovanja, čuli smo takođe vrjednosti suficita, gospodin ministar je rekao da je ukupan budžet za Ministarstvo obrazovanja oko 100 miliona evra 99 tačnije. Dakle, za ove knjige koje nedostaju već punih 8 godina potrebno je tek 0,1% ,odnosno jedan hiljaditi dio ukupnog budžeta za Ministarstvo obrazovanja. Mislim da je sramno da posle 8 godina djeca koja uče nastavu na bosanskom jeziku nemaju odštampane udžbenike i da to ministar, koji vidim ta tamo pomno bileži nešto u svojoj knjizi, treba da ubeleži i ovo. Dakle, naredne godine ne bismo trebali dočekati a da učenici u osnovnim i srednjim školama na bosanskoj nastavi 9-tu godinu započnu bez knjiga koje su odštampane. Apeliram da se to ispravi jer novca ima, potrebno je tek kao

što sam rekao 0,1% od ukupnog budžeta ili hiljaditi dijeo budžeta i tražim da se to ispravi, ako hoćemo da imamo jedinstven sistem nastave, kao što to piše, i ravnopravan sistem nastave.

Drugi problem na koji bi želio da obratim pažnju a koji je takođe važan jeste da nedostaje broj dovoljnih obrazovanih, angažiranih stručnjaka iz oblasti obrazovanja na ovim jezicima. Mi imamo nekoliko birokratiziranih službenika u Ministarstvu i po regionalnim kancelarijama, ali koji tamo uglavno dremaju, to su neke hanume koje gledaju svoja posla primaju platu i veoma malo haju za probleme obrazovanja za Bošnjake i druge zajednice.

Mislim da je krajne vreme da se u Ministarstvu za obrazovanje u svim važnim departamentima koji se tiču osnovnog obrazovanja, srednjeg obrazovanja ali i svim drugim departamentima koji se tiču obrazovanja za druge zajednice, da se angažiraju osobe koje će obavljati svoj posao za zajednice a ne za platu.

Treći problem na koji bih obratio pažnju, a koji je vrlo važan, jeste da u nekim selima u Župi, mislim na Mušnikovo zatim u nekim selima u Podgori, Skorobištu, Ljubiždi i Gornjem Selu u selima u kojima živi apsolutno bošnjačko stanovništvo i gdje deca do odlaska u školu govore bosanskim jezikom ili svojim jezikom a kad odu u škole ona uče nastavu na albanskom jeziku. Mislim da je to jedna nepravda koju treba ispraviti da je to jedna senka koja bez potrebe pada na obrazovni sistem koji mi apsolutno podržavamo. Da na pomenem ono što smo 100 puta rekli da jesmo ida ćemo stalno biti za jedinstveni sistem obrazovanja na Kosovu, ali da je apsolutno nedopustivo da se u pojedinim selima u Prizrenskoj regiji, koja sam spomenuo, u selima koja su stoprocentno bošnjačka, da se nastava izvodi na albanskom jeziku. Napominjem i to da se zabeleži Mušnikovo, Skorobište, Ljubižda, Gornje Selo. Molimo vas ispravite te nepravde koje samo štete ugledu Kosova i većinskih Albanaca i Bošnjaka i svih stanovnika Kosova.

Na kraju da pomenem jeda problem koji je vezan za Dragaš, vrlo konkretan, koji se tiče sledećeg, kao što znate tamo godinama postoji problem oko udžbenika i sistema nastave prema kome se jedan dijo građana zalaže za to da se njihova deca obrazuju prema starom obrazovanu sistemu i gde jedan broj nastavnika još uvek nije potpisao ugovore sa Ministarstvom za obrazovanje.

Tokom čitavih tri ili četiri meseca uopšte nije izvođena nastava u Dragašu što je nedopustio, mislim da stvari trebamo rješavati mirnim putem da ne treba sprovođiti nasilje i da se treba doći do dogovora. Ako je taj problem trajao punim 8 godina sačekajmo status Kosova koji je na pragu i on će naravno rješiti i taj problem u okviru jedinstvenog sistema nastave na Kosovu.

Situacija statistički stoji tako da od 196 nastavika za koje postoje ugovori da 150 njih nije potpisalo ugovor sa Ministarstvom obrazovanja iz onog famoznog problema prema kome veliki broj njih nažalost prima i dalje plate iz Beograda. Međutim, vidite koja reakcija od tih 150 koji nisu potpisali ugovore, 76 je ostalo bez posla a druga polovina 74 i dalje ide i obalja svoj posao. Ja apelujem da ako se postupa i preduzimaju mere da svi postupi budu ravnopravni i da budu pravedni a ne da se prema nekom primenjuju mjere i isterivanja a da drugi ostaju na poslu. Dakle jedinstveni standardi bez dvostruknih aršina i da se bude pravedno i transparentno. Da napomenem i to da je vezano za onaj broj nastavnika koji su isterani s posla da je primljen jedan broj koji su potpuno

nekvalifikovani ,koji već imaju po pet ili šest drugih poslova i koji su očigledno skloni ili servilni lokalnoj kvalifikacionoj vladi u Dragašu. Ja molim da se pravedno i razumno postupi prema svima i da se preduzmu mera koje su adekvatne i koje su poštene.

I sasvim na kraju ,zadnje, onaj problem koji se tiče zajednički svih nas a to je je takode onaj koji je podržan od jednog djela predstavnika u našoj grupi za integraciju insistiramo i bilo bi veoma dobro da se otvori javna tema, javna rasprava oko uvođenja vjeronauke u škole. Mi mislimo da je potpuno pravdano da se vjeronauka uvede u škole da bude u osnovnim i srednjim školama, treba da se povesti jedna javna debata u kojoj treba uključiti sve organizacije civilnog društva i imati na umu činjenicu da u cjelom regionu ima vjeronauke u školama, jedno nema na Kosovu. Dakle to je nešto što je o tema o kojoj mi želimo razgovarati. I ja bih zamolio mog komšiju profesora da mi ne dopacuje. Ti si upravo pred tim da ideš u grob, ja bih ti preporučio da se obratiš bogu i onome koji ti stvorio. Evo sa ovim završavam sasvim. Mislim da sa ovim ozbiljnim temama koje su vrlo bitne, već bio blizu da završim, odnosno već sam završio. Najbolje bi bilo bez dobacivanja ili bilo kakvih neukusnijih primedbi. Sve što sam rekao je u interesu ovog naroda, ove zemlje Kosova i mislim da svi vi trebate o tome dobro da razmislite. Hvala vam ljepo.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nga LDD-ja deputeti Ramadan Kelmendi.

Ali ipak su grupe. Ramadan prit më vonë, do të japi përparësi Xhezairit. Urdhëroni Grupi 6+. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murat.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Hvala gospodine predsedniče, istovremeno primedba kako ste mogli dati reč parlamentarnoj grupi koja je pod znakom pitanja jer ima pet poslanika a po našem poslovniku treba najmanje šest da bi neko bio parlamentarna grupa. Dakle, napravili ste jedan propust, ja vas molim da povedite računa o tome.

Drugo, evo uz zahvalnost prisutnim ministrima posebno pozdravljam i g-dina Velijua, zatim kolege poslanike i zahvalnost parlamentarnoj grupi Demokratske partije koja nam je omogućila ovu današnju raspravu u kojoj bih ja hteo da iznesem određene primedbe koje se odnose specifično po zajednicu koju predstavljam.

Naime, gospodo, Ministarstvo se potrudilo da nam uradi jedan detaljan i sveobuhvatan izveštaj, ja ću reći da je na mom maternjem jeziku napravljeno dosta materijalnih grešaka, jezičkih i lektorskih, tako da se na pojedinim mestima gubi smisao i suština onoga što treba da se kaže.

Drugo, obrazovanje za sve zajednice predstavlja osnovni fundament, pogotovu za manjinske zajednice. Ja bih rekao ovom prilikom da bez obrazovanja u onom punom smislu riječi nema ,dakle, ni prespektive opstajanja zajednica. Ja bih pohvalio počev odmah nakon rata i još i prelaznu Vladu koja je omogućila nama da izvršimo promjene uspostavljanjem nastave na bosanskom jeziku. Potom, i oba ministarstva dakle u prvom i drugom mandatu, učinila su dosta napora da nam izađu u susret i omogućće nam, kako je ministar rekao ,normalnu nastavu a ja bih to zamijenio, malo bih precizirao uglavnom normalno izvođenje nastave, zašto kažem uglavnom, zato što smo evo već toliko godina nakon rata suočeni sa dosta poteškoća i problema i ja bih ovdje danas samo neke pobrojao koji su krucijalni, koji su izuzetno značajni za nas.

Prvo što bih pomenuo je to da nam udžbenici još uvijek ostaju glavni problem, a da ne govorimo o priručnicima, raznim nastavnim listićima itd. Ako se kaže da je udžbenik osnovno nastavno sredstvo a priručnik pomoćno, mi nemamo udžbenike a kamoli pomoćna, dakle, priručnike, nastavne listiće, razne pravopise itd.

Drugo, kvalifikaciona struktura u nastavi na bosanskom jeziku je još uvijek dosta nepovoljna. Ja bih molio, predsjedniče, da nas saslušate. Kvalifikaciona struktura zaposlenih u nastavi na bosanskom je dosta nepovoljna pogotovu u nekim opštinama kao što je Peć, gdje mnogi stručni kadrovi ostaju nezaposleni a nestručni i politički podobni su zaposleni. Ovo sa punom političkom odgovornošću izjavljujem gdje nam, na primjer, neko sa kožarskim usmjerenjem vodi nastavu, samo zato što je politički poslušan nekome a nezaposleni su ljudi pedagozi, profesori i tako dalje....

I ja bih ovdje istovremeno uputio primjedbu Direktorijatu za obrazovanje opštine Peć što ove kardinalne propuste ne ispravljaju.

Treći problem, o kojem bih ovdje govorio je kombinovana nastava. Naime, broj učenika u nastavi manjinske zajednice u dosta slučajeva se suočavamo sa manjim brojem učenika. Ja bih molio da se posebna prava, rezervisana prava, primjene prema međunarodnim poveljama i konvencijama, tako da se toleriše broj učenika kada nedostaje, zato što je kvalitet nastave u kombinovanim odjeljenjima, dakle kvalitet, mnogo je lošiji jer prije nego sam došao ja ovdje u ovu Skupštinu, prije pet i po godina, došao sam iz učionice i katedre, tako da sam radio sa raznim starosnim strukturama učenika i obrazovanje je meni upravo profesija. Dalje, imamo nedovoljnu opremljenost kabineta, o čemu su i kolege govorili iz nastave na albanskom jeziku. Imamo problema sa nedovoljnom zainteresovanošću ženske omladine pogotovu u 9-većim razredima i nastavak srednje škole zbog udaljenosti područnih odjeljenja, isturenih odjeljenja pa bih molio da se u isturenim odjeljenjima ubuduće se odvija nastava devetog razreda. Zatim pad motivacije je isključivo zbog teškog materijalnog stanja u obrazovanju i ovo je zajednički problem svih obrazovnih. Ja bih apelovao da ova današnja debata pokuša da spasi ljudski i pedagoški dignitet zaposlenih u obrazovanju.

Imamo mnoge prosvjetne radnike koji dodatna sredstva stižu na tezgama, zamislite njihov osjećaj kada njihov učenik dođe i da nešto kupi pred njima a znamo kolegnica Salja kako je govorila šta znači za sve učenike dakle za sve šta znači prvi učitelj itd.

U nastavi na bosanskom je nedovoljna zastupljenost u predškolskom obrazovanju, dakle nizak procenat. Molim, da se to ispravi. Dalje, ja bih molio da se omoguće i izrade udžbenici za albanski jezik u nastavi na bosanskom jeziku, jer ih nema i nastavnici se dovijaju svako na svoj način, tako da je tu kvalitet nastave nizak a nama je stalo do kvalitetnog održavanja i učenja jezika sredine, u devetim razredima nije zastupljen albanski jezik u nastavi na bosanskom, da se ta nepravda ispravi, gospodo.

Da bude što veća kontrola nastave, zato što je moguća upotreba udžbenika koji odgovaraju programima aktuelnih zakona u nastavi dakle koje smo usvojili ovdje u Skupštini. Molio bih da nastavimo sa organizovanjem profesionalnih seminara za nastavnike i za intenzivnu nastavu zato što su nastavnici na bosanskoj jeziku prisustvovali na ogromnom broju takvih seminara i oni su se pokazali za novu reformisanu školu na Kosvu kao veoma kvalitetni.

Mi smo suočeni ,gospodo, sa poteškoćama kada je u pitanju lektira. Mi je nemamo, ako je imamo, imamo je u opštinskim centrima, kako će učenici iz područnih škola da u gradskoj biblioteci tamo gdje nam je kao u Prizrenu jedna donacija prošla, gdje je dovoljan broj primjeraka lektire, ali kako učenici da dođu do njih, itd.

Kada su u pitanju isturena odjeljenja takođe molimo da se za ta odjeljenja povede računa o kvalifikacionoj zastupljenosti o kontroli da li se nastava izvodi. Ja bih kao kuriozitet i naveo jedan primjer u Peći, gdje imamo jedan slučaj zaposlenog prosvjetnog radnika iz Rožaja, koji je usput taksiranjem napunio putnike do Peći, pa onda ostavi auto pred školom i kad mu se napune putnici on nastavu koju izvodi kasnije prekida i tako dalje, to je samo jedan kuriozitet u vezi onog o čemu sam govorio kad je u pitanju materijalni položaj zaposlenih.

Ja bih ovdje zamolio ministra i njegov kabinet da ozbiljno uzmu u obzir da u nastavi na bosanskom jeziku napravimo rotaciono smjenjivanje smjerova u srednjim školama, ako se oni zadrže više školskih godina, onda imamo hiperprodukciju određenih kadrova. Takođe, mi smo već uredno podnijeli zahtjev za Pedagoški fakultet u Prizrenu, da nam se, od naredne školske godine omogući katedra za bosanski jezik i književnost, jer nemamo dovoljno predmetnih nastavnika, iz ove oblasti kao i za matematiku i engleski, ali to one , dakle,one naredne školske godine.

Dakle, ja sam ovde samo napomenuo neke od najvećih problema koji su karakteristični za našu nastavu. Ja bih priveo svoju diskusiju kraju, ali bih rekao da prilikom otvaranja konkursa za nacionalne predmete u nastavi na bosanskom da se u buduće otvaraju konkursi i za priručnike, jer je to neophodno za izvođenje nastave da bi ona bila koliko-toliko kvalitetna i na kraju,mi izvodimo nastavu u tri regiona i u osnovnim i u srednjim školama , u Prizrenu, Dragašu, Peći i u otežanim uslovima u Prištini zbog malog broja učenika i Mitrovici kao i u opštini Istok. I potpuno na kraju, gospodine ministre. pet i po godina nakon uspostavljanja institucija i ministarstava mi još uvijek u Ministarstvu obrazovanja, dakle, u MONT-u nemamo savjetnika za nastavu na bosanskom jeziku. Mislim da potrebe iziskuju primanje, iako je bilo obećanja od prethodnih premijera da se otvori takvo jedno radno mjesto iz praktičnih potreba. Ne bih bacao ljagu na naše koordinate koji su zaposleni i pri ministarstvu i pri regionalnim kancelarijama jer i ovaj izvještaj koji sam ja ovdje danas podnio je upravo u saradnji sa koordinatorom nastave na bosanskom jeziku u regionalnim kancelarijama.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni prof. Agani. Deputeti Ferid Agani e ka fjalën

DEPUTETI FERID AGANI – Faleminderit z. kryetar. Mendoj se vërejtja e kolegut Murati ishte shumë jo korrekte. Grupi Parlamentar për Integrim është formuar që në nëntor të vitit 2005, pra që një vit e gjysmë. Shumë herë kemi qenë në situatë që të lajmërohëm pas Grupit 6+ dhe asnjëherë nuk kemi bërë vërejtje të tilla, duke konsideruar se grupet parlamentare me nga 6 deputetë e kanë një lloj të drejtës së barabartë që të paraqiten dhe me siguri edhe ju e kemi jap fjalën në bazë të rendit se si jemi paraqitë.

Mirëpo me qenë se z. Murati e ngriti këtë çështje, atëherë vetëm t'ia bëjë me dije se Grupi Parlamentar për Integrim është grup i cili është duke funksionuar në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës. I ka 6 deputetë me mandat të plotë dhe se edhe në periudhën e ardhshme mendon që të zhvillojë një aktivitet të tillë. Ky grup

parlamentar i përfaqëson 18 mijë qytetarë të Kosovës, krahasuar me Grupin Parlamentar 6+ i cili i përfaqëson diku rreth 12 mijë qytetarë të Kosovës. Prandaj, në qoftë se fillojmë në këtë mënyrë që të barazohemi, atëherë mendoj se çështja është shumë e qartë. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Xhezair Murat.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Gospodine predsjednice ovaj kolega Agani je izgovorio notornu neistinu. Oni imaju 5 poslanika jedan im je u azilu i to je poznato javnosti Kosova. Drugo, Parlamentarna grupa 6+ obuhvata bošnjačku i tursku zajednicu i to većinsku podršku ima i izabrana mjesta gdje je on to skupio 18 hiljada podržavalaca njegove grupe to i sam Bog zna, pošto smo obojica vjernici i išala će nam odgovoriti na ova pitanja.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. z. Agani urdhëroni.

DEPUTETI FERID AGANI – Faleminderit z. kryetar. Mendoj se situata është shumë e qartë, si duket përkthimin e ka pas gabim z. Murati. Unë fola për 18 mijë votues, për të cilët kanë votuar për parti politike që janë të mbledhura në Grupin Parlamentar për Integrim, ndërsa sa i përket deputetit që qenka në azil e që unë tash po dëgjoj për një gjë të tillë. Unë mendoj se kjo është çështje e Kryesisë së Kuvendit. Pra, sa jam i njoftuar deputeti i partisë e cila përfaqëson komunitetin e ashkalinjeve të Kosovës është në një pushim me leje nga Kryesia e Kuvendit. Së paku e di që e ka informuar Kryesinë e Kuvendit me shkrim dhe ky deputet, në qoftë se Kryesia e Kuvendit ka informatë se ju ka marrë mandati i deputetit ose ka marrë vendim për një gjë të tillë, ju lutem që të na informoni. Në qoftë se ky është deputet me të gjitha të drejtat e deputetit të Kuvendit të Kosovës, atëherë ju lutem që ta mbronin dinjitetin e tij. Dhe mos të nëpërkëmbët- nuk ka nevojë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Për Grupin Parlamentar të LDD-ës Ramadan Kelmendi. Urdhëro.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit kryetar. Unë nuk desha të kyçem në këtë replikën e fundit, por vlerësoj se duhet ta dha një mendim. Kam çmuar, çmtoj dhe do të çmtoj çdo deputetë këtu, cilësinë e deputetit dhe çdo grup parlamentar dhe shef të grupit parlamentar, por do të ishte në rregull që vërtet fjala t'u jepej me një rend të cilin do ta përcaktojë kryetari i Kuvendit dhe jo kështu, herë jepet e herë merret, nuk është fortë me rëndësi.

Më lejoni që i nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë të nderuar. Grupi Parlamentar i LDD-ës problemin e arsimit e shef si një problem permanent, problem që zgjon interesim dhe duhet të zgjojë interesim dhe trajtim të përhershëm. Dhe natyrisht shqyrtimi i çështjes së arsimit është i rëndësishëm së veçantë për tërë shoqërinë kosovare dhe me një interes më të shtuar për të gjitha institucionet e Kosovës, ngase nga aty burojnë kuadrat të cilat ushtrojnë, natyrisht, funksionet me rëndësi në shoqërinë tonë institucionale.

Nën dy, arsimtarët ishin ata që kanë dhënë kontribut gjatë gjithë periudhës paraprake, janë duke dhënë dhe do të dhënë, me gjitha kushtet që i kanë dhe kushtet që ne u njohim

mund t' ju premtojmë. Jam thellë i bindur se ata donë vetëm barazi, as nuk donë premtime as lëmoshë.

Dhe e treta, në procesin arsimor është përfshirë një pjesë shumë e madhe e popullatës më vitale e qytetarëve të shtetit të Kosovës e ata janë nxënësit. Ata janë një numër shumë i madh, u theksua këtu dhe vërtet ata janë fëmijët tanë dhe ne kemi obligim shumë të shtuar dhe duhet të kemi një kujdes të madh për ta që vërtet të përgatiten për ardhmërinë e tyre dhe për prosperitetin e këtij shteti që po krijohet. Nuk do mend, nuk do analizë të madhe se gjendja në arsimin para universitar në Kosovë është e rëndë, por është shumë e vërtetë se në procesin arsimor nuk janë angazhuar shumë aq sa duhet dhe kërkohen ekspertët, të cilët këtë çështje e dinë, kanë mundësi potencial profesional për ta avancuar. Nuk është lehtë të konstatohet se gjendja është e rëndë, por është vështirë të jepen propozimet se si dilet nga kjo situatë në raport me situatën edhe politike edhe ekonomike edhe gjendjen e lartë të papunësisë së prindërve, të cilët bëjnë çmos për t'i arsimuar dhe edukuar këta fëmijë.

Është numri i madh i nxënësve dhe shqetëson fakti se nga ky numër i madh kemi që nuk vijnë mësimin, që e braktisin shkollën, por është fat i madh që Kosova ka një kontingjent kaq të madh të rinjsh që vërtet me një entuziazëm shumë të madh i rrekën shkollës. Ku të shkojnë, në hapësira shumë të vogla për të cilat këtu u diskutua dhe unë nuk dua më ta marrë fjalën për atë, por mund të them se ka mundësi, siç është pjesa veriore e Mitrovicës ku objektet rrinë të boshatisura, thatë, sepse atje nuk vijohet mësimi dhe nuk ka kush ta vijojë, ndërsa nxënësit tanë janë dëbuar dhe Ministria e Arsimit, Drejtorja e Arsimit në nivelin komunal dhe Qendra Rajonale për Arsim e Mitrovicës duhet të bëjnë çmos që vërtet t'i kthejnë nxënësit në shkollat e tyre nga dhe në atë drejtim nuk ka organizim sa duhet dhe si duhet.

Flitet se arsimtarët i kanë apo më mirë me thanë edukatorët dhe arsimtarët tanë - pagat e vogla. Është e vërtetë se i kanë pagat e vogla. Ata nuk kërkojnë paga të mëdha, por kërkojnë paga të nivelizuara në pajtueshmëri me kriteret që i ka çdo shoqëri e organizuar. Duhet të ekzistojnë kriteret edhe për ne edhe për shërbime civile edhe kudo, në përjashtim me sistemin privat se kriteret janë ato që zërthejnë në bazë të përgatitjes profesionale, përvojës në punë, kualitetit edhe janë disa kritere që përcaktohet pagesa. Me një përgatitje profesionale të njëjtë dikush në shërbim civil i merr x rrogë një profesor ose një pedagog ose një arsimtar mbetet me atë që e dimë dhe ky është ofendimi që ia bëjmë, jo pse s'kemi mundësi t'ua japim pagat, t'ua rritim dhe pse t'iu premtojmë na që s'mundëm, por t'i nivelizojmë pagat dhe ky nivelizim duhet bërë në tërë shoqërinë kosovare nëse duam stabilitet shoqëror pas përfundimit të statusit të Kosovës.

Plan programet mund të themi se nuk janë adekuate dhe binduni se nuk janë adekuate. Për një lëndë mësimore nxënësi, fëmija ynë i ka tri- katër libra, të tri- katër autorëve. Arsimtari, mësuesja degradon, dërgon mere këtë, mere atë. Nxënësi jonë e ka një çantë prej 20 kilogramëve në klasë të parë dhe të dytë dhe pikërisht ky plan program është joadekuat. Ne duhet angazhuar ekspertët në këtë drejtim.

Unë ju them vetëm dy çështje. Jam profesor i diplomuar i gjeografisë dhe shumica e teksteve të lëndës së gjeografisë në shkollën fillore dhe të mesme lëre që nuk janë adekuate, por janë të tejkaluara edhe të vjetërsuara dhe këto lëndë p.sh. lënda e gjeografisë për Kosovën është tmerr të mendohet se çka përmban nuk dua të them këtë, pozitën gjeografike, popullatën, elementit që vërtetë nuk janë, klimën e tjera - popullatën

,të gjitha janë të bartura nga librat e vjetra- (të moçme). Ose kemi " Edukatën qytetare", zotëri unë nuk dua t'i përmendi autorët e " Edukatës qytetare" Unë nuk them se s'kanë edukatë, po nuk kanë profesionalizëm për t'i dhënë konceptet juridike të cilat aty. Janë një grup i sociologëve, të cilët vërtet nuk kanë të qartë çka duhet përmbajë edukata qytetare çka është komuna mos ta elaborojë lëndën. Prandaj them plan programet pa tjetër duhet të jenë dhe koncepti i Lidhjes Demokratike të Dardanisë është në profesionalizëm në profesionalizëm dhe atë në të gjitha nivelet duke i avancuar dhe duke i dhënë mundësi që të vinë në shprehje edhe në procesin arsimor.

Përgatitja joadekuate për tregun e punës. Vërtetë shkollat tona kanë pësuar dhe po pësojnë një transformim për të cilin është flitë dhe po flitet në të gjitha nivelet duke filluar prej universitetit e deri te parashkollorët por, nuk jemi duke e studiuar shumë tregun e punës. mundësitë e punësimit të tyre dhe mundësitë e regjistrimit në fakultet. Ne duhet të jemi brengosur se shumica që mbarojnë shkollën e mesme dhe pikërisht këtu është, pse nuk na dhënë tekstin nxënësit tonë që mbarojnë shkollat e mesme në fakultet, mos jemi fajtor ne, mos janë nxënësit, mos janë plan programet, mos janë mos angazhimi i arsimtarëve.

Fjala është për drejtorët. Ju lutemi, pa të keqe, shumica, ndoshta nuk është, por një përqindje bukur e dukshme e drejtorëve është me koncepte të pa reformuara. Drejtorë, të cilët vërtet nuk kanë qenë kurrë as të reformuar, në një mënyrë kanë ngelur në nivelet shumë të ulëta të organizimit dhe pikërishti tyre me zyrat rajonale kanë krijuar probleme shumë të mëdha. Unë kam konsideratë dhe e lus ministrin që vërtet t'i shikojë raportet, jo raportet politike, por vetëm raportet pedagogjike -profesionale, arsimore, organizative, mbikëqyrëse në mes të drejtorëve të drejtorive për arsim dhe qendrave rajonale të arsimit dhe çka ndodh atje.

Unë ia dha vetëm një shembull. Në një shkollë në regionin e Mitrovicës që ka 10 të punësuar 5 janë me mbiemër të administratës rajonale. Dhe të 5 janë pa përgatitje adekuate profesionale dhe janë larguar nga procesi arsimor edukativ të gjithë ata që i kanë plotësuar kushtet . Pikërisht kjo duhet t'i zgjojë ndjenjat se vërtet arsimi nëse mendohet të shkohet në këtë mënyrë nuk do të ecë.

Kam edhe një propozim mjaftë konkret. Në procesin edukativo- arsimor shkollat dhe drejtorët rajonal apo drejtorët e shkollave me autorizimin e tyre organizojnë ekskursione/ Lë të organizojnë nëse kanë të drejtë, por duhet ta kenë një koncept të qartë, një prospekt historik kulturor mbi trashëgiminë tonë kulturore dhe t'i përfshijë vendet e të kaluarës historike, të afërt dhe të largët, t'i vizitojnë ku duhet jo të shkojnë dhe të pushojnë në Durrës edhe të helmohen. Kjo duhet të kemi kujdes dhe së fundi shumica e shkollave me momentin e pranimit të nxënësve fillestarë mungon kontrolli psikik, pedagogjik, psikologjik, sociologjik i pranimit. E pranon drejtori, i cili është gjuhëtar është ku ta di unë dhe në këtë mënyrë ne duhet në tërësi ta shikojmë procesin e reformimit të arsimit.

Mendojmë dhe kemi shumë argumente se shoqëria kosovare, institucionet e Kosovës kanë kuadër të mjaftueshëm, potencial dhe profesional po që se ka vullnet që ata të përfshihen dhe në veçanti në hartimin e teksteve, zvogëlimin e numrit të teksteve dhe orientimin e çdo mësuesi, arsimtari ,prej shkollës fillore deri në shkollën e mesme me cilën lëndë punohet dhe nga cila shtëpi botuese . Pikërisht, mësueset që kanë mësuar fëmijën tim kurrë me të njëjtat libra nuk ka mësuar. Herë më kanë orientuar t'i blej nga tri herë librat brenda një viti. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Duhet t'ju njoftoj se deri tash janë lajmëruar edhe 30 kandidatë për diskutim. Do të thotë nëse shkojmë nga 10 minuta janë 300 minuta, 5 orë. A mendoni se është e nevojshme ta shkurtojmë, ta kufizojmë? Pyes shefat e grupeve parlamentare për mendimin e tyre. Urdhëroni z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryetar. Ne në përgatitje për këtë seancë plenare me Kryesinë e Kuvendit dhe me shefat e grupeve, me këshilltarë tuaj vendorë e ndërkombëtarë, morëm vendim që debati të zhvillohet sipas forcës politike në Kuvend. Ne kemi dalë në zgjedhje për ta pas forcën politike me zbatua një program. Ajo sot nuk po shkon kështu, po respektohet rregullorja që çdo deputet i ka 10 minuta, ne si grup parlamentar jemi të organizuar dhe ne e mbështesim propozimin që debati të jetë 5 minuta për një deputet, jemi në dijeni që shefi i grupit parlamentar të PDK-së pajtohet, unë jam konsultuar me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, është çështje juaj se si jeni të organizuar. Ju mund me pranuar, apo mos me pranuar. Për mua në emër të grupit parlamentar të PDK-së fol Jakup Krasniqi, nëse ju keni zgjedhje tjetër është çështje e juaja.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është pajtua, kështu që mbetet dhe kërkojmë të mbetet një votë formale.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Koci, z. Koci e ka fjalën. Atëherë fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Ne vërtet nuk kemi biseduar, por megjithatë ne biseduam për çështjen, pasi i kemi gati 30 vetë të lajmëruar. Unë z. kryetar nuk isha dakord edhe me zgjatjen e minutave për folësit e mëparshëm. Një deputet që nuk është në gjendje për 10 minuta të thotë atë që duhet ta thotë, edhe një orë po t'ia lëmë s'mund ta thotë. Unë pajtohem që deputetët të jenë më koncizë, të marrin çështje pak më të ngushta dhe të jenë më konkret. Unë mendoj që edhe me 5 minuta të thuhet ajo që duhet të thuhet. Megjithatë, le të vendosë Kuvendi, nëse do ta reduktojë nga 10 në 5 minuta. Megjithatë, personalisht mund me thënë atë që duhet edhe për pesë minuta.

KRYETARI KOLË BERISHA – Vë në votim formal kohëzgjatjen e diskutimit 10 apo 5 minuta, kush është për 5, ju lutem numëroni votat.

Ju faleminderit

Kundër..... 8

Ju faleminderit,

Konstatohet se me shumicë votash Kuvendi ka miratuar propozimin që të shkurtohet diskutimi në 5 minuta. Vazhdojmë më tutje, fjalën e ka deputetja Gjylshene Berisha.

DEPUTETJA GJYLSHENE BERISHA - I nderuari kryetar i Kuvendit, ministra dhe të nderuar deputetë,

Unë çmoj larf vënien në rend dite sot, debatin për Arsimin para universitar, një ditë pas ditës së shënimit të Evropës.

Arsimi është interes vital për bashkimin e Evropës. Është faktor vendimtar në konkurrencën e industrisë evropiane, kohezionit shoqëror dhe integritetit të shteteve në Bashkësinë Evropiane (shpresoj që edhe Kosova në një të ardhme të afërt të jetë pjesë e BE-së) në bazë të mirëkuptimit të përbashkët, të demokracisë, sundimit të ligjit dhe vlerave të përbashkëta.....rishikimi i

kurikulave në arsim, duhet të përfshijë elemente që promovojnë vlera evropiane.

Të nderuar deputetë, politikat arsimore duhet të mos jenë të huaja për ata që pritet t'i zbatojnë. A jemi në rrugë të mirë në hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave. Përshtypja se arsimi ynë është mirë, nuk është reale, porse është në rrugë të mirë është reale në bazë të strategjisë 2007/2017.

Strategjia e arsimit para universitar është një projekt shumë i suksesshëm ku ministria ka paraqitur misionin dhe vizionin për të ardhmen.

Ajo synon cilësinë e shërbimit dhe përcaktimin e standardeve për nxënës dhe mësuesit të krahasueshëm me shoqëritë përparimtare. Shpresoj të mos mbetet vetëm në letër.

Sepse përmes kësaj strategjie ne formojmë qytetarin evropian për të bashkëjetuar me Evropën.

Përgjegjësia para qytetarëve për këtë nuk është vetëm e Ministrisë por është edhe e jona.

Sistemi i arsimit para universitar është një strukturë komplekse e përbërë nga shumë komponentë, nivele, segmente të rëndësishme dhe ndonjëherë divergjente të cilat garojnë për trajtim parësor nga Ministria, Qeveria dhe nga shoqëria në përgjithësi.

Unë do të insistoja në strategjinë e programit të përgjithshëm për fëmijë, sepse kujdesi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme është një fushë relativisht e re e qendrës së vëmendjes në shkallë ndërkombëtare.

Të përqendrohemi te fëmijët e moshës 0-5 vjet sepse nuk ka përkujdesje prej shtetit për këta fëmijë.

Ndihma për familjet që të sigurojnë që fëmijët e tyre të arrijnë moshën shkollore të shëndetshëm dhe të ushqyer mirë, kureshtarë edhe nga pikëpamja intelektuale, të sigurt edhe në shoqëri dhe të pajisur me një bazë të shëndoshë të mësuarit gjatë gjithë jetës, është thelbi i misionit të kujdesit dhe zhvillimit në fëmijëri të hershme. Ky është një qëllim ambicioz që kërkon veprime kur përfshihen familja, bashkësia dhe qeveria.

Mendoj se fëmijët e moshës 0-3 vjeç që janë në çerdhe duhet t'i lihen në përkujdesje Ministrisë së Shëndetësisë, kurse prej 3-6 e tutje duhet t'i lihen në përkujdesje Ministrisë së Arsimit dhe pushtetit lokal. Të bëhet financimi pjesërisht nga prindërit dhe simbolikisht nga komuna, sepse një kontroll prej shtetit është më i mirë se ai privat dhe mund të jetë i dëmshëm edhe për fëmijë.

Licencimi bëhet sa për sy e faqe, p.sh fëmija i sëmurë mbahet në çerdhe. Nëpër këto private, sepse atë e intereson vetëm t'i marrë ato të holla.

Paradoksale është pengimi për gjithë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione parashkollore, pengimi për të bërë vizita studimi dhe refuzimi i mjeteve didaktike në ndonjë prej këtyre çerdheve nga tekete e udhëheqësve jo të përgjegjshëm.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë në arsim dhe me qëllim që ligji të implementohet, nevojitet hartimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Shkollat duhen të jenë person juridik.

Duhet një ligj, sepse ky ligj, ekzistues, është me më se 100 udhëzime administrative dhe lejohet ndikimi i një partie në Ministri. Parlamenti duhet të vendosë kriteret bazë në ligj. Shkolla duhet të jetë person juridik, duhet një ligj sepse ky ligj ekzistues është ma i madh se 100 udhëzim administrative, lejohet ndikimi i një partie në ministri dhe Parlamenti duhet të

vendosë kriteret bazë të këtij ligji. Gjithashtu me ligj duhet të rregullohet edhe rrjeti i shkollave .

Me ligj të rregullohet edhe mënyra e financimit në tërësi,sepse kemi një ndarje në shkollat private dhe ato publike. Në Evropë shkollat private me të drejtë publike pra ato që përdorin plan programet e ministrisë kanë të drejtë të konkurrojnë për mjete në Ministri.

Me ligj duhet të caktohen edhe kriteret bazë për licencim të shkollave. Kurse ministria mund të caktojë standardet ,a duhet 2 apo 3 metër katror për nxënës .Në Evropë është 5 metër katror kurse në Gjilan është 1.66. Po z. Hoxha edhe unë ju them ejani në Gjilan dhe do të shikoni se Gjilani ka nevojë të krijohen kushte normale për zhvillimin e procesit mësimor në komunën e Gjilanit ne qytet duhet te ndërtohen 5 objekte shkollore njëra për shkollën e mjekësisë,sipas standardeve te kërkuara që një paralele të këtë 30 nxënës, kohëzgjatja e orës mësimore te jetë 45minuta dy ndërresa dhe sipërfaqja për një nxënës të jetë 2.5 m. katror. Por shkollën nuk e bëjnë vetëm objektet. Shkollat e Gjilanit të gjitha kanë fituar grante prej Bankës Botërore.

Është investuar në trajnimin e mësimitdhënësve për përdorimin e metodologjive te reja mësimore,janë trajnuar 1222 mësimitdhënës, 97.14% nga organizata ta ndryshme vendore dhe ndërkombëtare te cilat i falënderoj.

Dhe do te kaloj përsëri ne arsyeshmërinë e ndryshimit apo plotësimit te ligjit ekzistues.

Gjatë zbatueshmërisë ka pasur probleme sepse në shkolla nuk kemi mundësi të ofrojmë zgjedhje profesionale,psikologë,pedagogë,mjekë etj, e kjo arsyetohet me mungesë mjctesh financiare.

Kemi kodin e mirësjelljes dhe masën e përjashtimit të nxënësit .Duhet raporti i psikologut sipas udhëzimit administrativ për të marrë masa ndëshkuese ose përmirësuese për nxënësit.

Kemi situata të ndryshme por shoqëria gjithsesi duhet të mbrojë fëmijën.

Është për të përshëndetur aksionin që ka marrë Ministria për t'i thënë STOP dhunës në shkollë.

Ka nevojë për veprimtari të shumta edukative ,trajnuese ,vlerësuese dhe parandaluese të dukurisë së dhunës ndaj fëmijëve.

Të sigurohet një klimë pozitive ku nxënësit edukohen dhe mësojnë në kushte të sigurta. Larg dhunës që realizimi i procesit të mësimitdhënies të mbështes dhe të respektoj të drejtat universale të njeriut që shkolla të sigurojë një mjedis ku sjelljet e dhunshme ndaj fëmijëve të mos lejohen dhe le të përvetësohen sjellje dhe vlera jo të dhunshme.

Nxënësit të kenë njohuri më të madhe rreth gjyqësisë,të hartojmë plan programe që ato të njihen me të drejtat dhe përgjegjësit e tyre .

Qeveria duhet të hartoi dhe miratoi një strategji të zhvillimit ekonomik dhe social ku do të parashikohet çdo vit një rritje e sistemit të pagave në sistemin arsimor.

Të parashikohet një rritje e përvitshme dhe në krahasim me pagat e sotme ato duhet të dyfishohen .

Duhet të gjenden forma për pajisjen me mjete ,për ngritjen e pagave .

Të bëhet licencimi i punëtorëve të arsimit.

Të lihet mundësia e shkollës për të fituar mjete vetanake për punën e vet edhe kjo të rregullohet me ligj.

Të bëhen kooperativat, sepse është mënyra ku shkolla ndihmon aksione për biznesin lokal dhe nxënësi edukohet për menaxhim.

Kemi konvikte të cilat janë nëpër qendra të ndryshme që nuk shfrytëzohen,dhe të shndërrohen në shkolla publike, të pajisen me laboratorë dhe me salla ku mund të mbahet nësimi praktik.

Duhet një vëmendje t'i caktohet arsimit të obliguar që t'ia ofrojmë të gjithë mundësitë për arsim cilësor,si p.sh mësimi i gjuhës ,9 vitet e para të shkollimit mundëson përdorimin e gjuhës standarde.

Kontributi për arsim i Qeverisë të jetë gjithmonë prioritet.

Kyçja e shkollave në rrjetin e internetit si kusht i domosdoshëm për thellimin e reformave në arsim, është komunikim që mundëson lidhjen e nxënësve me botën dhe shkëmbimin e ideve, të përvojave.

Ky proces që ka filluar duhet të kryhet.

Edhe pse ka shumë çka të flitet, sepse ja kemi borxh fëmijëve mendoj se këto janë disa prej pikave në të cilat jam fokusuar.

Fati i Kosovës qëndron në gjeneratat e tanishme dhe në ato të ardhmet.

Faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ – Z. kryetar, të nderuar z. ministër të nderuar deputetë dhe përfaqësues të sindikatave të arsimit.

Shqyrtimi i Gjendjes në arsim, e konsideroj qasje serioze institucionale, se krijon mundësin për tu njohur me gjendjen faktike në arsim, por edhe për propozimin e iniciativave konkrete për sanimin e gjendjes, aty ku është e mundëshme dhe shumë e domosdoshme, edhe pse unë konsideroj se është një ndër fushat, që ma se miri funksionon, falë përkushtimit të dinjitetshëm të punëtorëve të arsimit, të cilët me seriozitet jetësojnë politikën arsimore të nivelit lokal dhe qëndror.

Informata e ofruar nga MASHT-i në debatin e sotshëm, është një material në vijë të trasha që ofron të arriturat në arsim, me një pasqyrë numerike të nr. të nx.; të arsimtarëve dhe nr. të institucioneve parashkollore fillore, të mesme dhe shkollave speciale. Në këtë material paraqitet infrastruktura ligjore me të cilin funksionojnë këto dy nivele të arsimit, si dhe ligjet që janë në procedurë dhe shumë të domosdoshme për reformën e arsimit. Njëherit edhe sfidat që e presin arsimin në të ardhmen.

Edhe pse në planin zhvillimor të MASHT-it, me program, ka përmirësimin e infrastrukturës në objektet shkollore, me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit, gjithëpërfshirjes dhe zbatimit të reformave arsimore, thellësishtë janë e interesuar të di:

Sa janë të harmonizuara tekstet shkollore me programet e hartuara dhe sa janë në hap me të arriturat shkencore;

Sa është niveli i mësimdhënies dhe mësimnxënies në krahasim me vështirësitë që e përcjellin arsimin në Kosovë (me We rast do të veçoja për të mirë fillimin e ngritjes profesionale të arsimtarëve dhe certifikimin e tyre për disa vite, që është hap konkret për të rritë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies) Sa janë efikas mekanizmat që bëjnë kontrollin e cilësisë së arsimit në të dy nivelet;

Sa janë shkollat tona konkurruese me shkollat simotra të vendeve të tjera;

Pasi kemi filluar jetësimin e reformës në arsim, sa punohet që të njihën dëftesat e të dy niveleve në shtetet e tjera jashtë Kosovës; cilat janë masat konkrete të kësaj Ministrie dhe të drejtorive komunale për parandalimin e dhunës që kohëve të fundit shqetëson prindërit dhe qytetarët;

Sa është prioriteti i kësaj Ministrie shqyrtimi i pozitës materiale të punëtorëve të arsimit dhe cilët janë hapat konkretë shpresëdhënës në këtë drejtim (këtë po e potencoj, se sa here takohem me punëtorët e arsimit në Ferizaj, i vetmi interesim është: a ka diçka të re për rritjen e pagave, por edhe një fakt tjetër. Në një debatë që e patëm unë e zoti Bajrush Xhemajli me shoqërinë civile në Ferizaj, interesimi qytetar ndër të tjera është: "cilët janë hapat konkretë që do të ndërmarrin Parlamenti dhe Qeveria për përmirësimin e gjendjes materiale të punëtorëve të arsimit; si dhe

A do të rriten pensionet dhe pse Parlamenti nuk bjen një vendim ,me i lirue pensionistët nga pagesa e rymës.

Per zgjidhjen efikase të këtyre çështjeve, që unë i konsideroj si prioritete,konsideroj si të domosdoshme kthimin në rishqyrtim të Ligjit per arsimin fillor dhe të mesëm, që të amandamentohet në mënyrë që suksesshëm ta jetësojmë reformën në arsim.

z. minister, Komuna e Ferizajt, sikurse edhe një pjesë e madhe e komunave të Kosovës, ballafaqohet me probleme të theksuara në sferën e arsimit

Ferizaji,ballafaqohët me mungesë të hapsirës shkollore.Nga 5 shkollat fillore sa ka qyteti me 70.000 banorë, dy prej tyre punojnë me 4 ndërresa, dy në tri e një në dy ndërresa e të mos flasim per kabinete e hapsira per poligone sportive e domosdoshmërinë e pranisë së mjekut, psikologut pedagogut per evitimin e dukurive negative dhe mbrojtjen e nxënësve nga sëmundjet ngjitëse.

Por, në këtë drejtim është një shkëndijë shprese, se së shpejti në Ferizaj përfundojnë dy objekte shkollore (njëri i financuar nga MASHT-ti e tjetri nga KK),ku do të krijohen hapësira shkollore bashkëhore shumë të domosdoshme për më se 3000 nx.

Buxheti i vitit 2007për Ferizajn është zvogëluar në krahasim me numrin e nx.,me nr. e paraleleve.Për DKA dhe 37 institucioneve të arsimit me 1654punëtor dhe është caktuar shuma 4.710.724 euro

Kjo sasi e mjateve nuk siguron cilësi në përputhje me standardet;

Nuk realizohen politika adekuate per trajnimin profesional në shërbim të reformës per arsimtarë dhe per trajner; nuk mund të sigurohen mjete adekuate mësimore; si dhe

Shkollat profesionale ende nuk ofrojnë cilësinë e duhur,sidomos per pjesën praktike;

Këto janë disa nga arësyet që buxheti duhet të rritet e jo të zvogëlohet.

z. Minister, në Ferizaj në të dy nivelet ka 29.982nx..Në bazë të ligjit per kokë nx. ndahën nga 5 euro,që bëjnë 149.910euro Nga shpenzimet kapitale të planifikuara Ferizajit nuk i janë nda (80.836)

Nga mallra e shërbime është minus 56.483,që bëjnë137.319

Per të gjitha këto, është e njoftuar MASHT-i dhe MEF, nga udhëheqësia komunale prandaj, z, minister kërkoj t'i rishqyrtoni politikat buxhetore pas 6 mujorit të pare dhe Ferizajit të i ofrohët sasia e mjeteve financiare nga shpenzimet kapitale dhe mallra e shërbime që i takojnë se me këtë sasi të mjeteve Ferizaji rrit cilësinë në arsim.

Z. minister, unë e di që arsimi ndan fatin e njejtë me popullin e Kosovës, në këtë faze të tranzicionit, ku përkundër vështirësive sukseset j anë evidente .

Por unë kërkoj hapa konkretë, per zgjidhjen e këtyre çështjeve që i shtrova para jush,se edhe përkundër sukseseve, që i kemi si Parlament dhe si Qeveri, qytetarëve u interesojnë zgjidhja e problemeve konkrete dhe ate, në mënyer urgjente. Dt.9.05 2007....

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Remzije Nimani,

DEPUTETJA REMZIJE NIMANI - I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari ministër i vetëm që e kemi këtu, zonja dhe zotëri deputetë.

Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm është i një rëndësie të madhe dhe shumë i domosdoshëm për nivelet 01 dhe 2. Por meqenëse ky është ndër ligjet e para që është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe gjatë zbatimit të tij në praktikë është vërejtur se ka mjaftë të meta. Me qëllim që të vendosen rregulla ligjore në arsimin fillor dhe të mesëm është i domosdoshëm që të bëhen disa ndryshime në këtë ligj.

Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, ka bërë vizita shumë komunave që u përmend edhe deri më tash, dhe gati nëpër gjitha ato kanë qenë vërejtje të njëjta për të bërë

ndryshim në këtë ligj. Nga të gjithë drejtorët e shkollave që kemi vizituar kemi marrë përgjigje se ky ligj duhet të pësojë ndryshime. Vërejtjet e mia që do të fillojë me arsimin e nivelit zero janë:

Arsimi parashkollor që përshin fëmijët e moshës 3 deri 5 vjeç, është dëshirë e prindërve që të regjistrohen fëmijët e tyre. Me atë numër që do të regjistrohen një vit më pas në klasën e parë. Por kjo dëshirë e tyre nuk realizohet, sepse është hapësira shkollore që nuk mjafton, por edhe buxheti komunal nuk i mbulon këto. Për parashkollorët drejtoria komunale jep një numër të caktuar p.sh. në shkollën ku unë punoj kemi të drejtë t'i regjistrojmë 50 nxënës në paralelet parashkollore. Kurse edhe 100 tjerë mbesin jashtë bankave. Shkollimi i detyruar është prej 6 vjet, por këtu në ligj nuk ceket prej cilit muaj. Ndodh që fëmija i mbush 6 vjet në janar, por ndodh edhe 6 vjet nga 15 shtatori e nuk ka drejtë të regjistrohet. Edhe këtu duhet të bëhet një ndryshim, sepse për një vit e humb vitin shkollor..

Për pranimin e drejtorëve të shkollës formohet një komision nga MASHT-i dhe komuna, unë propozoj që të jetë edhe një anëtar i komisionit nga shkolla që do ta pranojë drejtorin. Në ligj po ashtu thuhet se komuna organizon transport për arsimtarët që udhëtojnë prej qytetit në shkollat e fshatrave dhe anasjelltas, por kjo nuk ndodh te ne.

Do të ishte shumë mirë sikur kjo të realizohet, por deri tash nuk ka ndodhur, prapë po ju them. Mësimdhënësi e ka normën e plotë 20 orë, mësimi në javë. Nëse i mungon një orë, p.sh. i ka 19 orë ai dëmtohet, nëse e plotëson normën me 24 orë, nuk shpërblehet nuk paguhet d.m.th. Këtu kam vërejtje edhe te pushimi mjekësor ku u përmend edhe nga parafolësit e mi .Me këtë ligj janë paraparë 15 ditë pushimi brenda një viti, prandaj mësuesja nuk guxon të sëmurët, ose të ketë ndonjë sëmundje serioze sepse paguhet vetëm 15 ditë, e pjesa tjetër hiqet prej listës së rrogave në tërësi.

Kam vërejtje edhe te pushimi i lehonisë, në kontratën që është nënshkruar dy tri herë, nuk është implementuar gati asnjë pikë. Thuhet se pushimi i lehonisë ka hyrë në fuqi ,por kjo nuk është e vërtetë. Arsimitaret që shkojnë në pushim të lehonisë paguhet 70% tre muaj, nëse donë me vazhdua duhet të stimulohen vetëm me 40%. Prandaj, ato janë të detyruara ta ndërpresin pushimin, dhe të kthehen dhe kanë premtuar se do t'i marrin edhe bebet me vete. Shkolla duhet ta ketë një pjesë të buxhetit sepse është shumë e nevojshme në përditshmërinë duhen të holla ta kenë një buxhet të shkollës, kjo nuk është te ne, te paralelet dhe nxënësit me aftësi të veçanta, në shkollën ku unë punoj në Mitrovicë kemi dy paralele, një të parë dhe një të tretë me asnjë,

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Drita Statovci, le të përgatitet deputeti Gani Koci

DEPUTETJA DRITA STATOVCI - I nderuari kryetar, ministra, te nderuara kolege e kolegë, Të nderuar të pranishëm

Arsimi është vlerë, është kapital i së tashmes dhe investim i së ardhmes, prandaj shfaqet tipike që arsimin dhe arsimimin ta pretendojmë, ta respektojmë dhe ta çmojmë që të gjithë. Mirëpo, angazhimi i institucioneve tona, të cilat kanë për detyrë dhe obligim gjithnjë të sigurojnë mënyra dhe mekanizma funksionalë rezultativë në këtë fushë, shpesh here në veprimet e veta shfaqet në kundërshtim me tipiken për arsim. Prandaj ky angazhim shfaqet atipik, dhe joadekuat për shoqërinë tonë krahas lirisë ndërton edhe demokracinë dhe pretendon arsimin cilësor.

Duke mos i mohuar të arriturat në fushën e arsimit dhe duke dëshiruar që këto të bëhen edhe me të avancuara, do të shtroj këtu vetëm disa raste ilustruese për tipiken dhe atipiken në arsim, të zgjedhura krejt rastësisht, por që gjithashtu krejt rastësisht komunikojnë dhe qartësojnë shumë dukuri.

Per arsimin tone sot, per institucionet tona shfaqet fare tipike të pretendohet njëhershëm, cilësia dhe reforma. Mirëpo, me keqardhje duhet konstatohet investimi dhe rezultatet në këtë drejtim shfaqen atipike në raport me kërkesat dhe me rrjedhat e përditëshmërisë. Arsimi ynë parafillor, fillor dhe arsimi i mesëm përballët me probleme paradoksale, atipike per kohen me të cilën jetojmë. Është e habitshme se pikërisht në kryeqytet, aty ku i kemi të grumbulluara të gjitha institucionet e mundshme të arsimit, në disa shkolla, si psh. në shkollën "Hasan Prishtina", mësimi zhvillohet në 4 ndrrime, ndërsa per shkolla tjera të Prishtinës është fare e rëndomtë që mësimi të zhvillohet në tri ndrrime ("Naim Frashëri", "Pjetër Bogdani", "Ismail Qemali", "Elena Gjika" etj.). Hlasët kanë numër të madh nxënësish 30 ose 40, ndërsa hapësira ku zhvillojnë mësim, si shprehen mësimdhënësit "mezi lejon të ngopen frymë". Ora mësimore zgjatë 40 ose 30 minuta, varësisht nga ndrrimi i paraditës ose i pasditës, ndërsa inventari dhe kushtet higjienike brenda shkollës nuk janë fare të lakmueshme. Ngjashëm ndodhë edhe në qendra të tjera. Në Gjilan psh., përveç se punohet në 4 ndrrime, në shkollën fillore "Abaz Ajeti", per arsye të hapësirës se pamjaftuar, klasët e nënta detyrohen ta zhvillojnë mësimin në një ambient të adaptuar të ish-Kombinatit të tekstit. Raste të ngjashme të "bredhjes" se nxënësve dhe të mësimdhënësvë, madje "atraktive", sepse duhet udhëtuar nga qyteti në fshat shënuam psh. në Mitrovicë. Shtrohet pyetja cili është efekti dhe cili është rezultati i mësimin në kushte të tilla, dhe

cilat janë përpjekjet e Qeverisë, ose të Ministrisë për tejkalimin e gj. endj. es së tillë?

Në kohën e sotme arsimi parafillor shfaqet shumë tipik dhe i dëshirueshëm për të gjithë dhe në mbarë hapësirën gjeografike të Kosovës. Mirëpo, përfshirja e fëmijëve në këtë shkallë arsimore shfaqet atipike dhe mospërfillëse ndaj dëshirës së të gjithëve, madje kjo as në qendrat urbane e aq më pak në vendbanimet rurale. Në anën tjetër, mbështetur në preferencat e reformës në arsim, nxënësi i moshës 6- vjeçare që pranohet në klasën e parë fillore, duhet të vijë i përgatitur nga niveli parashkollor. Shtrohet pyetja sa përmbushet ky kriter reformues? Sa ka bërë Ministria në këtë drejtim? A mund të quhet standard dhe dukuri tipike për arsim dhe edukim, nëse mësimi-edukimi për fëmijë të moshës 4-5 vjeçare organizohet në grupe me 30, ose 50 fëmijë, si psh. në shkollën "Thimi Mitko" të Gjilanit. Ose, a mund të konsiderohet ligjore kur në shkollën publike paralelet parashkollore finansohen nga prindërit, si fjala vjen në Prizren.

Për arsimin e mesëm po përmend një rast shumë sinjalizues. Në Prizren, klasa e 12-të e Shkollës së Mesme të Mjekësisë, në programet e veta paska hiq më pak se 18 lëndë mësimore (!). Kjo është shenjë tipike emergjente se duhet ndryshuar programet jotipike, rënduese, joracionale në shkollat tona. Shtrohet pyetja ku mbetet veprimtaria e Ministrisë në këtë drejtim?

Natyrisht koha moderne e pretendon edhe artin, veçanërisht artin muzikor, prandaj për shoqërinë tonë u shfaq fare tipike ta kemi shkollën e muzikës. Mirëpo, kushtet në të cilat punon Shkolla e mesme dhe e ultë e muzikës, fjala vjen në Prishtinë, vërtetë janë atipike dhe fare të papërshtatshme. Hapësira shkollore është tejet e vogël, instrumentet tejet të vjetëruara dhe të dëmtuara, madje ngjashëm sikur mungojnë librat falas dhe të parapara me ligj për shkollat fillore, këtu mungojnë psh., violinat që do të huazoheshin për nxënësit në nevojë. Të mos harrojmë, nga këto nivele rekrutohen solokëngëtarët, ose instrumentistët-anëtarë të ardhshëm të Orkestrës së Filharmonisë së Kosovës. Po ashtu si shoqëri e pretendojmë edhe baletin, madje kemi në plan realizimin e projektit të operas dhe të baletit. Është tipike që ushtrimi për balet të fillojë në moshën 4-5 vjeçare, ndërsa

këtu te ne kjo ndodh në moshën 14-15- vjeçare. Vërtet atipike për dukurinë dhe për artin e quajtur balet.

Tani, pas shembujve të këtyllë shtrohet pyetja: janë këto kushte tipike dhe standarde për nxënësin, për mësimdhënësin, për shkollën, apo janë atipike dhe larg standardeve të nevojshme për arsim. Si të arrihet cilësia me kushte të tilla, si të evaluohen treguesit e cilësisë për nxënësin, për mësimdhënësin ose për shkollën?! Do të ishte dukuri dhe veprimtari tipike që mekanizmat e këtyllë dhe kushtet e nevojshme të ndërtohen dhe të ofrohen nga organet kompetente qeveritare.

Për fund dëshiroj ta spikas faktin se është krejt tipike dhe e natyrshme që barrën e arsimit e bart mësuesi-mësimdhënësi. Por, është krejt atipike dhe e paarsyeshme që shoqëria, institucionet qeveritare ende hezitojnë të punojnë në drejtim të përmirësimit të pozitës materiale tejet të rëndësishme të mësimdhënësit. Zërat nga terreni porosisin: "është momenti i fundit dhe i pashtyeshëm që arsimi të jetë prioritet për shoqërinë në përgjithësi dhe për Qeverinë në veçanti".

Fjalën time e fillova me konstatimin se arsimi është vlerë. Tani po e përfundoj me konstatimin se këtë vlerë dëshirojmë ta shijojmë dhe ta gëzojmë që të gjithë. Po përfundoj duke vërejtur se: ndërmyjet dëshirës dhe shijimit na shfaqet një distancë me shumë probleme. Për përballimin e kësaj distance duhet të prinë Qeveria, Ministria dhe me radhëhuierarkia e organeve kompetente, por natyrisht duhet t'i bashkohemi edhe ne të gjithë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Gani Koci le të përgatitet deputeti Xhelal Canziba.

DEPUTETI GANI KOCI - Z. ministër në fillim dua t'ju pyes në buxhetin e vitit 2006 për shpenzime kapitale keni pasur afro 10 milion euro. Sa nga këto, dhe ku i keni realizuar, do të përpiqem në pesë minuta të jem shumë shkurtër.

Në Skenderaj veprojnë 48 shkolla, prej tyre 21 shkolla të plota fillore dhe dy shkolla të mesme me 20 paralele të ndara në fshatrat ruro. Në vitin 2006 --2007 në gjitha këto shkolla vijojnë mësimet mbi 16 mijë nxënës.

Gjendja në këto shkolla është si vijon: Bë 13 shkolla fillore mungon uji i pijes, në 8 shkolla nuk ka rrymë, në 7 shkolla mësimi zhvillohet në konteiner, në 6 shkolla nuk ka poligone sportive fusha që duhet t'i ketë shkolla. Qe 7 vite e këndeje nga institucionet e Qeverisë janë investuar vetëm 650 mijë euro në një shkollë. Ndërsa, falë donatorëve janë rinovuar ose janë ndërtuar 13 shkolla të cilëve ju jemi mirënjohës. Në anën tjetër dje kur diskutuam buxhetin kjo ministri për shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë ka harxhuar hiq më pak se 300 mijë euro. Për furnizim me ushqim me pije nuk di ku kanë shkuar afro 1 milion euro. Për naftë afër 487 mijë euro. Vetëm për qira që i mbanë në objekte të ndryshme, objekte pa leje ndërtimi, pa leje të ndikimit të ambientit mbi 320 mijë euro, dhe kështu me radhë. A ka mundur kjo ministri që një pjesë të këtyre mjeteve t'i përqendrojë në ato vende dhe sidomos në komunën e Skenderajt dhe në Drenicë në përgjithësi në mënyrë që të mos pikin kulmet e shkollave, që nuk e desha të përmendi në cilat shkolla me emra dhe mbiemër, dhe sado pak të rregullohet dhe të përmirësohet kjo gjendje. Folën të tjerët për kualitetin e mësimit por, kjo është gjendja e shkollave të mesme dhe shkollave fillore në Skenderaj. Për këtë le të japë përgjigje ministri. Para se të përfundojë unë dua të tregojë një anekdotë:

"Në kohën e mbretit Zog një mësues shkon të ankohet në ministrinë e arsimit. Ministri e pret dhe në bisedë e sipër e pyet se çfarë mësuesi çfarë lënde e jep në shkollë, ky thotë jam mësues i muzikës, ministri e pyet thotë cilit instrument i bien, mësuesi ia kthen prej që jeni

ju ministër thotë po i bie vetëm barkut" Për deri sa është kjo qeveri dhe kjo ministri arsimtarët do t'i bien vetëm barkut. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit – fjalën e ka deputeti Xhelal Canziba, le të përgatitet deputeti Hajredin Hyseni.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA – I nderuar z. kryetar të nderuar ministra, të nderuar deputetë. Tani kur jemi duke trajtuar çështjen e arsimit për periudhën e shkuar të vitit 2006 mund të shfrytëzojmë rastin për t'i prezantuar disa të dhëna që kanë të bëjnë në arsimin në komunën e Rahovecit për periudhën në fjalë. Dihet mirëfilli se arsimit paraqet shtyllën kryesore të zhvillimit të një vendi dhe se pa arsimim të mirëfilltë nuk do ta kemi një shtet çfarë dëshirojmë ne.

Ky segment kaq i rëndësishëm i jetës në komunën e Rahovecit me tërë kompleksitetin e vet në mënyrë mjaft reale pasqyron shkallën e ulët të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vetë komunës. Komuna e Rahovecit e cila për afërsisht numëron diku 75 mijë banorë në gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2006 procesin edukativ arsimor e ka pas të organizuar në 23 shkolla fillore dhe në një shkollë të mesme me dy paralele të ndara në Krushë të Madhe dhe në Ratkocv, megjithëse nxënësit të regjistruhen 13317.

Procesin edukativ arsimor e kanë zhvilluar 703 punëtorë arsimi, prej të cilëve 139 pa kualifikim adekuat për punën arsimore, ose shprehur në përqindje diku afër 20% dukuria e të cilave përcillet gati për çdo vit, dhe e cila me drejtë për drejtë ka ndikuar në sukses jo të mirë në shkollat tona. Klasën e kanë përsëritur në shkollat fillore 125 nxënës, ndërsa në shkollën e mesme 253 nxënës, ose 14% të regjistruhen në fillim të vitit. Nëse kësaj i shtohet edhe numri mjaft i madh i atyre që e braktisin shkollën gjatë vitit shkollor e në veçanti arsimin fillor në viset rurale nga ana e vajzave, atëherë komunës sonë i lindin problemet shtesë të rritjes së numrit të analfabetëve apo gjysmë analfabetëve për çfarë do të duhen mjete shtesë për ri shkollimin e tyre.

Ne mendojmë se për një gjendje të këtyllë jo të mirë të arsimit në komunën e Rahovecit shkaktarë kryesorë janë, organizimi i dobët i institucioneve arsimore për punë edukative arsimore, kuadri kualifikues jo adekuat personelit edukativo arsimor, mungesa e hapësirës së duhur mësimore në përputhje me standardet bashkëkohore, mungesa e kabinetëve dhe e mjeteve bashkëkohore mësimore, kuadri drejtues i shkollave me pa aftësi të duhur organizative i zgjedhjes sipas kriterëve të përkatësive partiake jo atyre profesionale si është rasti në shumë shkolla fillore, ku refuzohet kandidati me fakultet i cili në intervistë ishtee pranohet ai me shkollë të lartë vetëm se është i partisë në pushtet. Ose kur në shkollën fillore Ardhmëria në Rahovec për drejtor pranohet kandidati i cili udhëton nga komuna tjetër vetëm e vetëm se e përkrah drejtori drejtorisë për arsim. Ndërsa refuzohet kandidati i cili plotëson kushtet ligjore por që nuk i takon partisë në pushtet.

Braktisja e shkollës si u përmend më parë, niveli i ulët i përgjegjësisë së punëtorëve arsimorë ndaj vetë punës, mosbashkëpunimi i këshillit të prindërve me shkollën, keq menaxhimin e mjeteve buxhetore, kjo tregon se kualiteti i mësimit dhe përcjellësi i diturisë të nxënësit nuk mund të meritojnë notë pozitive. Komuna dhe kompetentët e tjerë të niveleve më të larta janë të obliguar sipas ligjeve në fuqi që të sigurojnë kushtet për mësim normal nëpër shkollat për nivelin më të ulët e deri te ai i mesëm.

Të bëhesh me dije do të thotë të kesh fuqi, e fuqinë e bëjnë njerëzit dhe shoqëria e arsimuar. Prandaj lypet me i ndërmarrë këto masa. Punëtorët edukativo arsimorë duhet t'i kthehen integriteti dhe dinjiteti nëpërkëmbur shumë- vjeçar përmes rritjes së të ardhurave personale. Të shpejtohen edhe reformat në arsim, reforma që do të mundësojnë ngritje të individit, aftësinë të tij profesional lidhur me sektorët e ekonomisë ku do të mundësojë edhe punësimin e tyre më të shpejtë. Të bëhen investime të duhura në pajisjen e shkollave me hapësirë të duhur shkollore me objekte përcjellëse konform standardeve dhe ligjit për arsim të të gjitha nivelet që i ka komuna. Shkollat të pajisen me mjete adekuate bashkëkohore mësimore si të jenë mundësitë për nxënësit që të bëjnë ngritje arsimore paralel me kërkesat e zhvillimit teknologjik, informative dhe komunikative. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit – Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, le të përgatitet deputeti Ferid Agani

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, z. ministër, të nderuar deputetë.

Edhe pse pas përfundimit të luftës pritej që institucionet e krijuara ndaj arsimit të kishin një qasje vërtet meritore ashtu siç edhe e meriton, Edhe mësimdhënësit dhe qytetarët në tërësi kaluan një golgotë për vitet e tëra fatkeqësisht gjendja e arsimit vazhdon të jetë e mjerueshme edhe pas kaq vitesh që frymohet lirisht. Kjo gjendje e rëndë është edhe për shkak të një keq menaxhimi që vazhdon nga institucionet që e drejtojnë sot arsimin, dhe sikur të mos mjaftonte ky keq menaxhim arsimit vazhdon të mashtrohet me premtime që nuk u realizuan asnjë herë si është kontrata kolektive e nënshkruhet nga ministri, nga kjo qeverisje, për ta lënë vetëm si kujtim në letër dhe për t'u shpresuar ndonjëherë.

Zonja dhe zotërinj

Për ta kuptuar gjendjen e arsimit sot në Kosovë nuk duhet shumë mund dhe nuk nevojitet shumë kohë. Mund të shkosh në cilën do komunë dhe do të shohësh atë gjendje që pasqyron gjendjen e përgjithshme në Kosovë. Do të shohësh mungesë të kushteve. Në një klasë mësojnë edhe 40 nxënës, do të shohësh se informatikën e ligjërojnë ekonomistë, se arsimtarët e gjuhës angleze japin gjuhë amtare dhe gjuhëtarët japin edukatë fizike. Kjo është gjendja e arsimit sot.

Unë para jush do të sjell vetëm dy tre shembuj nga komuna e Besianës që reflektojnë këtë gjendje të përgjithshme në arsim. Në qoftë se kemi parasysh zhvillimin e mësimin që bëhet edhe pas shtatë vite në konteinerë të 200 nxënësve të shkollës fillore "Eqrem Qabej" në Buricë të Besianës jo shumë larg nga kryeqendra e Prishtinës do të kuptosh politikën që ndjek sot Qeveria dhe ministria në raport me arsimin, dhe realizimin e programit të saj politik e cila lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë dhe determinon këtë zhvillim.

Mjafton të shikosh 32 shkolla fillore sa ka kjo komunë për të parë sa është e involvuar politika dhe kriteri partiak për zgjedhjen e drejtorëve dhe të kuadrit udhëheqës në shkollat e Kosovës sot, dhe nga këto 32 shkolla, 30 drejtorë do t'i gjesht aktivistë dhe kuadro të LDK-s, nga vjen ministri dhe shkollat shpesh i shndërrojnë në vende për të kryer aktivitete partiake, që po dëshmohet edhe në lënien e suksesit të nxënësve dhe me lënien çdo ditë edhe më shumë të shkollës nga vetë nxënësit. Ky kriter i cili të kujton shpesh periudhën pas 81-tës të diferencimeve po vazhdon ta dëmtojë rënd arsimin në Kosovë. Sepse edhe në qoftë se plotëson kriteret kualifikuese një mësimdhënësi, por në qoftë se ai nuk është në vija

partiake të ministrit dhe drejtorit të departamentit ata do të degdisen sa nga një vend në një vend tjetër, për ta demoralizuar vullnetin e tij dhe për ta detyruar të heqë dorë nga mësimdhënia. Kjo politikë ka degraduar arsimin në nivel edhe më të keq se sa ishte para 20 ose 30 vitesh.

Sepse nga 318 maturantë sa kishte komuna e Besianës në vitin e kaluar testin kombëtar e kanë kaluar vetëm 98 nxënës, dhe ka mbetur 220 pa diplomuar në afatin e parë.

Ky rezultat i shpjegon të gjitha politikat që ndiqen në arsim sot. Se në çfarë kushtesh sot ndodhet arsimi dhe ku zhvillohet mësimi, vërtetë kjo mund të mësohet po të flas vetëm për komunën e Besianës "vetëm të vizitosh dy tri shkolla si janë, shkolla "Sheq Mirovci" në Shtedim, "Ali Hadri " në Peran," Luigj Gurakuqi" në Batllavën dy dhe kjo gjendje e vështirë e cila pamundëson zhvillimin normal të arsimit do të jetë shumë e qartë, por kjo gjendje ka një shpjegim të vetin. Po të shikosh se kush i fiton tenderët për meremetimin dhe ndërtimin e shkollës, del se i i fitojnë firmat e afërta me komunarë të arsimit dhe kjo ndodh çdo herë sepse këto firma janë pa konkurrent.

Zonja dhe zotërinj deputetë, një rast i freskët tash voni më së miri tregon se sa dhe si mund të keqpërdoret dhe keq menaxhohet buxheti deri në banalitet dhe ky rast është në fshatin Gërdovc prapë të komunës së Besianës. Me buxhetin sa ishte paraparë për të ndërtuar klasë për të plotësuar nevojat që ndiheshin, ministria dhe kuvendi komunal kishin vendosur që të ndërtojnë vetëm dy klasë në këtë shkollë. Por kur reagon fshati dhe ua ndërprejnë punimet, sepse premtimet ishin të ndërtojnë aq klasë sa të plotësohen nevojat, madje të ndryshojnë edhe planin, sepse tani kanë mundësi të ndërtojnë me të njëjtin buxhet tri klasë dhe një podrum.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ferid Agani dhe pastaj dalim në pauzë.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra kolegë deputetë. Është e evidente se në sistemin arsimor janë duke u bërë përpjekje të mëdha për t'u ballafaquar me sfidën e edukimit dhe të arsimimit të numrit të madh të rinjve në rrethanat e ri seksioneve të skajshme buxhetore. Kjo vlen veçanërisht për mësimdhënësit në nivelin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm të cilët janë duke bërë punë të jashtëzakonshme me numër të madh të nxënësve në kushte që janë larg standardeve të punës edukative dhe arsimore.

Rrethanat e lartpërmendura rezultojnë me pamundësitë e zbatimit kualitativ të programit arsimor si dhe me humbjen së paku në masë të madhe të rolit të tyre edukativ. Shkollat tona duhet të jenë institucione të cilat ndihmojnë në formësimin e personaliteteve stabile psikologjike të rinjve. Për fat të keq kjo nuk është duke ndodhur këto ditë.

Një prej indikatorëve të këtyre zhvillimeve negative është dhuna e shtuar në shkolla dhe vartësia nga substanca psiko-aktive në moshë të re shkollë. Veçanërisht na brengos dukuria e vetëvrasjeve të shtuara në mesin e adoleshentëve pra të rinjve të moshës shkollë. Sipas hulumtimit të bërë 30.1% e numrit të përgjithshëm të vetëvrasjeve në Kosovë, do të thotë 111 të rinj në periudhën 2000/2005 janë të kryera nga adoleshentët. Ky është indikator shumë serioz i çrregullimeve socio psikologjike në shoqërinë tonë. Lidhur me këtë është shkalla dhe gjithnjë në rritje të dhunës së manifestuar nga nxënësit në shkolla. Më lejoni që përkritazi me këtë t'i them disa fjalë për iniciativën e kahershme politike të Partisë së Drejtësisë për institucionalizimin e lëndës së arsimimit dhe edukimit

fetar në shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës si lëndë fakultative që zbatohet në pajtim me vullnetin e prindërve dhe të nxënësve.

Është fakt i verifikuar në mënyrë shkencore se bindjet e formuara dhe të pjekura fetare të individit janë ndër faktorët më të rëndësishëm për stabilitetin psikologjik të të riut, dhe faktorë parandalues të aktit të vetëvrasjes. Në këtë aspekt realiteti i vrazhdë i privimit të nxënësve tanë nga e drejta e arsimimit dhe edukimit fetar në shkolla publike fillore dhe të mesme paraqitet si mangësi serioze e sistemit tonë shkollor.

Të përkujtoj se, ky lloj i arsimimit dhe i edukimit është duke u zbatuar në mënyrë sistematike në shumicën e shteteve të Bashkësisë Evropiane. Të nderuar deputetë, pamundësimi i arsimimit dhe edukimit fetar në shkollat publike fillore dhe të mesme të Kosovës hap rrugën për forma të deformuara të indoktrinimit dhe të manipulimit të rinjve me ideologji të huaja fetare, gjë që në mënyrë më të vendosur duhet parandaluar. Rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka integrimi i identitetit fetar dhe i identitetit kombëtar të nxënësve tonë që do të parandalojë çfarë do deformimi ideologjik të personaliteteve të tyre. Një aspekt i këtij problemi është edhe pengimi i disa nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës që të vijojnë shkollimin për shkak të veshjes që është në pajtim me dispozitat e besimit të tyre fetar.

Përkundër qëndrimeve zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës se kjo nuk guxon të ndodhë, sepse veshja e nxënësve nuk mund të kategorizohet si propagim i fesë në institucionet shkollore. Masat e këtilla në rrethanat kur vetëm 56% e vajzave shqiptare, dhe 40% e vajzave të komuniteteve të tjera etnike, vijojnë shkollimin e mesëm pas atij fillor, janë të papranueshme. Masë e rëndësishme që do të ndikonte në zhvillimin harmonik intelektual dhe psikologjik të nxënësve në shkollat tona është edhe punësimi urgjent i psikologëve të rinj në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës.

Unë kam njohuri se disa masa në këtë drejtim janë inicuar në vitin e kaluar, mirëpo është evidente se situata nuk ka ndryshuar në terren, së paku jo në nivel të sistemit arsimor. Fatmirësisht gjendja sa i përket shërbimit psikologjik në Kosovë është duke u përmirësuar nga dita në ditë pas fillimit të punës së departamentit të psikologjisë në Universitetin e Prishtinës para 4 viteve. Jam i bindur se punësimi i këtyre psikologëve të rinj natyrisht pas licencimit të tyre adekuat, do të ndikojë dukshëm në përmirësimin e rrjedhave psiko-sociale brenda shkollave tona. Konsideroj se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet që në mënyrë urgjente të iniciojë këtë çështje dhe për vitin 2008 të sigurohen mjete të nevojshme buxhetore.

Të nderuar deputetë, gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës për kundër përpjekjeve, e arritjeve evidente paraqitet si komplekse dhe me sfida të mëdha.

Në drejtim të përmirësimit dhe përparimit të proceseve në këtë lëmi me rëndësi strategjike për vendin tonë sugjeroj që si masa të domosdoshme afatshkurtra të bëhet rritja substanciale e pagave të punëtorëve të arsimit nga mjetet e pashpërndara të buxhetit. Të bëhet rritja e investimeve dhe kapitaleve në sektorin e arsimit,shfrytëzimi i tyre i plotë, të bëhet ndryshimi i programeve mësimore në pajtim me traditën kombëtare dhe kulturore të vendit përfshirë edhe zbatimin e lëndës së arsimimit dhe edukimit fetar, si dhe të vazhdohet me

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, për drekë deri në ora 2:00

(Pauza)

Mbledhja fillon pas pauze

KRYETARI KOLË BERISHA – Lus deputetët të hyjnë në sallë dhe të vijnë sa më parë të fillojmë me punë.

Vazhdojmë punën. Atëherë fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Zotëri kryetar i Kuvendit, ju faleminderit që më në fund mi lejuat 5 minutat e mi. Do të flas shkurt, e shpejtë, si pjesëmarrës, si dëshmitarë, dhe si përfaqësues i arsimit. Tema që është vu në rend dite sot mund të shikohet dyfarësh. Mund të shikohet si vështrim i problemit për një mandat pra, për një qeveri, dhe për një ministri, dhe mund të shtrohet si temë: Arsimit si strategji e zhvillimit nacional që shkon përtej një mandati. Unë mendoj që sot këtu është e dobishme të flasim për mandatin e një qeverie, por shumë ma e dobishme është të flasim për strategjinë e zhvillimit nacional të arsimit që nuk lidhet as me një ministër, as me një mandat, por lidhet me një shoqëri që pretendon të krijojë arsimin me përmasa e nevojave të veta strategjike .

Arsimi te ne vitet e fundit ka kaluar në dy gjendje, nga një gjendje mbijetesës ku shkolla ka qenë bashkë me arsimin si rezistencë në një shkallë të organizimit, ku arsimi duhet me marrë rolin e vet themelor përtej politikës si një veprimtari që është motori i zhvillimit të gjithë shoqërisë. Pra nga një mbijetesë të nevojë për një reformë. Reforma do kohë dhe do para, do mjete materiale. Pra reforma për kah natyra janë të shtrenjta dhe të vështira. Unë po them që në lëmin e arsimit janë edhe më të vështira përkundër deklarimeve, sepse kjo për kah natyra është lëmi ma konservative, jo vetëm te ne, por edhe në botën tjetër përtej nesh. Edhe ajo që këtu artikullohet si reformë te ne, unë mendoj që në disa pika i ka pikat e shkëlqimit të vet dhe këtu u tha nga dy pozicionet që u drejtuan këtu. Edhe nga opozita që paraqiti kërkesën edhe nga ministri, që ekzistojnë ato që quhen kurikule elementare dhe dokumente strategjike që s'i konteston askush. Kemi një mori ligjesh që s'mund t'i kontestojë askush, por është problem tjetër sa vepronjë ligjet dhe nëse ato praktika në arsim i ka deklaruar që në pikat të veçanta janë të kontestueshme atëherë ato mund të ndryshohen në këtë Kuvend.

Pra, unë dua të dal tek ajo themeloria, që puna e arsimit te ne nuk do të rregullohet as në klithjet e sojit që ne po i poshtërojmë me paga arsimtarët, sepse ajo është në kuptimin elementar demagogjike, sepse janë edhe shtresat tjera të shoqërisë që paguhen edhe më pak se kaq. Problemi i arsimit të shikohet strategjikisht, problemi i arsimit në Kosovë ashtu si dëshirojmë ne nuk mund të zgjidhet për pa u deklaruar prioritet i Kosovës, jo vetëm i një qeverie e i një mandati dhe unë mendoj që duhet të deklarohet prioritet i Kosovës në mënyrë që të krijojë të ardhurat, vullnetin, kualitetin dhe veprimin për të arritur nivelin që na duhet.

Unë këtu mund të deklaroj sot pa bërë llogaritje që puna e arsimit nuk është puna vetëm e pagave të arsimtarëve, nuk është puna vetëm e mjeteve mësimore, nuk është puna vetëm e hapësirave shkollore. Ma e rëndësishme shumë është strategjia e gjithë punës që i lidh gjitha këto. Në mënyrë parciale do të thosha që rogat e arsimtarëve janë të vogla dhe kjo Qeveri duhet të bëjë gjithçka që këto rroga të ngritën në fuqi që i ka kjo qeveri për të paguar, gjitha shifrat që epen me vullnet e dëshira nuk funksionojnë, pra unë e thërras qeverinë dhe

kërkojë që të jetë edhe një nga rekomandimet e kësaj mbledhjeje të Kuvendit, që të shikohen mundësitë që këto të ardhura të rriten. E dyta që të vazhdohen reformat, sepse reforma në kuptimin e shkollës shkollimit ka ndodhur, por reformat nënkuptojnë pra, edhe koncentrik të kualitetit në gjitha nivelet edhe ët punës, unë nuk dua të flas për arsimin universitar se disa e prekën, sot nuk e kemi temë këtë, po them edhe një herë në gjitha pikat që janë esenciale, arsimit do të shkojë para vetëm nëse do të deklarohen prioritetet i qeverisë dhe unë mendoj që...

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka nëse është në sallë deputetja Naxhije Doçi, le të përgatitet deputeti Ymer Halimi.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – I nderuari z. kryetarë, i nderuar z. ministër, të nderuar deputetë, e nderuara sindikatë e arsimit dhe gjithë ju tjerët në sallë.

Për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe për ligjin që e mbulon këtë sferë shumë të rëndësishme është debatuar më shumë se një herë nga institucionet përkatëse publike, ku janë bërë vlerësime të duhura dhe ku janë dhënë edhe vërejtje dobiprurëse, për mbarëvajtjen sa më të mirë të procesit edukativoarsimor në Kosovë. Janë bërë vlerësime edhe nga organizatat të tjera, e sidomos nga Sindikata e Arsimit përkatës, që preokupim të vetin kryesor ka të drejtat e punëtorëve të arsimit dhe gjendjen e arsimit në Kosovë. Debatet i sotëm do t'i fuqizojë dhe do t'i pasurojë edhe më shumë debatet të tjera për këtë qëllim dhe do të ndikojë pozitivisht në ndryshimin dhe plotësimin e mangësive, që ekzistojnë në arsim.

Përmes ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, që do të rishqyrtohet dhe që do të amandamentohet serish në këtë Kuvend, do të rregullohet më mirë, në aspektin ligjor mbarëvajtja e punëve në përmirësimin e gjendjes në arsimin në fjalë. Do të definohen më mirë të drejtat dhe kompetencat e secilit person juridik dhe fizikë në Kosovë, të cilët merren me organizimin e arsimit përkatës, ku secili do t'i di përgjegjësitë e veta.

Me informatën e MASHT-it " Gjendja në Arsimin Parauniversitar në Kosovë, trajtohen të arriturat në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, kryesisht vetëm në aspektin pozitive. Janë pasqyruar përparimet arsimore, që në fakt edhe janë bërë përparime në këtë aspekt. Janë përshkruar të arriturat në fushën e legjislacionit. Të arriturat në ndërtimin e shkollave të reja dhe të renovimit të shkollave të vjetra dhe të atyre të shkatërruara nga lufta e fundit në Kosovë. Është një informatë gjithëpërfshirëse dhe kjo është mirë, se në të shihet puna e MASHT-it për krijimin e kushteve për mësim cilësor në shkollat e Kosovës, duke i përfshirë edhe komunitetet, që me të dukshëm plotësohen standardet shumë të kërkuara në shoqërinë tonë.

Krahas kësaj, mendoj se në këtë informatë është dashur për të treguar edhe për vështirësitë e MASHT-it në këtë aspekt, se nuk ka qenë e mundur për t'u realizuar të gjitha detyrat dhe obligimet ndaj arsimit në Kosovë, ndër të tjera për shkak të mungesës financiare. Në mungesë të mjeteve financiare, që kanë krijuar ngecje në procesin arsimor në Kosovë, e që një gjë e tillë duhet të jetë shqetësim për tërë Kosovën, e jo vetëm për MASHT-in.

Si deputete e Prishtinës do të ndalem pak në paraqitjen e realitetit për gjendjen në shkollat e Prishtinës. Prishtina si qendër me e madhe e urbanizuar në Kosovë, me më se gjysmëmilioni banorë në të, të ardhur, sidomos pas luftës së fundit nga viset rurale përreth saj, por edhe nga e tërë Kosova, e më gjërë, ka nevojë të

madhe për objekte shkollore. Janë gjithsej 69 institucione shkollore në komunën e Prishtinës, nëntë prej të cilave të minoritetit serb, edhe pse ata kanë dilema për të bashkëpunuar me institucionet arsimore të Kosovës. Në komunën e Prishtinës më shumë

janë ndërtuar shkolla në pjesët rurale, më shumë me shumë me donacione, por shqetësimet janë, se atje nuk ka nxënës, për shkak të zhvendosjes së popullatës. Një dukuri e tillë është problem i madh dhe i dhëmbshëm, se banorët e fshatrave largohen nga vatrat e tyre për shkak të kushteve të vështira të jetesës, për shkak të mos zhvillimit të infrastrukturës.

Në qytetin e Prishtinës vetëm tri shkolla fillore janë ndërtuar pas luftës, njëra me mjetet e buxhetit të Kosovës, ndërsa për shkollate mesme nuk është ndërtuar asnjë objekt shkollor deri më tani. Nevojat për objekte shkollore të të gjitha niveleve janë të mëdha dhe planifikimet janë bërë të cilat presin momentin e duhur kur të krijohen mjetet.

Me gjithë mungesën e hapësirës shkollore në shkollat e Prishtinës, ku sipërfaqe mësimore për kokë të nxënësit ka 0.86 metra katror, ku suksesi në mësim është e një cilësie të lartë.

Kjo krijohet përmes mekanizmave, që jetësojnë rregullin dhe disiplinën në shkollë, duke e zbatuar ligjin. Dhe meritë të veçantë për këtë kanë edhe mësimdhënësit, të cilët si gjithëherë nëpër kohë punojnë me përkushtim për të iu ofruar dije cilësore dhe reformuese nxënësve të tyre. Puna dhe entuziazmi i të gjithë mësimdhënësve duhet vlerësuar dhe shpërblyer, se e meritojnë. Duhet shtuar krenaria e emrit dhe e punës së tyre dhe kjo mund të bëhet me krijimin e kushteve më të mira materiale për ta, me aktualizimin dhe me respektimin e kontratës kolektive dhe me nivelizimin e pagave.

Zbatueshmeria e reformave në shkollat e Prishtinës, që rumbullaksimim e vet do ta arrijë në fillimin e vitit të ri shkollor 2007-2008, me funksionalizimin edhe të klasës së pestë sipas reformës. Reforma e ka pasuruar dhe përfeksionuar metodologjinë e punës në arsim në Kosovë. Në Prishtinë është bërë trajnimi i personeli mësimor dhe vazhdon ende të trajnohet, që suksesshëm të ecet me trendet e kohës.

Për nxënësit e klasëve të nënta të pjesëve rurale, por edhe për të gjithë arsimtarët, që udhëtojnë është siguruar transporti falas.

Bëhet organizimi tradicional i garave të recitatorëve dhe i garave të diturisë, pothuaj se në të gjitha lëndët, të të trija niveleve dhe suksesi që arrihet është gëzim për nxënësit dhe për shkollat, se përmes tyre kurorizohen sukseset dhe dallohen veçantitë të nxënësit. Puna e pakursyer në hulumtimin e dukurive të këqija dhe të dhunës në shkolla, si edhe puna për luftimin dhe sfidimin e tyre është poashtu një e arritur. Ko arrijtshmëri bëhet më së shumti përmes mekanizmave drejtuese, që përkujdesen për shkollat, por edhe përmes ligjjeratave që mbajnë njerëzit e profesioneve të caktuara, si që janë psikologët, mjekët etj. Jetësimi i rritjes së cilësisë arsimore në shkollat e Prishtinës, por edhe Kosovës nxit domosdoshmërinë për praninë e mjekut dhe të psikologut në institucionet shkollore, sepse ndihmon në evitimin e dukurive jo të mira në mjediset shkollore, si janë pirja e duhanit, përdorimi i drogës, që është shqetësim i madh për prindërit dhe shoqërinë në përgjithësi. Ndikon në edukimin për ruajtjen e shëndetit, si edhe në evitimin e sëmundjeve ngjitëse të ndryshme. Në shkollat e Prishtinës është në realizim e sipër prania e psikologut dhe prania e mjekut.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! – Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, le të përgatitet deputeti Ramë Buja

DEPUTETI YMER HALIMI – Ju faleminderit, me qenë se e shkurtuat kohën s'ka përshëndetje më të gjatë.

Ata që punuan dhe sot punojnë me ditar në dorë janë pjesa më e përgjegjshme e kombit, por sot ata përballen me vështirësi financiare e nuk kanë kushte pune se Kuvendi dhe qeveritë i anashkaluan hallet e tyre.

Kombet e organizuara mirë kështu assesi nuk vepruan, prandaj të gjitha shtetet me një sistem shkollimi publik të fuqishëm kanë ngritje socio kulturore dhe ekonomike, sepse investojnë në te.

Deputetë të nderuar, vizitova drejtoritë e arsimit në Prishtinë, Kastriot, Vushtrri, Skenderaj dhe Drenas që sot flas me kompetencë. Në Vushtrri në shkollën fillore Ali Kelmendi ishin 2300 nxënës ku për 04 m² sipërfaqe ishte nxënësi. Mësimi zhvillohej me pesë ndërrime. Në Skenderaj ka paralele shkollë kontenier, Mur, Gleqinë, Kuqicë, Prekaz, Radishevë, kështu ngjashëm ishte edhe në Kastriot. Në shkollën fillore Qirez në klasën e parë pash 47 nxënës infrastrukturë të vjetërsuar, përballë shkollë gjendeshin 284 vare të të rënëve për liri, a e meriton ai brez rinor dhe ata njerëz një anashkalim të tillë ku po shihet se sa dhanë për shtetin e vet.

Është e dëmshme që reformat nuk u kuptuan drejtë, reformat u eksperimentuan me donacionet e shoqatave individët që vijnë nga jashtë. Reforma e arsimit është proces substancial, evolutiv e i kontrolluar dhe shumë i kushtueshëm për buxhetin e shtetit, dhe atë e udhëheqë shteti, MASHT-i krijojë administratë megalomane, jo funksionale, zhveshi drejtoritë e arsimit komunal nga përgjegjësitë, shkollat i zhveshi nga kontrolli pedagogjik dhe institucional, zgjedhja e drejtorëve u politizua, shkollat nuk kanë laboratorë, kabinete me mjete demonstrimi hapësirë pune e as qasje interneti.

Shqetësimin e vërejtën të gjithë në klasën e pestë në mësimin klasor, ka filluar strukturimi i vendeve të punës në proces mësimin, tekstet kaptinë e veçantë dhe shumë e dhimbshme, disa udhëzime administrative janë desh me ligjin, disiplina në shkollë është për tu dëshiruar, ministria shpenzon mjete shtesë me fajin e vet duke ripërsëritur ndërrimin e plan programe,

Nuk menaxhohet në mënyrën e duhur politike profilizimeve në shkollë të mesme, nxënësit nuk përgatit me dije për ekonominë e tregut për të sotmen dhe të ardhmen dhe as për universitet. Shikoni rezultatet e tekstit kombëtar, ky është alarm shqetësim për gjithë ne, po të ishim shtet me përgjegjësinë sociale, ministri do ta shkundte Ministrinë. Thuhet se nuk kishte apo nuk ka buxhet për të investuar në arsim.

Nuk kemi dije, se buxhet po. Analizoni shpenzimet e AKM-së 617 milion euro kompanive publike shpenzimet e qeverisjes për 6 vjet, vetëm 30% e këtyre mundësive që ceka të ishin destinuar në investime kapitale e paga në arsim gjendja do të ishte 100% e ndryshme, kjo ka qenë e mundur, kjo nuk mund të arrihet se mungon vizioni si kuptim thelbësor i politikës për shtetin, u lanë anash profesionistët e njohës të mirë, politikat e çdo niveli për hir të djemve dhe farefisit. Zgjedhja e këtillë e udhëheqësve ishte e papranueshme nga Platoni, Aristoteli, por edhe në demokracinë e sotme përëndimore. Por për ne vlen.

Deputetë të nderuar,

Gjendja do të ndërrojë kur ndërrohet krijuesi i gjendjes, kjo është teoria e Aristotelit mbi të cilën Luteri e ngriti protestantizmin. Ky është thelbi i ngritjes njerëzore, kjo ka për të ndodhur edhe te ne, besoj kjo është e qartë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! – Fjalën e ka deputeti Ramë Buja, le të përgatitet deputeti Ragip Zekolli

DEPUTETI RAMË BUJA – Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar z. kryetar dhe z. ministër. Unë nuk desha të harxhojë as pesë minutëshin që ishte paracaktuar por megjithatë jam i grishur nga shumë diskutues që të them edhe unë mendimin tim dhe qëndrimin tim rreth kësaj problematike që dikush nga kolegët e mi e tuajën e quajti njëherë nga ma serioze, njëherë nga më kryesoret e unë do të thosha s'ka asnjë ma kryesore, se s'ka asnjë më të rëndësishme, se që është arsimiti, sepse nuk thua arsim, kur thua vetëm mësues arsimtarë dhe profesor, por kur thua edhe inxhinier, edhe mjek, edhe astronom, edhe gjitha strukturat andaj unë mendoj që nga pak, mos ma merrni për fyerje e kemi krizë mendësie dhe qëndrimi ndaj problemit më boshtor, më esencial më të rëndësishëm të shoqërisë në gjithë botën, por shoqërisë kosovare në veçanti.

Unë mendova që sot nuk do të fërkohemi partiakisht, por do të debatojmë për këtë problem kaq madhor. Megjithatë nuk është e mundur, dhe kjo gjë nuk më pëlqeu por megjithatë nuk kam qare tash pa futur edhe unë në atë sfonde gjithësesi, u quajtur se gjëja problemi arsimor sot qenka shtruar për fushatë. Është krejt e palogjikë të mendosh se është fushatë për të biseduar për një armatë të tërë arsimtarësh, mësuesish, dhe profesorësh të cilët janë në gjendje që ata e dinë më së miri por edhe ne për afërsisht po. Na u quajtur fushatë neve të opozitës edhe atëherë kur e nxorëm problemin e madh të shpërdorimeve brenda Kuvendit. Na u quajtur fushatë edhe atëherë kur 236 mijë e 500 euro e makinës famoze nuk e dimë edhe sot ku janë, u quajti fushatë edhe atëherë kur insistuam për ta themeluar komisionin hetimor, nuk prishë punë, e kalojmë këtë gjë, por problemi esencial është që, po kështu një kolegë i imi e përmendi Irlandën, Irlanda është alfa ose e arsimit botëror dhe ne ishim për fatin e mirë tonin për të bartur përvojat por nuk dimë ku me i bartë.

Dhe aty nuk kishte shumë parulla të shkruara por një ishte gati e vetmja që e hasnim kudo që shkonim dhe ajo ishte zhvillimi ynë mbështetet në dije, zhvillimi ynë mbështetet në dije, as nuk mund t'i shtosh as nuk mund t'i heqësh asgjë. A thua qëndrimi dhe mendësia jonë mendojnë dhe sillen rreth kësaj apo për afërsisht rreth një bordi të tillë që zhvillimi ynë të mbështetet në dije. Nuk është ashtu fatkeqësisht nuk është ashtu.

Dhe u tha, përveç tjerash, se jo ë gjitha familjet kosovare përballojnë shkollimin e fëmijëve të tyre-, shumë e qëlluar, edhe shumë e vërtetë, por ata të cilët nuk kanë mundësi vërtetë ta përballojnë arsimin e fëmijëve të tyre kryesisht janë punëtorët e arsimit të cilët ishin dikur ata që mbajtën gjallë, edhe mendësinë racionale njerëzore por edhe mendësinë kombëtare tonën për një kohë shumë të gjatë dhe ne sot dimë ta mos e çmojmë për aq sa duhet. Unë nuk dua të merrem me shifra se nuk jam i shifrave hiq, për ato është ithtarë dhe shumë përmendës i tyre Gani Koci dhe e falënderoj shumë dhe debati i djeshëm fliste shumë për ato shifrat të cilat ne do të duhej menduar shumë për ato shpenzimet tepër iracionale që ndodhin por megjithatë unë do të shkojë diçka tjetër.

U tha po kështu se arsimiti nuk është shpenzim, por është investim në të ardhmen shumë e qëlluar edhe kjo, por a thua çfarë po bëhet për investime në të ardhmen, a thua është menduar ndonjë herë vërtet në mënyra të arsyeshme dhe shumë racionale dhe kur është debatuar për buxhetin e përgjithshëm të Kosovës që të thuhet dhe të insistohet se ky buxhet për arsimin të jetë më ndryshe, është e pa mundur kolegë të nderuar të mendojmë dhe të profetizojmë dhe të moralizojmë dhe të themi se ne duam Kosovën e nesërme të ndërtuar

mirë, të ndërtuar ligjshmërisht, të ndërtuar si shtet të konsoliduar pa njerëz të konsoliduar mirë në aspektin profesional.

Dhe nëse dikush e përmendi dhe falënderoj po dua ta ripërmend, nëse ne nuk e bëjmë prioritet numër një, absolutisht numër një arsimin ne nuk kemi bërë asgjë, ne mund të ndërtojmë fabrika çfarë çdollojshme por nuk kemi bërë asgjë. Andaj po ju them që dikush e përmendi edhe një taksi, një taksistë që qenka arsimtarë dhe bënë punën e taksistit, ishin ndie mirë shumë arsimtarët po të kishin pas para për ta blerë një makinë për të bërë punën e taksistit pas orarit, por nuk kanë as atë mundësi, andaj do të duhej që ne të mendojmë seriozisht që kjo gjendje të ndërrojë, nuk e them vetëm për ata që aktualisht janë në Qeveri.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli, le të përgatitet deputeti Kamber Kamberi.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI- Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar ministër, të nderuar kolegë.

Para se të filloj dua të sqarojë dy gjëra që u thanë nga kolegët tonë këtu. Një çështje nga deputeti Numan Baliq dhe doli se nxënësit boshnjakë nuk kanë fare tekste shkollore por ato vetëm këtë vit kanë filluar të dalin, dhe ajo hiq nuk është e vërtetë për arsye se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2000 ka bërë një marrëveshje me Bosnjën dhe të paktën edhe tekstet e historisë vetëm teksti Kosovës është shkruar këtu dhe janë dërguar dhe botuar në Bosnje.

I njëjti kriter vlen edhe për minoritetin turk, dhe çështja tjetër që u shtrua nga një kolegë i yni ishte se fëmijët tonë pikërisht shkojnë në shkollë qoftë edhe pa kontrollin e vetëm se në çfarë faze ndodhen ata në klasën e parë kur hyjnë. Unë po e them edhe për hir të opinionit, por edhe për hir të realitetit se në 7 qendra rajonale të Kosovës janë formuar grupe ekspertësh ku përfshihet edhe pedagogu, edhe psikologu, edhe logopedi dhe në një formë bëhet kategorizimi i këtyre fëmijëve kur dërgohen në ato paralele dhe në shkollat speciale. Duke parë kohën e kufizuar nuk do të merrem shumë me çështjet por do të shtrojë vetëm objektivat ndoshta apo me një formë si mund ta kalojmë situatën me një kusht që vërtetë në fund të këtij takimi mos të mbetet pa dalë me rekomandimet tona.

Cila do të ishte e para, vërtet një prioritet arsimit që u tha nga shumica është propozuar dhe në kohën e buxhetit kur ka qenë kjo çështje po ajo mund të arrihet sidomos për infrastrukturën kur ne vendosim një taksë të veçantë edhe për naftën edhe për kozmetikën, për duhanin, lojërat e fatit e kështu me radhë.

Çështja e dytë, kisha dashur që vërtet të mos i mashtrojmë mësimdhënësit shumë kur u themi do t'jua rritim pagat, qoftë si u tha këtu, kur u që u përmend 100%, apo përqindje të ndryshme, por për mua është brengosëse diçka, dhe ajo është që 4 qeveri në Kosovë pas luftës nuk bënë nivelizimin e pagave, mendoj që kjo është ma e dhimbshmeja dhe ajo e cila me një formë duhet parë edhe studiuar. Çështja e tretë është pikërisht delegimi i kompetencave në organet komunale, çështjet që u përmendën shumë këtu nga disa kolegë tonë vërtetë janë të ngarkuara se janë kompetencë e ministrisë sepse ministria qeverisë edhe me objektet shkollore sepse, kërkojë falje komuna qoftë gjithashtu me numrin e mësimdhënësve dhe çështjet e tjera, një çështje tjetër e cila vërtet na doli vitin e fundit dhe mendoj se duhet të bëhet deri në shtator është organizimi i ri i rrjetit shkollor.

Provimi i maturës, me gjithë vështirësitë që kishte, vuri në pah dy gjëra:, e para se vërtet fëmijët tanë duhet të ketë në nivel të dijes të matet dija e tyre në harmoni me vendet e rajonit dhe ato evropiane dhe me keqardhje, të nderuar kolegë ,unë mund t'ju them që ne kemi shkolla ku shifra e parë është zero.

Cilat janë ato? Janë kryesisht paralele të ndara të cilat i kemi trashëguar që nga lufta e këto janë tipet e gjimnazit që ndodhen edhe nëpër fshatra, andaj mendojmë që është formuar një rrjet, një komision, i cili do të shikojë këtë rrjet do të propozojë dhe gjithsesi duhet bërë. Dhe çështja e fundit e cila u paraqit nga shumë kolegë tanë është çështje edhe një herë e rishikimit të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm. Vërtet mendojmë se ka ardhur koha dhe duhet ndryshuar dhe se një pjesë e rregullatives në fuqi duhet të jetë në nivel me kohën dhe me trend,t në të cilat punojmë. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Kamber Kamberi, le të përgatitet deputeti Nexhat Rexha

DEPUTETI KAMBER KAMBERI – Ju faleminderit z. kryetar, unë do të përpiqem që të mos i përsëris gjërat, sepse ato më neuralgjiket dhe më qenësoret ku theksohet nga profesor Hamiti profesor Ali Musa, profesore Sala Ahmeti dhe ndonjë tjetër prej deputetëve profesor Halimi dhe ndonjërit tjetër prej deputetëve. Problemi i arsimit kujtoj se nuk është problem vetëm i Ministrisë së Arsimit siç po aludohet por është problem i të gjithë neve i gjithë shoqërisë Kosovare.

E thashë se unë do të përqendrohem te ligji mbi arsimit fillor dhe të mesëm. Në agjendën e ligjeve që do të rishqyrtohen do të plotësohen është edhe ligji i arsimit dhe u tha edhe nga kolegu i mëparshëm se kjo është një domosdoshmëri e kamotshme, dihet se ligji është miratuar në vitin 2002 që ka krijuar konfuzitet edhe shpeshherë edhe mospushtes në arsimin tonë kosovarë. Ky ligj duhet të rishqyrtohet të plotësohet, gjithashtu udhëzimet, rregulloret normativat duhet të rishqyrtohen, duhet të kristalizohen dhe të qartësohen të mos krijohen konfuzitet dhe të mos bien ndesh njëra me tjetrën.

E kam fjalën p.sh. te zgjedhja e drejtorëve dhe nëpër shkolla. Ligji në fuqi i mundëson një drejtorin ndoshta të jetë drejtor i përhershëm në një shkollë. Në këtë rast janë të diskredituar konkurrentët e tjerë ose rival të tjerë që mund t'i bëjnë konkurrencë drejtorit. Unë kujtoj që duhet të përcaktohet që drejtori duhet të ketë dy mandate ta zëmë dhe ta lirojë vendin. Gjithashtu të përcaktohet edhe mosha, sepse ka ndodhur që një drejtor në moshën 64 vjeçare të zgjidhet drejtor, ai edhe një vit pensionohet.

Gjithashtu, është e domosdoshme që të rritet efikasiteti nëpër shkolla që një shkollë p.sh. që ka më se 500 nxënës të ketë edhe zëvendës drejtorin, një shkollë punon me ndërresa me 990, nxënës në dy a tri ndërrime dhe të mos ketë zëvendësdrejtor. Nuk ka efikasitetin në punë. Gjithsesi këto sidomos shkollat ku numri i nxënësve kalohet mbi 500, duhet të kenë gjithsesi psikolog ose pedagog. Do të theksoj se edhe te teksti kombëtar i klasave të nënta, unë kujtoj që ky test duhet të rishqyrtohet të rritet të gjendet ndonjë formë tjetër, si në shkollat e perëndimit që nxënësit të orientohen qysh në klasat e gjashta të shkollës fillore, sepse shpesh herë ky tekst di të mos jetë real dhe nxënësit e dobët të mbërrijnë kushtin të regjistruhen në shkolla të mesme ku të donë, ndërsa nxënësit e shkëlqyeshëm që nuk kanë treguar sukses, mund të jetë e një momenti emocional dhe të mos tregojë sukses të mbetet pa u përfshirë në shkollat e mesme. Unë nuk do të zgjatem më shumë, por kisha bërë thirrje që Ligji mbi arsimin të vije në Parlament sa më shpejt që është e mundur dhe ky ligj duhet të rregullonte sa do ku do gjendjen e arsimit dhe efikasitetin e punës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nexhat Rexha le të përgatitet deputetja Qibrje Hoxha.

DEPUTETI NEXHAT REXHA – I nderuari z. kryetarë, ministër dhe të nderuar kolegë deputetë.

Gjendja në arsimin para universitar në Kosovë informatë e përgatitur nga Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji. Është dokument i rëndësishëm që pasqyron punën e ministrisë përkatëse dhe një herrit në të paraqiten të dhënat telegrafike mbi zhvillimin dhe rrjedhën e arsimit para universitar në Kosovë.

Duke lexuar dhe analizuar punimin e përgatitur në këtë informatë të shkurtër por të rëndësishme konsideroj se për njohësin e mirë të problemeve arsimore në Kosovë janë pasqyruar anët pozitive si dhe janë prekur sipërfaqësisht anët negative të rrjedhës së arsimit në përgjithësi në Kosovë.

Të gjithë e kuptojmë se arsimi është hallka më e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme për një shoqëri. Mirëpo, kjo hallkë duhet ndërlidhur me vullnet dhe mjete ndihmëse nga i tërë spektri politik si ai vendor, dhe ndërkombëtar edhe me mjete shtesë financiare që do ta përshpejtonin procesin e reformave më të avancuara në Kosovë. Arsimi do një përkrahje më të madhe financiare dhe jo vetëm morale, sepse arsimi në Kosovës e ka dëshmuar anën morale të tij me vite të tëra. Pra, arsimi në Kosovë e ka tejkaluar fazën emergjente, tani kërkohet të realizohet reforma në praktikë e cila është duke dhënë rezultate pozitive, mirëpo, nëse dëshirojmë të ndërtojmë një shoqëri më të avancuar atëherë kërkohet edhe angazhim shumëdimensional. Në këtë dokument të përgatitur nga MASHT-i mungojnë shënimet në sa shkolla fillore dhe të mesme mësimi mbahet në tri ndërrime. Me qëllim që sa më shpejt të evitohet kjo dobësi që nuk duhet të tolerohet, sepse puna në tri ndërrime bëhet me shumë zbrazësi.

Propozoj që për të ardhmen të ketë fond të veçantë për furnizimin me libra për bibliotekat e gjitha shkollave të plota fillore dhe të mesme, për këto 7 vite bibliotekat e shkollave nuk janë furnizuar aspak apo janë furnizuar keq, sepse mos furnizimi me literaturë të re e dënon të ardhmen e shkollarëve tanë. Gjendja e tanishme në këto institucione me mjete të domosdoshme është siç është më së keqi, e për këtë nuk është fajtor Ministria e Arsimit por mënyra e shpërndarjes së buxhetit nëpër shkollat tona, do të ishte mirë që për të ardhmen të ketë fonde të posaçme për aktivitete të ndryshme të shkollave si për aktivitete të lira e të tjera.

Unë po e ilustroj shembullin pozitiv të RTK-së për kuizin e diturisë e cila është titulluar, 1,2,3, fillo për shkollat fillore, por në disa raste mungojnë edhe mjetet e transportit për nxënësit e këtyre shkollave. Në këtë periudhë tranzitore për Kosovën janë zhvilluar edhe procese pozitive. Në këtë informatë nuk janë përmendur fare sukseset e kësaj gjenerate që po shkollohen në Evropë, çka është me rëndësi, të duket vija institucionale.

Çështja e arsimit, mos integrimi i tij i plotë për minoritetin serb në arsimin e Kosovës është penguar dhe pengohet nga politika e Serbisë. Është koha e fundit që institucionet e Kosovës problemin e arsimit ta shikojnë me një optikë më me ngulm dhe fokusimi ynë të jetë në një pikë. Avancimi i arsimit mund të bëhet me rritjen e buxhetit për këtë fushë.

Reforma e arsimit në Kosovë është avancuar edhe me nxjerrjen e ligjeve dhe këto ligje kanë ndikuar pozitivisht në zhdukjen e disa dukurive në institucionet arsimore në Kosovë. Marrë në tërësi, materiali që kemi në dorë është pasqyrim i mirë i një pune të bërë, por që kërkon angazhim dhe punë dhe rezultate për të ardhme. Ato mund të arrihen vetëm nëse ndryshohet për të mirë pozita materiale e arsimtarëve dhe ndryshohet rregullohet infrastruktura e tyre. Pra, arsimi në Kosovë me të gjitha dobësitë që po e përcjellin e ka shkallën evropiane, por që kërkon mbështetje më të madhe nga të gjithë ne. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Qibrije Hoxha le të përgatitet deputeti Fetah Berisha

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA – Ju faleminderit z. kryetar. E përshëndes këtë inicim të debatit për shkak se arsimit para universitar është segment i rëndësishëm që paraqet shtyllë shumë të rëndësishme të një shteti demokratik. Mirëpo t’ju them të drejtën unë kam prituri nga opozita e cila e ka shtruar këtë çështje se do të ketë propozime ose do të dalim me propozimet konkrete se si me ndihmuar Kosovën ose si me ndihmuar arsimin para universitar në Kosovë tu marrë parasysh gjendjen e arsimit.

Përveç konstatimeve që dolën dhe vetëm një vlerësim të zonjës Sala Ahmetaj e cila doli me dy propozime konkrete deri më tash kërkosh prej opozitës nuk doli me propozime konkrete përveç se me konstatime edhe akuza ndaj pozitës që nuk është obligim i opozitës në tërësi, edhe natyrisht se mandej merret edhe fushatë tjetër e tj.

Unë tash desha të ndalem edhe në sugjerimin rreth këtij informacioni. Mendoj se këto pikat domethënë objektivat dhe të arriturat e deritashme është dashur të zbërthehen pikërisht ashtu si i zbërthej ministri me gojë. Më duket se është një variant shumë i shkurtër edhe mendoj se janë bërë disa lëshime teknike, them janë lëshime teknike sepse e di dhe referoi edhe ministri se ka punuar në këtë drejtim dhe këtu nuk janë përfshirë si është fjala bashkëpunimi i MASHT-it me sindikatat e arsimit që domethënë nuk është përmendur dhe në objektiva gjithashtu është bërë lëshimi i bashkëpunimit të MASHT-it me lidhjen e arsimtarëve shqiptarë në diasporë nuk duhet me harruar këtë bashkëpunim sepse janë hartuar programet për mësimin plotësues në diasporë dhe kjo vetë tregon se veç ky bashkëpunim ekziston. Natyrisht këto bashkëpunime duhet të thellohen por kurrsesi nuk duhet të harrohen të përmenden. Kjo ishte nga ana ime, ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

DEPUTETI FETAH BERISHA – I nderuari z. kryetar, z. ministër dhe kolegë deputetë. Kjo temë madhore për të cilën po debatojmë sot, për gjendjen e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, është temë mjaft me rëndësi, kjo është shtruar edhe në informatën e MASHT-it që e kemi përpara e cila është mjaft e thuktë dhe e argumentuar, sepse kur flitet për këto nivele të dijeve duhet të flitet me përgjegjësi edukative dhe pedagogjike, sepse bëhet fjalë për mësimdhënie dhe edukim të brezit të ri. Ta edukosh brezin e ri të Kosovës do të thotë ta edukosh dhe ta arsimosh të ardhmen e Kosovës, sepse edhe shtetet e zhvilluara në demokraci nuk e vënë rastësisht arsimin dhe nuk e radhitin krahas shëndetësisë, drejtësisë, policisë, bile edhe ushtrisë, ngase të gjitha i kanë rrënjët në arsim.

Te sjellim në mendje vetëm dy gjëra, të sjellim në mendje diskriminimin e arsimit shqip gjatë pushtetit totalitar serb, të sjellim në mendje bërthamat e përbashkëta të plan programeve mësimore të regjimit jugosllav me të cilat dirigjoheshin se cilët shkrimtarë nuk duhet mësuar në shkollat tona siç ishte Gjergj Fishta, Faik Konica e të tjera. Pastaj pasoi edhe helmimi i nxënësve dëbimi nga lokalet shkollore etë tjera, pra nuk ka vend për alarm sot për arsimin e sotëm.

Bazuar në informatën e MASHT-it krahasuar me të kaluarën e arsimit tanë vërehej një konsolidim i sistemit arsimor në Kosovë i cili premtim synim të arritshëm dhe objektiva standarde. Është për çdo lëndatë plotësimi standardeve për lëmin e arsimit, finalizimi afatmesëm 2007-2017, themelimi i institutit pedagogjik, përpilimi i plan programeve dhe

teksteve shkollore, pastaj është për t'u lavdëruar edhe testi i maturës, testi kombëtar etj., por për çdo lëndatë

është edhe plan programi për minoritetet për të cilat vërtetohet se shqiptarët shumicë në Kosovë nuk lejojnë të diskriminohen të tjerët nga shqiptarët e Kosovës. Me rëndësi dhe për t'u lavdëruar është edhe plan programi dhe bashkëpunimi i Ministrisë me diasporën, se MASHT-i gjithashtu duhet të jetë me diasporën edhe më i kujdesshëm, atje bëhet fjalë për integrimin i cili nënkupton asimilimin me mësimin në gjuhën jo amtare. Arsimiti i nxënësve tanë edhe në gjuhën amtare nuk do të thotë mosrespektiminndihmës që na dhanë vendet në kohërat më të vështira, kështu ne përmbushim deri diku obligimin tonë ndaj diasporës, sepse diaspora ishte ajo që na jepte ndihmë në ditët shumë të vështira.

Është për t'u lavdëruar mekanizmi i kontrollit dhe i vlerësimit dhe verifikimit të diplomave. Gjithashtu mund të cekim se gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm në komunën e Rahovecit është mjaft e mirë, atje deri tash janë ndërtuar 12 objekte shkollore dhe në to objekte shkollore ndjekin mësimet rreth 15 mijë nxënës. Këtu e shfrytëzoj rastin për ta falënderuar në emër të qytetarëve të Ratkovcit Ministrinë e Arsimit e cila ka ndihmuar financiarisht ndërtimin e shkollës së mesme atje ku sot nxënësit mësojnë. Këtu në shkollat e Rahovecit është i plotësuar edhe kuadri mirë, këtu është i plotësuar edhe mësimi mjaft cilësor.

Këtu është tejkaluar tani një praktikë e keqe dhe shterpe e asaj qeverie të përkohshme dikur ku emëronte apo caktonte drejtorët pa kriterin e institucionit të konkursit. Këtë dobësi tani po e vuan komuna e Malishevës.

Ti kthehem tani sërish arsimtarëve. Mësimdhënësit shqiptarë të Kosovës ishin ata që mbijetuan arsimin në ditët më të vështira. Dhe unë mund të them lirisht dhe nëse ka dëshmorë të gjallë të tillë janë mësimdhënësit tonë të asaj kohe të cilët edhe sot arsimojnë dhe edukojnë brezin e ri të Kosovës. Prandaj, z. ministër, ministra financiar e të gjithë të tjerët është koha e fundit të marrim diçka për ngritjen e pagave të mësimdhënësve tonë sepse këta e meritojnë. Të thuhet sot se në arsim është gjendja alarmante nuk qëndron për arsye se nuk e njohim rrugëtimin e mirë të arsimit tonë shqip. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Dëshmorë të gjallë nuk ka, ka heronj, megjithatë vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – I nderuar kryetar, të nderuar deputetë. Tema që po e diskutojmë sot, besoj që është ndër temat më me rëndësi dhe me interesim që përcjellët në Kosovë, dhe besoj që qëllimi i këtij debati nuk është që të përcaktohet se kush po e thotë se arsimi në Kosovë është i suksesshëm dhe kush po thotë ma pak. Ajo çka na bashkon besoj është dëshira e gjithë neve që të kemi një arsim cilësor në Kosovë dhe ajo çka na dallon besoj në momente të caktuara është. Përkushtimi për arsimin, dija për arsimin dhe aftësia për të bërë ndryshime dhe në veçanti edhe përgjegjësia. Mua pak sa më befasuan disa thënie që Ministria e Arsimit nuk është përgjegjëse, është e vërtetë se është arsimi i mirë apo i keq të gjithë ne i kemi pasojat qoftë pozitive ose negative. Por unë prita nga ministri i arsimit që të del dhe të reagon dhe thotë se: Unë jam njeriu përgjegjës për arsimin në Kosovë. Kjo kudo në botë besoj edhe te ne në Kosovë.

E kam marrë një projekt do ta quaj ose një raport nga ministria e arsimit dhe mund të them se edhe pse e ka titullin për arsimin para universitar aty kemi informata për seminarët për gjuhë dhe letërsi shqipe për universitete verore, dimërore dhe kështu me radhë.

Kisha pas dëshirë që herëve tjera që kur na vjen dokumentacioni të jetë i theksuar dhe jo për mbledhjen e raporteve të disa dikastereve që ka Ministria e Arsimit. Çka duhet të theksoj që është me rëndësi, fillimisht duhet të themi se qasja ndaj arsimit në Kosovë duhet të ndryshojë. Ne i kemi dy ekstreme për arsimin. Ekstremi i parë që edhe unë jam në mesin e atyre, ne arsimtarëve mësimdhënësit i shohim si misionarë. Dhe ekstremi i dytë është ata të cilët mësimdhënësit dhe arsimtarët i shohin si shërbyes civilë. Ata të cilët mendojnë se arsimit në Kosovë dhe arsimtarët janë misionarë kanë pasur dhe kanë të drejtë deri në vitin 1999, pas vitit 1999 mendoj se duhet të koncentrohemi më shumë në punën e mësimdhënësit në cilësi në arsim sesa në punën e tij në mbrojtjen e interesit kombëtar. Ndërsa, ata të cilët mendojnë se mësimdhënësi është shërbyes civil dhe nëse e ke zgjedhur një drejtor të mirë si në kooperativë bujqësore ka me shkuar puna mirë, nuk mendoj që kanë qasje reale. Pra duhet tentojmë ta vëmë diku vendin e arsimit në shoqërinë tonë. Në mes asaj që quhet misionar ose janë quajtur për një kohë të gjatë dhe asaj që dikush mund t'i trajtojë si shërbyes civilë e në raste të caktuara ndoshta edhe si raste sociale.

Një problem për mua i veçantë, shkollat fillore dhe sidomos të mesme përveç kushteve tjera është ambienti ku mësohet. Për mua është e papranueshme, besoj edhe për ministrin edhe gjithë të tjerët që në ambientet afër shkollave të ketë kafiteri, ku përdoret alkooli, lojërat e ndryshme të fatit apo në rastet e caktuara edhe droga.

Mendoj që ambienti në arsim duhet të jetë një prej prioriteteve tona, sidomos për arsimin e mesëm. U përmendën kushtet dhe unë pajtohem për kushtet për mësim duke përfshirë edhe pagat edhe pse për mua paga nuk është i vetmi kusht për arsim cilësor, për mua paga është një ndër kushtet, ndërsa laboratorët pajisjet tjera teknike teknologjike janë mjete shtesë apo e garantojnë suksesin. Ne mund t'i bëjmë pagat më të mira në botë për mua që janë mësimdhënës, por nëse nuk pajisen me dije tjetër, me pajisje tjera, unë nuk do ta jap cilësinë që duhet, pra mos ta shoh njeriun e arsimit si njeri që përmes pagës e zgjidh çdo gjë. Unë e kam vërejtur një punë dhe po e them me pa modesti. Unë jam me prejardhur nga fshati, arsimit fillor dhe i mesëm në Kosovë bënë dallime dhe po e them konkurrencën në Kosovë. Nëse ne kemi shkolla fillore dhe të mesme në disa qytete dhe fshatra të Kosovës që nuk ka internet që nuk ka mësim adekuat të gjuhës angleze, nuk ka profesor adekuat të matematikës dhe fizikës, çka nënkupton të gjithë ata nuk janë konkurrentë për nivelin qendror në Kosovë, dhe me këtë po ballafaqohemi ne.

Nxënësi më i dobët po e them kushtimisht në shkollën e mesme të Prishtinës, ose në shkollën fillore të Prishtinës, fiton para atij që mund të quhet i mirë në një shkollë tjetër, jo për fajin e nxënësve por për fajin që nuk janë në kushte adekuate ose minimum konkurrenca nuk është e barabartë.

Në këtë drejtim mendoj se duhet ta kemi një barazi do ta quaja në mes të asaj që nëse flasim për një sistem arsimor, nëse flasim për një vend, nëse flasim për një ministri, kushtet në të cilat mësohet, jepet mësimi, duhet të jenë të përafërta ose së paku të ngjashme. U përmend edhe raporti, do ta quaja depolitizimi i shkollave hapësirave shkollore, pajtohem me konstatimet. Unë po e them një hapësira shkollore është problem kryesor por po e them edhe tjetrën, mos tentojmë që të investojmë në shkolla ku duhet të mendohet vetëm politikisht a fitojmë vota prej tyre apo jo. Dua ta marrë shembullin ku e kam kryer shkollën fillore. Profesori Niman e dinë shumë mirë, për interesim për drejtorin e shkollës ka pas nivel më të lartë ministrisë së arsimit të Kosovës, për interesim që në atë shkollë mësojnë nxënësit nga tri katër kilometra nuk interesohet askush. Dua të them le të interesohen për drejtorë por le të

interesohen edhe për kushtet e tjerë. Unë nuk kam fatin që ta falënderoj si zotëriu që tha.....

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hilmi Ahmeti, le të përgatitet deputetja Hatixhe Hoxha

DEPUTETI HILMI AHMETI – I nderuari kryetar, i nderuar ministër të nderuar deputetë. Edhe për kundër përpjekjeve të vazhdueshme të Ministrisë së Arsimit të shkencës dhe të Teknologjisë për përmirësimin e gjendjes në arsimin fillor dhe të mesëm ende ka ngecje. Përmirësimi i kësaj gjendje nuk mund të jetë as i lehtë as i shpejtë. Raporti i ministrit është i mirëseardhur dhe gjithëpërfshirës besoj se nga ky debat do të dalin përfundime që do ta ndihmojnë MASHTI-n për masa shtesë në drejtim të avancimit të arsimit në këto nivele.

Pjesë e sistemit të arsimit në një formë jemi të gjithë, qoftë si deputetë si mësimdhënës si prind dhe në këtë drejtim duhet angazhim dhe bashkëpunim i gjithëve jo vetëm i Ministrisë së Arsimit. Sa më shumë përkushtim ndaj arsimit aq më e madhe do të jetë perspektiva e fëmijëve tanë, e rinisë kosovare dhe e Kosovës në përgjithësi.

Nisur nga gjendja e tanishme e arsimit në këto nivele pra në atë fillor dhe të mesëm ende mbetet shumë për t'u bërë. Sidomos në arsimin e mesëm të lartë. MASHT me mjetet e Qeverisë së Kosovës dhe me ndihmën e shumë donatorëve ka bërë në drejtim të sigurimit të hapësirës fizike për mbajtje të mësimet. Kjo është theksuar edhe në raport, por ka ende për t'u bërë në këtë drejtim. Arsimit ende i mungon hapësira fizike, i mungon laboratorit, punëtorit për pjesën praktike të mësimet, kabinetit, kompjuterit

Mungesë e hapësirës nëpër shumë shkolla ndihet edhe për bibliotekat shkollore dhe kjo në të gjitha nivelet. Mirë që reformat në arsim kanë filluar. Jemi të vetëdijshëm se ato nuk përfundojnë, mendoj se duhen masa shtesë për të dhënë një shtytje më të madhe, janë trajnuar po thuaj se gjithë personeli mësimdhënës, efektet pozitive ende nuk janë të kënaqshme. Në një numër jo të vogël të shkollave të mesme profesionale nuk mund të zbatohen reformat si pasojë e mungesës së teksteve për lëndë profesionale dhe në mungesë të praktikës profesionale si rezultat i kësaj. Këtyre shkollave kryesisht ua mësyjnë nxënësit me sukses jo të mirë nga shkollat fillore.

Ata marrin një certifikatë apo diplomë pas mbarimit të shkollës, por nuk janë të përgatitur për tregun e sotëm të punës. Në shkollimin e mesëm, të lartë, duhet një angazhim më i madh në parandalimin e dukurive devijuese të një numri nxënësish të cilët pengojnë mësimet. Masat disiplinore ndaj tyre mendoj se duhet të jenë më të rrepta. Është fjala për nxënës të shkollave të mesme.

Neni 31 pika 5 i Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm zgjat procedurat për masat disiplinore ndaj këtyre nxënësve. Sipas këtij neni të ligjit parashihet që kuvendet komunale të marrin masën e fundit disiplinore ndaj nxënësve të larguar nga shkolla dhe kryesisht kuvendet komunale ndoshta edhe për shkak të mungesës së fondeve për të organizuar shkollimin alternativ për këta nxënës siç parashihet me ligj, vendosin që t'i kthejnë prapë në shkollë, me ç'rast po shkaktohen vështirësi në mbajtjen e mësimet.

Pavarësisht prej reformave të nisura sistemi i arsimit ende nuk është orientuar drejt rezultateve. Në mungesë të rezultateve të pritura po ndikojnë plan programet që në shumë raste nuk janë në përputhje me nevojat e kohës. Për mbështetjen e ndryshimeve pozitive në arsimin fillor dhe të mesëm duhet dhënë përparësi hartimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit dhe të rritjes së fondeve dhe si efekt të këtyre politikave do të kemi një zhvillim më të shpejtë ekonomik të vendit. Për një arsimim më cilësor, në të gjitha nivelet duhet një

stimulim më i mirë financiar i mësimdhënësve në mënyrë që ata të motivohen për punë më cilësore. Profilizimi i shkollimit më shumë t'i përshtatet tregut të punës, më shumë kujdes mekanizmit të mbikëqyrjes së procesit arsimor e sidomos procesit të vlerësimit.

Ministria e Arsimit më së shumti ka plotësuar legjislacionin me udhëzime administrative dhe akte të tjera nënligjore dhe ato vetëm duhen zbatuar. Për fund, kam bindjen që Qeveria e Kosovës bazuar në realitetin kosovar të përcakton një politikë financiare që do të mbështetë në mënyrë më të efektshme zhvillimin e arsimit në të ardhmen. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputetja Hatixhe Hoxha le të përgatitet deputeti Zef Morina.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. kryetar, më vjen mirë që ma në fund pas një periudhe të gjatë të pritjes ka hyrë në rend dite çështja e debatit për arsimit fillor dhe atë të mesëm.

Ne sot para vetes kemi informatën që na ka ofruar Ministria mbi gjendjen e arsimit para universitar. Unë do të ndalem në disa pika të kësaj informate ku thuhet se citojë:

Gjendja në arsim nga viti në vit po shënon trende pozitive të zhvillimit në të gjitha drejtimet. Duke pasur parasysh gjendjen faktike në këtë sferë nuk mund të pajtohem me këtë formulim.

Thoni se në lëmin e infrastrukturës ligjore është mbuluar çdo veprimtari. Është e vërtetë se janë miratuar disa ligje në fushën e arsimit. Mirëpo shtrohet pyetja sa, dhe si, po arrijnë ata të zbatohen në praktikë. Duket se disa nga këto ligjet duhet të rikthehen për t'u amendamentuar me qëllim të zbatimit më të lehtë.

Thuhet se ministria ka nxjerrë mbi 100 udhëzime administrative, mendoj se është e rëndësishme nxjerrja e udhëzimeve administrative por është shumë e nevojshme që ato të përmbushin nevojat e kërkesat që parashtrohen para tyre. Kërkesë e personelit mësimor është që ato të jenë sa më të qarta dhe të specifikuar.

Në pikën që i referohet ngritjes së infrastrukturës objekteve arsimore ju thoni se atje është gjendja e mirë. Ju jepni të dhëna se sa shkolla janë ndërtuar apo meremetuar, pa u ndalur fare te fakti se a po ndërtohen ato objekte në kohën e paraparë dhe a po i plotësojnë kushtet e parapara për mësim. Këto pyetje i shtroj për dy arsye.

Sipas informacioneve që kemi shihet se përkundër planeve dhe premtimeve ka raste kur këto projekte nuk realizohen edhe me vite. Rasti në shkollën fillore në lagjen Vreshta të Prishtinës kur edhe pse është ndarë lokacioni dhe janë dedikuar mjetet, ende nuk ka filluar ndërtimi i shkollës dhe nxënësit janë të obliguar të shkojnë në tri katër shkolla tjera të qyteti.

Sa i përket çështjes tjetër dëshiroj të shtroj pyetjen: Se sa po punon në përputhje me detyrën që ka komisioni për pranimin e objekteve të ndërtuara, për faktin në shkollën fillore Hilmi Rakovica në Prishtinë është pranuar objekti godina shkollore e kësaj shkolle fillore e në fakt ka atje shumë e shumë të meta të cilat do të thotë shihet se nuk i plotësojnë kushtet për mësim. Ende po përballemi me mungesën e hapësirave shkollore pra dashur pa dashur kjo gjendje pasqyrohet edhe në cilësinë e mësim.

Thuhet se procesi i reformave po rrjedhë mirë, por dëshiroj që tua përkujtojë z. ministër se reformat e ndërmarra pa përgatitje paraprake gjithherë kanë rezultuar edhe jo si të suksesshme.

Sa u përket testeve kombëtare ju thoni se keni pasë sukses, ndërsa unë dëshiroj të theksoj se edhe ju e dini shumë mirë bile, se sa rezultate kanë treguar testet kombëtare vitin e kaluar.

Në raport keni thënë se po krijohet ambiente atraktive në shkollë, pa u ndalur fare te fakti se shkolla tash po përballlet gjithnjë me fenomenin e dhunës në shkolla, si ministër dhe çka keni bërë të krijoni ambiente të sigurta për nxënësit.

Në pjesën e informatës ju thoni se keni rritje të përfshirjes në arsim, ndërsa nuk jepni asnjë të dhënë se çfarë thonë statistikat, çfarë është shkalla e analfabetizimit a është grafikoni në ulje apo në ngritje.

Me fjalën tuaj z. ministër në debatin për Universitetin, ju pati thënë se do të angazhoheni për depolitizimin dhe departizimin e universitetit. Pyetja ime është kjo: Çfarë keni bërë ju gjatë mandatit të juaj për depolitizimin dhe departizimin e arsimit fillor dhe të mesëm?

Dua t'ju rikujtoj se që nga koha kur patëm debatuar për Universitetin asgjë nuk ka ndryshuar në komunën e Therandës ku postet e larta në shkollat fillore dhe të mesme i mbajnë zyrtarët e lartë politikë. Z. ministër ju asnjë herë nuk keni ndërmarrë që të mos u lejohet zyrtarëve të lartë që mbajnë poste që vlerësohet se kanë konflikt interesi. Kështu p.sh. si mundet një ligj vënës të monitorojë ministrinë që ju drejtoni kur ai vet mban postet e larta brenda ministrisë së juaj.

Dhe në fund z. ministër sa do informata të bukura që të shkruani ju nuk po arrini të përmirësoni gjendjen edhe ashtu të rëndë të arsimit. Por për kundrazi me menaxhimin tuaj mësimdhënësit edhe më tej vazhdojnë të jenë në pozitat e mjeruara. Në një gjendje të këtillë i cili do të ishte motivacioni i tyre për një punë më cilësore. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! fjalën e ka deputeti Zef morina le të përgatitet deputeti Ramadan Musliu.

DEPUTETI ZEF MORINA – Ju faleminderit z. kryetar. Të nderuar zonja dhe zotërinj, mendoj që debati që po zhvillohet sot në Kuvend është dashur të bëjë shumë më parë dhe të ketë debate më të shpeshta. Duke pasur parasysh se treguesi kryesor në përcaktimin e rrjedhave të përgjithshme zhvillimore në të gjitha dimensionet e jetës shoqërore dhe avancimit kulturor ekonomike shkencore, sociale, dhe emancipuese, varen pikërisht nga shkalla e ngritjes cilësore të njohurive dhe aftësive të cilat shoqëria e një vendi i fiton përmes arsimit.

Kosova dhe populli shqiptar ka pasur vështirësi të mëdha në realizimin e së drejtës për t'u shkolluar në gjuhën e tyre. Për shkak të sistemeve dhe regjimeve të cilat e patën pillakosur vendin tonë edhe pse regjimi i Millosheviqit në vitet e 90-ta i mbylli të gjitha shkollat dhe fakultetet arsimit ishte hallka kryesore që mbajti gjallë frymën kombëtare dhe patriotike të popullit shqiptarë, ku më shumë se 10 vjet në një shtetretim të hekurt arritën të mbajnë kualitetin dhe cilësinë në arsimin në një nivel mjaft të lartë, duke nxjerrë dhe përgatitur kuadër të niveleve ndërkombëtare. Pra ishin dëshira dhe vullneti i palëkundur i mësimdhënësve të sakrifikohen më së shumti për të krijuar një shoqëri të emancipuar dhe të shkolluar sipas standardeve perëndimore.

Tani 8 vjet pas çlirimit edhe pse situata është shumë më e mirë niveli i kualitetit në arsim nuk është për t'u lavdëruar.

Arsyet janë të shumta duke filluar nga gjendja financiare dhe ekonomike arsimtarëve. Kushtet teknike në objektet shkollore, mosinteresimi nxënësve për dituri etj. Në këtë drejtim mendoj se institucionet qendrore dhe lokale nuk kanë bërë mjaft për të ndryshuar këtë gjendje, për faktin se arsimit është lënë si prioritet i dytë. Kjo gjë është vërtetuar edhe

në hulumtimin e bërë nga programi i kombeve të bashkuara për zhvillim UNDP-ja, i cili tregon për cilësinë e ulët në arsim. Sipas këtij programi arsimit në Kosovë është në gjendje shumë të keqe. Qeveria, ministria dhe drejtoritë e arsimit duhet të jenë më të përkushtuarën e gjetjeve të mundësive për të bërë reforma më të mirë në arsim, dhe ngritjen e nivelit të arsimit. Nuk mund të kërkosh nga një arsimtarë i cili merr pagën mujore më pak se 190 euro që të mbajë orën e mësimit në nivel të duhur, dhe para nxënësve të jetë i përgatitur, sepse pas orarit të punës ai duhet të punojë punë fizike për të siguruar ekzistencën e familjes pasi paga në arsim është e pamjaftueshme për të jetuar.

Gjithashtu, është edhe interesimi i nxënësve për të mësuar është shumë i ulët nga se duke parë se arsimtari i tyre nuk është i lumtur me punën që bën edhe atyre u humb vullneti për të vazhduar shkollimin. Kështu që një numër i konsiderueshëm që ende pa kryer arsimin e mesëm ndërpresim mësimit dhe orientohen në mërgim në botën perëndimore.

Në raportin buxhetor të vitit 2006 të paraqitur nga Ministria e Financave shihet qartë se Qeveria nuk ka qenë e vëmendshme në kontrollimin e shpenzimeve buxhetore. Shpenzime të pakontrolluara ka pasur në disa gjëra të cilat kanë mundur të kursehen, si p.sh. shpenzime norme në karburant, shërbimet telefonike, mallra dhe shërbime, e shpenzimet tjera të cilat po të mos shpenzoheshin pa kriter do të kurseheshin mbi 40 milion euro. Këto mjete do të mund të shërbenin për ngritjen e pagave të arsimtarëve në vlerë prej 60 deri në 80 euro në muaj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e standardit të arsimtarëve, gjegjësisht ngritjen e pagave 30 gjer 40% dhe në këtë mënyrë do të ngritej edhe cilësia në arsim.

Demokristianët e Kosovës kërkojnë që për të sanuar këtë gjendje duhet urgjentisht të merren masa nga Qeveria duke krijuar mekanizëm për sigurimin e kushteve më të mira, në radhë të parë për arsimtarët dhe infrastrukturën e arsimit në përgjithësi sepse një politikë e tillë jo vetëm që do të bie edhe më tej nivelin e kualitetin e arsimit, por do të ketë rënie të përgjithshme të sistemit arsimor. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramadan Musliu le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU – Të nderuar z. kryetar, z. ministër dhe kolegë deputetë. Është konstatim unanimit dhe i palëkundshëm se arsimi është në krizë, por nuk është vetëm arsimi në krizë është gjithë shoqëria në krizë, është në krizë se jemi në transicion se duhet bërë ndryshime se duhet si jemi mësuar të themi deri tash se bëhet shteti d.m.th. çdo gjë fillohet nga e para, por nëse është diçka në krizë atëherë na obligon që të jemi sa më racional edhe të flasim asi soji që të ndërtohet një strategji dhe një ide se si të dilet nga kriza. Vazhdimisht flitet se arsimi është kështu, është ashtu, normalisht prej segmenteve vitale të funksionimit të shoqërisë dhe kjo na obligon që të qasemi ashtu si duhet dhe të ndërtojmë si thashë një strategji të caktuar. Mirëpo ky problem duhet të shihet jashtë zhvillimit të një shoqërie jashtë skemës ekonomike, nëse nuk kemi ne një ekonomi të zhvilluar e cila do ta ushqejë arsimin por në anën tjetër edhe do ta absorbojë kuadrin që e jep arsimi atëherë nuk mund të kemi një arsim tamam si duhet.

Në këtë ekonomi që e kemi nuk mund të bëhet një planifikim i mirëfilltë i arsimit i cili është obligim i Ministrisë së Arsimit dhe ministrit konkretisht të cilin po e atakojmë pothuajse pa mëshirë për fajet të cilat besoj që nuk i ka bërë. Si mund të bëhet planifikimi i

arsimit kur duhet të krijojnë kuadro të tilla të cilat duhet t'i absorbojë ekonomia për shkak se arsimit është ai që ta jep së pari profesionin.

Po shihet saktësisht se në momentin aktual mund të prodhojmë kuadër vetëm për shërbime civile, kuadër për arsim, si me thënë që janë të rrogave buxhetore për shkak se zhvillimi ekonomik nuk është ku ta di se çfarë, dhe kjo varet prej shumë arsyeve të cilat nuk është e udhës të përmendet në këtë debat. Po ashtu jemi mësuar se kur flitet për arsimin ta marrim si shembull arsimin atë modelin pararendës që ishte një arsim masiv. Dihet se gjatë komunizmit ka pasur projekte gjigante me të cilat është identifikuar sistemi dhe ka shërbyer si një perde me të cilën është mashtruar elektorati dhe në përgjithësi mileti dhe është mbajtur sistemi. Ndër ta kanë qenë elektrifikimi dhe arsim. Ka ekzistuar një arsim masiv dhe efektet e këtij arsimit na i dijmë. Ka prodhuar një shtresë të të arsimuarve fillestarë, të mesmes për shkak është dashur të prolongohet problemi social i punësimit i tyre se problemi i punësimit nuk është i tashëm, është i përhershëm këtu është dashur të dërgohen në studime.

Nëse ne vazhdojmë të veprojmë me skema të tilla që të prodhojmë kuadër i cili do të shkojë shkallë-shkallë prej arsimit fillor, të mesmit, deri në arsimimin e lartë, ne vetëm e prolongojmë problemin social dhe e ndërtojmë një skemë sociale e cila potencialisht do të krijojë probleme. Si problem tjetër po ashtu, për të cilin u fol mjaft, është edhe problemi i pozitës sociale të punëtorit të arsimit. Mund të them lirisht se këtë problem po ashtu duhet ta shohim brenda një skeme të caktuar sociale, çfarë është rroga e tij, çfarë është pozicioni real i tij, edhe në çfarë skeme mentale zhvillohet edhe problemi statusit social i punëtorit të arsimit. Mund të them lirisht se rrogat e arsimtarëve nuk janë as më të vogla as më të mëdha sesa të shteteve të rajonit të cilat kanë një traditë të gjatë të arsimit dhe të sistemit arsimor shtetëror.

Te ne gjendja sociale është shumë e vështirë kur një person duhet ta mbajë gjithë familjen dhe është rrogë e pamjaftueshme. Me këtë nuk do të them se nuk ka nevojë të punohet në ngritjen e rrogave të arsimtarëve është e domosdoshme por duhet të mendojmë dhe çka do të bëjmë edhe për një armatë të tërë të të papunëve. Ne kemi obligim jo vetëm që nuk janë në punë por kemi obligim edhe ndaj atyre që s'janë në punë. Edhe që ta konkretizojë gjithë këtë debat mendoj që problemi kryesor që momentalisht duhet të orientohet, Ministria e Arsimit është ndërtimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të arsimit, ka shkolla sikur po flas për komunën e Vitisë, një qytetet si është Vitia e ka një shkollë fillore ku punohet me shumë ndryshe dhe është e pamjaftueshme dhe e mora si shembull pothuajse në të gjitha fshatrat janë kapacitetet e pa mjaftueshëm. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Profesor Marku, fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETI MARK KRASNIQI – I nderuar kryetar, i nderuar ministër dhe deputetë. Po flasim që katër pesë orë sot për një problem shumë të rëndësishëm për arsimin para universitar. Ky problem është aq i rëndësishëm sepse e kemi gati gjysmën dhe të katërtën e popullsisë të inkuadruar në shkollat para universitare ku përgatiten edhe njerëzit për studime më të larta. Aftësia e këtyre njerëzve nuk varet vetëm nga kualitetit të shkollës, prej ndërtesës ose prej gjërave tjera, prej buxhetit, por para gjithash varet nga arsimtarët, prej atyre që shesin mend, siç themi ne, se arsimtari gjithmonë shet mend shet dije. Prandaj, është më se e nevojshme që aftësisë së arsimtarëve t'i kushtohet një kujdes i

përhershëm me anë të seminareve, me anë të takimeve të ndryshme të aftësohen që të mos e harrojnë atë që duhet ta kenë edhe duhet ta shesin, por të pasurohet edhe dija e tyre. këtu është e lekturuar. Këtu u fol për rezultatet dhe për mangësitë që i kemi pasë deri tash në këtë fushë. Rezultatet janë evidente prej materialit që kemi në dorë dhe prej ekspozent që e dha ministri. Këtu shihet se kjo ministri dhe kjo shoqëri ka punuar shumë në këtë drejtim që të aftësohet rinia jonë në shkollat para univerzitare. Këto rezultate janë evidente, por si tha edhe ministri vet, nuk duhet të jemi të kënaqur me kaq, sepse ka edhe mangësi të mëdha, por duhet të përpiqemi që ta mbërrijmë në një shkallë shumë më të lartë të aftësisë të njerëzve. Nuk mjafton që ta ketë nxënësi, maturanti ose kushdo që të jetë tjetër vetëm diplomën që e ka kryer, por është para së gjithash duhet ta ketë atë diplomë dhe atë dije ta ketë në kokën e vet edhe atë ta përdorë për të mirën e popullit ...

Unë jam për depolitizimin edhe defetarizimin e arsimit, sepse me politizim dhe me fe mund të krijojmë, mund të ndikojmë në ndasi në brezin e ri, që d të jetë shumë, shumë e dëmshme për ne e sidomos këtu në Kosovë, prandaj jam që në shkolla fetare le të mësohet, edhe le te barten edhe le të vishen si te donë ose le të bëjnë ato shamitë ose kryqet ose çka të donë, sepse kanë të drejtë në shkollat fetare të kenë të tillë. Unë jam për atë, se tash janë kushtet e tjera, por vetë e kam përjetuar në kohën shumë, shumë më parë në Jugosllavinë e Kralit si themi ne, se nxënësit e gjimnazit kanë qenë të gjithë të detyruar ta kenë kapelën dhe numrin e klasës në ballë, do me thënë në kapelë, kurse vajzat t'i kenë, këto çka i thonë fustanin e njëjtë për shkollë uniforma, bile më kujtohet vajza e naçellnikut, si i themi prefektit të rrethit të Prizrenit erdhi me një fustan të mëndafshit, drejtori që e bënte atë evidentimin para se të hynin në shkollë, e nxori prej radhës dhe i tha: "ti shko te shpija dhe vishu si shoqet tua", kurrsesi nuk duhet me pas dallim në qoftë se nuk imponohet dallimi me gjendjen ekonomike te dikush.

Prandaj, unë them se, në qoftë se donë dikush me u dekoruar le ta bëjë në shqipen në gjoks ose ku të doje, në krah e jo në ndonjë shenjë partiak, ndonjë shenjë fetar ose ndonjë shenjë tjetër që dallon njëri prej tjetrit. Nejse, me qenë se është puna shumë e kufizuar, unë nuk dua edhe t'i përsërisë këto gjëra por nuk duhet ta harrojmë edhe diasporën, dhe këtu kur u tha, u përmendë gjëja se Partia demokristiane çka mendojnë kështu. Popullin edhe ne nuk na intereson çka mendojnë demokristianët e përjashtuar nga partia Shqiptare Demokristiane, ato janë rrugë edhe le të bëjnë çka të donë. Aspak nuk e intereson këtë strukturë të njerëzve as arsimit e as defetarizmi. Duhet të përkushtohemi si njerëzit që i kemi përjashta, janë shumë, mos ta harrojmë gjuhën shqipe, mos ta harrojmë historinë, mos ta harrojmë letërsinë etj. kurse ne përpiqemi që ta përkrahim arsimin sepse kualiteti kërkohet në Evropë.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit Profesor. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatçiu, le te përgatitet Nuran Malta

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA - I nderuari Kryetar, ministër, të nderuar deputetë,

Nëse dëshiron të dimë për gjendjen e një shoqërie sot, për prioritetet e asaj shoqërie dhe për të ardhmen e asaj shoqërie, atëherë shiko çfarë prioriteti i jep ajo shoqëri arsimit. Jo rastësisht arsimit ishte në shënjestër të regjimit të Millosheviqit, sepse me shkatërrimin e arsimit e shkatërron ardhmërinë e një populli. Arsimit në Kosovë gjatë kësaj kohe mbijetojë dhe e mbajti frymën e kombit në kushte jashtëzakonisht të vështira, por në dëm të kualitetit, por qëllimi i mbijetesës së arsimit shqip dhe mbajtja e kontinuitetit e kishte rëndësinë kruciale dhe atëherë arsyetohej edhe kjo rënia e kualitetit. Por, kjo

rënie nuk mund të arsyetohet sot në asnjë mënyrë. Pas luftës kur arsimtarët e kryejnë detyrën e tyre shumë fisnike dhe shumë të rëndë, nuk kishte më arsye që arsimi të mbetet në nivel të mbijetesës por të fillon që me hapa shumë të shpejtuar të tenton ta zë vendin e vet në mesin e vendeve të tjera, të cilët nuk e patën fatin e keq të stagnimit dhe kushtet e aparteidit, por është për të ardhur keq që kjo nuk ndodhi.

Gjendja sot, 8 vite pas lufte ende nuk dallon shumë nga ajo gjendje emergjente. Kur flitet për hapësira shkollore, çdo herë referohet në buxhet të vogël, ndërsa në të njëjtën kohë asnjëherë nuk referohet sa përpjekje janë bërë për shkurtrimin e shpenzimeve të Ministrisë. Rast i veçantë kur arsim mbahet një kushtet jashtëzakonisht të vështira është arsimi në Mitrovicën e veriut, konkretisht shkolla fillore në Kodrën e Minatorëve, shkollë kjo e cila përbëhet prej dy kontejnerëve në të cilët mësojnë nxënësit prej klasës së parë e deri në të tetën.

Vitin e kaluar, Kryeministri dhe vetë Presidenti i Kosovës premtojnë ndërtimin e shkollës fillore në këtë lagje, shkolla dhe mundësia e shkollimit në Mitrovicë nuk është vetëm arsim, është arsye për të qëndruar dhe jetuar në Mitrovicë. Mospërfillja e këtij problemi të bënë të mendosh se Qeveria ka hequr dorë nga veriu i Mitrovicës. Në arsimin ton hasim edhe një paradoks interesat. Kur kemi parasysh rezultatet pozitive në shkollën fillore dhe në atë të mesme, ndërsa në anën tjetër rezultate dëshpëruese të provimit të maturës vijmë deri te një paradoks ose rezultatet në shkollën fillore dhe të mesme nuk janë reale ose provimi i maturës është përgatitë për nxënësit e Japonisë. Vetë ky fakt për gjithë shoqërinë e posaçërisht për Ministrinë duhet të jetë alarm për të marrë masa adekuate për eliminimin e këtij paradoksi.

Tregim në vete është eksperimentimi me tërë një gjeneratë, me klasën e trembëdhjetë. Në ditët e ardhme maurantët e përfundojnë shkollimin e tyre të mesëm. Edhe një paradoks tjetër në Kosovë, është se këtë muaj nuk diplomon vetëm një gjeneratë e maurantëve, në fakt këtë muaj diplomojnë dy gjenerata të maurantëve, maurantët me 12 vite shkollim dhe maurantët me 13 vite shkollim. Në fakt, afro 22 mijë maurantë e kryejnë shkollën e mesme dhe ia mësojnë dyerve të fakultetit. Këta të dytit janë të shpërblyer me 5 pika shtesë për klasën e 13 ose për humbjen e tërë një viti pa tekste, pa kutikulë të mirëfilltë.

Kush e ka përgjegjësinë për humbjen e afro 10.000 viteve pësim të nxënësve të një gjenerate, kush e ka përgjegjësinë për ngarkimin e më se 10.000 familjeve me shpenzimeve shtesë për mbajtjen e nxënësit i cili shpërblehet me 5 pika të plota në provimin e maturës? Kush ka përgjegjësi për probleme në regjistrimin në fakultet të këtyre dy gjeneratave? Kur t'i vërshojnë ata dyert e fakulteteve.

Gjatë debatit patëm rast të dëgjojmë për ndarjen e buxhetit, se buxheti nuk është adekuat. Pyes kush e bëri këtë ndarje të buxhetit, kush e votoj këtë buxhet? Dëgjuam se nuk ka ligj i cili e bënë ndarjen e pagesës së arsimtarit praktikant nga ai me përvojë shumëvjeçare. Prapë pyes: Kush duhet ta bëjë këtë ligj? Nëse ju si pozitë e keni udhëhequr që shtatë vjet arsimin edhe tërë Qeverinë, jeni në dijeni për këto probleme, cika është arsyeja që vazhdon me këtë politikë diskriminuese e nuk ndërmerri ndryshime.

Deputetët e opozitës treguan për problemet e shumta, se arsimi duhet të shpallet prioritet, dëgjuam se duhet shumë kohë për zgjidhjen e këtyre problemeve kur i dimë se

tashmë kanë kaluar tetë vite, pyes pozitën: Edhe sa vite ma tepër ju duhen për t'i zgjidhë këto probleme? Duke pasur parasysh aftësinë aktuale, duket se do të duhen shumë dhjetëvjeçar. Propozojmë që Ministria dhe Komisioni Parlamentar për Arsim të mbledhen dhe në bazë të debatit të sotëm të përpilojnë rekomandime, dhe në njërën prej seancave të ardhshme të vijnë me propozime konkrete, me rekomandime për përmirësimin e gjendjes së arsimit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nuran Malta, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj

DEPUTETJA NURAN MALTA - Sayın Başkan, sayın bakan, sayın milletvekiller

Eğitim, her devlet ve her toplumun en önemli alanlarından biridir. Kosova'dan söz edilince bu konu, azınlıklar toplulukları açısından daha büyük önem kazanmaktadır. Dolayısıyla toplulukların varlığı ve entegrasyonu da, eğitime oldukça bağlıdır.

Konuşmamın daha başında, toplulukların dilleri, somut olarak Türk dili üzere eğitiminde Bakanlığın ve Kosova'nın diğer kurumlarının şimdiye kadarki faaliyetlerinden dolayı memnuniyet duyduğumuzu vurgulamak istiyorum. Türk dili üzere eğitim her düzeyde uygulanmaktadır, dersler Kosova programlarına göre ve ortak okullarda yapılmaktadır.

Ancak eğitimde de hepimizi ilgilendiren sorunlar mevcuttur. Aralarında enfastrüktürün yetersiz olması, yardımcı gereçlerin eksikliği, öğretmenlerin ve diğer kadroların düşük gelirlerini anmak gerekir. Bunlar, hepimizin ortak sorunudur ve dolayısıyla, eğitimin son derece önemli bir alan olması itibriyle bu alanda düzeyli bir kaliteye sahip olması için çözüm yollarının da bulunması şarttır.

Türk topluluğu ve KDTP açısından sorunlarımız ve önerilerimiz Türk eğitimle ilgili şunlardır:

- Yayınlanan kitaplar sayısının yetersizliği;
- Türk dilinde eğitim gören öğrenciler için Arnavut dilinin öğrenimi konusunda plan ve kadroların olmayışı;
- Kadro yetersizliği;
- Türk topluluğu sıralarından yönetici ve idari kadronun yetersiz sayıda olması;
- Elverişsiz çalışma mekanları ve dershaneler.

Bu yüzden önerilerimiz şunlardır:

- Ana sınıflardan üniversiteye kadar Kosovada Türkçe ders kitaplarının yayınlanması.
- Kosova Eğitim ve Bilim Teknoloji Bakanlığının Türk sorumlusunun seçilmesi
- Kosovada bazı okullarda Türk büyüklerinin isminin verilmesi
- Kosova ve Türkiye arasındaki eğitim alanında protokolün imzalanması ve Türkiye ile şimdiye kadar olduğu gibi her yanlı ilişkilerin devam etmesi.
- Priştine Üniversitesinde Türkçe yeni bölümlerin açılması, ki bu yıl Prizren Eğitim Fakültesinde bizim öğretmenlik bölümümüz vardır, zaten bazı derneklerin önergesi de vardır, bu yıl eğitimin öğretmenlik kadrosu yerine hukuk ve matematik bölümlerinin açılması.
- Tabi ki Mamuşada ana sınıfın açılması.

Eđitimde ve eđitimle ilgili sorunlarımızın varlıđını bilerek biz, sđzkonusu sorunların ortadan kaldırılması iin katkımız sunmaya devam edeceđiz. Düşüncemize göre, sadece kaliteli ve etkili bir eđitim sistemi bizleri ayakta tutabilir.

Dikkatinize teđekkür ederim. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLĒ BERISHA – Ju faleminderit! FjalĒn e ka deputeti Xhevdet Neziraj, pĕrgatitet deputeti Ilaz Pireva

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – Ju faleminderit Z. Kryetar, i nderuar z. Ministĕr dhe kolegĕ deputetĕ,

Nuk e pata ndĕrmend tĕ diskutoj, por tabela e cila ka ardhur nga Ministria e Arsimit mĕ detyroi qĕ tĕ diskutoj, sepse pĕr tabelĕ ĕshtĕ dashur tĕ diskutoj dje pĕr arsye se ka qenĕ e profesionit e jo sot t'u jepet hapĕsirĕ profesionistĕve, por shpeshherĕ po ndodhĕ qĕ, njerĕzit qĕ duhet tĕ flasin tema tĕ caktuara po heshtin e ndonjĕherĕ kur duhet tĕ heshtin po flasin, dhe unĕ do tĕ vazhdoj kĕtu pĕr shkak se tabelat qĕ janĕ ofruar nga, kush janĕ mbledhur nuk di, por me siguri ju kanĕ mashtruar pĕr shumĕ ka.

Unĕ dua tĕ them njĕ gjĕ se, dhe metoda dhe mĕnyra e mbledhjes sĕ kĕtyre shĕnimeve nĕ disa shkolla ĕshtĕ bĕrĕ nĕ mĕnyrĕ shumĕ tĕ gabuar, kur e them kĕtĕ, e them me argumente pĕr arsye se nĕ Komunĕn e Pejĕs, dihet se mĕsimi pĕr komunitetin egjiptas zhvillohet edhe mĕ herĕt jo vetĕm pas luftĕs nĕ gjuhĕn shqipe, kanĕ shkuar njerĕz tĕ Ministrisĕ apo kush ka shkuar dhe t'i identifikon brenda klasĕs fĕmijĕt nĕ shkolla fĕmijĕt nĕ shkolla, nĕ klasa tĕ parĕ, tĕ dytĕ – tĕ cilit komunitet i takojnĕ. Do tĕ thotĕ ĕshtĕ njĕ papĕrgjegjĕsi dhe ajo formĕ nuk ĕshtĕ e mirĕ qĕ tĕ identifikohen brenda klasĕs se cilit komunitet i takojnĕ. Nĕ Kosovĕ mĕsimi zhvillohet nĕ gjuhĕn shqipe, nĕ gjuhĕn boshnjake dhe nĕ gjuhĕn turke, ashtu ĕshtĕ bĕrĕ edhe klasifikimi i arsimtarĕve. Unĕ dua ta pĕrmendi njĕ fakt kĕtu: profesori Muhaxheri ĕshtĕ kĕtu dhe ka punuar shumĕ vite me njĕ profesor tĕ komunitetiz egjiptas, i cili ka qenĕ, ka jap mĕsim nĕ gjuhĕn shqipe dhe nga Ministria, Drejtoria e Arsimit tĕ Pejĕs identifikohet me njĕ komunitet krejt tjetĕr, unĕ e kuptoj ndarjen e drejtĕ buxhetore, e cila ĕshtĕ bĕrĕ nĕpĕr komuna dhe po dĕshirohet qĕ tĕ klasifikohen si minoritar dhe tĕ hekĕn nga ajo skema e pagesave, tĕ ardhurave buxhetore, mirĕpo unĕ besoj qĕ sistemi i arsimit se profesor Hamiti e ceku shumĕ mirĕ, duhet ta ketĕ njĕ strategji shumĕ tĕ mirĕ, tĕ pĕrpiluar mirĕ dhe nuk ka nĕ strategji tĕ arsimit mĕsim pĕr pakicat dhe pĕr shumicĕn, por mĕsimi nĕ tĕ cilat gjuhĕ zhvillohet nĕ Kosovĕ.

Unĕ duhet atĕ ta them pĕr arsye se po mbahen edhe seminare tĕ ndryshme nĕ tĕ cilĕn po bĕhen strategji pĕr romĕ, egjiptas dhe ashkalinj qĕ ĕshtĕ nĕ kundĕrshtim them me do normĕ, nuk ka strategji pĕr komunitete, komuniteti egjiptas dĕshiron tĕ integrohet dhe ka qenĕ i integruar. Unĕ shohĕ kĕtu qĕ njerĕz qĕ dĕshirojnĕ tĕ integrohen, bĕjnĕ strategji pĕr ... po japin mjete me i integruar, nuk po integrohen. Unĕ besoj se duhet tĕ ndĕrrohet kjo strategji edhe tĕ Komisionit tĕ Arsimit, edhe Ministrisĕ por edhe Qeverisĕ. Mirĕpo, duhet ta lavdĕroj Ministrinĕ e Arsimit pĕr arsye dhe personalin arsimor sidomos nĕ rrafshin e dukagjinit ku graviton komuniteti ynĕ, nuk ka asnjĕ lloj diskriminimi, pĕrkundrazi kanĕ pasur njĕ shtyrje pozitive dhe ajo ĕshtĕ, sepse ĕshtĕ detyrĕ e pedagogut dhe atĕ e kanĕ treguar profesorĕt tanĕ dhe arsimtarĕt tanĕ. Unĕ shpresoj se nĕ tĕ ardhmen kĕsi gabime nuk do tĕ lĕshohen, dhe ne si komunitet dĕshirojmĕ jo vetĕm

integrim, por edhe një shtyrje pozitive në një zhvillim edhe më të hovshëm sepse arsimit është përzgjedhë dhe me kuadro të arsimuara do të përfitojmë të gjithë edhe vetë shteti i Kosovës.

Një gjë që do të kisha me e përmendë është se Ministria e Arsimit ka bërë edhe financimin e mësimit intensiv, që është mirë të bëhet për këtë komunitet dhe për disa komunitete të cilat e kanë ndërpre shkollimin, kjo duhet të bëhet edhe disa pjesëtarë të komunitetit Shqiptarë, të cilët kanë pasur probleme, sepse nuk ka analfabet vetëm komuniteti egjiptas, romë dhe ashkalinjë, por ka shumë edhe të komunitetit Shqiptarë që unë i di shumë mirë bile, po ta marrim numerikisht ka më shumë se sa këto komunitete tjera. Prandaj, duhet një strategji e mirëfilltë, një strategji e cila do të jetë e suksesshme për të gjithë.

Diçka që kisha me thënë është që në regjistrimin e shkollave të mesme të ketë shtyrje pozitive për arsye se po ka debalancë, sikurse e përmendi z. Hajredin Kuqi, dallimin në mes shkollave fshat-qytet, por edhe, janë edhe disa gjëra tjera që nuk mund të ndalen, edhe them ndonjë intervenim. Unë besoj që aty komuniteti ynë duhet të ketë një përkrahje në regjistrimin, në disa degë siç është mjekësia ose drejtimet tjera që janë më të kërkuara.

Unë ju falënderohem dhe ju përsërisht dhe besoj që edukimi që është prioritet i Qeverisë të realizohet, por jo vetëm i kësaj Qeverisë, por të gjitha qeverive që do të vijnë sepse arsimit nuk mund të zgjidhet për një kohë dhe një afat shumë të caktuar se janë probleme të grumbulluara që nga regjimi serb, dhe tani jemi në tranzicion dhe reforma, dihet që duhen edhe pare, por edhe duhen njerëz të përgatitur.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ilaz Pireva, përgatitet deputeti Zylfi Merxha

DEPUTETI ILAZ PIREVA - I nderuari Z. Kryetar, Z. Ministër, Kolegë deputetë Informatën për arsimin para universitar të paraqitur sot nga z. Agim Veliu, ministër i arsimit e vlerësoj si informatë reale, objektive të pa telejisur me vështirësitë dhe me të arriturat në këtë fushë të jetës.

Sikur po harrojmë ku ishim, po harrojmë kohën e robërisë, sidomos vitet '90 – '99, po e harrojmë luftën. Nga disa diskutues po del sikur arsimit paska pasur një periudhë të artë edhe në aspektin material. Po me tregoni cila ishte ajo kohë? Përkundër mendimit dhe vlerësimit pozitiv që kemi për arsimin, ai nuk mund të shkëputet nga fushat e tjera të jetës. Ku e kemi shëndetësinë, ku i kemi skemat e ndihmës sociale, ku i kemi pensionet, ku e kemi zbatimin e Ligjit për pjesëtarët e UÇK-së, invalidët e luftës, viktimat e luftës dhe të tjerët.

Më duket e pavend zënia në gojë e akademikut tonë të nderuar dhe shkencëtarit në kontestin e pagës së ulët të arsimtarit. Ai dhe shumë të tjerë tani bëjnë pjesë në skemat e ndihmës sociale në 40 euro. Edhe atë përshkrim me rrethoja të rrënuara dhe pa rrethoja nuk qëndrojnë. Unë kam pritur krejtësisht një qasje profesionale dhe dhënie të zgjidhjes për kapërcimin e këtyre vështirësive që janë në fushën e arsimit, e kam fjalën për njerëz të cilët janë të profesionit përkatës.

Lidhur me dallimin që ekziston fshat-shkolla-zytet dhe shkolla fshat nuk është i sotshëm. Me këtë rast do të përmendi edhe përkujdesjen e mbarë shoqërisë që duhet pasur lidhur me fshatrat buzë kufijve, të cilat për ditë po na mbesin pa njerëz, përkatësisht po na mbesin pa nxënës, në mungesë të infrastrukturës dhe të kushteve të vështira. Pra arsimit duhet të jetë përkushtim i tërë shoqërisë pra edhe i pozitës edhe i opozitës, me sa di unë opozita është deklaruar se kanë hequr dorë nga roli i saj i opozitës deri në zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Unë jam optimist se edhe arsimit, edhe për arsimin do të vijmë ditë shumë më të mira siç do të vijmë edhe për të gjitha fushat tjera të jetës. Prandaj, përkundër asaj që, me rastin e miratimit të buxhetit të Kosovës për vitin 2007 arsimi i është dhënë prioritet si edhe dy fushave të tjera, megjithatë nuk mjafton vetëm dhënia e prioritetit, por puna që duhet bërë në këtë fushë, punë e cila lypset prej të gjithë shoqërisë dhe vetëm atëherë mund të themi se vërtetë po i duhemi arsimi.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi, le të përgatitet deputeti Bajrush Xhemajli

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. Kryetar, të nderuar deputetë, do të përpiqem t'i shfrytëzoj pesë minutat që i kam në dispozicion, po e filloj me sfidat që i kemi në raportin e Ministrisë. Ju përpara në Raport keni tri sfida dhe mendoj që këto tri sfida janë edhe të shekullit XIX edhe të shekullit XX. Pak është folur për sfidat e vërteta që i ka arsimit kosovar sot. Unë do t'i numëroj vetëm disa janë: librat shkollor, literatura ndihmëse shkollore dhe shkencore, mjetet mësimore, laboratorët shkollor, teknologjia informative dhe diçka që nuk i kemi asnjë informacion në tërë këtë raport janë mungesa e kuadrit të kualifikuar arsimor në arsimin fillor dhe të mesëm që nuk figuron në këtë Raport, dhe mendoj që edhe kjo është një sfidë për arsimin edhe fillor edhe të mesëm për mos të thënë edhe për arsimin e lartë.

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i debatit nuk është për të bërë fushatë, por për të ndryshuar gjendjen pozitivisht në procesin e arsimi, ndryshimin e kanë për obligim ta bëjnë ata që i ekzekutojnë politikat programore të Qeverisë të propozuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. E kanë për obligim ta ekzekutojnë ata që menaxhojnë me buxhetin e Kosovës dhe me buxhetin e Kosovës menaxhojnë ata që e kanë pushtetin. Dhe të nderuar deputetë, është pozita ajo që menaxhon me Kosovën pasi menaxhon me shumicën e buxhetit të Kosovës dhe për dështimet, jo në sferën e arsimit nuk mund të akuzohen të tjerët.

Unë e falënderoj deputetin Hoxhaj, për fjalën hyrëse që e ka thënë në emër të Partisë Demokratike dhe mendoj ka qenë një përshkrim i plotë duke dhënë dhe sugjerime se si mund të dilet nga kjo gjendje. Por, duhet ta them edhe këtë – opozita u tha se ka udhëhequr me Universitetin, e njëjta gjë vlen me Universitetin dhe me të gjitha segmentet e jetës në Kosovë udhëheqin ata që e kanë buxhetin dhe që qeverisin vendin. Ne i dëshirojmë ndryshimet në arsim, ndryshimet pozitive në arsim, por me këtë buxhet me këtë mënyrë të menaxhimit të buxhetit dhe me këto vjedhje që i bëhen buxhetit të

parave pa hyrë në buxhet edhe kështu edhe ato që hyjnë në buxhet mendoj që gjendja as në arsim dhe as në një segment të jetës nuk do të ndryshon.

Unë, do të ndalesha në segmentin e edukimit, mua më vjen keq që shkolla jonë sot, jo vetëm që nuk ka kapacitet për të edukuar në aspektin e dijeve, dijeve shkencore njeriun tonë të rij, por vërtetë ka mangësi të shumta edhe në edukimin. Këtu nuk u tha asnjë fjalë se nxënësit tonë sot nuk edukohen si duhet as me përdorimin e gjuhës shqipe, as me njohuritë që fiton për historinë, as për njohuritë kulturore, as për traditën e kulturës sonë, dhe natyrisht shkolla jonë dhe në Kosovë në përditë kemi mundësi të vërejmë pamje, sjellje dhe kulturë që është e frikshme për njerëzit tanë për faktin se ato kultura nuk janë vendore, ato kultura janë të huaja, ato kultura nuk kanë prodhuar kulturë, nuk kanë prodhuar histori, nuk prodhojnë ardhmëri as prej vendeve nga ato vijnë e mos të flasim për Kosovën që më së paku i duhen. Shkolla jonë është shkëputur shumë nga tradita kombëtare, është shkëputur shumë nga rilindja kombëtare dhe si pasojë kemi akte devijante të ngjarjeve të 2004, dhe e kemi aktin e fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që është pasojë e mungesës së edukatës në arsimin tonë, dhe krejt në fund, unë propozoj që Universiteti i Prishtinës të ndahet në tri universitete së paku dhe të liberalizohet regjistrimi i studentëve në Universitet, në mënyrë që ...

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, përgatitet deputeti Ymer Muhaxheri. Po Merxha, e keni prekur sigurisht, është emri i fundit tash

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI - Ju faleminderit Z. Kryetar, përshëndetje për të gjithë. Gjykuar sipas Raportit që na është sjellë këtu, dhe sipas fjalës së Ministrit, del se gjendja nuk është keq në arsimin e Kosovës, por realiteti në terren e demanton kategorikisht Raportin ashtu edhe ministrin. Mjafton të përmendet fakti se ka edhe aso shkolla të ne ku gjarprijtë bëjnë strofuj siç kemi parë imazhet nga TV-të tona, siç është shkolla e Lugarit apo LLukarit e cila nuk është hiq më larg se 5-6 kilometra prej këtij Kuvendi ku ne po debatojmë, kjo tregon, ndoshta më së miri për të parë se ku jemi.

Këtu kolegu Kamberi me të drejtë tha se arsimi nuk është çështje vetëm e një ministrie apo i një ministri, por sa përkrahje ka arsimi në Qeverinë e Kosovës shihet edhe me faktin që kemi përpara si deputetë. Ministri këtu para nesh qëndron tërë ditën i vetmuar, pa pasur afër askënd, as kryeministrin, as ndonjë kolegë ministër, as zëvendësministra madje as zëvendësministrin e tij, ndoshta mendon që i dinë të gjitha dhe mund të na përgjigjet në fund, por po them se ky është një indikator shumë i madh se sa Qeveria është e interesuar për ta qar arsimin përpara. Pra nuk është çështje, do të kisha thënë edhe unë e vetëm i një ministri e ministrie, por është çështje e tërë Qeverisë madje edhe ma shumë se kaq.

Këtu një kolege, parafolëse tha se opozita vetëm po kritikon dhe nuk po ofron zgjidhje. Unë dua të them se edhe për veti, por edhe çdo njërin nga diskutuesit që diskutojnë nga Partia Demokratike e Kosovës kanë ofruar zgjidhje dhe atë një zgjidhje unike, pra rekomandime që ka ofruar z. Enver Hoxhaj në emër të këtij debati, të kësaj pike dhe si referues i kësaj pike.

Ka shumë çka të thuhet, nuk dua t'i përsërisë, ato të përgjithësuara çka janë për arsimin, që u thanë vërtetë shumë këtu, dhe me të drejtë u thanë, unë dua të fokusohem në

gjendjen në arsim prej komunës nga vij unë, nëse më del pak kohë, me kohë jemi krejt keq tash.

Komuna e Ferizajt është lartë qëllimit për të siguruar arsimin dhe edukimin cilësor, hapësira të pamjaftueshme dhe infrastruktura e dobët dhe jo funksionale duke i shtuar keq menaxhimin dhe keqpërdorimit të shumta janë faktor determinues të cilët nuk garantojnë arsimim dhe edukim të mirëfilltë. Për shtatë vite me radhë Komuna e Ferizajit me një plogështi të paparë sikur ka konservuar gjendjen sidomos në qytet, shkollave me 3-4 ndërrime nga dy deri tri orë qëndrimi të nxënësve në shkollë. Për më tepër në horizont nuk duket ndonjë iniciativë serioze për të dalë nga kjo gjendje. Se realiteti është i hidhur dëshmojnë vetë mësojtorët e shkollave të qytetit të Ferizajit me rrethinë, të pakta janë klasat aty ku zhvillohet beteja e mësim zënies dhe mësimdhënies ku mundemi të gjejmë mjete elementare, konkretizimi, tabela e shumica të përdorshëm. Paralelet e stërngarkuara me nxënës deri në 45 nxënës jashtë të gjitha kriterëve dhe normave pedagogjike. Hapësirat shkollore që nuk ofrojnë nxehje të mjaftueshme për zhvillim normal të procesit mësimor. Dëshmi e kësaj kanë qenë humbja e orëve të panumërta, të pa kompensueshme dhe të evidentuara nëpër shumë shkolla të Ferizajt. Higjiena është katastrofave, e cila nuk do t'i shpëtonte asnjë komisioni sanitar, por asnjëherë deri më tani inspektim higjenik nuk ka pasur. Dështimet e plota dhe të pjesërishtme të shumë projekteve si nga Qeveria ashtu edhe nga Banka Botërore apo organizatat humanitare për shkak të nderimeve të korruptuara, për shembull dështimi i projektit prej 15.000 eurosh në gjimnazin "Kuvendi i Arbërit", dështimi i projektit në shkollën fillore në fshatin Zaskok etj. dështime të cilat nuk i mohon as vetë qeverisja aktuale. Për shkak të këtyre keqpërdorimeve janë kërkuar para nga nxënësit për intervenime të ndryshme nëpër shkolla dhe atë deri në largim të nxënësve nga orët e mësimi, duke shkelur Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës.

Dështimet në zbatimin e reformës dhe të metodologjive të reja mësimore, përkundër trumbetimeve të mëdha lidhur me trajtimin e mësimdhënësve, trajnimin e mësimdhënësve. Suksesi i dobët i treguar i nxënësve në testin kombëtar, mos organizim të paratestit nga drejtoria arsimore në mungesë të letrës etj.

Mënyra e shpenzimit të buxhetit të shkollave nga ana e drejtorisë komunale është skandalozë dhe si duket askush nga kompetentët nuk shikon se si shpenzohen dhe sa ka shpërputhje në këtë aspekt. Ja një shembull: shkolla "Gjon Sereçi" në proporcion me nxënësit që ka shpenzon një herë më shumë buxhet se sa ta zëmë shkolla "Tefik Çanga" për më tepër drejtoria.....

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri, përgatitet deputeti Januz Kastrati

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvendi i nderuar, Z. Kryetar. Kamë nevojë dhe ndiej obligim, që në mënyrë publike me kërkuar falje prej doktor Baliqit, në fjalën e tij në lidhje me "Vero naukën". Është shqetësuese fakti se një intelektual i nivelit të caktuar, i kyçur në politikë mos me e pasur të kjartë terminin fazën juridike: shtet profan, shtet civil, shtet qytetarë, e të gjitha këto profile të shtetit është e ndarë me ligj feja, religjioni si sistem vlefte, sistem i unikë, organizimi përcjelljes për procesin edukativo mësimor. Ato koekzistojnë, kohabitojnë në shoqëri, nuk kanë kundërshtim. Qytetari me të drejtat universale të tij e shfrytëzon atë të drejtë për ato lloj njohurish.

Shqetësues është fakti se këta e përdorin në konotacionin politik, besimtari kapet në këtë menjëherë dhe ai e siguron bazën e deleguese. Kjo nuk i duhet Kuvendit nuk i duhet as atyre si intelektual si deputetë.

Religioni mos me thellu në atë e ndërton "cilitate dej" një shoqëri rinore. Kërkush nuk ka kundër atij koncepti, atij tretmani, shoqëria qytetare e ka një orientim tjetër, racional shpjegimit të fenomeneve. Për atë e theksoj këtë si nevojë publike për me u distancua lidhur me atë motiv – motiv propagandues të tyre. Për një çështje tjetër e cila më tangon dhe kam nevojë me e dhënë mendimin tim është një segment i pozitës së arsimtarit, e që është ana financiare paga, është shqetësuese, brengosësh një qëndrim poshtërues, fyes ndaj personalitetit të arsimtarit, ndaj dinjitetit të tij. Kjo pozitë kesi soji jo e lakmueshme ndikon edhe shumë në atë në koeshiencën profesionale. Ai me gjithë qenen e tij nuk i shpjegon njësitë metodike që i ka të parapara në program. Me sjelljet dhe veprimin e tij jo korrekt ndikon në etikën e detyrës.

Sugjerim: dje u fol për një – do tri fonde 30 e sa milion, u përmend edhe një suficit prej ndërtimeve kapitale prej 50 e sa milion. Ky Kuvend e ka atë kompetencë me e bë ridestinimin e këtyre mjeteve, vetëm është e nevojshme që të kanë invencion, iniciativë, Komisioni për Arsim me dal në Kuvend e me plotë kompetencë me e bë një gjë të tillë. Kishim me e parandaluar një lëvizje e cila është reale, e mundshme me na ndodhë tash apo ma vonë. Kur nuk është vonë mu kthye mbarë, kur nuk është vonë me e sanuar një gjendje kur shihet se ka lëshime.

Edhe një çështje tjetër, që është jashtë temës, por është lidhur ngushtë me temën. Politika rigide e Ministrisë ndaj numrit të pranimit të studentëve, për çdo vit dalin ka 22 mijë, kjo politikë rigide po e theksoj rigide i merr 5000 dhe 2000 tjerë me korrespondencë, e përpara në atë sistemin që ne e gjykojmë gjithqysh, Universiteti i ka pasur 48.000 studentë edhe janë marrë 9.000 edhe në mënyrë të pakufizuar me korrespondencë. E drejtë universale e këtyre të rinjve dhe qëndrim human që pritet prej arsimit, që me ua dhënë të drejtën të gjithë këtyre studentëve me u regjistrua, me konkurruea për regjistrim, por me një racionalizim i cili mundet me u bë ...

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit Profesor! Fjalën e ka deputeti Jonuz Kastrati, përgatitet deputeti Berat Luzha

DEPUTETI JONUZ KASTRATI - I nderuar Kryetar, i nderuar ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Është mirë që gjendja në arsimin, në arsimin fillor dhe të mesëm të debatohet në këtë nivel dhe me këtë rast përgëzoj ministrin Veliu për gjithë punën që është bërë në Ministri, si dhe të gjithë donatorët e sidomos ata të jashtëmit që ndihmuan në përparimin e arsimit. Na bënë përshtypje të mirë fakti, që ndër sfidat e Ministrisë përmendet gjendja jo e mirë materiale e arsimtarëve e që gjithsesi ndikon në edukimi dhe arsimimin e gjeneratave.

Edhe pse shkollat përmenden si institucione edukative dhe arsimore, më duket sikur aspekti edukativ është zbehur pak sa kohëve të fundit, në vend që të shkoj drejtë avancimit.

Më gëzon fakti se nga 439.445 nxënës sa ka në arsimin parauniversitar, mbi 200.000 janë femra e që tregojnë një ngritje të përfshirjes së femrës në arsimim. Në këto shënime

statistikore për vitin shkollor 2006-2007 mungon struktura kualifikuese e punëtorëve dhe me këtë rast shpreh shqetësimin tim se, si edhe më tej kompensohen si të kualifikuarit ashtu edhe të pakualifikuarit. Përveç saj nuk merret parasysh as përvoja, por që shpresojmë se këto do të rregullohen në një kohë sa më të afërt. Ndër rezultatet e pritura të shënuar në këtë material përmendet edhe rritja e përfshirjes në arsim e që gjithsesi duhet t'i kushtohet kujdes i shtuar, sepse më duket krejtësisht i pakuptimit fakti se derisa në vitet '60 - '70 të shekullit të kaluar, njerëzit kanë pasur mundësi të kryejnë edhe fakultete, tash nipat dhe mbesat e tyre nuk mund të regjistrohen të gjithë në shkollat e mesme. Për shembull në komunën ku unë punoj dhe jetoj, në vitin e ardhshëm shkollor, nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje mund të mesin pa u regjistruar në shkollën e mesme së paku 400 nxënës. Në pjesën ku është dhënë numri i institucioneve arsimore edukative në Kosovë shihet se nga 1117 shkolla - 458 janë paralele të ndara, e ku sipas meje duke i pavarësuar këto paralele do të forcohet institucioni i përgjegjësive. Nuk mund të kërkohet përgjegjësi nga njerëzit për atë që nuk paguhet. I kam të qarta edhe kriteret e parapara, por mendoj se duhet bërë ndryshime në këtë drejtim. Përgjegjësit e shkollave, krahas përgjegjësive konsideroj se duhet të kenë edhe kompetenca sepse, nëse në asnjë vend nuk kërkohet nënshkrimi i drejtorit, atëherë për pak kompetenca mund të flitet.

Një shqetësim i madh gjithsesi është, se edhe më tej ka raste ku në një shkollë ushtrojnë detyrën dhe marrin pagë nga dy drejtorë, e që sipas meje është ky një paralelizëm që komunat, sikur është rasti i komunës sime e bëjnë Ministrisë të Arsimit, e që nuk do të duhet lejuar të vazhdoj më tej në këtë drejtim. Me gjithë vërejtjet dhe sugjerimet që kemi, unë shohë me optimizëm mundësinë e edukimit dhe arsimimit të gjeneratave të ardhshme, kuptohet me angazhimin edhe më të shtuar të gjithë pjesëmarrësve në veprimtarinë e arsimit. Prandaj në fund, inkurajojmë ministrinë që të vazhdoj me hapa të tjerë që ndikojnë në përparimin e arsimit në Kosovë, sepse hapat e hedhur deri më tash, sigurisht se janë të vlerësuar pozitivisht. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, përgatitet deputetja Zylfije Hundozi

DEPUTETI BERAT LUZHA – Ju faleminderit Z. Kryetar që më dënuat që më latë krejt të fundit. Hera e parë që jam vonuar.

(Kryetari, është dënim i elektronikës e jo i imi, të lutem)

Vazhdon Berat Luzha - Në fjalën e tij Ministri tha se deputetëve ju është shpërndarë një material voluminoz, në fakt deputetëve iu ka shpërndarë një informatë mjaft e varfër vetëm në 13 faqe. Informata e Ministrisë së Arsimit jo vetëm se nuk është voluminoze, por është mjaft e mangët dhe jo reale. Në asnjë mënyrë nuk mund të flitet për të arritura në arsim, përkundrazi mund të flitet për dështimet e një pas njëshme. Arsimi sot ndodhet në gjendjen më të rëndë të mundshme, në gjendje të mjerueshme. Niveli i arsimit është edhe më i dobët se që ka qenë para 10 vjetëve, kur mësimi zhvillohej nëpër podrumë.

Në informatë thuhet se funksionon sistemi unik arsimor, në fakt funksionojnë dy sisteme paralele për çka fajtoje nuk është Ministria, megjithatë edhe arsimi në serbisht financohet nga buxheti i Kosovës, dhe nuk duhet t'i lejohet Ministrisë të mos e di as numrin e nxënësve, as numrin e arsimtarëve të cilët duhet t'i paguaj as numrin e

shkollave me mësim në gjuhën serbe. Në informatë nuk kemi as një shifër për këto gjëra, të paguash dike e të mos dish se kush është ai dhe çka punon ai është krejt e pakuptueshme. Mësimi në shumicën e shkollave zhvillohet në tri e katër ndërresa me numrin të tepër të nxënësve nëpër klasa, kurse orët e mësimit janë të shkurtuara deri në 30 minuta. Merrni me mend se çfarë cilësie e mësimit mund të mbahet në klasën me mbi nxënës e me orë të mësimit 30 minuta. Në vend të mbarëvajtjes së arsimit dhe sukseseve kemi rënie drastike të cilësisë së mësimit, kemi rënie të disiplinës së nxënësve në mësim dhe të arsimtarëve në punë, kemi rritje të dhunës, kemi braktisje të shkollave, kemi rënie të interesimit të nxënësve për mësim etj. Pagat e mësimdhënësve janë tepër të ulëta, çështje e cila po ndikon shumë në funksionimin e arsimit. Mendoj se Ministria deri tash nuk ka bërë asnjë përpjekje serioze që kjo gjë të përmirësohet. Pse ende nuk zbatohet kontrata kolektive, e cila është nënshkruar disa herë?

Në nivelin qendror ka mos koordinim në mes të dy ministrive, asaj të Financave dhe të Arsimit. Ky mos koordinim po shkakton huti dhe probleme të mëdha në mbarëvajtjen e arsimit.

Ministria nuk mund të lavdërohet për sukses në ndërtimin e objekteve shkollore. Vetë fakt i cili pranohet edhe në informatë se ende ka shkolla që mësojnë në kontenier flet më së miri. Në informatë thuhet se Ministria për vitin 2007 ka paraparë të investojë në 50 projekte, duke përfshirë këtu ndërtimin, renovimin dhe zgjerimin e shkollave. Se sa nga këto 50 projekte do të realizohen është çështje tjetër. Listën e këtyre objekteve Ministria nuk ia ka bashkëngjitur informatës, por unë dua të theksoj se asnjë nga këto 50 projekte nuk është paraparë të ndërtohen në komunën e Kaçanikut. Nga 24 shkolla të reja që i paska ndërtuar kjo Qeveri nga viti 2005, asnjë nuk ndodhet në komunën e Kaçanikut. Nga 29 shkolla të renovuara përsëri, asnjë në komunën e Kaçanikut. Të theksojmë se kjo Qeveri që nga marrja e mandatit në dhjetor 2004 e deri sot, nuk ka realizuar asnjë projekt për komunën e Kaçanikut. Ka tri vjet që një projekt i vetëm për ndërtimin e një shkolle të fshatit rri i kyçur në sirtarët e Ministrisë, pa gjasa për t'u realizuar ndonjëherë.

Përzierja e Ministrisë në zgjedhjen e drejtorëve të shkollave është një temë tjetër. Përfaqësuesit e Ministrisë në komisionet intervistuese për drejtorë shkollash veprojnë me direktiva nga lart, duke mos përfillur kriteret profesionale dhe as cilësitë e kandidatëve. Kriteri i vetëm i tyre është përkatësia partiake. Ka ndodhur që në Kaçanik edhe pas tri konkurseve të mos zgjidhen drejtorët në dy shkolla, sepse përfaqësuesit e Ministrisë në komisione ..

KRETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, përgatitet deputetja Fatmire Mulhaxha

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z. kryetar, z. Ministër, deputetë të nderuar. Unë sot dua ta përgëzoj Sindikatën e cila ka arritur që me këmbëngulësinë e vet ta shtyjë Komisionin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji që ta mbajë dëgjimin publik me ta dhe njëkohësisht ta vë në rend të ditës temën e arsimit për diskutim në këtë Parlament. Edukim dhe arsimit paraqesin një rëndësi prej shtyllave të shtetit, prandaj është e dhe prioriteti i Qeverisë. Shteteve që e kanë kuptuar dhe që kanë bërë investime afatgjate në arsim, siç është India, një shtet i varfër, por i cili ka investuar shumë në këtë lëmi, vitet e fundit po i shpaguehet me zhvillim të madh ekonomik dhe rritje të GTP-së për 8 deri 9% për çdo vjet.

Ky shtet, dikur shumë i varfër, falë investimeve afatgjate në arsim, sot është bërë vend udhëheqës në zhvillimin e teknologjisë informative dhe sistemit bankar në tërë botën. Investimi më i madh në arsim në Kosovë është imperativ i kohës, pasi që Kosova po përgatitet për investime të huaja, që vetëm me forcë punëtorët e aftësuar në përputhje me trendët botërore do ta gjejnë leverdinë e vet. Si ta arrijmë këtë? Motivi është forca shtytëse që e shtynë njeriun të bëjë veprime të caktuara. Pra, duhet të rritet motivi i arsimtarëve për punë e kjo do të arrihet vetëm duke i rritur pagat e tyre. P,a rritje të pagave nuk ka zhvillim të mirëfilltë të arsimit në Kosovë. Të bëhet puna e arsimtarit, arsimimi i fëmijëve, punë primare dhe e vetme. Kot investohet në trajnime, përpilime të kurikuleve, kur nuk ka motive të zbatohen ato.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës me shitjen e licencës për Operatorin e Dytë të Telefonisë Mobile është rritur për 75 milion euro. Qeverisë i mbetet që të gjejë rrugë dhe metoda adekuate që të bindë Fondin Monetar se rrogat e punonjësve në arsim duhet të rriten, se prej kësaj varet e ardhmja jonë.

Nën 2, ndërtimi i shkollave të reja dhe plotësimi me infrastrukturë dhe riparimi i shkollave ekzistuese, nga suficiti i përmendur dje në këtë Kuvend.

Nënë 3, menaxhimi adekuat i shkollave fillore dhe të mesme, vendosja e njerëzve të përgatitur për këtë punë, e jo drejtorë të politizuar.

Nën 4, pos pagesës adekuate të arsimtarëve të bëhet edhe stimulimi i nxënësve dhe i shkollave më të mira, gjë që do t'i stimulonte nxënësit të mësojnë më mirë. Le të jetë kjo shumë simbolike prej 10 euro në muaj, e që në ditë paraqet 3,3 cent dhe

Nën 5, vetëdijesimi i popullatës për vazhdim të shkollimit, se statistikat e bëra kohëve të fundit tregojnë që ka rënie të numrit të nxënësve, sidomos të femrave që e vazhdojnë shkollimin pas shkollës fillore.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!Fjalën e ka deputetja Fatmire Kollçaku, përgatitet deputeti Ibush Jnuuzi

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar. Përshëndes të gjithë të pranishmit e në veçanti përfaqësuesit e SBASHKUT që janë këtu sot me neve këtu dhe besoj me vëmendje po na dëgjojnë, do me thënë Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Unë do të flas konkret për disa çështje që deri tani nuk janë fol, se është biseduar shumë për të gjitha problemet që janë në sistemin e arsimit sot në Kosovë.

Është biseduar, është prekur pak çështja e gjeneratave me të cilat po eksperimentohet. Konkretisht është bisedua për klasën e 13-të që këtë vit do të jenë maturantë dhe ata kanë pësuar. Mirëpo tash është në prag edhe një eksperimentim tjetër me klasën e katërt fillore.Do të thotë nxënësit, të cilit këtë vit do ta përfundojnë klasën e katërt do të jenë gjithashtu, pjesë e një reforme, por unë e quaj eksperiment, sepse, duke mos u krijuar kushte paraprake, ne hyjmë në reforma dhe çka ndodhë kjo gjeneratë, e cila tani do të

diplomojë, nuk i ka pasur as plan-programin as nuk i ka pasur librat për atë për çka është dashur ta vijojë atë vit shkollor.

Tash po flasim për edukatorët, do të thotë mësuesit. Po e them një rast konkret në komunën e Pejës ku në shkollën fillore "Lidhja e Prizrenit" dhe tash po flas në cilësinë e prindërit dhe të gjithë prindërve tjerë të brengosur. Është paraparë që kjo gjeneratë të shkojë edhe në klasën e pestë me mësuesin e vet, do të thotë të mos kalojë si përpara me arsimtar. Mirëpo, çka po ndodhë? Aty propozohet që një vit, në klasën e pestë të ndërrohet mësuesi, do të thotë vjen vetëm për një vit mësuesi tjetër, ndërsa mësuesja e cila i ka përcjellë për katër vite të merr gjeneratën e re dhe pas vitit të ardhshëm përsëri të kalojnë në ciklin, do të thotë me arsimtarë. Unë e quaj këtë eksperiment dhe këtë brengosje të prindërve po e përcjelli te Ministria që të ketë kujdes, të mos të ndodhin eksperimente, secila komunë të bënë model për veti, por të jetë një model i cili do të vlejë për të gjitha shkollat në qoftë se hyjmë në reforma para përgatitjeve paraprake të cilat janë më se të nevojshme. Nënë dy, kisha dashur që Ministria e Arsimit ta marrë parasysh çështjen e personave me aftësi të kufizuara dhe me një intervenim shumë të vogël, të ketë parasysh edhe ata kanë të drejtë shkollimi, edhe shkollimin para universitar dhe objektet, do të thotë të jenë në përputhje me nevojat e tyre. Një fëmijë që është në karrocë ka të drejtë që të jetë me fëmijët tjerë në shkollimin e rregullt, por atij nuk i mundësohet qasja. Do të thotë hyrjet të adaptohen në bazë të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Çështja e tretë për të cilën edhe do të flas është çështja e Sindikatës, sepse me një kërkesë qysh e kuptova nga Përfaqësuesit e Sindikatës së Arsimit ka qenë kërkesa që letra e tyre t'iu distribuohet sot edhe deputetëve paraprakisht, që të jenë të njoftuar me kërkesat e përfaqësuesve të Sindikatës. Kjo nuk ka ndodhur dhe nuk e dimë arsyen. Ndoshta duhet të mos harrohet që Sindikata ka qenë partner shumë konstruktiv deri tani dhe një faktor i stabilitetit, sepse jo vetëm që ka qenë e mashtrome, jo vetëm që ka qenë nënshkruese e një letre që quhet Kontratë Kolektive, e cila kurrë nuk është zbatu dhe për të cilën askush nuk është skuqur, për të cilën një kryeministër nuk e merr obligimin e kryeministrit tjetër, por thotë shpesh nuk i njohin obligimet që janë marrë para tyre dhe një sindikatë që ka treguar konstruktivitet duhet shumë të respektohet, duhet të kihet parasysh kërkesat e tyre. Kërkesa që janë në këtë letër janë shumë zonja dhe zotërinj të thjeshta, janë kërkesa minimale, kërkesa për mbijetesë, që kërkojnë të shqyrtohen me një vëmendje të posaçme edhe nga ne deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe nga Ministria dhe shpresojmë se rekomandimet që do të dalin pas kësaj seance, do t'i marrin parasysh.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi, le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi

DEPUTETI IBUSH JONUZI - Ministër, deputetë të respektuar, zonja dhe zotërinj, Do të jem i shkurtër, sepse nuk është punë e zanatit tim. U tha shumë për arsimin. Arsimi është i një rëndësie të veçantë. Do të ndalem vetëm në çështjen e arsimit në mërgatë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të hartojë program të veçantë për nxënësit në mërgatë. Kjo pjesë e popullatës sonë ka nevojë të përkrahet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga Qeveria e Kosovës me qëllim që gjeneratat e reja përmes mësimit plotësues të gjuhës shqipe të jetojnë me Kosovën edhe në mërgatë. Mërgata shqiptare ka bërë shumë për arsimin në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, përgatitet deputeti Zylfi Merxha

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - I nderuar z. kryetar, i nderuari z. ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Nuk e pata ndërmend të flas, por këtu dëgjova disa përshkrime të gjendjes materiale jashtëzakonisht të keqe të shkollave fillore dhe të mesme, që unë pajtohem se janë në gjendje të mjerueshme. Mirëpo mos të harrojmë se para 8 viteve në disa prej shkollave tona, ato kanë qenë të shndërruara në kazerna dhe si të tilla janë shkatërruar dhe nuk mund të kemi ne një shkop magjik t'i ndërtojmë ato përnjëherë, por çdo gjë bëhet hap pas hapi.

Ajo që nuk u përmend sot dhe nuk u pa se është përfshirë në raportin e Ministrit të Arsimit është një segment shumë rëndësishëm i shoqërisë kosovare e lidhet me mos shkollimin apo pamundësinë e shkollimit të një kategorie të nxënësve të gjinisë mashkullore për shkak të ngujimit të familjeve, për shkak të gjakmarrjes apo hasmisë që janë me njerëzit e tjerë. Për këtë kategori mendoj se duhet, ose të ndërmerret diçka që t'u mundësohet të shkojnë lirshëm edhe ata në shkollë dhe t'u bashkohen kolegëve të tyre shkollarë ose të hartohet ndonjë projekt që do t'u mundësojë arsimimin në shtëpitë e tyre. Hiq më pak se një muaj kemi hasur në shkrim në gazetën tona se në një fëmijë 8 vjeçar mashkull është i mbyllur në shtëpi dhe ka pesë – gjashtë muaj që nuk shkon në shkollë për shkak se familja e tij ka ra në hasmi me një familje tjetër dhe nuk i jepet leje që të shkojë në shkollë. Kjo është e mjerueshme për ditët e sotme dhe duhet të ndërmerret diçka sa më parë.

Përndryshe Raportin e ministrit të Arsimit e vlerësoj si një raport korrekt dhe nuk mund të mendojmë ne, të paramendojmë ne gjendjen materiale në shkollat tona dhe atë ta krahasojmë me shkollat që janë në vende më të zhvilluara dhe që kanë standard shumë më të lartë.

Është e vërtetë se vetëm dy metra e gjysmë katror janë të siguruar për një nxënës, por besoj se, nëse realizohen të gjitha projektet dhe nëse të gjithë angazhohemi që të kursejmë dhe të mos abuzojmë mjetet shoqërore dhe mjetet e tatimpaguesve do të na dalin edhe mjete edhe për ngritjen e pagave të arsimtarëve, të mësimitdhënësve, por edhe për krijimin e kushteve më të mira për shkollim. Prandaj, angazhohem që pozita materiale e punëtorëve të arsimit të përmirësohet, angazhohem për përfshirjen sa më të madh të numrit të nxënësve, mundësisht të gjithëve në shkollim, sepse më mirë është të kemi të papunësuar të shkolluar, se sa e kundërta, të punësuar e të pa shkolluar. Gjithashtu angazhohem që të ndajmë në buxhetin e ardhshëm më shumë mjete për fushën e arsimit.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha, përgatitet deputeti Rifat Krasniq

DEPUTETI ZYLFI MERXHA – Ju faleminderit z. kryetar, z. ministër, zonja dhe zotërinj që jeni këtu, deputetë të nderuar, po ashtu mysafirë lartë që po na dëgjojnë.

I dëgjova 46 a 7 emra, në diskutimin e vet që e folën profesionalisht, që po e njohin punën e vet edhe situatën e arsimit në Kosovë. Mirëpo, kisha ba një pyetje po ja nisi prej kryeparlamentarit Kolë Berishës edhe ministrit, po ashtu, të gjithë kolegëve, asnjani nuk i përmendi të gjitha shkollat janë rrënu, duhet t' i bajmë kështu e ashtu, por derisa do të presim na romët që të shkollohemi në gjuhën amtare, që 8 vjet kaluan pas luftës. Na a do të arsimohem apo jo? Në qoftë se jo e lypi përgjigjen, në qoftë se po – kur dhe qysh se po me duket, Kosova e pavarur- sovranë po bohet. Në qoftë se nuk i arsimoni, e tue ditë se arsimimi i romëve është ma i ulët në Kosovë, qysh do ta mbani veten? Këtë se kam thënë as në Vjenë as para ambasadorëve, por po e them para Parlamentit tim se këtu është një demokraci ku është pozita edhe opozita. Deri kur edhe sa duhet të presim apo të himë të bajmë asimilimin e krejt romëve, sikur unë që jam shkolluar në gjuhën shqipe, le të shkollohen edhe ata, mirëpo të gjithë nuk bëhen Merxha. Ata donë ta dinë gjuhën e vet, prejardhjen, historinë, veshën e vet. Ju lus juve, deri tash dëgjova edhe nuk u zemërova që nuk e mora fjalën, ndoshta është gabim i madh gjithmonë peshku i madh e han peshkun e vogël, i vogël unë jam. Mirëpo, kjo që u ndodh, vetëm një krenari kom ndaj romëve të mi, që në burg ta dini nuk e keni asnjë rom për kriminalitet, për vjedhje, për mbytje, për drogë për tjera gjana. Na të gjithë çka po ndodh e mira e Kosovës është edhe e mira e romëve, por ju të gjithë këtu çka jeni deputetë, kolegët e mi, na keni harru, na keni lënë në skaj. Ju lus juve edhe ministrin e Arsimit mos të na le vetëm tha : Pak janë romët, egjiptas, ashkalijë, s' di çka pak. Na pak jo, po shumë jemi. E kjo është disa herë që e kam kërku, kurrë s' kam marrë përgjigje, por kësaj here besoj se që ky Parlament e kam meritë, e du këtë Parlament edhe e meritoj të kem një përgjigje të ndershme që edhe romët e mi të shkollohen sikur të gjithë fëmijët e juaj, që po doni të shkollohen sa më naltë edhe na të jemi diku, të mos jemi qorr me dy sy. Në qoftë se na lejohet mësim shtesë dy e dy, shqip po na mëson bon katër. Molla është mollë, dardha është dardhë, pse nuk na mësojnë molla në gjuhën rome është **pabaj**, me na mësuar në gjuhën rome çka është ose dy e dy bajmë katër. Në gjuhën rome thenë **shtrar**, po edhe ato na japin në gjuhën shqipe edhe krejt janë arsimtarët shqiptarë

Unë po ju pyes edhe një herë: A do të hynë në ligj që romët të shkollohen apo jo? Se këtu po flitet edhe gjuha boshnjake edhe gjuha serbe edhe gjuha turke. Unë nuk kam lypë kur të flas një gjuhë tjetër jashta shqipes, për atë po ju lus që të më ndihmoni mu edhe popullin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rifat Krasniq, përgatitet deputetja Sala Berisha- Shala

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ –Ju faleminderit z. kryetar, I nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë

Para se ta filloj fjalimin tim, në emër të Grupit parlamentar 6+ dhe në emrin tim dëshiroj të përsënder të gjithë mësuesit dhe arsimtarët të cilit japin kontributin zhvillimit të arsimit në Kosovë, sepse sipas mendimit tim ata janë me të vërtetë personat që mundohen të zhvillojnë arsimin në Kosovë në një mënyrë sa më të mirë, jo vetëm pas luftës, por edhe para luftës.

I nderuar ministër, ne, përfaqësuesit e turqve dhe boshnjakëve kemi pasur një debat më datën 27.6.2006 lidhur me arsimin dhe librat në gjuhën turke dhe boshnjake. Në këtë debat kanë qenë të ftuar ministri i Arsimit dhe Komisioni Parlamentar për Arsim, por fatkeqësisht në këtë mbledhje nuk kanë marrë pjesë asnjë prej këtyre.

Në këtë debat janë dhënë informata që botimi i librave në gjuhën turke dhe boshnjake kushton 1.450.000 euro dhe me sigurimin e kësaj shume mund të zgjidhet problemi i librave. Ky problem z. ministër është që 7 vite, na tue lyp, tue jap kërkesa që këtë problem me e zgjidhë, se kurxho tjetër problem s' kemi. Në shkollën fillore "Naxhi Ymer Lutfi" në Mamushë, janë 899 nxënës. Buxheti i shkollës është 227.900 euro. Prej kësaj shume 152.900 euro janë ndarë për rroga, kurse 75.000 janë për shpenzimet e tjera, por që 7 vjet kjo shumë e shpenzimeve nuk janë përdorur për shkollën fillore të Mamushës.

Na disa here kemi pyetur drejtorin e Arsimit të Prizrenit z. Hasan Hotin, kurrë përgjigje nuk kemi marrë. Ku janë shpenzuar ato para 75.000 euro që 7 vjet? $7 \times 7 = 49$, do me thënë 500 mijë euro, as 5 euro nuk ia kanë ndarë, nuk i ka shpenzuar shkolla fillore e Mamushës. Besoni ju lutem zotërinj deputetë edhe z. ministër.

Me hy në shkollën fillore në Mamushë, kishit thënë se nuk jemi në shekullin XXI. Unë para dy muajve kam dal nëpër shitore, kam kërkuar 5 euro, euro dhe me ato të holla i kemi ndreq do ngjyra, sende.

Pilot njësia e Komunës së Mamushës ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje lidhur shpenzimet, të cilat janë ndarë për Mamushën. Më dt. 31.8.2006 ishte kërkuar përcjellja lidhur me këtu. Para se përfundoj fjalimin tim ftoj ministrin e Arsimit z. Agim Veliun dhe kryetarin e Komisionit për Arsim z. Enver Hoxhaj, me anëtarët e Komisionit, të vizitojnë shkollën fillore në Mamushë.

Ju faleminderit shumë z. kryetar. Kjo ka qenë fjala ime.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha Shala, të përgatitet deputetja Qibrije Hoxha

DEPUTETJA SALA BERISHA- SHALA - Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, i nderuar z. ministër.

E kam lexuar materialin e Ministrisë, por nuk do të ndalem në komentimin e tij, sepse është një material jashtëzakonisht i varfër. Unë dok të përpiqem t'i shfrytëzoj minutat në vazhdim.

Qasja jo e drejtë dhe jo e njëjtë e Qeverisë ndaj arsimit në tërë Kosovën, përkatësisht dallimi esencial në mes të kushteve të mësimdhënies dhe mësim nxënies në qytet dhe në zonat rurale është një qasje që reflekton më tutje në konkurrimin e këtyre nxënësve për shkollim të mëtutjeshëm. Kjo qasje jo e drejtë ka filluar menjëherë pas luftës, kur gjatë fazës emergjente në Kosovë ka pas donacione edhe në këtë fushë. Po e marr një shembull shumë të thjeshtë: derisa një shkollë e Prishtinës pajiset me 30 kompjuterë, në fshatrat e Drenasit mësojnë nëpër tenda. Dihet pastaj se si do të jetë konkurrenca në mes këtyre nxënësve për të vazhduar më tutje dhe Qeveria asnjë hap nuk e ka bërë në

drejtim të nivelizimit të drejtës së arsimit të atyre fëmijëve që janë rritur në kushte jo të barabarta më herët, do me thënë edhe që kanë përjetue edhe momentet e luftës.

Pra diferencimi e ka zanafillën më herët qysh në fazën e donacioneve e po vazhdon tani edhe më tutje, kur këtë obligim për arsim e ka Qeveria. Problem në vete që dëmton tërë nxënësit në Kosovë është edhe eksperimentimi me reforma për të cilin nuk do të shkoj më tutje.

U përmend në materialin e Ministrisë se janë nxjerrë 100 udhëzime administrative për ta bërë të zbatueshëm Ligjin për Arsim, por nuk e di se çka rregullojnë ato 100 udhëzime. Për shembull nuk e di se a rregullohet përdorimi i uniformave të nxënësve në shkolla, a është e rregulluar ashtu që, sa herë të ndërrohen drejtorët në shkolla, të ndërrohet edhe ngjyra e uniformave dhe nxënësit të jenë të obliguar të blejnë tjera uniforma. Ky është një shembull konkret në një shkollë të Prishtinës, në shkollën fillore "Ismail Qemajli" që ka ndodhur tash së fundi.

Një tjetër çështje që është dashur ta ketë parasysh Ministria, mendoj në Kosovën e pasluftës, e që nuk e ka perceptuar si të domosdoshme, është prezenca e psikologut apo e pedagogut në këtë nivel të arsimit në Kosovë. Unë mendoj që ta ketë si rekomandim Ministria e Arsimit që t'i obligojë shkollat fillore dhe të mesme që ta kenë në stafin e tyre pedagogun ose psikologun.

Pastaj, u përmendën edhe shumë çështje të tjera nga kolegët e mi rreth plan programeve arsimore dhe të mos të vijmë në konfuzion që gjysmë vjetorin e dytë si prind të obligohemi t'i blejmë ndoshta dy parë tekste, një parë tekste në fillim dhe një parë tjera në gjysmë vjetorin e dytë. Kaq. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Dy kandidatët e fundit janë Qibrije Hoxha dhe Fetah Berisha, të dytë kanë diskutuar nga një herë dhe nuk e shoh të arsyeshme të paraqiten përsëri.- Vetëm nëse keni polemikë – replikë. Urdhëro

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA - Replikë – 1 minutë
Ju faleminderit z. kryetar,

Unë desha vetëm të replikoj me z. Bajrush Xhemajli edhe pse nuk mu ka përmend emri, por ai ka aluduar në fjalën time, kur thash se: Opozita nuk ka dal me propozime konkrete rreth zgjidhjes së situatës në arsimin fillor dhe atë të mesëm. Po e shfrytëzoj rastin t'i propozoj opozitës që unë jam e gatshme, që në bazë të fjalës së z. Enver Hoxhaj që e kemi në transkript, unë jam e gatshme që të debatoj në media në çdo kohë sepse kështu bëhet në shtetet demokratike dhe besoj që do t'i kontribuojmë çështjes së arsimit dhe të shohim se cilat propozime i ka dhënë z. Enver Hoxhaj në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Vete a ki replikë? Nuk t'u ka përmend emri. Urdhëroni z. Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit për replikën. Po edhe unë besoj që z. Enver Hoxhaj ka dëshirë të debatoj dhe mendoj që nuk është një debat i barabartë, por sidoqoftë mund me dal kurdo që të kanë nevojë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Diskutimi ka përfunduar. E thërras hartuesin e mocionit nëse ka diçka të thotë
Hartuesi i mocionit ka të drejtë ta marrë fjalën

DEPUTETI ENVER HOXHAI - I nderuari z. kryetar, i nderuari ministër, të nderuar deputetë.

Më lejoni që pas një konsulte që kemi pasur edhe me gjithë ata që merren me arsim në kuadër të grupeve parlamentare që janë në Kuvendin e Kosovës, të atyre që janë të pranishëm në Kuvendin e Kosovës sot, meqë po e shoh që një grup nuk është komplet i pranishëm, t'i ofroj tri rekomandime kryesore, të cilat në fund të fundit i zgjidhin të gjitha ato dilema, të gjitha ato shqetësime të cilat sot janë ngritur nga të gjithë deputetët. Për mendimin tim ka qenë një vlerësim pothuajse i drejtë dhe linear i situatës- gjendjes në arsimin fillor dhe të mesëm. Këto tri rekomandime janë me karakter afatshkurtër dhe mendojmë që do të jenë ndihmesë për Qeverinë e Kosovës, për Ministrinë e Arsimit që vërtet të fillojë t'i zgjidhë ato dilema të cilat ne i kemi ngritë gjatë ditës së sotshme.

Rekomandimi i parë është ky: Të bëhet arsimi në Kosovë, jo vetëm arsimi fillor dhe i mesëm, por të bëhet arsimi në Kosovë- prioritet kombëtar dhe të përfshihet në programin qeverisës për vitin e ardhshëm, por ta reflektoj ndjeshëm edhe praninë e tij në buxhet. Meqë është në interes të Kosovës, që edhe në program por edhe në buxhet thjeshtë arsimi të jetë prioritet vendimtar.

D dyta, të rivlerësohen të gjitha ligjet që deri më tash janë miratuar në fushën e arsimit fillor, të mesëm, të lartë, joformal dhe të tjerat dhe të shihen të cilat janë pengesat, sa miratohen, sa zbatohen këto ligje dhe sa janë afër realitetit të cilin e ka Kosova.

Rekomandimi i tretë është: të ngritet buxheti për arsim, të paktën të shihet mundësia nga suficiti buxhetor i vitit që e lamë, që për këtë vit të kemi ngritje të pagave të arsimtarëve, të kemi ngritje të investimeve kapitale dhe të kemi ngritje të buxhetit për mallra dhe shërbime. Kjo e fundit për mallra dhe shërbime nënkupton çdo gjë që ka të bëjë me pajisjen e shkollave, prej mjeteve më të thjeshta deri te mjetet më të nevojshme për mësim dhe për konkretizimin e lëndës mësimore. Jam shumë i sigurt që shumica prej jush do të kishin edhe rekomandime të tjera, por për mendimin tonë, në bazë të një konsulte të shkurtër me të gjitha grupet parlamentare, këto tri rekomandime i përmbledhin në formë të katalogut të gjitha ato shqetësime të cilat sot në një debat shumë të gjatë i kemi shpreh.

Përveç kësaj më lejoni që në emër të gjithë deputetëve që janë në Komisionin për Arsim t'ju shprehë gatishmërinë e tyre, që ne si Komision kishim qenë në dispozicion që rekomandime të tilla t'i zbërthejmë në formën edhe më të detajuar për çdo gjë që ka të bëjë me arsimin fillor dhe të mesëm sa përket debatit që kemi pasur ditën e sotshme.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Kërkoj qëndrimin e shëfave të grupeve parlamentare për këto veprime. Urdhëroni z. Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar

Mendojmë se debati i sotëm ka qenë mjaft produktiv. Nuk përjashtohet mundësia e hipër egzagjërimeve të çështjeve në mënyrë të ndryshme, por kjo ndodhë. Rekomandimet e shtruuara janë rekomandime të cilat janë bërë në konsultim të plotë me grupin tonë parlamentar, dhe ne e mbështesim dhe e inkurajojmë Qeverinë që në maksimumin e vet, në kuadër të mundësive reale që t'i marrë në konsideratë për zbatim në përpikëri të rekomandimeve të sotme.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Unë edhe një herë i falënderoj të gjitha grupet politike që janë në Parlament, që iu kanë bashkëngjitur këtij debati për një segment më vital - njëri nga segmentet ndër më vitalët në Kosovë, siç është arsimi fillor dhe i mesëm.

Pajtohem me rekomandimet që u dhanë nga konsultimi mes anëtarëve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë e të tjera, por mendoj që nga ky debat duhet të dalë edhe një propozim tjetër dhe e ka arsyzhmërinë e tij besoj mjaft të madhe. Është thënë edhe nga të tjerët më herët, por mendoj që ka ardhur koha që Universiteti i Prishtinës të ndahet së paku në tri universitete publike. Megjithatë në raport e keni dhe arsimit i mesëm është shumë i lidhur me Universitetin dhe nxënës që kryejnë arsimin e mesëm duhet të shkojnë diku dhe ky Parlament dhe Qeveria dhe Ministria duhet të mendojmë që të bëhet një liberalizim i regjistrimit të studentëve në universitetet e Prishtinës. Mendoj që kështu e kursejmë edhe buxhetin e familjeve edhe ashtu të varfra, të cilët detyrohen të regjistrohen me çmime të larta në universitetet private.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Për AAK-në Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit z. kryetar,

Ne gjithashtu e thamë që në fillim, që edukimi për ne është prioritet dhe siç e pamë edhe për të gjithë kolegët tjerë. Prandaj, rekomandimet të cilat u propozuan, mendojmë që janë veprime të cilat sjellin zgjidhje dhe përmirësimin e gjendjes në arsim. Gjithashtu presim dhe do ta japim kontributin tonë në këtë aspekt dhe presim nga Qeveria që t'i implementojë.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Genc Gorani nga ORA

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Reformiste ORA deklaroj se i përkrahim në tërësi rekomandimet që i propozoj z. Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit për Arsim dhe në veçanti insistojmë që këto rekomandime t'i përcillen Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, me qëllim të zbërthimit, të detajizimit dhe në veçanti të afatizimit të realizimit të këtyre rekomandimeve.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Džezair Murati

DEPUTETI DŽEZAIR MURATI - Hvala G. Predsedniçe!

Ja pdržavam primjedbe i predlagača današnje rasprave i mojih kolega koji su iznijeli i samo dopunio da se vodi računa o specifičnostima integrisanih manjinskih zajednica, kada su u pitanju udžbenici, priručnici, administrativna uputstva da se prevode na vrijeme. Nastavni planovi i programi da se talpdke prevode na vrijeme, prevod udžbenika za početak školske godine, takodje da se omogući, znači to je od prilike negde težište naše da ja ne bi bio duži odavde da se uzmu u obzir ove primjedbe. Ja mislim da to ne iziskuje velike troškove, nego samo iziskuje malo više shvatanja i razumijevanja naših problema. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju falënderoj. Nga LDD-ja. Urdhëroni profesor Muhaxheri, a jeni përfaqësues i ..

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Ku me marrë, është nderë me qenë anëtar atij grupi, po si jo.

Ju lutem, a bën në kuadër të këtyre tri rekomandimeve si primat mu marrë edhe politika e liberalizimit (Kryetari: në emër të kujt po flitni profesor). Jo bre në emrin tim. Unë nuk kam grup, jam kështu qe pa grup, ju e dini.

Ta formuloj në mënyrë koncize. A bën me u marrë në kuadër të tyre tri primatave edhe këto që e propozoj zotni Jakupi, jo zoti, mu marrë si primat politika e përfshirjes së studentëve, diçka me pagesë e nja 10 – 12 mijë pa pagesë, me i përfshi të gjithë ata 22.000 . Është e drejtë e tyre universale, ju lutem kjo duhet me kon primat i joni. U dhanë konstatime se çfarë vlefte përfaqëson arsimimi i popullit. Ju lutem te keni kujdes në lidhje me këtë. Kaq.

KRYETARI KOLË BERISHA – Më pëlqen ky propozim i juaji, por kur ta kemi këtë çështje para vetës, përndryshe sot kemi diskutuar rreth arsimit fillor dhe të mesëm. Milazim Haliti e ka fjalën

DEPUTETI MILAZIM HALITI – Ju faleminderit kryetar! Edhe pse ne nuk jemi konsultuar nga referuesi, megjithatë ne i përkrahim rekomandimet që u prezantuan këtu para Kuvendit. Mendoj se këto tri rekomandime dhe të gjitha diskutimet e tjera do të ndikojnë te ministri dhe Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji që të angazhohen dhe punojnë më tepër për përmirësimin e gjendjes në arsim në Kosovë. Ju faleminderit!

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Raport lidhur me funksionimin e arsimit fillor.

Arsimi si veprimtari me interes madhor kombëtar e posaçërisht arsimi fillor i cili përben bazen e një arsimi të mirefilltë sot është ne gjendje te mjerueshme në aspektin material, hapësirës mërsimore, me hapësira ndihmëse (sallat e edukimit fizik, kabineteve, bibliotekave dhe kopshteve te femijëve) mjeteve bashkëkohore teknike për mbajtjen e mesimit kompjuter internet etj .

Mungojnë kadri ndihmes psiko-pedagogjik ,psikologët dhe padagogët kur dihet se fëmijët e kësaj moshe që është specifike sa kanë nevojë për psikologë dhe padagogë .

Shkolla i është nenshtuar reformës.por pa përgaditje paraprake kadrovike dhe materiale - reforma është kopjim i shkollave të vendeve shumë të zhvilluara ku mbahet mësimi me qendrim ditor ne shkollë, ku nxënësi të gjitha problemet arsimore edukative i kryen në institucion-detyrat shtepijake mësimin plotësues shtuës, aktivitet e lira, si dhe persos afinitetet e lindura, ndërsa shkolla jonë punon në tri turne me numër shumë të madhë nxënësish në paralele.

Rrethi i shkollës ende nuk ka bazë materiale. por – edhe nuk është i vetëdijesuar që shkolla është e atij rrethi .

Centralizimi i tepruar që të kujton vitet e para te pasluftës se Dyte Boterore ku Ministria, Departamentet dhe DKA-te e kanë ngulfatur autonomine e insitucionit - kadri,drejtoret zgjedhen pa pelqimin e kolektiveve, pra iu imponohen atyre çka i demoblizon mesimdhenesit të jenë subjekt i një përparimi të gjithëmbareshëm të punës në shkollë,pra kolektivet shkollore nuk i njeh askush as qe i pyet për asgje .

Në të kaluarën ndarja e mjeteve materiale nëpër shkolla është bërë në bazë të sipërfaqes hapësinore dhe numrit te nxënësve, ndërsa tani ndarja e këtyre mjeteve bëhet pa kriter dhe lë mundesi për keqperdorime -ka dukuri abnormle qe është banale te permenden .P.sh për një xham të thyer apo nje bravë të prishur duhet drejtori të vrapojë edhe deri në një muaj qe nga Drejtorati t'i sigurojë ato .

Është koha e fundit qe situatë në arsim te shqyrtohet gjithaneshëm dhe të futet në binarët e interesit të veçantë kombëtar .

KRYETARI KOLË BERISHA – Shkojmë në votim të rekomandimeve. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë aktualisht janë 68 deputetë. Shkojmë në votim me ngritje dore. Ju faleminderit! A ka kundër? Nuk ka.

Konstatohet se miratohen rekomandimet e propozuara.

Pika e tetë e rendit të ditës

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës

Në pajtim me nenin 25.3 të Ligjit për konkurrencën, Komisioni për Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion, pas shqyrtimit të propozimeve, në bazë të intervistës me kandidatët, vendosi që Kuvendit t'ia rekomandojë emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës.

Rekomandimi i Komisionit bashkë me biografitë e kandidatëve u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit Raportues z. Ibush Jonuzi, ta marrë fjalën.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Ju faleminderit i nderuari kryetar, deputetë të respektuar, zonja dhe zotërinj,

Sipas konkursit të shpallur në tri gazetatat ditore, Komisioni Qeveritar ka pranuar 27 aplikacione, prej këtyre 26 kandidatë janë intervistuar nga Komisioni intervistues. Prej 26 kandidatëve të mundshëm për Komisionin Kosovar të Konkurrencës 10 prej tyre janë zgjedhur për listën, e cila i është paraqitur Kuvendit të Kosovës, respektivisht Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti dhe Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Në bazë të Ligjit 2004/36 për konkurrencën, emërimi i anëtarëve, neni 25, pika 25.1 Komisioni Kosovar i Konkurrencës përbëhet nga 5 anëtarë. Bazuar në nenin 41 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 25, pika 25.3 e Ligjit për konkurrencën nr. 2004/36 në dokumentacionin personal të kandidatëve dhe të përshtypjes, rezultatet nga intervista e drejtpërdrejtë me kandidatët, Komisioni Parlamentar FunkSIONAL prej 10 kandidatëve të mundshëm i propozon këta 5 kandidatë, të cilët në Komision Parlamentar FunkSIONAL janë votuar me vota unanime.

1. Remzije Hajdari, juriste,
2. Mustafë Hasani, ekonomist,
3. Deniz Jonuzi, ekonomist,
4. Hysni Terziu, ekonomist dhe
5. Hydajet Hyseni, jurist

Pika 25.5 e Ligjit për Konkurrencën parasheh emërimin e anëtarëve sipas mandatit. Anëtari i parë një vit, dy anëtarë nga dy vite dhe dy anëtarë nga 5 vite. Hydajet Hyseni propozohet nga Komisioni të jetë anëtar me një vit, Hysni Terziu dhe Deniz Jonuzi, anëtarë me nga tri vite dhe Mustafë Hasani e Remzije Hajdari nga pesë vite.

Kandidatët e përzgjedhur i plotësojnë të gjitha kushtet formale, si dhe kanë përvojë të gjatë në lëmit përkatëse dhe për fund në emër të Komisionit Parlamentar FunkSIONAL i propozoj seancës plenare të Kuvendit të Kosovës që pesë kandidatët për anëtarë të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, të votohen. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Propozimin e hedh në votim. Urdhëroni z. Muhaxheri

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. kryetar që ma dhe mundësinë për me fol. Para nesh e kemi rekomandimin e Komisionit për zgjedhjen e kandidatëve dhe rekomandimin e Komisionit Parlamentar për këtë çështje.

Nga 25 persona, të cilët kanë dorëzuar aplikacionin për të konkurruar për Komisionin Kosovar të Konkurrencës, 26 janë intervistuar. Kryesisë së Kuvendit i është dorëzuar lista me 5 anëtarë, po i lexoj me emra, janë po të njëjtit që sot propozohen: Remzije Hajdari, Mustafë Hasani, Deniz Jonuzi, Hysni Terziu dhe Hydajet Hyseni.

Kryesia e Kuvendit, bazuar në ligjin ia ka kthyer Rekomandimin Komisionit se propozimin që e ka prurë në Kryesi të Kuvendit Komisioni për Tregti dhe Industri, nuk e ka përfillë ligjin të cilin e ka nxjerrë ky Kuvend. Ligjin të cilin e ka nxjerrë ky Kuvend është i 2004/36, thotë se nga të gjithë kandidatët që i propozon Komisioni, do me thënë 10 kandidatë që i propozon Komisioni, do me thënë 10 kandidatë, duhet të merren në intervistë, të intervistohen dhe 5 prej tyre t'i rekomandohen Kuvendit. Nuk

është përfillë ky ligj, i është kthyer Komisionit dhe Komisioni e ka bërë intervistimin. Çka ka ndodhur? Komisioni Kuvendit i propozon, pasi që i ka marrë në intervistë prapë pesë persona të njëjtë. Do me thënë ky Komision, pa i intervistuar këta anëtarë, ka qenë në dijeni se këta të pestit duhet të zgjedhen dhe i kanë kualitetet për t'u zgjedhur. Këta pesë qytetarë tjerë që nuk zgjedhen, e humbin besimin në institucionin e Kuvendit edhe në Komisionin.

Për të qenë cirkusi edhe më i madh zotërinj, këta të pestit kandidatë që propozohen janë pesë nga regjioni i Gjilanit. A është e mundur që nga 26 vetë që kanë konkurruar për Komisionin e Konkurrencës në finale na mbërrin pesë që janë të gjithë prej një regjionit edhe ata regjionit të Gjilanit. A thua nuk është shpërndarë dija për konkurrencë edhe luftimin e monopolit në pjesët tjera të Kosovës, por ka mbetur veç në regjionin e Gjilanit. Kjo mënyrë e përzgjedhjes prej fillimit kur është bërë Komisioni e deri tash ku ka ardhur në këtë finale, lë shumë për të dyshuar. Prandaj, i propozoj Kuvendit që të votojë kundër kësaj, t'i kthehet Komisionit në fillim për përzgjedhje edhe të kenë kujdes që të lejojnë një garë fer e atyre që konkurrojnë për të punuar në institucionet e Kosovës. Nuk është e mundur që 5 njerëzit që zgjedhën për Komisionin Kosovar të Konkurrencës të jenë prej Gjilanit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Deputeti Berat Luzha e ka fjalën.

BERAT LUZHA – Z. kryetar, kemi informacione edhe nga Komisioni, kemi konsultuar edhe këto biografite dhe del se përzgjedhja në Komision është bërë mbi baza partiake dhe mbi baza regjionale. Unë propozoj që, ose të hyjnë në votim të gjithë këta emra që janë këtu, ose të përsëritet procedura prej fillimit. Kjo do të ishte vërtet skandaloze. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Sadudin Berisha.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – Reagoj ashpër ndaj deklaramit të kolegut tim Gazmendit se të gjithë pesë kandidatët e rekomanduar janë nga Gjilani. Nuk është e vërtetë, le t'i shikojnë biografite e përcjella nga Komisioni për çdonjërin prej tyre dhe pikërisht sa duket, sikur të kishin qenë 5 nga Peja nuk kish me reagua, sigurisht do ta heshte. Po e vërtetë është pesë nga regjioni i Gjilanit nuk janë.

KRYETARI KOLË BERISHA - Replikë një minutë

DEPUTETI GAZMEND MUHXHERI – Ju faleminderit kryetar. Po i lexoj tash të gjithë janë të regjionit të Gjilanit: Remzije Hajdari, Kamenicë, Mustafë Hasani, Viti, Deniz Jonuzi - Gjilan, Hysni Terziu- Viti, Hydajet Hyseni- Gjilan. Prej dhjetëve të propozuar 8 janë të Gjilanit dhe të kemi kujdes, është problemi që diskutohet për Komisionit për Konkurrencë. Si është e mundur që ti do me i luftu monopolet a po e bartë krejt monopolin në një regjion e mos të them edhe në një parti politike ose një plan të ngushtë të interesit?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Propozimin e dhënë vë në votim. Kush është për?

Meqenëse elektronika nuk punon, nuk funksionon tash, atëherë votojmë me ngritje dore. Në sallë janë momentalisht 62 deputetë, 60 më falni s' ka kuorum. Urdhëroni z. Jonuzi

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Ju faleminderit kryetar. Më vjen keq prej asaj që e thotë Gazmendi në këtë Kuvend, por realiteti është krejt diçka tjetër. Ne si Komisioni Funksional mendoj se mjaft seriozisht dhe parimisht e kemi shqyrtuar këtë çështje në bazë të ligjit. Nuk e udhëheq vetëm pozita Komisionin Parlamentar, por participojnë të gjitha subjektet politike. Intervistimi është bërë. Aty kanë marrë pjesë edhe anëtarë tjerë të Komisionit Funksional. Unë e thashë fjalën time se unanimisht në Komision është bërë votimi i tyre. Nuk qëndron fakti se të gjithë janë të Gjilanit edhe kjo. Remzije Hajdari është e lindur në Kamenicë, e martuar në Mitrovicë dhe jeton në Prishtinë, prandaj nuk është nga Gjilani. Mustafë Hasani është nga Vitia, jeton në Ferizaj, Deniz Jonuzi është nga Gjilani, Hysni Terziu është në Ferizaj dhe Hydajet Hyseni është Gjilan. Do të thotë dy janë nga Gjilani, të tjerët nuk janë nga Gjilani. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni Gazmend

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Z. kryetar i Kuvendit, Kryesia ia ka kthyer Komisionit propozimin e parë që e ka ba pa e bërë intervistimin, edhe në momentin kur këta kanë bërë përzgjedhjen, edhe pse jonë kon të obligum me ligj me e ba, tuj i intervistua këta 10 kandidatë, vetëm për hir të pestë kandidatëve që kanë ra, ky Kuvend duhet me e anulua këtë konkurs se po shihet se kanë punuar kundër ligjit. A plus është ky problemi që të gjithë janë të regjionit të Gjilanit edhe nuk ashtë. Për me e ruajtur nivelin ky Kuvend duhet me ia kthye Komisionit edhe mu bë përzgjedhja prej fillimit.

KRYETAR KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Z. Xhemajli, urdhëroni.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Z. kryetar - a është më mirë me lënë për një seancë tjetër derisa të sqarohet kjo situatë këtu që u tha. Gjithashtu, nuk e di sa kam të drejtë me pyet Komisionin. A e ka pasur parasysh se unë nuk p i njoh këta kandidatë, por për njërin nga këta në internet e kam gjetur, në këtë Raportin për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të njeriut. Do me thënë, është i datës, jo po i muajit gusht 2002 në raport, nuk e di a e keni pas zotërinj të Komisionit parasysh. Këtu përmendet, me lejoni që ta lexoj: Dy udhëheqësit më të lartë të kësaj fabrike, do me thënë të kësaj të duhanit në Gjilan, Hysen Behxhetit dhe Deniz Jonuzit u është zgjatur paraburgimi edhe për dy muaj, ndërsa Gjykata e Qarkut në Gjilan ka angazhuar dy ekspertë vendorë për të bërë ekspertizën e gjendjes materialo-financiare, sepse këta janë të akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe pasurim të paligjshëm. Kisha dëshiruar prej Komisionit mu sqarua.

KRYETARI KOLË BERISHA – Sadudin Berisha e ka fjalën.

SADUDIN BERISHA - Meqë përmendet kandidati Deniz Jonuzi për kinse akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare, le ta shikojnë aktgjykimin e gjykatës kompetente se cili është përfundimi i saj? A është i shpallur fajtor, apo është i pafajshëm për akuza që i janë bërë?. Kujtoj se vendimi, aktgjykimi i gjykatës kompetente është valid dhe i besueshëm, andaj ne duhet t'i besojmë asaj e jo thash e thënave. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. Jonuzi, urdhëroni

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Ju faleminderit kryetar. Edhe një herë më duhet të sqarojë atë që përsëri u potencua çështja e intervistimit apo mos intervistimit nga Genci. Pas sugjerimit të Kryesisë së Kuvendit, Komisioni Funksional po e përsëris

edhe një herë e ka bërë intervistimin e 10 kandidatëve të mundshëm për anëtarë të Komisionit Kosovar të Konkurrencës. Po e them haptas se plotësisht është vlerësimi i drejtë se kanë qenë kandidatët më të mirë të mundshëm, kurse ato që e shtron z. Xhemajli, ne nuk kemi mundësi me qenë Komision Hetues a ka qenë dikush a s'ka qenë, por në bazë të rezultateve të treguara në intervistim të dëshmime të veta, që i kanë paraqitur, ne i kemi vendosur për pesë kandidatët në fjalë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar. Mua në këtë pjesë të mbledhjes më është përmendur shumë herë emri edhe tash nuk guxoj ta quaj replikë, por megjithatë më lejoni një sqarim. Hydajet Hyseni, që përmendet këtu është një tjetër Hydajet Hyseni dhe e them këtë edhe për opinionin që të mos ngatërrohet. Kurse një arsye tjetër për replikë ka qenë, është përmendur shpesh Gjilani dhe sipas një logjike këtu që po implementohet, po zbatohet, nëse përmendet edhe regjioni, ki të drejtë për replikë. Unë kam vë re vërtetë se ka shumë kandidatë nga Gjilani, nuk besoj se i ka fajet Gjilani, por ju siguroj që dy nga kandidatët që kanë mbetur pa përfshirë janë shumë të mirë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputetja Gjulshen Berisha.

DEPUTETJA GJULSHEN BERISHA – I nderuari kryetar, unë do të doja që të kalojmë, në qoftë se e kemi kuorumin në votim, sepse me të vërtetë e ndjeva vetëm pa keq kur z. Emrush i përmendi dy emrat të cilët kanë qenë në paraburgim në Gjilan. Njëri fatkeqësisht është i ndjerë tashmë, i cili ka pasur pasojat nga ai burgim i pavend dhe z. Emrush e di se çka është kur të akuzojnë, kur nuk je fajtor, i cili ka vetëm një banesë njëdhomëshe dhe sot ka problem për t'i shkolluar fëmijët e vet dhe ajo është akuza, apo mendoj shpërblimi për punën 30-vjeçare që e ka bërë në atë Kombinat, prandaj do të doja të kalojmë menjëherë në votim. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Në mungesë të kuorumit duhet ta ndërpresim sebatin rreth kësaj dhe votimi. E kemi edhe një pikë tjetër të rendit të ditës, ju lutem. Leqë edhe për pikën tjetër të rendit të ditës, natyrisht se lypet kuorumi për të votuar se nuk e kemi sonte, propozoj që kjo të mbetet për një mbledhje tjetër të ardhshme.

kaq përfundon seanca e sotme. Mirë u pafshim!

seanca përfundoi në orën 17,00.